



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Emergjenca shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës

Prishtinë, 2021

Përmbajtja

Parathënie	1
Metodologjia	2
Kompetenca e Avokatit të Popullit	3
I. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat e vendeve me demokraci të zhvilluara	4
Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut – Udhëzues për COVID- 19 dhe të drejtat e njeriut.....	5
Masat emergjente	5
Përfshirja e të gjithëve.....	5
II. Kufizimet e të drejtave të njeriut dhe legjislacioni në përgjithësi.....	8
Aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në nxjerrjen e vendimeve që ndërlidhen me pandeminë COVID-19	8
Komunikimi joadekuat i informacionit lidhur me pandeminë COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara	11
Aktivitetet në nxjerrjen e ligjeve që ndërlidhen me pandeminë COVID–19.....	12
Vlerësimi i Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID–19 në Territorin e Republikës së Kosovës	13
Vlerësimi i Ligjit nr. 07/L-015 për Rimëkëmbjen Ekonomike COVID-19.....	13
Vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit për Pakon Emergjente Fiskale dhe gjithëpërfshirjen e saj	14
III. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në shëndetin publik.....	17
Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar dhe Inspektorati Shëndetësor	19
Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë (IKShPK).....	19
Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës.....	20
Sindikata e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës.....	20
Qytetarët të infektuar me COVID-19.....	20
Rregullat e transportit dhe të varrimit për personat e vdekur nga COVID-19.....	21
Kujdesi shëndetësor i personave me aftësi të kufizuar gjatë COVID-19 dhe masat e izolimit social.....	22
IV. Shëndeti mendor dhe ndikimi i pandemisë COVID-19.....	25
Shëndeti mendor gjatë pandemisë së COVID-19 në botë: të drejtat e njeriut në kontekst	25
Shëndeti mendor në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19: të drejtat e njeriut në kontekst.....	27
Prevalenca e çrregullimeve të shëndetit mendor në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19.....	28
Përgjigjet e institucioneve publike të shëndetit mendor gjatë pandemisë.....	29
Indikatorët nga raportet e punës së QShM-ve.....	31
Ndikimi i pandemisë në shëndetin mendor të popullatës.....	32

Vështirësitë që i kanë përjetuar personat me çrregullime mendore gjatë pandemisë sipas perceptimit të punëtorëve shëndetësorë	33
Përvojat e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë.....	34
Ndihma psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19.....	39
Qasja në informacione e personave me aftësi të kufizuar gjatë COVID-19	39
V. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (funksionimi i sistemit: gjyqësor, prokurorial, veprimet e policisë në shqiptimin e gjobave, procedura kundërvajtëse gjatë pandemisë COVID 19 në Kosovë)	41
Ndikimi i pandemisë në funksionimin e sistemit gjyqësor	42
Ndikimi i pandemisë në funksionimin e sistemit prokurorial	43
Ndikimi i pandemisë në funksionimin e Policisë së Kosovës.....	44
Ndikimi i pandemisë në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	45
VI. Të drejtat e komuniteteve joshumicë dhe ndikimi i pandemisë Covid-19.....	51
Informimi i komuniteteve joshumicë lidhur me pandeminë Covid-19	51
Ndihma ekonomike - procedurat për qasje në paketën fiskale emergjente.....	53
Qasja në arsim dhe në shërbimet shëndetësore	55
VII. Të drejtat e personave të privuar nga liria dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, nga këndvështrimi i MKPT-së	57
Kufizimi i të drejtave dhe i lirive në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit.....	58
Kufizimi i të drejtave dhe i lirive në institucionet e menaxhuara nga Ministria e Punëve të Brendshme.....	59
Përdorimi i Qendrës së Mbajtjes për të Huajt si karantinë pas paraqitjes së COVID-19	59
Qendra Studentore në Prishtinë e përdorur si karantinë.....	59
Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit	60
Sfidat e organeve kompetente për të kryer punën gjatë COVID-19	60
Kufizimi i të drejtave dhe i lirive themelore të personave të privuar nga liria e tyre në kuptim të standardeve ndërkombëtare	61
VIII. Ndikimi i pandemisë në të drejtat sociale dhe ekonomike dhe në të drejtën e punës në sektorin publik dhe privat.....	66
Korniza ligjore lidhur me të drejtat ekonomike dhe sociale	67
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës	68
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës në Kosovë	68
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në varfëri	69
Të drejtat ekonomike dhe sociale dhe e drejta e punës	70
Të drejtat e punëtorëve shëndetësorë	72
Administrata Tatimore e Kosovës.....	73
E drejta për qasje në kursimet pensionale	74
Shtyrja e kredive nga bankat komerciale	76
Të drejtat e konsumatorit.....	78

Të drejtat ekonomike të bizneseve	81
Të drejtat ekonomike të grave në biznes	83
Vonesat, zvarritja e pagesave të masave mbështetëse të qeverisë	84
Pensionet, përfitimet sociale dhe përfitimet e veçanta gjatë COVID-19 për personat me aftësi të kufizuara.....	87
IX. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe përgjegjësia për mjedisin jetësor	88
Vendimet e Qeverisë për parandalimin e pandemisë COVID-19 dhe ndikimi i tyre në mjedis	90
Ligjet dhe aktet nënligjore të planifikuara dhe të miratuara gjatë periudhës së pandemisë që trajtojnë çështje të mjedisit.....	91
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në qasjen në informata	91
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje	92
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në qasjen në drejtësi për çështje mjedisore.....	93
Mbikëqyrja inspektuese.....	93
Operimi i minierave	94
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në menaxhimin e mbeturinave.....	95
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në cilësinë e ajrit	95
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ujërat	96
X. Dhuna në familje gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë	97
Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV).....	101
XI. Liria e tubimit, liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, si dhe kufizimet e këtyre të drejtave gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë.....	101
Liria e tubimit.....	101
Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë	104
XII. Liria e shprehjes, liria e mediave, e drejta e privatësisë dhe të drejtat zgjedhore gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë	106
Liria e shprehjes dhe liria e mediave.....	106
Kufijtë dhe kufizimet e lirisë së shprehjes duke mos cenuar të drejtat e njeriut	107
Udhëzuesit ndërkombëtarë për ruajtjen e lirisë së shprehjes gjatë pandemisë	109
Zhvillimet gjatë kësaj periudhe sa u përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave	112
Liria për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide	117
Siguria e gazetarëve	121
E drejta e privatësisë gjatë pandemisë COVID-19.....	123
Zhvillimet gjatë kësaj periudhe sa i përket së drejtës së privatësisë.....	125
Të drejtat zgjedhore në periudhën e pandemisë COVID-19	129
XIII. Të drejtat e fëmijëve, ndikimi i emergjencës shëndetësore në jetën e fëmijëve, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe vështirësitë e hasura gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë	131
Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve	131

E drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim.....	133
E drejta për shërbime shëndetësore dhe sociale	136
Shërbimet Shëndetësore.....	137
Vizitat dhe intervistat e realizuara nga IAP-ja.....	138
Shëndeti mendor	139
Shërbimet sociale	140
E drejta për mbrojtje nga dhuna	141
Privimi nga liria	142
Mbrojtja e fëmijës pa përkujdesje prindërore	143
Vizitat dhe intervistat e realizuara nga IAP-ja.....	144
XIV. E drejta për arsim dhe për aktivitete kulturore gjatë pandemisë.....	147
Vendimet e Qeverisë lidhur me sektorin e arsimit në Kosovë gjatë pandemisë.....	149
Vizitat dhe intervistat e realizuara nga IAP-ja.....	153
Arsimi parauniversitar	157
Trajtimi i nxënësve me aftësi të kufizuara.....	158
Trajtimi i personave në vuajtje të dënimit	160
Arsimi i lartë	160
Kultura, rinia dhe sporti	161
XV. Rekomandimet e Avokatit të Popullit	162


Parathënie

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në mars të vitit 2020 vlerësoi se përhapja e virusit COVID-19 po kalonte në nivel pandemie. Pas këtij vlerësimi, shumë shtete e konsideruan të domosdoshme ndërmarrjen e masave kufizuese, kryesisht ndaj lëvizjes së qytetarëve, me qëllim parandalimin e përhapjes së shpejtë të virusit. Në këtë situatë u përfshi edhe Kosova, ku pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19, më 13 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ndërmori disa masa si përgjigje ndaj situatës pandemike, të cilat më pas u hoqën, u rivendosen dhe u modifikuan në disa raste, për të qenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Është e kuptueshme që pandemia e shkaktuar nga COVID-19 përbën kërcënim për shëndetin publik në përgjithësi dhe për të drejtat e njeriut në veçanti, siç është e drejta për jetën, dhe ekziston një lidhje racionale mes përgjegjësive që ka qeveria në mbrojtjen e shëndetit publik dhe luftimin e pandemisë dhe rrezikun me të cilin përballen qytetarët. Mirëpo, sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, qeveritë e kanë edhe përgjegjësinë për të treguar se çdo kufizim që vendosin mbi të drejtat e njeriut duhet të jetë i balancuar dhe proporcional me kërcënimin real që u kanoset qytetarëve. Çdo masë e aplikuar, e cila i kufizon të drejtat, duhet të synojë arrirjen e një qëllimi legjitim, e që kjo është e nevojshme të demonstron fuqishëm.

Nga këndvështrimi i Avokatit të Popullit, Raporti vlerëson ndikimin e COVID-19 në të drejtat themelore të qytetarëve dhe aplikimin e masave qeveritare për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Në këtë drejtim, ky raport trajton ndikimin e këtyre masave, në veçanti kufizimet e të drejtave të njeriut dhe legjislacionin në përgjithësi; ndikimin e pandemisë në shëndetin publik, në shëndetin mendor; ndikimin e pandemisë në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; të drejtat e personave të privuar nga liria; të drejtat ekonomike dhe sociale; të drejtën e punës dhe ndikimi i pandemisë në sektorin publik dhe privat; mjedisin jetësor; dhunën në familje; lirinë e tubimit, besimit e ndërgjegjes dhe e fesë si dhe kufizimet e këtyre të drejtave; lirinë e shprehjes, lirinë e mediave; të drejtën e privatësisë dhe të drejtat zgjedhore; të drejtat e fëmijëve dhe ndikimi i emergjencës shëndetësore në jetën e fëmijëve, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara; të drejtën për arsim dhe aktivitete kulturore si dhe analizimin e standardeve ndërkombëtare dhe të praktikave të vendeve me demokraci të zhvilluara.

Ky raport pasqyron gjendjen e të drejtave të njeriut në situatë emergjente e shkaktuar nga pandemia COVID-19, për periudhën mars 2020 deri në shtator 2021, dhe reflekton qëndrimet e Avokatit të Popullit të shprehura nëpërmjet rekomandimeve, të cilat u adresohen autoriteteve publike me qëllim që në të ardhmen të respektohen standardet për të drejtat e njeriut në secilën masë kufizuese që mund të vendoset në situata emergjente.


Naim Qelaj
Avokat i Popullit

Metodologjia

Raporti mbështetet në të dhëna cilësore dhe sasiore të mbledhura nëpërmjet një qasjeje të metodave të kombinuara. Varësisht prej temave që trajton raporti, është përzgjedhur edhe metodologjia e punës. Duke qenë se në këtë raport trajtohet ndikimi i COVID-19 në aspektet e ndryshme të të drejtave të njeriut, dhe se në hartimin e këtij raporti kanë kontribuar një numër relativisht i madh i zyrtarëve dhe hulumtuesve, janë përdorur metodologji të ndryshme të hartimit dhe të hulumtimit.

Përveç të tjerash, Raporti bazohet në analizën e legjislacionit, të vendimeve të marra nga qeveria, veprimeve të autoriteteve, analizës së konventave ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë, rasteve që janë trajtuar në institucion, intervistave të realizuara, të dhënave të nxjerra nga raportet e institucioneve relevante, posaçërisht të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Disa të dhëna janë rezultat i pyetësorëve, nëpërmjet të cilëve është synuar që të krijohet një pasqyrë me e qartë e veprimeve të ndërmarra nga autoritetet si dhe të marrim perceptimin e përgjithshëm qytetar për veprimet e autoriteteve në raport me ndërmarrjen e masave.

Pyetësori është përdorur me qëllim të pozitës së personave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë dhe të masave të përgjithshme dhe të veçanta të ndërmarra për t'i mbrojtur personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë. Pyetësori ka targetuar institucionet e nivelit lokal e qendror si dhe OJQ-të që merren me trajtimin e çështjeve të kësaj natyre. Po ashtu pyetësori është përdorur edhe me qëllim të vlerësimit të ndikimit të pandemisë në shëndetin mendor dhe në mirëqenien psiko-sociale tek popullata e përgjithshme. Ky pyetësor është përbërë nga pjesa e përgjithshme si dhe nga pjesa tjetër e përshtatur nga pyetësori Inventari i Shëndetit Mendor, i autorëve Weit & Vare, dhe është realizuar nëpërmjet rrjeteve sociale dhe nëpërmjet grupit hulumtues.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.” Ndërsa në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.” Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (*ex officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” (neni 16, paragrafi 4);
- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);
- “t’u rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i përmbushë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

I. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat e vendeve me demokraci të zhvilluara

Analizimi i standardeve ndërkombëtare dhe i praktikave të mira të të drejtave të njeriut luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e rrugës për mënyrat se si shtetet duhet të reagojnë gjatë emergjencave shëndetësore kombëtare. Ato sigurojnë një kornizë unike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut duke i udhëzuar shtetet drejt një reagimi, i cili merr për bazë perspektivën e të drejtave të njeriut, në çdo kufizim apo shmangie që u bënë këtyre të drejtave, të cilat janë të garantuara me ligje vendore, por edhe me të drejtën ndërkombëtare.

E drejta për standard më të lartë të arritshëm të shëndetit është një e drejtë e njeriut, e njohur në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e konsideruar si instrumenti kryesor i mbrojtjes së të drejtës së shëndetit, njeh: *“Të drejtën e të gjithëve në gëzimin e standartit më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor.”* Në nenin 12, paragrafi 2.3, në mënyrë që të arrihet realizimi i kësaj të drejte, Konventa i obligon shtetet që të ndërmarrin hapa për: *“Parandalimin, trajtimin dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe sëmundje të tjera.”*¹

Sipas Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht Komitetit të Përgjithshëm nr. 14: *“Shëndeti është një e drejtë themelore e njeriut e domosdoshme për ushtrimin e të drejtave të tjera të njeriut. Çdo qenie njerëzore ka të drejtë të gëzojë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit të favorshëm për të jetuar një jetë me dinjitet.”*² Rrjedhimisht, kjo e drejtë nuk mund të shikohet si e ndarë, por e lidhur ngushtë edhe me realizimin e të drejtave të tjera, siç janë: *“E drejta për ushqim, strehim, punë, arsim, dinjitet njerëzor, jetë, mosdiskriminim, barazi, ndalimi i torturës, privatësia, qasja në informacion, dhe liritë e asociimit, tubimit dhe lëvizjes. Këto dhe të drejta të tjera dhe liritë adresojnë përbërësit thelbësor të së drejtës për shëndetin.”* Rrjedhimisht, e drejta në shëndet duhet të jetë bazamenti i përgjigjes së shteteve në luftën ndaj pandemisë COVID-19.

*Parimet e Sirakuzës*³ për kufizimin dhe shmangien nga dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, e miratuara nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, ofron udhëzime të qarta lidhur me veprimet e qeverive në kufizimin e të drejtave të njeriut në rastet e emergjencave kombëtare apo të shëndetit publik. Sipas tyre, masat e ndërmarrja për mbrojtjen e popullsisë, të cilat kufizojnë të drejtat e garantuara, duhet të jenë të ligjshme, të domosdoshme dhe proporcionale. Shtetet duhet ta kenë parasysh që gjendja e emergjencës të jetë e kufizuar në kohë dhe çdo kufizim i të drejtave të marrë në konsideratë ndikimin joproporcional në popullata specifike ose në grupe të cënueshme.

Organizata të ndryshme botërore, që prej shfaqjes së pandemisë, janë angazhuar jashtëzakonisht shumë për hartimin e udhëzimeve adekuate për shtetet, në mënyrë që masat

¹ Kombet e Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 12 (linku: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx>).

² Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i Kombeve të Bashkuara, Komenti i Përgjithshëm nr. 14 lidhur me standardin më të lartë të arritshëm.

³ Parimet e Sirakuzës për kufizimin dhe shmangien nga dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, 1985, <https://www.icj.org/wp-content/uploads/1984/07/Siracusa-principles-ICCPR-legal-submission-1985-eng.pdf>

dhe kufizimet e ndërmarra të mos i shkelin të drejtat e njeriut. Këto udhëzime duhet të jenë pikë reference për çdo veprim që duhet të ndërmerret, në mënyrë që të mos shkelen garancitë themelore të të drejtave të njeriut.

Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut – Udhëzues për COVID- 19 dhe të drejtat e njeriut

Më 20 prill 2020, Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut publikoi Udhëzuesin për COVID-19, i cili përfshinë udhëzime për shtetet sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut në periudhën e përbaljes me emergjencën shëndetësore të shkaktuar nga COVID-19.⁴ Sipas tij: *“Respektimi i të drejtave të njeriut në mbarë spektrin, duke përfshirë të drejtat ekonomike dhe sociale, të drejtat civile dhe politike, duhet të jetë thelbësor në suksesin e reagimit për shëndetin publik.”*

Masat emergjente

Ky udhëzues sa u përket masave emergjente, ndër të tjera, këshillon: *“Masat që kufizojnë të drejtat e njeriut duhet të jenë në proporcion me rrezikun e vlerësuar, të jenë të nevojshme dhe të zbatueshme në mënyrë jodiskriminuese,[...] ato duhet të kenë një fokus dhe kohëzgjatje specifike, duke përdor qasjen sa më pak të bezdisshme të mundshme për mbrojtjen e shëndetit publik.”* Ai gjithashtu rikujton se disa të drejta nuk mund të kufizohen madje as gjatë një gjendje emergjente (të drejta të pacenueshme), duke përfshirë: *“Parimin e mos dëbimit, ndalimin e largimit kolektiv, ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit, të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjen dhe fesë dhe të tjera.”*⁵

Përfshirja e të gjithëve

Sipas udhëzuesit, ka individë të cilët janë të marginalizuar dhe përballen me vështirësi lidhur me qasjen në informacione dhe në shërbime publike, duke u përballur me diskriminim të thellë, prandaj qeveritë, në përpjekjet e tyre për reagim, duhet të kenë: *“Kujdes të veçantë në identifikimin e njerëzve të cilët mund të jenë në rrezik të anashkalohen ose të përjashtohen, siç janë pakicat kombëtare, etnike apo religjioze, emigrantët, personat e zhvendosur dhe refugjatët, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, personat e komunitetit LGBTI ose ata të prekur nga varfëria ekstreme.”* Në këtë çështje rol të rëndësishëm i jepet Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, siç është edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, por edhe shoqërisë civile, të cilat mund të ndihmojnë në *“identifikimin e njerëzve të cilët ka gjasa të anashkalohen apo të përjashtohen, duke mbështetur bartjen e informacioneve tek këto grupe, dhe duke u siguruar informacione autoriteteve mbi ndikimin e masave tek këto komunitete”*⁶, gjë të cilën do ta synojë edhe ky raport.

Sistemi i Kombeve të Bashkuara, i cili përfshin edhe Zyrën e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe Reporterët Specialë, bëjnë thirrje për shtetet që të sigurohen që të drejtat ndërkombëtare të njeriut të jenë në qendër të veprimeve dhe të përgjigjeve të tyre ndaj COVID-

⁴ Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, *“Udhëzues për COVID-19”*, (linku: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/alb_ohchr_covid-19_guidance.pdf)

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

19. Për këtë qëllim ata në Raportin “COVID-19 dhe të drejtat e njeriut⁷” kanë listuar disa rekomandime për shtetet, e ne më poshtë po i përmendim ato më të rëndësishmet:

Përdorimi maksimal i burimeve në dispozicion në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar dispozicionin, qasjen dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor si e drejtë njerëzore për të gjithë, pa diskriminim, duke përfshirë çështjet që nuk ndërlidhen me infeksionin me COVID-19; dhe të sigurojë që e drejta për jetë është e mbrojtur gjatë gjithë kohës.

Të sigurohen që pakot stimuluuese dhe veprimet e tjera për t’i zbutur ndikimet ekonomike të pandemisë janë të përqendruara në të drejtat e njeriut dhe mbështetin në mënyrë adekuate grupet më të prekura nga humbja e mjeteve të jetesës, si p.sh.: punëtorët informalë dhe të pavarur pa qasje në përfitimet e papunësisë, dhe në përgjithësi njerëz dhe grupe pa qasje në rrjetet e sigurimeve shoqërore.

Të sigurohen se veprimet e tyre kombëtare dhe lokale, si dhe planet e rimëkëmbjes vendosin masa që adresojnë ndikimin joproporcional të virusit në disa grupe dhe individë, përfshirë migrantët, personat e zhvendosur dhe refugjatët, njerëzit që jetojnë në varfëri, ata pa qasje në ujë, në higjienë ose në banesa të përshtatshme, personat me aftësi të kufizuara, gratë, persona të moshuar, personat LGBTI, fëmijët dhe njerëzit në paraburgim.

Të sigurohen që informacioni i saktë dhe i besueshëm i arrin të gjithë, duke e bërë atë qasshëm në formate dhe gjuhë lehtësisht të kuptueshme, përfshirë gjuhët autoktone dhe ato të pakicave, duke përshtatur informacionin për njerëzit me nevoja specifike, përfshirë personat me shikim dhe dëgjim të dobësuar, dhe qasja e atyre me aftësi të kufizuar për të lexuar, ose ata që nuk kanë qasje në internet dhe në burime të zakonshme mediale.

Ta garantojnë lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë e mediave, në mënyrë që informacioni që shpërndahet të jetë i pacensuruar.

Të sigurohen që masat emergjente, duke përfshirë ato për gjendjen e jashtëzakonshme, janë të ligjshme, proporcionale, të domosdoshme dhe jodiskriminuese, dhe kanë fokus specifik dhe kohëzgjatje dhe marrin për bazë një qasje sa më pak ndërhyrëse për mbrojtjen e shëndetit publik.

Të sigurohet që masat mbrojtëse ku përdoren teknologjitë e reja të mbikëqyrjes në përgjigje të autoriteteve të COVID-19, të përfshijnë respektimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave.

Të zbusin ndikimin e krizës tek gratë dhe vajzat, duke përfshirë qasjen e tyre në të drejtat për shëndetin seksual dhe riprodhues, mbrojtje nga dhuna në familje dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, të sigurojnë përfaqësimin e tyre të plotë dhe të barabartë në të gjitha vendimmarrjet afatshkurtra, zbutjen dhe rimëkëmbjen afatgjate.

Të ndërmarrin masa për lehtësimin e situatës me grupet e cenueshme, përfshirë migrantët dhe refugjatët, jashtë vendit të tyre të origjinës, në veçanti duke dhënë qëndrim të përkohshëm për migrantët, duke vendosur moratorium në depertimet dhe kthimet me forcë, dhe të sigurohen që individët janë në gjendje të kthehen në shtëpi vullnetarisht, të sigurt dhe me dinjitet.

⁷ Kombet e Bashkuara, “COVID- 19 dhe të drejtat e njeriut”, prill 2020, faqe 21-22, (linku: https://www.un.org/victimsofterrorism/sites/www.un.org.victimsofterrorism/files/un_-_human_rights_and_covid_april_2020.pdf)

T'i marrin mësimet e nxjerra nga kjo pandemi për të rifokusuar veprimet për t'i dhënë fund varfërisë dhe pabarazisë si dhe adresimin e shqetësimeve themelore të të drejtave të njeriut që na kanë lënë të cenushtëm nga pandemia dhe në masë të madhe kanë përkeqësuar efektet e saj, me qëllim të ndërtimit të një bote më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

II. Kufizimet e të drejtave të njeriut dhe legjislacioni në përgjithësi

Aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në nxjerrjen e vendimeve që ndërlidhen me pandeminë COVID-19

Më 31 janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli gjendjen e emergjencës shëndetësore globale, për shkak të përhapjes së këtij virusi me ritme tejet të shpejta. Më pas, si pasojë e përhapjes së tij me ritme e pasoja të paparashikuara, më 11 mars 2020, OBSH-ja shpalli gjendjen e pandemisë botërore.⁸

Më 13 mars 2020 u konfirmuan dy rastet e para me COVID-19 në Kosovë dhe si rrjedhojë Qeveria e Republikës së Kosovës filloi marrjen e masave të para për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. U vendosën në karantinë komunat e para, gjithashtu u pezullua trafiku ndërrurban dhe ndërkombëtar, u mbyllën kafenetë, baret, restorantet, qendrat tregtare, aktivitetet sportive dhe kulturore, institucionet shkollore dhe universitare, institucionet publike reduktuan stafin në listën e personave esenciale dhe ato private u urdhëruan ta organizonin punën nga shtëpia.

Përkritazi me këtë çështje, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/07, i datës 11 mars 2020, ka ndërprerë procesin edukativo – arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në tërë territorin e Republikës së Kosovës, deri më 27 mars 2020. Po ashtu me këtë vendim është bërë kufizimi i aktiviteteve publike dhe private, si dhe është ndaluar transporti i organizuar ndërkombëtar.

Më 12 mars Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/08, ka formuar Komisionin e Posaçëm për Parandalim të Infeksionit COVID-19. Sipas këtij vendimi, Komisioni ka për detyrë ta menaxhojë procesin e parandalimit të infeksionit COVID-19 [...]. Pra, vërehet që me këtë vendim është krijuar një organ i posaçëm me të cilin është mundësuar menaxhimi i procesit për parandalimin e infektimit me COVID-19.

Më 13 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin nr. 01/09, me të cilin ka vendosur që të ndalohen hyrjet-daljet në komunën e Klinës dhe të Vitisë. Po ashtu me këtë vendim është ndërprerë transporti ndërrurban në Republikën e Kosovës si dhe transporti i organizuar ndërkombëtar. Janë mbyllur kafenetë, baret, pabet, restorantet dhe qendrat tregtare, me përjashtim të farmacive dhe marketeve ushqimore, janë pezulluar të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive e po ashtu janë mbyllur tregjet e kafshëve dhe të automjeteve.

Lidhur me këtë çështje, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/11, i datës 15 mars 2020, ka shpallur emergjencën e shëndetit publik.

Më 23 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/15, ka ndaluar qarkullimin e qytetarëve dhe të automjeteve private nga data 24 mars 2020, gjatë orës 10 :00 – 16:00 dhe prej orës 20:00 – 06:00. Po ashtu janë ndaluar tubimet në të gjitha mjediset private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura [...].

Ky vendim ka aktivizuar edhe Gjykatën Kushtetuese të vendit, e cila më 31 mars 2020 njoftoi se ka marrë Aktgjykim në rastin KO 54/20 (i cili hyri në fuqi më 13 prill 2020), në rastin e ngritur nga presidenti i Republikës së Kosovës, përkritazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së

⁸ Jamie Ducharme, “Organizata Botërore e Shëndetësisë shpall COVID-19 ‘Pandemi’: ‘Ja çfarë nënkupton’”, Revista Time, Mars 2020, (linku: <https://time.com/5791661/who-coronavirus-pandemic-declaration/>)

Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 23 mars 2020, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendonte se nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe me nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Çështja kushtetuese që ngërthen ky rast ishte përputhshmëria e Vendimit të kontestuar të Qeverisë me Kushtetutën, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tij qeveria kishte kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara apo kishte dalë përtej autorizimeve të përcaktuara me ligj.⁹

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese kishte gjetur se Vendimi i qeverisë nuk ishte në përputhshmëri me nenin 55 (Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore) të Kushtetutës, në lidhje me nenet: 35 (Liria e Lëvizjes), 36 (E drejta për privatësi), 43 (Liria e Tubimit) të Kushtetutës dhe me nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4, me nenin 8 (E drejta për jetë private dhe familjare) dhe me nenin 11 (Liria e tubimit dhe asociimit) të KEDNj-së, prandaj kishte vendosur që i njëjti të shfuqizohej. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij rasti konstatoi se kufizimet që përmban vendimi i kontestuar i qeverisë përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të lartcekura, nuk janë të “përcaktuara me ligj”, andaj bien në kundërshtim me garancitë që përmbajnë nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në lidhje me nenet respektive të KEDNj-së, dhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili në paragrafin e tij të parë përcakton qartë se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj.

Për më shumë, Gjykata theksoi faktin që vendimi i kontestuar i qeverisë i referohej zbatimit të të dy ligjeve, të cilat e autorizonin MSh-në që të ndërmerre masa të caktuara në ato ligje me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse, por nuk e autorizonin qeverinë që t’i kufizonte të drejtat dhe liritë kushtetuese në nivel të tërë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa përjashtim.¹⁰ Pra, Gjykata sqaroi se qeveria nuk mund ta kufizonte asnjë të drejtë dhe liri themelore përmes vendimeve, nëse një kufizim i së drejtës përkatëse nuk është paraparë me ligj të Kuvendit.¹¹ Prandaj në frymën e këtij vendimi precizohet se qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës. Pra, duke marrë parasysh faktin se Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, si grupe të njëshme i përcakton familjet një prindërore, fëmijët jetim, të varfrit ekstrem, viktimat e trafikimit, të sëmurët kronikë, të moshuarit, të burgosurit, të pastrehët, përdoruesit e drogës me injektim, të sëmurët mentalë etj., autoritetet shëndetësore do të duhej t’i vënin në fokus të trajtimit së paku disa kategori personash.

⁹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykim në rastin KO54/20, 31 marsit 2020, publikuar më 6 prill 2020, Nr. ref.:AGJ 1543/20 (linku: <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-nr-01-15-te-qeverise-se-republikes-se-kosoves-te-23-marsit-2020/>)

¹⁰ Po aty.

¹¹ Gjykata sqaroi se termi “kufizim” i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të kufizojë të drejta dhe liri themelore, përmes ligjit, por vetëm për aq sa dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, duke precizuar se “kufizimi” nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes dhe kjo mund të bëhet edhe pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme; ndërkaq “shmangia” nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes, ngase nuk mund të bëhet kurrsesi pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme.

Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit, më 27 mars 2020, ia ka dërguar Gjykatës Kushtetuese Opinion, me të cilin ka shprehur qëndrimet e tij lidhur me këtë çështje.

Përderisa Gjykata Kushtetuese ishte duke vlerësuar kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 1/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 27 mars 2020 qeveria ka nxjerrë Vendim nr. 02/17, me të cilin ka ndërmarrë masa parandaluese me qëllim të parandalimit dhe të mospërhapjes së virusit COVID-19, duke ndaluar qarkullimin e qytetarëve dhe të automjeteve private gjatë orës 17:00-06:00, përveç nevojave mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë) dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlihen me menaxhim të pandemisë. Po ashtu me këtë vendim qeveria ka ndaluar qarkullimin e qytetarëve në zonat (sheshet) e hapura të qyteteve të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit, duke u bazuar edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ka vërejtur se Qeveria e Republikës së Kosovës, deri para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin e COVID-19, nuk e ka pasur një bazë të qartë ligjore pavarësisht ekzistimit të Ligjit nr. 02/109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

Mirëpo Avokati i Popullit ka vërejtur se pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Parandalimin COVID-19, më 25 gusht 2020, është krijuar baza ligjore sipas kërkesës së Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet së cilës është bërë i mundur kufizimi i lirive dhe i të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Njëkohësisht Avokati i Popullit ka vërejtur se Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdimisht ka nxjerrë vendime me të cilat ka ndërmarrë masa proporcionale me situatën e krijuar, me qëllim të mbrojtjes nga pandemia COVID-19.

Zyra e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në udhëzuesin për të ndaluar përhapjen e COVID-19, publikuar më 20 prill 2020, ndër të tjerash bën thirrje për sigurimin e informimit të saktë për pandeminë COVID-19:

“Informacionet relevante për pandeminë COVID-19 duhet të arrijnë tek të gjithë njerëzit, pa përjashtim. Kjo kërkon që informacionet të jenë të disponueshme në formate dhe gjuhë lehtësisht të kuptueshme, duke përfshirë edhe gjuhët vendëse dhe ato të pakicave nacionale, etnike dhe religjioze, dhe informacionet të përshtaten për njerëzit me nevoja të veçanta, duke përfshirë ato me dëmtime të shikimit dhe dëgjimit, dhe të arrijnë tek ata të cilët kanë pak apo aspak aftësi për të lexuar apo që nuk kanë qasje në internet.”

Me shpalljen e gjendjes tremujore të emergjencës së shëndetit publik, në mes të marsit 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi masa të menjëhershme që synonin parandalimin e përhapjes së virusit. Shpërndarja e informacionit në lidhje me situatën pandemike COVID-19 në përgjithësi, dhe masat e miratuara në veçanti, u karakterizua me mangësi në përkthim në gjuhët e komuniteteve joshumicë, që predispononin keqinterpretim dhe krijonin pasiguri midis anëtarëve të komuniteteve joshumicë që nuk e kuptonin gjuhën e komunitetit të shumicës. Çështjet e shpërndarjes së informacionit, megjithëse me larmi si dukuri, u vunë re si në autoritetet e nivelit qendror dhe lokal, ashtu edhe në mediat e Kosovës në gjuhët serbe dhe boshnjake.

Në këtë mënyrë, pas ankimimit që kishte të bënte me dështimin e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) për t'i informuar qytetarët në gjuhën serbe lidhur me pandeminë përmes ueb-faqes së tyre zyrtare në

internet,¹² IAP-ja u rekomandoi të dy autoriteteve, në pajtim me nenin 5 (paragrafi 1) të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, t'i informonin qytetarët dhe publikun përmes ueb-faqeve të tyre në internet në të dy gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.¹³ Më 15 prill 2020, respektivisht më 17 prill 2020, edhe IKShPK-ja edhe MSh-ja iu përgjigjën IAP-së. Ata shpjeguan: komunikimet e tyre bëhen në të dy gjuhët zyrtare; në komunikim medial ata përgjigjen në gjuhën serbe sa herë që pyetjet bëhen në gjuhën e tillë; rrjetet e tyre sociale/profili në Facebook përmban informacion në shqip, serbisht dhe anglisht; dhe se ata bëjnë çka është e mundur dhe se shumicën e informacioneve në lidhje me COVID-19 e kanë të qasshëm në të dy gjuhët, duke shtuar se faqja e MSh-së në internet ishte rirregulluar së fundmi dhe po mbushej gradualisht me informacione.¹⁴ Megjithëkëtë, autoritetet thanë se për shkak të situatës urgjente të pandemisë, ata përballen me mungesë të stafit të mjaftueshëm, andaj u shprehën të hapur për asistencë në përkthime nga cilido qoftë institucion. IAP-ja më pas vërejti përmirësim të përkthimeve.¹⁵

Masat e kufizimeve të lëvizjes për qytetarët, të prezantuara në prill 2020, ndër të tjera, parashihnin që nën kushte saktësisht të përcaktuara, qytetarët lejoheshin të lëviznin jashtë shtëpisë së tyre gjatë 90 minutave. Shpërndarja e informacionit për këto masa u karakterizua nga dy të meta kryesore. Së pari, informacioni për masat e paraqitura nga autoritetet në portalet e internetit dhe në rrjete sociale i la qytetarët të paqartë nëse numri përkatës përcaktonte kohën e lëvizjes së lejuar prej 90 minutash, referuar numrit të identitetit ose numrit të kartës së identitetit, dhe nëse numri përfundimtar ose i parafundit ishte përcaktues për lëvizje. Së dyti, autoritetet dështuan të botonin me kohë informacionin e fundit edhe në gjuhën serbe, duke lënë kështu anëtarët e komunitetit joshumicë të varur nga marrja e informacionit nga burime jozyrtare ose të varur nga të njohurit e tyre që flasin gjuhën shqipe.

Komunikimi joadekuat i informacionit lidhur me pandeminë COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara

Avokati i Popullit rithekson rëndësinë e së drejtës për qasje në informim, sidomos gjatë pandemisë COVID-19, veçmas për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht për ata me dëmtime të shikimit dhe të dëgjimit për t'u informuar rreth situatës me pandeminë COVID-19. Për kategorinë e personave të verbër, Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës, në qershor të vitit 2020 ka reaguar për shkak se deri atëherë nuk ishte shtypur asnjë informacion me shkrim për mbrojtje nga pandemia-COVID-19 në alfabetin Brail¹⁶ dhe ka bërë thirrje të zbatohet plotësisht Ligjit nr. 04/L -092 për Personat e Verbër.

Avokati i Popullit rikujton se Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 2 të saj, definon termin “Gjuhë”, që përfshin: “Gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave si dhe forma të tjera të gjuhës jo-të folur.” Termi: “Diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar”,

¹² Ankesa Nr.250/2020, Z. V. kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetësisë Publike të Kosovës, 15 prill 2020.

¹³ Po aty.

¹⁴ Divizioni i Komunikimit me Publikun, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Ref. Nr. 280/2020, 17/04/2020. Shih poashtu Përgjigja ndaj Ankesës Nr. 250/2021, Instituti i Shëndetësisë Publike i Kosovës, 15/04.2021.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Portali Zëri: “Asnjë informacion për mbrojtje nga COVID-19 nuk është shtypur për të verbërit”, 18 qershor 2020, i qasshëm në: <https://zeri.info/aktuale/353760/asnje-informacion-per-mbrojtje-nga-covid-19-nuk-eshte-shtypur-per-te-verberit/>

që do të thotë gfarëdo dallimi, përjashtimi ose kufizimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar që ka për qëllim ose që ndikon në dëmtimin ose anulimin e njohjes, të gëzimit ose të ushtrimit, në mënyrë të barabartë me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në cilëndo fushë tjetër.” Më 29 shtator 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte marrë Vendimin nr. 06/146, me të cilin kishte zyrtarizuar Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës¹⁷ dhe Rregulloren QRK nr. 15\2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës.¹⁸

Nga se u tha më lart, Avokati i Popullit e sheh tejet të rëndësishme dhe gjithashtu të drejtë themelore të njeriut sigurimin e informimit të saktë dhe të plotë në gjuhën amtare për të gjitha kategoritë të personave me aftësi të kufizuara, qoftë nëpërmjet shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, nëpërmjet shërbimeve të shtypit apo në ndonjë formë tjetër të përshtatshme, sidomos në një situatë pandemie ku rrezikohet shëndeti i gjithsecilit. Avokati i Popullit rikujton se Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duke u bazuar në mandatin dhe në kompetencat ligjore, është i autorizuar ligjërisht të ndikojë në ofruesit e shërbimeve audiovizuale drejt përmbushjes të së drejtës së informimit për grupet e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara duke iu përshtatur diversitetit. Ligji nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në nenin 34, shprehimisht përcakton: *“KPM-ja do të inkurajojë ofruesit e shërbimeve audiovizuale që të sigurojnë që shërbimet e tyre në mënyrë graduale bëhen të qasshme për njerëzit apo personat me paafësi dëgjimi dhe të të pamurit.”*

Avokati i Popullit rikujton se respektimi, mbrojtja dhe përmbushja e së drejtës së lirisë së shprehjes, për të shprehur mendimet e tyre, përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta, përbën parakusht themelor për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë dhe demokratike.

Aktivitetet në nxjerrjen e ligjeve që ndërlidhen me pandeminë COVID–19

Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke vepruar sipas udhëzimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese, ka miratuar Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Parandalimin e COVID–19) dhe Ligjin nr. 07/1-015 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19 (në tekstin e mëtejshëm: Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike). Miratimi i këtyre dy ligjeve paraqiste ndër ngjarjet më të veçanta që kanë ndodhur në procesin legjislativ gjatë vitit 2020.

Ajo që vlen të përmendet në këtë rast është fakti se Republika e Kosovës nëpërmjet këtyre dy ligjeve, që nga momenti i miratimit të tyre, ka rregulluar çështjet kryesore që janë shfaqur gjatë periudhës së pandemisë deri më tani. Pra, përveç përcaktimit ligjor për mundësinë e nxjerrjes së vendimeve për masat kufizuese gjatë pandemisë, Republika e Kosovës ka miratuar ligj me të cilin ka përcaktuar mbështetje për subjektet që janë prekur nga situata e krijuar nga pandemia COVID-19.

Avokati i Popullit konsideron që niveli normues për këtë periudhë ka qenë i kënaqshëm duke pasur parasysh se është rregulluar çështja e bazës ligjore për masat kufizuese që mund të merren

¹⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 06/146 për zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave, i nxjerrë më 29 shtator 2010: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_146-te_te_Qeverise_2010.pdf

¹⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10363>

përshtatshmërisht me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, e po ashtu është krijuar baza ligjore për mbështetjen financiare të subjekteve që janë prekur nga kjo situatë.

Vlerësimi i Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës

Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19.¹⁹ Që nga miratimi i këtij ligji, institucionet e Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë veprime konkrete me qëllim të parandalimit të pandemisë COVID-19, ngase i njejtë u ofron autorizime të posaçme për kufizimin e lirive dhe të të drejtave kushtetuese.²⁰

Sipas këtyre përcaktimeve ligjore, Ministria e Shëndetësisë ka autorizime:

“1. Në kohën sa zgjatë pandemia COVID-19, përveç autorizimeve nga Ligji Nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ministria e Shëndetësisë ka autorizime për sa vijon:

Kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, përjashtimisht ato të specifikuar në nenin 56 (2) të Kushtetutës, për aq sa një gjë e tillë është e domosdoshme për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19,

[...]

Kufizimi i lirive dhe të drejtave që kanë të bëjnë me të drejtat kushtetuese të lirisë së lëvizjes (Neni 35), lirisë e tubimit (Neni 43) dhe privatësisë (Neni 36) bëhet ashtu që jepen arsyetime të bollshme dhe të detajuara që dëshmojnë për lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të kufizimit dhe masave të ndërmarra për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19.” Neni 4, paragrafët 1 dhe 4).

Nga dispozitat e cekura më lart vërehet se ky ligj ka autorizuar MSh-në që të nxjerrë vendime për kufizimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe e domosdoshme. Dhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha vendimet e qeverisë që janë nxjerrë me qëllim të mbrojtjes nga pandemia COVID-19, e kanë bazën në këtë ligj.

Vlerësimi i Ligjit nr. 07/L-015 për Rimëkëmbjen Ekonomike COVID-19

Ky ligj ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e nëntë (9) ligjeve, me qëllim të mundësimin të rimëkëmbjes së ekonomisë së Republikës së Kosovës pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia COVID-19.²¹

¹⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID – 19, neni 1, më 25 gusht 2020.

²⁰ Po aty, Kapitulli II.

²¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore; Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-116; Ligji nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale; Ligji nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar; Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194, me Ligjin nr. 05/L-063 dhe me Ligjin nr. 05/L-007; Ligji nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102, me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 04/L-223; Ligji nr 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin

I njëjti, në kuptimin përmbajtjesor përbëhet tërësisht nga dispozita kalimtare, sepse ato mbesin në fuqi deri më 31 dhjetor 2021, dhe pas kësaj date shfuqizohen automatikisht të gjitha dispozitat, përveç nenit 5, i cili zbatohet deri më 31 dhjetor 2028, dhe nenit 7, paragrafi 3.

Neni 5 i Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike përcakton se me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, pjesëmarrësit mund t'i tërheqin dhjetë për qind (10%) të kursimeve të tyre pensionale në Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Mjetet e tërhequra nga pjesëmarrësi, sipas këtij neni, e të cilët kanë kursime deri në nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro (9999 euro) kompensohen në formë rimbursimi, duke filluar nga viti 2023.²² Ky përcaktim ka ngjallur diskutime dhe reagime nga pjesa e qytetarëve të cilët në kursimet pensionale kanë më tepër se nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë (9999), e të cilët nuk do të rimbursohen sipas këtij ligji.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka pranuar disa ankesa nga qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët pretendonin se kjo dispozitë i vë në trajtim të pabarabartë. Ende nuk ekziston ndonjë sqarim për pragun prej 9999 eurosh, prandaj edhe është kundërshtuar nga qytetarët me kursime mbi këtë tavan. Në këtë drejtim, sa i përket pretendimit të pensionistëve për të pasur të drejtë për t'i tërhequr mjetet nga Trusti Pensional, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kërkesë të Avokatit të Popullit, ka sqaruar se sipas përcaktimeve ligjore, vetëm pjesëmarrësit aktivë në trust kanë të drejtë tërheqjen e 10% të shumës.

Vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit për Pakon Emergjente Fiskale dhe gjithëpërfshirjen e saj

Më 30 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendim 01/19, me të cilin ka aprovuar Pakon Emergjente Fiskale. Ndërsa më 3 prill 2020, Ministria e Financave dhe Transfereve ka nxjerrë Vendimin nr. 31/2020 për Arovimin e Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente dhe më 17 prill 2020 ka marrë Vendimin nr. 06/25 për plotësimin e Pakos Emergjente Fiskale.

Në substancë, parimi i ligjshmërisë materializon vlerat e rendit kushtetues duke marrë parasysh se e drejta administrative është konkretizim i vlerave kushtetuese për të cilën gjë të gjitha aktet e organeve të administratës publike duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe në frymën e pajtueshmërisë me parimin kushtetues të sundimit të ligjit. Parimi i sigurisë juridike është baza e shtetit të së drejtës dhe siguron besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit nëpërmjet veprimeve të organeve administrative, parim ky i cili, ndër të tjera, konsiston në saktësinë, qartësinë dhe qëndrueshmërinë në tërësi të tërë rendit juridik të një shteti, pra jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm, i parashikueshëm dhe jo kundërthënës.

Në vijim po japim një përshkrim të shkurtër të 15 masava të parapara me Pakon Emergjente Fiskale:

- Masa 1 – PAGESA E DYFISHTË E VLERËS SË SKEMËS SOCIALE PËR MUAJT MARS, PRILL DHE MAJ;

nr. 05/L-080 dhe me Ligjin nr. 06/L-023; Ligji nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068; Ligji nr. 03/L-063 për Minierat dhe Minerale, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.

²² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 07/L-015 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19, neni 5, më 7 dhjetor 2020.

- Masa 2 – Pagesa shtesë prej 30 euro në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale nën vlerën prej 100 euro për muajt mars, prill dhe maj;
- Masa 3 – Mbështetja financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare si rezultat i situatës emergjente dhe atë:
 - mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 euro (2 muaj);
 - subvencioni i qirasë deri në 50 për qind të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; dhe
 - mbulim i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim.
- Masa 4 – Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike (kthimi bëhet deri në fund të vitit 2020);
- Masa 5 – Sigurimi i mbështetjes financiare për Komuna e Republikës së Kosovës;
- Masa 6 – Sigurimi i shtesës mbi pagën në vlerë 300 euro për punonjësit e sektorëve esencial të cilët janë ekspozuar drejtpërdrejtë rrezikut të infektimit për muajt prill dhe maj (stafi mjekësor, Policia e Kosovës, zyrtarët e Shërbimit Korrektues, zyrtarët e Agjencisë së menaxhimit të emegjencave-zjarrëfikësat, FSK, punëtorët që punojnë në Karantinim, Inspektorati i punës, ATK- inspektorët, doganierët, Inspektorët e Tregut, inspektorët përkatës komunal, Inspektorati i Mjekësisë së Punës;
- Masa 7 – Pagesë shtesë prej 100 euro për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe barnatoreve, për muajt prill dhe maj;
- Masa 8 – Pagesa e asistencës mujore prej 130 euro për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për shkak të situatës emergjente (regjistrimi përmes ATK-së, për muajt prill, maj dhe qershor;
- Masa 9 – Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikë e Kosovës, e të cilët janë goditur rëndë nga situata e emergjencës së shëndetit publik, në vlerë deri në 2 milionë euro;
- Masa 10 – Sigurimi i likuiditetit financiar për dy kategori:– mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci të Kredive, në shumën deri në 10 mijë euro për periudhën 2 vjeçare, në vlerë deri në 15 milionë euro; dhe shoqëritë tregtare/kompanitë e autorizuara të cilat ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike) me kthim deri më 31.12.2020, në kuadër të vlerës së përcaktuar të pikës 1.4 të vendimin për Pakon Fiskale Emergjente;
- Masa 11 – Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor, në vlerë prej 5 milionë euro;
- Masa 12 – Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga gjendja e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore, në vlerë prej 5 milionë euro;

- Masa 13 – Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik, në vlerë deri në 10 milionë euro;
- Masa 14 – Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, nga 130 euro për dy muajt pasues pas regjistrimit, në vlerë deri në 6 milionë euro;
- Masa 15 – Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130 euro për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, e që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga Buxheti i Kosovës dhe kjo për muajin prill, maj dhe qershor, në vlerë deri në 3 milionë euro;

Nga masat e parapara me vendimin për Pakon Emergjente Fiskale vërehet se ka gjithëpërfshirje për të gjitha kategoritë shoqërore. Megjithatë, ajo çka është vërejtur lidhur me zbatimin e Pakos Emergjente Fiskale, nga ankesat e qytetarëve dhe nga raportimet në media, është se aplikimi për përfitim nga disa masa ka qenë procedurë e komplikuar. Si p.sh. aplikimi për Masën 14, për pagesën e asistencës në vlerën prej 130 eurosh²³. Po ashtu është vërejtur se ka pasur vonesa në zbatimin e e pagesave për masat përkatëse të Pakos Emergjente Fiskale. Në intervistën e ish-ministrit të Ministrisë së Financave dhe Thesarit dhënë për një portal²⁴, përkitazi me vonesat në pagesat për Masën 15, ka thënë: *“Vonesa e pagave e disa punëtorëve nga Pakoja Emergjente Fiskale është për faktin se të dhënat e tyre janë ngarkuar gabimisht në sistem gjatë aplikimit për të përfituar nga kjo pako”* si edhe *“bizneset gjatë plotësimit të formularit kanë shkruar llogarinë e tyre bankare e jo të punëtorëve.”*

Po ashtu, nga deklarata që ministrja e Financave ka dhënë për media është raportuar: *“Qeveria e Kosovës nuk ka mjete të mjaftueshme për të zbatuar Pakon Emergjente Fiskale, pa rishikim të buxhetit i cili tashmë është dërguar në Kuvendin e Kosovës.”*²⁵ Njoftimin në media lidhur me vonesat për pagesat e Masës 15 të Pakos Emergjente Fiskale ka dhënë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), e cila ka njoftuar se nga data 17 gusht 2020, në të gjitha qendrat për punë sociale ka filluar procesi njoftues dhe ankimor lidhur me vendimin për asistencën mujore, sipas Masës 15 të Pakos Emergjente Fiskale. Nga sa u tha më lart, mund të nxjerrim konkluzionin se gjithëpërfshirje ka pasur, por zbatimi i këtyre masave është shoqëruar me vonesa.

²³ Ngadhnjim Avdyli, *“Bregat karshi Pakos Emergjente Fiskale”*, Kosovo 2.0, prill 2020 (linku: <https://kosovotwopointzero.com/bregat-karshi-pakos-emergjente-fiskale/>)

²⁴ Mesazhi: *“Bislimi sqaron vonesat e disa pagesave nga Pakoja Emergjente Fiskale”*, maj 2020, (linku: <https://mesazhi.com/bislimi-sqaron-vonesat-e-disa-pagesave-nga-pakoja-emergjente-fiskale/>)

²⁵ Bota e Lajmeve: *“Ministrja Bajrami: Pa rishikim të buxhetit s’ka pagesa të dyta për punëtorët”*, (linku: <https://botaelajmeve.com/ministrja-bajrami-pa-rishikim-te-buxhetit-ska-pagesa-te-dyta-per-punetoret/>)

III. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në shëndetin publik

Vitet 2020 dhe 2021 ishin vite sfidash apo situatë krize jo vetëm në Kosovë, por gjithë globin, për shkak të pandemisë COVID-19. Masat kufizuese që janë ndërmarrë për ta parandaluar kërcënimin ndaj shëndetit publik i kanë vendosur në qendër të vëmendjes detyrimet e shtetit për të drejtën në jetë nga njëra anë dhe respektimin e të drejtave të njeriut edhe në kohë krizash nga ana tjetër. Qeveria e trajtoi krizën e shkaktuar nga COVID-19, si një emergjencë e shëndetit publik, me mjaft kufizime e ndalesa në të gjitha fushat e jetës, derisa nga ana tjetër kishte qytetarë të cilët e mohonin ekzistencën e COVID-19.

Situata me pandeminë COVID-19 ka sfiduar sistemet shëndetësore në të gjitha shtetet, ashtu që edhe sistemi shëndetësor i Kosovës është ballafaquar me një situatë ku është gjetur i papërgatitur për t'i përballuar emergjencat shëndetësore. Avokati i Popullit edhe para kësaj situatë ua kishte tërhequr vërejtjen autoriteteve përgjegjëse për gjendjen jo të mirë të sistemit shëndetësor. E kjo për faktin se përveç mungesës së kapaciteteve në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës, ka munguar edhe informacioni dhe aprovimi i protokolleve për trajtimin e këtij virusi. Për këto arsye, shumica e strategjisë për menaxhimin e pandemisë së COVID-19 u bazua në lehtësimin e menaxhimit të përditshëm të rasteve të infektuara me COVID-19 dhe ndërtimin e kapaciteteve shtesë për të akomoduar dhe trajtuar raste të reja.

Në këtë drejtim edhe Raporti i Komisionit Evropian si dhe raportet e organizatave të tjera kanë konstatuar gjendjen jo të mirë të sistemit shëndetësor në Kosovë. Një shqyrtim multidimensional për Ballkanin Perëndimor i periudhës së pandemisë deri në shkurt 2021 konstaton një ndikim mesatar në shëndetin në Kosovë.²⁶ Ky raport konstaton se janë katër valë të pandemisë që kanë goditur Kosovën. Në këtë raport cekën si faktorë dobësitë në sistemin shëndetësor dhe të mbrojtjes sociale dhe nivelet e larta të papunësisë dhe informalitetit. Në po këtë Raport të Komisionit Evropian për Kosovën²⁷ citohet se në vendin tonë shpenzimet e përgjithshme shëndetësore mbeten më të ulëta në rajon dhe se pa sigurim shëndetësor në dispozicion publik, qytetarët mbanin rreth 40% të kostove totale të kujdesit shëndetësor nga xhepi para krizës, krahasuar me një mesatare prej 13% në OECD.¹²

Në një publikim të shkurtë nga Zyra Ndërlidhëse e OBSH-së në Kosovë tregohet se nga marsi deri në maj 2020, të gjitha shërbimet shëndetësore joakute u pezulluan në Kosovë, me rihapjen e tyre më pas në mënyrë graduale.²⁸ Ky publikim tregon se masat kufizuese të paraqitura për të zbutur shpërthimin e COVID-19, të shoqëruara me ripozicionimin e shërbimeve shëndetësore dhe kapacitetet e fuqisë punëtore shëndetësore në qendrat e trajtimit COVID-19, kanë ndikuar negativisht në shërbimet shëndetësore (thelbësore) në Kosovë, duke përfshirë qasjen dhe shfrytëzimin e tyre.

²⁶ OECD Library, “Efekti i COVID-19 në Kosovë”, (linku: <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/0314c10c-en/index.html?itemId=/content/component/0314c10c-en>)

²⁷ Komisioni Evropian, “Raporti për Kosovën 2018”, Bruksel, nëntor 2018. (linku: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/01_kosovo_report_2018_0.pdf)

²⁸ Ardita Tahirukaj et al, “Mirëmbajtja e Shërbimeve Thelbësore Shëndetësore në Kosovë”, Organizata Boterore e Shendetesise (linku: <https://hlh.who.int/learning-briefs/action-brief-kosovo---deep-dive>)

Raporti i Tretë i Vlerësimit të Shpejtë i Ndikimit Socio-ekonomik i COVID-19 në Kosovë i UNDP-së, UN Women, UNFPA-së dhe UNKT-së, i publikuar në maj 2021,²⁹ ndër të tjera ka bërë edhe matjen e vështirësive të lidhura me qasjen në shërbimet shëndetësore dhe sociale të rreth 1400 respondentë. Përderisa në rundin e parë në mars 2020, vështirësi të mëdha raportonin 3%, disa vështirësi i raportonin 23%, në rundin e dytë, në nëntor 2020, vështirësi të mëdha raportonin 6%, disa vështirësi i raportonin 18%, në rundin e tretë, në mars 2021, vështirësi të mëdha raportonin 4%, disa vështirësi i raportonin 13%.

Edhe një raport i Institutit Aspen³⁰ gjen se masat rezultuan me qasje të kufizuar në kujdesin mjekësor, që është një shkëlqje edhe më shqetësuese e të drejtave themelore të qytetarëve, të cilët kanë nevojë për kujdes të menjëhershëm shëndetësor.

Një raport i publikuar në dhjetor 2020, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë vë në pah se pandemia ka vënë në rrezik mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive civile, të cilat janë thelbësore për një demokraci funksionale.³¹ Këto efekte ndihen veçanërisht në mesin e grupeve të pafavorshme ose të marginalizuara.

Avokati i Popullit, për situatën e krijuar ka dalë me dy raporte me rekomandime drejtuar institucioneve përgjegjëse, lidhur me vlerësimin e realizimit të të drejtave shëndetësore gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë³² dhe në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me Virusin e Imunodeficiencës Humane (HIV) dhe me Tuberkuloz (TB), gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë.³³

Raportet e sipërpërmendura kanë trajtuar problematikat e krijuara nga COVID-19, pa u futur brenda bërthamës së vështirësive dhe të sfidave të pjesës së trajtimit të vetë COVID-19. Siç theksohet në këto raporte, i gjithë sistemi u përqendrua në parandalimin dhe trajtimin e të infektuarve me COVID-19.

Në raportin lidhur me vlerësimin e realizimit të të drejtave shëndetësore gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë, është konstatuar: *“Gjatë emergjencës shëndetësore në Republikën e Kosovës përkitazi me ofrimin përzgjedhës të shërbimeve shëndetësore, pa bazë ligjore, kishte shkëlqje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Autoritetet përkatëse nuk*

²⁹ Kombet e Bashkuara në Kosovë, “Një vlerësim i shpejtë i impactit socio-ekonomik të COVID-19 në Kosovë – 3”, qershor 2021, (linku: <https://kosovoteam.un.org/index.php/en/130632-rapid-socio-economic-impact-assessment-covid-19-kosovo-3>)

³⁰ Instituti Aspen, “Pandemia COVID-19 në Ballkanin Perëndimor: Pasojat dhe Qasja e Politikës” 2020, (linku: <https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2020-The-Covid-19-Pandemic-in-the-Western-Balkans.pdf>)

³¹ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, “Mes një shkëmbi dhe një vendi të vështirë: Sfidat e Kosovës në trajtimin e pandemisë COVID-19”, dhjetor 2020, (linku: http://www.qkss.org/repository/docs/Covid19_ENG_656195.pdf)

³² Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, “Raport me rekomandime, Ex officio, Rasti nr. 434/2020 në lidhje me kufizimet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë”, 12 mars 2021, (linku: <https://oik-rks.org/2021/03/12/raport-me-rekomandime-ex-officio-rasti-nr-4342020-ne-lidhje-me-kufizimet-e-ofrimit-te-sherbimeve-shendetesore-gjate-pandemise-covid-19-ne-kosove/>)

³³ Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, “Raport me rekomandime, ex officio nr. 698/2020 në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me virusin e imunodeficiencës humane (HIV) dhe me tuberkuloz (TB) gjatë kohës së pandemisë COVID-19 në Kosovë”, 27 janar 2021, (linku: <https://oik-rks.org/2021/01/27/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-6982020-ne-lidhje-me-qasjen-ne-sherbime-te-kujdesit-shendetesor-te-personave-te-prekur-me-virusin-e-imunodeficiences-humane-hiv-dhe-me-turbekuloz-tb-gjate-ko/>)

i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore kundrejt qytetarëve dhe kjo kishte implikime negative drejtpërdrejt në shëndetin dhe në jetën e personave, që potencialisht kanë pasur nevojë për shërbime shëndetësore.” Kjo edhe për faktin se autoritetet nuk kanë ofruar mundësi alternative për pacientët të cilëve nuk u është ofruar shërbim shëndetësor dhe as nuk i ka kompensuar.

Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave të paraqitura dhe të fakteve të mbledhura, në Raportin në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me Virusin e Imunodeficiencës Humane (HIV) dhe me Tuberkuloz (TB), gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë, konstaton “shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, meqë autoritetet përkatëse nuk kanë arritur t’i përmbushnin detyrimet kushtetuese dhe ligjore kundrejt personave të infektuar me HIV/AIDS dhe me TB, si pasojë e gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19”.

Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar dhe Inspektorati Shëndetësor

Avokati i Popullit, nga komunikimi me ShSKUK-në, me Inspektoratin Shëndetësor (ISh) dhe me MSh-në, lidhur me ndikimin e COVID-19 si dhe për sfidat me të cilat ata ballafaqohen, ka gjetur:

- Kapacitetet spitalore dhe personeli kanë qenë të kufizuara në çdo aspekt, kjo ka ndikuar edhe në vetë performancën e sistemit,
- mungesat legjislative deri në miratimin e Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës,
- mungesën e udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike specifike për trajtimin e COVID-19, mungesa e terapive specifike dhe të shtrenjta për trajtimin e COVID-19,
- sfida e menaxhimit të fluksit të madh të qytetarëve të kthyer nga jashtë, të cilët është dashur të karantinoheshin për dy javë dhe për të cilët është dashur të sigurohej mbikëqyrje dhe kujdes shëndetësor e social;
- mungesa e infrastrukturës adekuate për ruajtjen e vaksinave në kushte specifike (-70 gradë celsius) për vaksinat etj.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë (IKShPK)

Avokati i Popullit, nga komunikimi me IKShPK-në, lidhur me ndikimin e COVID-19 si dhe sfidat me të cilat ajo ballafaqohet, ka gjetur:

- Mungesa e furnizimit me aparatura, me reagensa dhe me mungesë të personelit (dy aparate RT PCR, me një specialiste të mikrobiologjisë dhe me një laborant), e gjithë kjo për shkak të shpërfilljes së vazhdueshme të nevojave për përkrahje në shërbime të mikrobiologjisë në Kosovë, nga autoritetet përgjegjëse.
- Me mbështetje të donatorëve, nga fillimi i qershorit 2021 janë siguruar aparatura të mjaftueshme për testim me RT PCR si dhe janë lidhur kontrata nga MSh-ja për furnizim të mjaftueshëm me material spenzues për testim me RT PCR. Gjithashtu nga fundi i vitit 2020 si dhe në fillim të vitit 2021 kanë nisur specializimin nga mikrobiologjia

mjekësore njëzet e pesë (25) mjekë të rinj, të cilat janë të angazhuar në testimin me RT PCR për COVID19.

- Janë ofruar testime për të gjithë personat që kanë indikacione epidemiologjike për testim (edhe pa pasur udhëzim nga mjeku) si dhe janë kryer mbikëqyrje aktive epidemiologjike në institucione të shumta publike të Kosovës.

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës

Sipas FSShK-së, shpallja e gjendjes emergjente si pasojë e paraqitjes së rastit të parë me virusin COVID-19, i gjeti të papërgatitur institucionet shëndetësore publike, po ashtu edhe punëtorët shëndetësorë, të patrajnuar për situata të tilla emergjente, si dhe me mungesë të stafit.

Sipas tyre, punëtorët shëndetësorë gjatë kësaj periudhe u përballën me sfida të shumta, duke u nisur nga mosnjohja e virusit dhe e simptomatologjisë, me mungesa të informatave burimore rreth trajtimit, me mungesa të kuadrove bartëse të procesit të testimit për COVID-19 (mungesa e infermierëve dhe e mjekëve specialistë për fusha të caktuara), mungesa e testeve për COVID-19, mungesa e furnizimit me barna esenciale, mungesa e hapësirave të posaçme për trajtim të personave me COVID-19 (mungesa në krijimin e hapësirave adekuate për trajtimin e pacientëve me COVID-19), mungesa e pajisjeve mjekësore të nevojshme për trajtim (furnizimi me bombola oksigjeni, respiratorë, mungesa të sistemit të oksigjenimit qendror), mungesa e udhëzuesve për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe një sërë mangësish që kanë rezultuar më pas edhe me fatalitet për punëtorët shëndetësorë. Sipas FSShK-së, deri më 11 qershor 2021, ishin evidentuar 37 punëtorë shëndetësorë të vdekur si pasojë e infektimit me COVID-19, kurse ishin infektuar rreth 4000 punëtorë shëndetësorë dhe staf mbështetës.

Sindikata e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës

Sipas Sindikatës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës (SIMPSHk), ka pasur shkelje të të drejtave të infermierëve, të mamive dhe të profesionistëve të tjerë shëndetësorë, gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, si: oraret e zgjatura dhe pa pushime gjatë shumicës së kohës së pandemisë në ShSKUK dhe në QMF; humbja e pushimit vjetor; mungesa e madhe e infermierëve në klinika, në reparte dhe në QMF në tërë territorin e Kosovës; mungesa e trajnimeve për rrobat antiCOVID dhe e trajnimeve për qasje me pacientët e infektuar me COVID-19 që sipas tyre ka rezultuar me infektimin e infermierëve; mungesa e rrobave, e maskave, e dorëzave të mjaftueshme; mungesa e mbulimit të shpenzimeve të shërimit nga COVID-19, mungesa e pagimit për punë jashtë orarit etj.

Qytetarët të infektuar me COVID-19

Avokati i Popullit, me qëllim që të ketë një vlerësim sa më real të situatës së krijuar nga COVID-19, ka vendosur kontakte të drejtpërdrejta me qytetarë, duke intervistuar persona të infektuar me COVID-19, si dhe shoqëruesit e tyre. Këta persona u takonin gjinive të ndryshme dhe rajoneve të ndryshme të Kosovës.

Po ashtu janë intervistuar shoqërues të personave me COVID-19, të cilët ishin infektuar gjatë shoqërimit të familjarëve të tyre nëpër spitalet/klinikat përkatës, si dhe persona familjarët e të cilëve kishin përfundim fatal nga infeksioni COVID-19.³⁴

Shqetësimet kryesore të qytetarëve të intervistuar ishin kushtet e rënda në spitale, joracionalizimi i hapësirave të spitalit, mungesa e personelit mjekësor, mungesa e ilaçeve për trajtimin e COVID-19, mungesa ofrimit në shtëpi të shërbimeve shëndetësore për të moshuarit dhe për persona me aftësi të kufizuara, rreziku i shpërndarjes së virusit te shoqëruesit e pacientëve, frika për t'u hospitalizuar, pasi në raste të caktuara nëpërmjet rrjeteve sociale dhe mediave raportohej për vdekjet që po ndodhnin në spitale dhe në klinika³⁵etj.

Nga këto informata, Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e mbulimit të shpenzimeve të shërimit, nga autoritetet publike, ka dëmtuar financiarisht pacientët, e kjo është edhe në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin dhe Kontrollin e COVID-19. Ndërsa mungesa e shërbimeve përkrahëse diagnostike si dhe e shërbimeve të tjera, si ato rehabilituese apo të shëndetit mendor, janë kufizim i qasjes në shërbime. Gjithashtu, si pasojë e mungesës së pajisjeve mbrojtëse dhe e pranisë së shoqëruesve janë rrezikuar ata dhe familjarët e tyre.

Rregullat e transportit dhe të varrimit për personat e vdekur nga COVID-19

Duke marrë parasysh faktin se një numër të madh të qytetarëve të infektuar me COVID-19, ka rezultuar me fatalitet, Avokati i Popullit është interesuar se si është vepruar te rastet kur pacientët e infektuar me COVID-19 kanë ndërruar jetë në institucionet shëndetësore, në cilindo nivel, si dhe nëse ka ekzistuar ndonjë udhëzues/protokoll apo ndonjë shkresë nga ana e MSh-së lidhur me rregullat epidemiologjike për rastet në fjalë. MSh-ja ka njoftuar se deklarimi i vdekjes nga mjeku për rastet që kanë vdekur nga COVID-19 është bërë sipas udhëzuesit të OBSH-së. Sipas MSh-së, ajo është bazuar në rregullat e përcaktuara nga Inspektorati Sanitar, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Përhapjen e Sëmundjeve Ngjithëse, Ligji për Inspektoratin Sanitar, dokumenti i ECDC-së, i rekomanduar nga IKShPK-ja, si dhe Manuali për Mbrojtje nga Përhapja e COVID-19.

Në anën tjetër, Inspektorati Sanitar i Kosovës ka njoftuar se me përpikëri i ka zbatuar rregullat e transportit dhe të varrimit për personat që vdesin nga COVID-19.

Avokati i Popullit vëren se kjo rregullore e publikuar në media³⁶ më 30 prill të vitit 2020 dhe në ueb-faqet e disa komunave kishte përmbytje të qartë, por nuk kishte datë të lëshimit, nuk ishte e protokolluar dhe nuk ishte e nënshkruar. Në fund të tekstit mbante kontaktet dhe emrin e kryeinspektorit të Inspektoratit Sanitar të Kosovës, e-mail adresën dhe numrin e telefonit.

Kjo rregullore është nxjerrë duke u bazuar në Ligjin për Inspektoriatin Sanitar të Kosovës, në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjithëse, si dhe në Urdhëresën për kushtet

³⁴ Intervistimi i qytetarëve A. N., më 4 korrik 2021; E. D., më 5 korrik 2021; Rr. L., më 13 korrik 2021.

³⁵ Ekonomia Online, “Policia bllokoi hyrjet – katër trupa të pajetë nxirren nga Infektiva”, korrik 2020, (linku: <https://ekonomiaonline.com/nacionale/shendetesi/policia-bllokon-hyrjet-kater-trupa-te-pajete-nxirren-nga-infektiva/>)

³⁶ Sinjali, “Pandemi/Këto janë rregullat e transportit dhe varrimit për personat që vdesin nga COVID-19 në Kosovë”, prill 2020, (linku: <https://sinjali.com/keto-jane-rregullat-e-transportit-dhe-varrimit-per-personat-qe-vdesin-nga-covid-19-ne-kosove/>)

dhe për mënyrën e bartjes së personave të vdekur (GZ Nr.17/1977). Rregullorja përmban 13 pika, të cilat përcaktojnë rregullat e transportit dhe të varrimit për personat që vdesin nga COVID-19.

Kujdesi shëndetësor i personave me aftësi të kufizuar gjatë COVID-19 dhe masat e izolimit social

Në kuadër të kujdesit shëndetësor, janë marrë masat për mbrojtjen e popullatës, të cilat përfshijnë një mori kufizimesh dhe rekomandimesh të IKShPK-së, të MSh-së dhe të OBSH-së.³⁷ Mirëpo situata me personat me aftësi të kufizuar ndryshon, sepse qeveria ka bërë pak për t'u siguruar udhëzime specifike dhe mbështetje që u nevojiten personave me aftësi të kufizuar për t'u mbrojtur gjatë pandemisë COVID-19.

Ka munguar mbështetja në situatat kur asistentit personal, i cili ofron ndihmë ditore dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuar, i është dashur të izolohej, ose kur personat që i ndihmonin ata, për shkak të respektimit të masave ose të frikës nga infeksioni i mundshëm COVID-19, nuk kanë mundur t'ua ofronin ndihmën e nevojshme.

Personat me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga situata e COVID-19, përballen çdo ditë me pamundësinë e lëvizjes për shkak të mungesës së qasjes fizike në të gjitha rrugët dhe në objektet ku ata marrin shërbime. Prandaj mund të nxirret konkluzioni se situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19 e ka përkeqësuar edhe më tej situatën tashmë të vështirë të personave me aftësi të kufizuar.

Sipas informatave nga Klinika e Sëmundjeve Infektive e Qendrës Klinike në Prishtinë, brenda periudhës raportuese, Klinika ka trajtuar 12 pacientë me aftësi të kufizuara, një nga ta me përfundim fatal. Në këto raste nuk janë zbatuar protokolle të veçanta për personat me aftësi të kufizuara për pacientët me COVID-19, por është marrë parasysh nevoja për akomodim specifik në varësi të nevojave të veçanta të këtyre pacientëve. Janë ndërmarrë masat e nevojshme në përputhje me burimet në dispozicion me qëllim që të përmbushen nevojat e veçanta të kësaj kategorie pacientësh. Kompetencat profesionale të mjekëve dhe të stafit ndihmës të Klinikës së Sëmundjeve Infektive gjatë periudhës pandemike ishin përqendruar në trajtimin urgjent dhe ishin shumë komplekse për të shpëtuar jetë.³⁸

Fluksi i madh dhe kapacitetet e kufizuara të Klinikës së Sëmundjeve Infektive, si dhe në varësi nga faza në të cilën ndodheshin, për pasojë kanë faktin që klinika të mos ketë një vlerësim të matshëm me parametra statistikore standardë dhe të ndryshueshëm. Bashkëpunimi i Klinikës me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe me institucione të tjera ka qenë i një rëndësie thelbësore për të nxjerrë konkluzione të sakta lidhur me ndikimin e COVID-19 në shëndetin e përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara.³⁹

³⁷ Nga përgjigjja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 9 korrik 2021, të cilën e ka dërguar Ministria e Financave, Punës dhe Transferit në Pyetësin e Avokatit të Popullit të Kosovës, dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

³⁸ Përgjigjja e Klinikës për Sëmundjet Infektive, e datës 6 korrik 2021, në Pyetësin e Avokatit të Popullit të Kosovës, lidhur me ndikimin e pandemisë COVID-19 mbi personat me aftësi të kufizuara, dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

³⁹ Po aty.

Personat me aftësi të kufizuara që ishin në karantinë, si dhe pacientët kronikë, nuk kanë mundur t'i vazhdonin të gjitha trajtimet e filluara dhe të nevojshme nga frika se do të sëmureshin nga COVID-19, gjë që çoi deri te një gjendje e përkeqësuar shëndetësore e kësaj kategorie pacientësh. Ndërsa kur bëhej fjalë për personat që kanë nevojë për dializë, ata shkuan në dializë edhe me ndihmën e HANDIKOS-it.⁴⁰

Sa i përket kujdesit mjekësor dhe qasjes në shëndetësi, Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës ka informuar se disa anëtarë të verbër dhe me shikim të pjesshëm, të organizatës së tyre, ishin prekur nga virusi COVID-19, janë infektuar rreth tridhjetë persona të verbër dhe me shikim të kufizuar, por nuk dihet nëse gjatë trajtimit hasën në ndonjë problem. Dy anëtare të Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës kanë vdekur nga infeksioni COVID-19. Të vdekurit ishin të moshës midis pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë e pesë vjeç dhe vuanin edhe nga sëmundje të tjera.⁴¹

Trajtimi me COVID-19 ishte shumë i shtrenjtë dhe i paarrtshëm për shumicën e shoqërisë, por një ndikim veçanërisht serioz pati te personat e verbër dhe te anëtarët e familjeve të tyre. Një person i verbër merr mbështetje financiare 250 euro në muaj, prej të cilave 125 euro i përkasin shoqëruesit, kurse 125 personit të verbër dhe këto mjete janë të pamjaftueshme për t'i mbuluar kostot nga infektimi me COVID-19. Sipas Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës, Ministria e Financave ka injoruar kërkesat për mbështetje të këtij komuniteti.⁴²

Që nga fillimi i pandemisë, Shoqata e të Shurdhërve e Kosovës ka regjistruar vetëm një rast të vdekjes së një personi të shurdhër që ishte i pastrehë dhe i cili humbi jetën për shkak të infektimit me COVID-19.⁴³

Bazuar në informacionin e mbledhur, mund të nxihet konkluzioni se as institucionet përkatëse shtetërore, as organizatat përkatëse të shoqërisë civile nuk kanë të dhëna për numrin e personave me aftësi të kufizuara që ishin infektuar me COVID-19 dhe as për numrin e vdekjeve.

Shteti nuk e ndihmon këtë kategori të popullsisë as duke siguruar pajisje ndihmëse specifike dhe i lë nën kujdesin e familjeve dhe ndihmën e OJQ-ve të specializuara.

Në E-platformën nuk ka rubrikë të veçantë për persona me aftësi të kufizuara për të aplikuar për vaksinim, por thuhet vetëm që caktimi i terminit bëhet, ndër të tjera, për pacientët me sëmundje kronike. Pra, personat me aftësi të kufizuara nuk kanë përparësi të drejtpërdrejtë, por të tërthortë si pacientë me sëmundje kronike, megjithëse problemet dhe nevojat e tyre janë shumë më komplekse sesa të pacientëve me sëmundje kronike.

⁴⁰ Takimi i përfaqësuesit të Avokatit të Popullit me drejtorin e OJQ-së HANDIKOS, i mbajtur më 8 korrik 2021, me qëllim të mbledhjes së informacioneve lidhur me pozitën e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, me fokusim të veçantë për pozicionin e personave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19 dhe nevojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këta persona, në përgjithësi dhe gjatë pandemisë.

⁴¹ Përgjigjja e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës, e datës 29 qershor 2021, në Pyetëtorin e Avokatit të Popullit në lidhje me ndikimin e pandemisë COVID-19 mbi personat me aftësi të kufizuara, dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

⁴² Po aty.

⁴³ Përgjigjja e Shoqatës së të Shurdhërve e Kosovës, e datës 30 qershor 2021, në Pyetëtorin e Avokatit të Popullit në lidhje me ndikimin e pandemisë COVID-19 mbi personat me aftësi të kufizuara, dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

Lidhur me vaksinimin kundër COVID-19, Ministria e Shëndetësisë informon se të gjitha qendrat/njësitë e vaksinimit në Kosovë kanë qasje për personat me aftësi të kufizuara (përveç në komunën e Deçanit, mirëpo personeli shëndetësor në këtë komunë e ka siguruar vaksinimin në ambientet e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara). Ministria e Shëndetësisë ka shënuar hyrje-daljen për personat me aftësi të kufizuara. Për të gjithë personat me aftësi të kufizuar që nuk ishin në gjendje të shkonin në qendrat e vaksinimit, vaksinimi u bë në shtëpi.⁴⁴

Konstatime

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës⁴⁵ ka përcaktuar përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësiave gjatë pandemisë COVID-19.

Pavarësisht faktit se MSh-ja kishte hartuar planin për gatishmëri dhe reagim kundër COVID-19 dhe qeveria kishte ndarë mjete financiare shtesë, kishte vështirësi dhe vonesa për furnizim me mjete mbrojtëse, me teste, me barna, me respiratorë dhe me materiale të tjera të nevojshme.

Mbi bazën e informatave nga institucionet shëndetësore, nga organizatat sindikale si dhe nga qytetarët, Avokati i Popullit vlerëson se ka mangësi në sistemin shëndetësor për shkak të kontributit të ulët buxhetorë për shëndetësi, moszbatimi i ligjeve dhe i politikave, moskoordinimi mes sektorëve, monitorimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e llogaridhënies.

Avokati i Popullit ripërsërit faktin se Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, i miratuar në vitin 2014, akoma nuk po gjen zbatim. Qëllim i këtij ligji ishte që qytetarëve t'u sigurohej qasje universale me shërbime kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes financiare për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor.

Avokati i Popullit vlerëson se paraqitet nevoja për hartimin e një strategjie dhe politike të veçantë nga qeveria për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të të moshuarve në situata emergjente për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, për faktin se kjo kategori është më e cenueshme dhe ka vështirësi specifike në marrjen e shërbimeve shëndetësore.

Fokusi në parandalimin dhe trajtimin e të sëmurëve me COVID-19, veç të tjerash, ka lënë anash shumë qytetarë, të cilët kishin nevoja shëndetësore të natyrave të tjera, përfshirë edhe ato kronike, e që solli sfida të shumta te institucionet shëndetësore, te personeli shëndetësor si dhe ndikoi në buxhetin e të infektuarve me COVID-19 dhe të familjarëve të tyre.

⁴⁴ Nga përgjigjja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 9 korrik 2021, të cilën e ka dërguar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në Pyetësin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

⁴⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, 25 gusht 2020.

IV. Shëndeti mendor dhe ndikimi i pandemisë COVID-19

Shëndeti mendor është një tregues i rëndësishëm i statusit të përgjithshëm shëndetësor në një shoqëri. Organizata Botërore e Shëndetësisë (2010) e definoi shëndetin mendor si një gjendje pozitive mendore, në të cilën realizohen aftësitë e tij, i menaxhon streset e jetës dhe në mënyrë efikase dhe mjaft kompetente me anë të sforcimeve të veta jep një kontribut në shoqërinë e tij/saj. Nga ana tjetër problemet e shëndetit mendor janë ndër kontribuuesit më të rëndësishëm në barrën globale të sëmundjes dhe të aftësisë së kufizuar. Problemet e Shëndetit mendor vlerësohen se përbëjnë 31% të paaftësisë, në mesin e individëve në të gjitha moshat dhe në të dy gjinitë (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2001).

Ndikimet e para të pandemisë në shëndetin mendor u vërejtën në shumë vende të botës, ashtu edhe në Kosovë. Izolimi shoqëror, mungesa e lëvizjes së lirë, humbja e vendeve të punës, problemet ekonomike, humbja e familjarëve, numri i vdekjeve në përgjithësi, frika nga infektimi etj., të gjitha këto kanë ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin mendor në përgjithësi.

Shëndeti mendor gjatë pandemisë së COVID-19 në botë: të drejtat e njeriut në kontekst

Që nga fillimi i pandemisë, ekspertë nga e gjithë bota kanë paraqitur pikëpamje në lidhje me ndikimet e mundshme negative të pandemisë në shërbimet e shëndetit mendor dhe kanë ngritur vetëdijen lidhur me nevojën e adresimit të problematikës së shëndetit mendor e me këtë edhe të çështjes së mundësisë së shtuar për cenimin/injorimin e të drejtave të personave me çrregullime mendore. Kështu në ato botime qartazi jepen qëndrimet se organizatat ndërkombëtare, përfshirë OBSH-në, avokojnë për integrimin e shëndetit mendor dhe mbështetjen psiko-sociale në përgjigjen kundër COVID-19.⁴⁶

Disa studime⁴⁷ gjejnë se kërkesat e reja për kujdesin e shëndetit mendor në vendet me të hyra të vogla ose të mesme kryqëzohen me sisteme të brishta shëndetësore, burime dhe kapacitete të pakta të fuqisë punëtore në përgjigje të strategjive të përmbajtjes së COVID-19, dhe qasje të përgjithshme të pakta dhe të pabarabartë në ndërhyrjet e bazuara në prova. Ndërsa Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) më 20 mars 2020 lëshoi një Deklaratë të Parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së sëmundjes COVID-19. Ata ua kujtojnë të gjithë aktorëve natyrën absolute të ndalimit të torturës dhe

⁴⁶ Adhanom Ghebreyesus T. "Adresimi i nevojave të shëndetit mendor: një pjesë integrale e përgjigjes ndaj COVID-19". World Psychiatry 2020; 19: 129–30. 6 UN. United Nations Policy Brief: COVID-19 dhe nevoja për veprim në shëndetin mendor. https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un_policy_brief-covid_and_mental_health_final.pdf (accessed May 24, 2020); Moreno, C., Wykes, T., Galderisi, S., Nordentoft, M., Crossley, N., Jones, N., ... & Arango, C. (2020). "Si duhet të ndryshojë kujdesi për shëndetin mendor si pasojë e pandemisë COVID-19". The Lancet Psychiatry; American Psychological Association. Mental Health is a Human Right (2020). (linku: <https://www.apa.org/international/pi/2018/12/mental-health-rights>); Rahman M, Ahmed R, Moitra M, Damschroder L, Brownson R, Chorpita B, Idele P, Gohar F, Huang KY, Saxena S, Lai J, Peterson SS, Harper G, McKay M, Amugune B, Esho T, Ronen K, Othieno C and Kumar M (2021) "Shqetësimet mendore dhe shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë COVID-19: Një rishikim i shpejtë i dëshmisë që informon të drejtat, nevojat e shëndetit mendor dhe politikën publike për popullatat e cenueshme". Front. Psychiatry 11:603875.

⁴⁷ Kola L. Global mental health and COVID-19. Lancet Psychiatry 2020; 7: 655–57; De Sousa A, Mohandas E, Javed A. 91 / "Ndërhyrjet psikologjike gjatë COVID-19: sfida për vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme". Asian J Psychiatr 2020; 51: 102128; Vigo D, Thornicroft G, Gureje O. "Rezultatet diferenciale të sëmundjes koronavirus 2019 në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme kundrejt vendeve me të ardhura të larta". JAMA Psychiatry 2020; 77: 1207–08.

trajtimin çnjerezor ose degradues.⁴⁸ Masat mbrojtëse kurrë nuk duhet të rezultojnë në trajtim çnjerezor ose degradues të personave të privuar nga liria.

Në kontekstin e pandemisë COVID-19, raportet nxjerrin në pah dëmtimin e madh të shëndetit mendor dhe shkeljet e lirive civile individuale dhe të të drejtave themelore ndër të tjerët edhe për popullatat e marginalizuara⁴⁹, ku ndër grupet e marginalizuara padyshim hyjnë edhe personat me çrregullime mendore. Përveç personave të sëmurë mendorë në komunitet, mjediset e banimit për personat me aftësi të kufizuara mendore dhe njësitë e shtrimeve psikiatrike mund të jenë veçanërisht të rrezikuara.⁵⁰

Ndër të drejtat që janë llogaritur/konstatuar janë: qasje e barabartë në kujdesin shëndetësor⁵¹, furnizimi i vazhdueshëm dhe qasja në ilaçe; vlerësimi i nevojave, përfshirë shëndetin mendor dhe psiko-social; përparësia e testimit; konsultimi i ngushtë dhe përfshirja në mënyrë aktive e personave me aftësi të kufizuara dhe i organizatave përfaqësuese të tyre në përkujdesjen e tyre; qasja në informacionin e përshtatur dhe miratimi i masave të ndihmës socio-ekonomike dhe i rrjeteve të sigurisë sociale.

Një përmbledhje e studimeve që shqyrtojnë shkeljet e të drejtave të njeriut në përgjigjen e COVID-19, me një fokus në popullatat e prekshme, dhe shoqërimin e tij me shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike, nga 24 studime midis dhjetorit 2019 deri në korrik 2020 të individëve që jetojnë me sëmundje mendore ose paaftësi, arrijnë në përfundimin se këto të drejta preken në mënyrë shpërputhëse për shkak të kufizimeve të COVID-19; dhe se këto shkelje të të drejtave përbëhen nga nivele të konsiderueshme të diskriminimit dhe stigmës.⁵²

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka kërkuar nga shtetet që të shpenzojnë më shumë për shëndetësi nga buxhetet e tyre, sa i takon shëndetin mendor.⁵³ Më 31 gusht, OBSH-ja ka

⁴⁸ Council of Europe, European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT), “Deklarata e parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së sëmundjes koronavirus (Covid-19)”, Mars 2020, (linku: <https://rm.coe.int/16809cfa4b>)

⁴⁹ Office of the High Commissioner for Human Rights. “COVID-19 dhe dimensionet e saj të të drejtave të njeriut”: Guidance (2020). <http://digitallibrary.un.org/record/3860124/files/COVID19Guidance.PDF>; CRPD Committee (June 2020). ‘Deklaratë mbi COVID-19 dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara’, (linku: <http://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25942&LangID=E>; Ruiz, R. (14 March 2020). “Koronavirus zbulon gjithçka që është e gabuar me sistemin tonë të kujdesit të shëndetit mendor”. Mashable Australia. (linku: <https://mashable.com/article/coronavirusanxiety/> last accessed 25 July 2021; Thome J, Coogan AN, Simon F, Fischer M, Tucha O, Faltraco F, Marazziti D, Butzer H (2020). “Ndikimi i shpërthimit të COVID-19 në të drejtat mjekësore-juridike dhe njerëzore të pacientëve psikiatrikë”. European Psychiatry, 63(1), e50, 1–2, (linku: <https://doi.org/10.1192/j.eurpsy.2020.58>)

⁵⁰Kavoor, A. R. (2020). “COVID-19 te njerëzit me sëmundje mendore: Sfidat dhe dobësitë”. *Asian Journal of Psychiatry*, 51, 102051; Kola, L., Kohrt, B. A., Hanlon, C., Naslund, J. A., Sikander, S., Balaji, M., ... & Patel, V. (2021). “Ndikimi dhe përgjigjet e shëndetit mendor COVID-19 në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme: duke imagjinuar shëndetin mendor global”. *The Lancet Psychiatry*; Vigo, D., Patten, S., Pajer, K., Krausz, M., Taylor, S., Rush, B., ... & Yatham, L. N. (2020). “Shëndeti mendor i komuniteteve gjatë pandemisë COVID-19”; Kelly BD. “Sëmundja koronavirus: sfidat për psikiatrinë”. *Br J Psychiatry* 2020;217(1):352–3.

⁵¹ Onwumere J. “Kujdestarët joformalë në kushte të rënda të shëndetit mendor: çështje të ngritura nga Mbretëria e Bashkuar SARS-CoV-2 (COVID-19) pandemic”. *Int J Soc Psychiatry* 2020; May 10, (linku: <https://doi.org/10.1177/0020764020927046>)

⁵² Rahman M, Ahmed R, Moitra M, Damschroder L, Brownson R, Chorpita B, Idele P, Gohar F, Huang KY, Saxena S, Lai J, Peterson SS, Harper G, McKay M, Amugune B, Esho T, Ronen K, Othieno C and Kumar M (2021), “Shqetësimi mendor dhe shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë COVID-19: Një rishikim i shpejtë i dëshmisë që informon të drejtat, nevojat e shëndetit mendor dhe politikën publike për popullatat e cenueshme”. *Front. Psychiatry* 11:603875. doi: 10.3389/fpsy.2020.603875.

⁵³ WHO, “COVID-19 duke prishur ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor në shumicën e vendeve”, (linku: <https://www.who.int/news/item/05-10-2020-covid-19-disrupting-mental-health-services-in-most-countries-who-survey>)

publikuar rezultatet e një hulumtimi mbi ndikimin e pandemisë në sistemet shëndetësore në 105 shtete të botës.⁵⁴ Nga të dhënat nga pesë rajone për periudhën mars-qershor 2020, dëshmohej se pothuajse çdo shtet (90%) ka përjetuar ndërprerje të shërbimeve të tyre shëndetësore, më të prekura kanë qenë shtetet me të ardhura të ulëta dhe mesatare.⁵⁵ Mbi 60% raportuan ndërprerje të shërbimeve të shëndetit mendor për njerëzit në nevojë.⁵⁶

Qasja më e dobët në shërbime dhe në mbështetje të pranuar që nga fillimi i pandemisë COVID-19 është gjetur në 8 studime.⁵⁷ Këtë e kanë konstatuar edhe studime të tjera.⁵⁸ Një studim po ashtu gjen se distancimi fizik ka zvogëluar pasjen e shumë mbështetjeve familjare, sociale dhe psikiatrike.

Shëndeti mendor në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19: të drejtat e njeriut në kontekst

Nga fillimi i përhapjes së pandemisë është diskutuar për ndikimin që mund ta ketë te shëndeti mendor, mirëpo në mungesë të analizave nuk ka pasur qëndrime të qarta se si duhet të trajtohet ky aspekt.

Nga raportimet në media është vërejtur se pandemia ka prishur ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor duke privuar shumë njerëz nga mbështetja e nevojshme. Gjithashtu është vërejtur se përkundër kërkesës në rritje për mbështetje të shëndetit mendor, MSh-ja nuk ka ndarë ndonjë fond shtesë për shërbimet e shëndetit mendor, ngase sipas zëdhënësit në këtë ministri, buxheti për shëndetin mendor ekziston.⁵⁹ Dihet se në Kosovë vetëm 2% e buxhetit shëndetësor është shpenzuar për shërbimet e shëndetit mendor, që është përsëri më i ulët se mesatarja e BE-së prej 4%.⁶⁰

Përballë pandemisë në Kosovë, ofrimi i shërbimeve thelbësore të shëndetit mendor për popullatën nga Qendrat e Shëndetit Mendor në formën e vizitave në shtëpi, vizitat urgjente psikiatrike, linjat telefonike të ndihmës psikologjike etj., kanë vazhduar.⁶¹ Qendra e Shëndetit Mendor në Prizren vazhdoi të ofronte terapi online ICBT, si pjesë e projektit Implementall, financuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të kornizës Horizon 2020.⁶²

Ndërkohë gjatë pandemisë kanë vazhduar edhe disa përpjekje të fragmentuara, si p.sh.: krijimi i shërbimeve telefonike dhe i atyre të tjera mbështetëse të shëndetit mendor në internet (MSh-ja dhe Departamenti i Psikologjisë së UP) që ofronin ndihmën e parë psikologjike gjatë

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Moreno, C., Wykes, T., Galderisi, S., Nordentoft, M., Crossley, N., Jones, N., ... & Arango, C. (2020). "Si duhet të ndryshojë kujdesi për shëndetin mendor si pasojë e pandemisë COVID-19". *The Lancet Psychiatry*.

⁵⁸ Pfefferbaum B and North CS: Mental health and the Covid.19 pandemic. *N Engl J Med* 383: 510-512, 2020.

⁵⁹ Kasapolli-Selani, "Ankthi dhe depresioni, problemet më të shpeshta në pandemi", (linku: <https://www.evropaelire.org/a/shendeti-mendor-pandemia-30917863.html>)

⁶⁰ Fanaj N & Mustafa: "Gjendja e reformës së shëndetit mendor në dritën e ndërhyrjeve të reja të shëndetit mendor. Punim i paraqitur në Seksionin e Epidemiologjisë dhe Psikiatrisë Sociale të Kongresit të 19-të", (linku: https://www.researchgate.net/publication/324683979_STATE_OF_MENTAL_HEALTH_CARE_REFORM_IN_KOSOVO_IN_LIGHT_OF_NEW_MENTAL_HEALTH_INTERVENTIONS) 2018.

⁶¹ Fanaj, N., & Mustafa, S. (2021). "Depresioni i matur me PHQ-9 në Kosovë gjatë shpërthimit të COVID-19: një sondazh online". *Psychiatria Danubina*, Vol. 33, No. 1, pp 95-100.

⁶² Po aty.

pandemisë.⁶³ Në total 35 vullnetarë ofruan ndihmën e parë psikologjike nëpërmjet një telefoni, 7 ditë në javë, ku nga prilli deri në gusht 2020 kishte 1278 thirrje të regjistruara nga e gjithë Kosova dhe ku shqetësimet kryesore për thirrje ishin: ankth, depresion, frikë nga COVID-19, probleme financiare, probleme ndërpersonale dhe sociale, çështje shëndetësore në lidhje me pandeminë COVID-19 ose të ngjashme. Kurse gjatë prillit, majit dhe qershorit, në total 808 njerëz kontaktuan shërbimet e bisedës (chat).⁶⁴

Prevalenca e çrregullimeve të shëndetit mendor në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19

Shumë pak studime që kanë matur nivelin e çrregullimeve të shëndetit mendor në Kosovë gjatë pandemisë së COVID-19 janë gjendur në internet. Kështu një studim online i 904 studentëve nga UP-ja gjatë fazës së hershme të bllokimit kombëtar për shkak të pandemisë COVID-19, gjen se 22.4% raportuan nivele të lehta ankthi, 10.9% raportuan nivele mesatare të ankthit dhe 3.7% raportuan nivele të rënda të ankthit.⁶⁵ Po ashtu 18.5% raportuan nivele të lehta të depresionit, 7.9% raportuan nivele mesatare të depresionit dhe 1.7% raportuan nivele të rënda të depresionit. Sipas autorëve⁶⁶, nivelet e depresionit dhe të ankthit në këtë studim ishin më të ulëta sesa ato të raportuara në Bangladesh, kurse gjetjet mbi ashpërsinë e ankthit ishin të ngjashme me gjetjet nga studimet që eksplorojnë shëndetin mendor të studentëve gjatë pandemive, të tilla si për ankthin në Kinë, në Itali, në Kroaci, në Spanjë dhe në Shqipëri.

Një studim i shpejtë në internet për të shqyrtuar ndikimin e pandemisë COVID-19 në statusin dhe në shëndetin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor në një mjedis shëndetësor në shëndetin publik në Kosovë, në prill 2020, që përfshiu 592 punonjës të kujdesit shëndetësor, gjen se nivel anormal të ankthit kishin 44.6% dhe të depresionit kishin 38.7%.⁶⁷ Sipas autorëve, nivelet e rezultuara ishin shqetësuese, megjithëse mungon një krahasim para-COVID-19.

Në një studim tjetër online⁶⁸, ku ishin 155 pjesëmarrës, në periudhën 27.4.2020 deri më 5.6.2020, del se 63% e pjesëmarrësve ranë dakord se situata e ka përkeqësuar gjendjen e tyre psikologjike; 35.6% kishin një formë të lehtë deri të rëndë depresioni dhe 18.7% kishin simptoma minimale. Depresioni dukshëm më i lartë rezultoi për femrat dhe për grup-moshën 18 deri 24 vjeç.⁶⁹ Sipas autorëve, gjetjet që 63% kanë përkeqësim të gjendjes së tyre psikologjike, është më e lartë se raportet në Itali (38%); në Spanjë (31%) dhe në Kina (35%), por i ngjashëm me Iranin (61.1%) dhe me Bangladeshin (59.7%). Gjetja që 35.6% e pjesëmarrësve raportuan simptoma depresioni nga mesatarja në të rëndë, tregon një nivel të lartë depresioni në këtë mostër krahasuar me studimin në Shqipëri 25.2% dhe në Bosnjë e

⁶³ Arenliu, A., Uka, F., & Weine, S. (2020). "Ndërtimi i shërbimeve të ndihmës së parë psikologjike online dhe telefonike në një mjedis të ulët të burimeve gjatë COVID-19: Rasti i Kosovës". *Psychiatra Danubina*, 32(3-4), 570-576.

⁶⁴Po aty.

⁶⁵ Arënliu, A.; Bërxulli, D.; Perolli - Shehu, B.; Krasniqi, B.; Gola, A. & Hyseni, F. (2021). "Ankthi dhe depresioni në mesin e studentëve të universiteteve kosovare gjatë fazës fillestare të shpërthimit dhe bllokimit të pandemisë COVID-19", *Health Psychology and Behavioral Medicine*, 9:1, 239-250, DOI: 10.1080/21642850.2021.1903327.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Gallopeni, F., Bajraktari, I., Selmani, E., Tahirbegolli, I. A., Sahiti, G., Muastafa, A., ... & Tahirbegolli, B. (2020). "Ankthi dhe simptoma depresive në mesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë: Një studim kryq sektoria". *Journal of psychosomatic research*, 137, 110212.

⁶⁸ Fanaj, N., & Mustafa, S. (2021). "Depresioni i matur me PHQ-9 në Kosovë gjatë shpërthimit të COVID-19: një sondazh online". *Psychiatra Danubina*, Vol. 33, No. 1, pp 95-100.

⁶⁹ Po aty.

Hercegovinë 28.4%, si dhe me të gjitha studimet e tjera të cituara këtu, që shënuan 17.3 deri 31.6%.⁷⁰

Raporti i Tretë i Vlerësimi të Shpejtë të Ndikimit Socio-ekonomik i COVID-19 në Kosovë i UNDP-së, UN Women, UNFPA-së dhe i UNKT-së, i publikuar në maj 2021,⁷¹ ndër të tjera ka bërë edhe matjen e prishjes së shëndetit të tyre psikologjik ose mendor te rreth 1400 respondentë. Përderisa në rundin e parë, në mars 2020, prishje raportnin 28%, në rundin e dytë, në nëntor 2020, prishje raportnin 36%; në rundin e tretë, në mars 2021, prishje raportnin 23%. Një sondazh online Kosovo - Mental Health U-Report, i 30 tetorit 2020, gjen se ndër 1401 respondentë, vetëm 8% e kanë përdorur linjën e ndihmës për shëndet mendor, ndërsa 35% as që e kanë ditur që ekzistonte.⁷² Po ashtu 18% janë përgjigjur se mbështetja profesionale e shëndetit mendor do të ishte më ndihmuese për t'u ndierë më mirë dhe më sigurt gjatë pandemisë.

Është publikuar edhe një studim online tek 897 studentë nga gjashtë universitete në Kosovë, që u krye në shkurt të vitit 2021, ku del se 73.5% e mostrës përjetonin ankth, përkatësisht 12.9% e tyre ankth të rëndë, 22.2% ankth të moderuar dhe 38.4% ankth të butë.⁷³ Një komunikim me e-mail me Zyrën e Informimit të DPP na tregon se bazuar në të dhënat e Sistemit Informativ të PK-së, në vitin 2019 ka pasur 31 vetëvrasje dhe 142 tentim të vetëvrasjes; në vitin 2020 ka pasur 40 vetëvrasje dhe 101 tentim të vetëvrasjes, ndërsa deri më 21 korrik 2021 ka pasur 21 vetëvrasje dhe 81 tentim të vetëvrasjes. Sipas mendimit tonë, ky shtim për 9 raste nuk tregon rritje, sepse prapëseprapë shifra prej 40 rasteve është më e ulët sesa mesatarja për 19 vitet e pasluftës në Kosovë që është 55 raste për vit.⁷⁴

Përgjigjet e institucioneve publike të shëndetit mendor gjatë pandemisë

Lidhur me integrimin e politikave dhe praktikave të drejtave të njeriut në politikën dhe në menaxhimin e përgjigjes ndaj pandemisë COVID-19 në institucionet e shëndetit mendor, të intervistuarit nuk japin të dhëna nëse kjo është realizuar. Disa dokumente të realizuara që më shumë synojnë përcaktimin e veprimeve, si p.sh.: “*Plani i Veprimit për Shëndet Mendor gjatë dhe pas pandemisë COVID-19- 2020-2021*”, i nënshkruar në dhjetor 2020 dhe i publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Shëndetësisë, nuk japin përgjigje në këtë drejtim. Përkundrazi, ky ka ngelur një dokument i panjohur për institucionet dhe fare nuk është bërë përpjekje për implementimin e tij. Edhe një dokument tjetër i konceptuar në nëntor 2020: “*Procedura Standarde Operative (PSO) për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë*”, nuk është miratuar dhe as proceduar për implementim. Manualin për mbrojtjen nga përhapja e virusit COVID-19, i Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ka asnjë fjalë që merr parasysh specifikat

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Kombet e Bashkuara në Kosovë, “*Vlerësimi i shpejtë i ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 në Kosovë-3*”, qershor 2021, (linku: <https://kosovoteam.un.org/index.php/en/130632-rapid-socio-economic-impact-assessment-covid-19-kosovo-3>)

⁷² Ballkani Perëndimor, “*Kosovë - U -Raport i Shëndetit Mendor*”, tetor 2020, (linku: <https://westernbalkans.ureport.in/opinion/2100/>).

⁷³ Shala M, Çollaku Jetishi P, Hoxha A, Balaj Bllaca S. Preteni D. “*Një vit pas rasteve të para të COVID-19: Faktorët që ndikojnë në ankthin tek studentët e Universitetit Kosovar*”. J Health Soc Sci. 2021;6(2):241-254.

⁷⁴ Korrespondenca me email me Zyrtarin për Informim të Policisë së Kosovës, 21.07.2021.

e personave me çrregullime mendore. Të intervistuarit në këtë pyetje theksin e vënë vetëm tek mosndërprerja e shërbimeve.

Në menaxhimin e pandemisë COVID-19 në institucionet e shëndetit mendor, nga përgjigjet e të intervistuarve është e qartë se përfaqësuesit e shëndetit mendor nuk janë përfshirë në asnjë nga trupat ose mekanizmat e krijuar për menaxhimin e pandemisë COVID-19 (MSh, ShSKUK, komuna). Disa hapësira të Klinikës së Psikiatrisë janë dhënë në përdorim për klinikat e tjera në të cilat janë vendosur të sëmurët me COVID-19. Vetëm një komitet komunal ka pasur përfaqësuesin e shëndetit mendor. Edhe tre nga të intervistuarit që mendonin se kanë qenë pjesë e mbulimit shëndetësor, nga shembujt që japin bëhet fjalë për angazhime të zakonshme të shërbimeve të shëndetit mendor, por jo të një qasjeje integrale në menaxhimin e pandemisë nga institucionet.

Lidhur me furnizimin e vazhdueshëm me banra dhe qasje në to për të sëmurët kronikë psikiatrikë gjatë përballjes me pandeminë COVID-19 në institucionet e shëndetit mendor, përgjigjet e të intervistuarve theksonin se furnizimi bazik esencial ka qenë i mirë përkundër mungesës së disa preparateve. Në të shumtën, intervistuesit nuk janë përgjigjur lidhur me qasjen në banra të të sëmurëve kronikë psikiatrikë gjatë pandemisë.

Lidhur me konsultimin e ngushtë dhe përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe të organizatat e tyre përfaqësuese gjatë përballjes me pandeminë COVID-19 në institucionet e shëndetit mendor është e qartë se kjo nuk ka ndodhur në asnjë rast. Disa nga të intervistuarit përmendnin raste të bashkëpunimit që kanë pasur të bëjnë me ofrimin e ndihmës në strehimore (një intervistues), në kishë (një intervistues) ose në shtëpia me bazë në komunitet (një intervistues).

Sa i përket prioritizimit të testimit të të sëmurëve kronikë psikiatrikë (të vendosur në kujdesin rezidencial), si kategori e ndjeshme gjatë përballjes me pandeminë COVID-19, të intervistuarit janë shprehur se pavarësisht faktit se s' kanë pasur ndonjë prioritet, sa herë kanë pasur indikacion për testim, nuk kanë hasur në vështirësi për t'i kryer ato.

Testimi i të sëmurëve kronikë psikiatrikë, si kategori e ndjeshme gjatë përballjes me pandeminë COVID-19, sipas të intervistuarve, është bërë me indikacione e jo sipas faktit nëse është person me çrregullim kronik psikiatrik.

Vaksinimi i të sëmurëve kronikë psikiatrikë (të vendosur në kujdesin rezidencial dhe të të tjerëve që marrin shërbime në QShM), si kategori e ndjeshme gjatë përballjes me pandeminë COVID-19, sipas të intervistuarve, është radhitur me prioritet, pas vaksinimit të punëtorëve shëndetësorë; të moshave mbi 80 vjeç, 70 vjeç, 55 vjeç dhe pastaj të sëmurët kronikë. Sa u përket të sëmurëve kronikë psikiatrikë, që marrin shërbime në QShM, së fundmi janë hartuar listat e pacientëve, por nuk kanë informacion nëse është bërë diçka që të zbatohet vaksinimi i tyre me prioritet. Vetëm një QShM tregon se ekipet e vaksinimit kanë ardhur në institucion për t'i vaksinuar personat.

Lidhur me planifikimin dhe optimizmin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale (PPE) tek punonjësit shëndetësorë gjatë përballjes me pandeminë COVID-19 në institucionet e shëndetit mendor, të intervistuarit deklaruan se përgjithësisht kanë qenë të furnizuar mirë, por

nuk janë trajnuar për përdorimin e PPE-së. Një QShM e ka refuzuar trajnimin e ofruar nga Spitali Regjional.

Lidhur me faktin se a ka pasur informacion ose material informativ të përshtatur për specifikat e kategorisë së personave me sëmundje kronike psikiatrike gjatë përballjes me pandeminë COVID-19 në institucionet e shëndetit mendor, të intervistuarit deklaruan se kanë pasur materiale informative të përgjithshme, por jo të përshtatur specifikave të personave me sëmundje kronike psikiatrike.

Lidhur me faktin se çfarë ka qenë qasja dhe mbështetja në marrjen e shërbimeve shëndetësore për kategorinë e personave me sëmundje kronike psikiatrike gjatë përballjes me pandeminë e COVID-19 në institucionet e shëndetit mendor, të intervistuarit deklaruan se disa QShM e kanë ndërprerë qëndrimin ditor plotësisht, disa e kanë reduktuar shumë numrin e personave në qëndrim ditor. Sipas vendimeve nga Komiteti Menaxhues i ShSKUK-së për Pandeminë, ka pasur periudha kur janë kryer vetëm vizitat emergjente. Klinika e Psikiatrisë e ka ndërprerë punën në vizitat ambulatore. Klinika e Psikiatrisë dhe disa QShM kanë ofruar konsulta nëpërmjet telefonit. Një QShM ka ofruar një trajtim alternativ nëpërmjet psikoterapisë online në internet. Janë ndërprerë aktivitetet psikosociale, grupore dhe rekreative. Kanë vazhduar vizitat shtëpiake dhe dhënia e preparateve depo të antipsikotikëve. Janë dhënë shërbime të shëndetit mendor edhe në karantinë, në aeroport dhe në klinika me pacientë të shtrirë me COVID-19.

Lidhur me faktin se si është realizuar trajtimi në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër (Shtëpitë integruese dhe QIRSPK Shtime) gjatë periudhës së pandemisë, me theks të veçantë në sferën e lirive dhe të të drejtave, të intervistuarit deklaruan se varësisht nga gjendja e pandemisë, aktivitetet e natyrës psiko-sociale dhe rekreative janë zvogëluar ndjeshëm, po ashtu edhe daljet në shetitjet jashtë ShIB-it, por ka pasur periudha gjatë lirimimit të masave kur këto aktivitete i kanë rifilluar. Kontakti fizik me familjarët është ndërprerë dhe është bërë nëpërmjet telefonit.

Indikatorët nga raportet e punës së QShM-ve

Bazuar në raportet vjetore të viteve 2019 dhe 2020 si dhe nga raportet gjashtëmujore të viti 2021 të QShM-ve, gjejmë se ka një rënie të numrit të vizitave psikiatrike (14%), psikologjike (58%), të shërbimeve të punëtorit social (42%), të qëndrimit ditor (56%) si dhe të vizitave shtëpiake (47%), nga viti 2019 deri në vitin 2020. Edhe indikatorët për gjashtëmujorin e vitit 2021 tregojnë se numri i vizitave psikiatrike dhe psikologjike ka rënie të vogël krahasuar edhe me vitin 2020, kurse shërbimet e punëtorit social, të qëndrimit ditor si dhe të vizitave shtëpiake ngelen të njëjta ose janë përmirësuar pak krahasuar me vitin 2020.

Nga raportet kemi shikuar nëse kishte ndonjë ndryshim në kategoritë e çrregullimeve psikiatrike që kishin pranuar shërbime. Është e qartë se nuk ka ndonjë ndryshim ngase çrregullimet psikotike zinin dy të tretat e shfrytëzimit të shërbimeve: 72% (2019), 71% (2020) dhe 74% (2021). Çrregullimet e ankthit dhe ato depresive nuk tregojnë rritje (e hipotetizuar si pasojë e pandemisë) në shfrytëzimin e shërbimeve në shëndetin mendor: 18% (2019), 19% (2020) dhe 16% (2021).

Ndikimi i pandemisë në shëndetin mendor të popullatës

Në hulumtimin e publikuar online në faqen zyrtare të IAP-së në Facebook dhe të shpërndarë pastaj edhe në llogari të tjera nga autorët e hulumtimit, kemi pasur 196 respondentë (192 shqiptarë dhe 4 serbë). Sipas moshës ishin nga 17 deri 73 vjeç, moshja mesatare 37.41 vjeç. Sipas gjinisë respondentët 122 (62.2%) ishin femra, 72 (36.7%) meshkuj, kurse 2 (1%) raste nuk e kanë deklaruar gjininë. Sipas vendbanimit, 158 ose 80.6% e respondentëve ishin nga qyteti, 36 ose 18.4 % ishin nga fshati dhe 2 (1%) raste nuk e kanë deklaruar vendbanimin. Sipas nivelit të shkollimit të përfunduar, më së shumti ishin me nivel baçelor – 81 ose 41.3 %, pastaj me master 76 ose 38.8%, me shkollë të mesme 27 ose 13.8%, me doktoratë 8 ose 4.1% dhe me fillore 4 ose 2%. Mbi gjysma e respondentëve – 113 ose 57.7%, ishin të martuar, 75 ose 38.3% ishin të pamartuar, 5 ose 2.6% të ve dhe 3 ose 1.5% të divorcuar. Sipas gjendjes ekonomike, shumica ishin me gjendje të mesme të deklaruar, 130 ose 66.3%, me gjendje të mirë 59 ose 30.1%, dhe me gjendje të dobët ekonomike 7 ose 3.6%. Prej tyre ishin 84.1% të punësuar.

Në pyetjen se a kanë pasur ndonjë çrregullim mendor para pandemisë, vetëm 5 respondentë ose 2.6% kanë deklaruar se po, 11.3% e respondentëve kanë deklaruar se kanë sëmundje kronike mjekësore. Gati gjysma e respondentëve 90 ose 45.9% kanë deklaruar se kanë qenë të infektuar me COVID-19.

Në pyetjen se a keni pasur përkeqësim të gjendjes psikike gjatë pandemisë, me po janë përgjigjur 21 respondentë, ose 10.7%; deri diku 66 të tillë, ose 33.7%.

Në pyetjen se a keni ndier nevojë të kërkontë ndihmë nga psikologu/psikiatri, 43 respondentë ose 21.9% janë shprehur pozitivisht. Por ndihmë kanë kërkuar vetëm 12 ose 6.1% e respondentëve. Arsyet e shprehura se pse nuk kanë kërkuar ndihmë, janë: S' kam pasur informacion se ku (18 respondentë); Kam pasur turp (6 sosh); Kam pasur frikë nga infektimi (9 të tillë); S' kam pasur besim (7 respondentë); Kam pasur përvoja të këqija më herët (4 persona). Nga personat që kanë marrë ndihmë del se 31% kanë marrë ndihmë si konsultë nga interneti, 21% kanë marrë ndihmë nga mjekët privatë, 17% nëpërmjet telefonit, 10% në klinikë dhe po aq në mjekësinë familjare, 7% në spital. Duhet të kemi parasysh se 4 raste kanë marrë ndihmë në dy vende. 19.4% nuk kanë qenë aspak të kënaqur me ndihmën e ofruar, 51.6% deri diku kanë qenë të kënaqur dhe 29% kanë qenë të kënaqur shumë.

Në pyetjen se pse nuk keni marrë ndihmë, janë përgjigjur 40 respondentë, ku prej tyre 45% e theksojnë pamundësinë financiare për trajtim tek mjekët privatë, 30% deklarohen se kjo ndihmë nuk u është ofruar në institucione shëndetësore publike dhe 25% sepse nuk kanë mundur të udhëtonin.

11.4 % e respondentëve kanë deklaruar se kanë familjarë të afërt me sëmundje mendore, 9.7% e tyre kanë marrë ndihmë psikologjike/psikiatrike gjatë pandemisë për ta. Prej tyre 4.1% e kanë marrë ndihmën nga mjekët privatë, 2.6% nga konsultimet prej internetit, 1.5% në spital dhe nga 1% në QShM, në klinikë dhe nëpërmjet telefonit.

Indeksi i Shëndetit Mendor i matur me anë të pyetësorit për muajin e fundit, d.m.th. deri në kohën e kryerjes së hulumtimit, ka treguar vlerën mesatare prej 153.18 (devijimi standard 31.21); distresi psikologjik i respondentëve ka rezultuar me vlerë mesatare 63.28 (devijimi standard 21.13), mirëqenia psikologjike ka rezultuar me vlerë mesatare 49.26 (devijimi

standard 9.15), ankthi ka rezultuar me vlerë mesatare 23.98 (devijimi standard 8.82), depresioni ka rezultuar me vlerë mesatare 10.32 (devijimi standard 4.11) dhe kënaqësia e jetës ka rezultuar me vlerë mesatare 7.85 (devijimi standard 2.45).

Këto vlera bazuar në rangun e rezultatit total janë përreth mesatares së vlerave dhe tregojnë një nivel mesatar të vështirësive. Sa i përket distresit psikologjik, 65.8% e respondentëve janë nën vlerën mesatare; tek ankthi 67.4%; tek depresioni 64.1%; tek kënaqësia me jetën vetëm 9.7%. Ndërsa tek Indeksi i Shëndetit Mendor vetëm 12% e respondentëve janë nën vlerën mesatare.

Ndonëse femrat kanë indeks më të vogël të shëndetit mendor, kurse distres psikologjik, ankth dhe depresion më tepër, këto dallime nuk janë sinjifikative. Të papunët kanë rezultuar se kanë indeks më të vogël të shëndetit mendor, kurse distres psikologjik, ankth dhe depresion më të madh sinjifikativisht. Personat që kanë deklaruar se edhe më parë kanë pasur çrregullim mendor kanë rezultuar se kanë indeks më të vogël të shëndetit mendor, kurse distres psikologjik, ankth dhe depresion më të madh sinjifikativisht. Personat që kanë deklaruar se vuajnë nga sëmundje mendore kronike kanë rezultuar se kanë indeks më të vogël të shëndetit mendor, kurse distres psikologjik, ankth dhe depresion më të madh sinjifikativisht. Të qenët i infektuar me COVID-19 nuk tregohet se ka ndikuar në indeksin e shëndetit mendor, distresit psikologjik, ankthit dhe depresionit. Personat që kanë deklaruar se kanë gjendje ekonomike të dobët kanë rezultuar se kanë indeks më të vogël të shëndetit mendor, kurse distres psikologjik, ankth dhe depresion më të madh sinjifikativisht.

Vështirësitë që i kanë përjetuar personat me çrregullime mendore gjatë pandemisë sipas perceptimit të punëtorëve shëndetësorë

Pyetësorin lidhur me vështirësitë që i kanë përjetuar personat me çrregullime mendore gjatë pandemisë sipas perceptimit të punëtorëve shëndetësorë, e kanë plotësuar 80 profesionistë të shëndetit mendor nga të gjitha QShM-të. Këta punëtorë janë zgjedhur për faktin se ata kanë qenë direkt në kontakt me pacientët me çrregullime mendore gjatë kohës së pandemisë. Plotësimi është bërë direkt në kontakt me psikologun e IAP-së. 57 prej tyre ishin femra, 23 meshkuj. Moshë e punëtorëve ishte nga 22 deri në 62 vjeç (mesatarja 44.18 vjeç). Sipas profesionit, 59 ishin infermierë, 9 psikiatër, 4 psikologë, 4 punëtorë socialë, 3 këshilltarë psiko-socialë dhe një punëtor administrativ. Përgjigjet në pyetjet e dhëna janë mundësuar nëpërmjet një shkalle në rangun 1 (fare e parëndësishme) deri në 5 (shumë e rëndësishme).

Vështirësitë që i kanë përjetuar personat me çrregullime mendore gjatë pandemisë	Mesatarja	Devijimi standard
Rikthimi dhe përkeqësimi i shëndetit mendor të shkaktuar nga streset e COVID-19	4.66	0.65
Rritja e vështirësive për familjet/kujdestarët	4.53	0.68
Mungesa e qasjes në mbështetjen e zakonshme nga shërbimet e shëndetit mendor	4.50	0.90
Detyrimi për të qëndruar në shtëpi në kushte të këqija, ose të mos pasurit shtëpi	4.47	0.97

Mungesa e qasjes në rrjetet e zakonshme të mbështetjes së familjes dhe miqve	4.43	0.88
Mungesa e qasjes në barna dhe në proceset për administrimin dhe monitorimin e tij	4.43	0.78
Mungesa e punës dhe e aktiviteteve të tyre të zakonshme	4.35	0.84
Rritja e rrezikut nga marrëdhëniet abuzive në familje	4.35	0.87
Vështirësitë për ushqim, para ose burime të tjera themelore për nevojat	4.30	0.95
Vështirësia për të kuptuar ose ndjekur kërkesat aktuale të qeverisë për distancimin shoqëror, vetë-izolimim dhe/ose mbrojtjen	4.26	0.76
Rreziku i rritjes së përdorimit të drogës dhe të alkoolit ose lojërave të fatit	4.22	0.86
Qasja e zvogëluar në kujdesin shëndetësor fizik për probleme të tjera, përveç COVID-19	4.18	1.07
Mungesa e qasjes në mbështetjen e zakonshme nga shërbimet e tjera (kujdesi parësor, kujdesi social, sektori vullnetar)	4.11	0.86
Problemet me policinë ose me autoritetet e tjera për shkak të mungesës së të kuptuarit/aftësisë për t'iu përmbajtur kërkesave aktuale të qeverisë për COVID-19	4.03	1.07

Siç shihet edhe nga tabela, punëtorët e shëndetit mendor gati unanimisht i vlerësojnë nga mesatarisht të rëndësishëm deri në shumë të rëndësishëm të 14 faktorët e përmbledhur në këtë pyetësor. Bie në sy se *Mungesa e qasjes në mbështetjen e zakonshme nga shërbimet e shëndetit mendor* renditet e treta për nga rëndësia (67.5% e shohin shumë të rëndësishme) dhe vjen pas *Rikthimit dhe përkeqësimit të shëndetit mendor të shkaktuar nga streset e COVID-19* (75% e shohin shumë të rëndësishme) dhe *Rritjes së vështirësive për familjet/kujdestarët* (64% e shohin shumë të rëndësishme).

Përvojat e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë

Pyetësorin lidhur me përvojat e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë e kanë plotësuar 121 respondentë nga të gjitha Qendrat e Shëndetit Mendor. Respondentët ishin vetë pacientët në -113 raste (93.4 %) kurse familjarët e tyre në 8 raste (6.6%). Plotësimi është bërë në të gjitha Qendrat e Shëndetit Mendor direkt në kontakt me pacientët/ familjarët e tyre nga psikologu i IAP (33 raste ose 24.8%) dhe nga infermierët (91 raste ose 75.2%). Sipas moshës ishin nga 22 deri 76 vjeç, moshë mesatare 46.52 vjeç. Sipas gjinisë respondentët 36 (29.8 %) ishin femra, 85 (70.2 %) mashkuj. Sipas vendbanimit 110 ose 90.9 % e respondentëve ishin nga qyteti, 11 ose 9.1 % ishin nga fshati. Sipas diagnozës së çrregullimit 108 ose 89.3 % e pacientëve ishin të sëmurë nga skizofrenia, 8 raste nuk deklaruan

diagnozën e tyre, 3 raste ishin me prapambetje mendore dhe dy raste me çrregullime personaliteti. Përgjigjet ishin në rangun nga 0 (jo) deridiku (1) dhe po (2).

Përvojat e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë	Mesatarja	Deviji mi standard	Përgjigjet me PO (%)
Në 12 muajt e fundit, a ju ka mbështetur dikush nga shërbimet e shëndetit mendor për t'u bashkuar me një grup ose për të marrë pjesë në një aktivitet?	0.95	0.96	43.0
A kanë përfshirë shërbimet e shëndetit mendor një anëtar të familjes suaj ose dikush tjetër afër jush aq sa ju dëshironit?	1.24	0.91	56.3
A e dinit kë të kontaktonit jashtë orarit të punës së QShM-së, nëse do të kishit një krizë?	1.28	0.93	61.2
Në 12 muajt e fundit, a ju kanë dhënë ndonjë ndihmë ose këshillë shërbimet e shëndetit mendor për të gjetur mbështetje financiare ose sociale?	1.50	0.82	71.1
A ishit i përfshirë gjatë vizitave aq sa do dëshironit se çfarë kujdesi do të merrni?	1.52	0.70	64.1
A kanë diskutuar ndonjëherë me ju për ilaçet tuaja?	1.69	0.63	78.5
A ju është dhënë koha e mjaftueshme për t'i diskutuar nevojat dhe trajtimin tuaj?	1.82	0.45	84.3
Në 12 muajt e fundit, a e morët ndihmën që ju duhej kur u përpoqët të kontaktonit shërbimet e shëndetit mendor?	1.83	0.42	85.1
Në 12 muajt e fundit, a ndiheni se keni marrë shërbime të shëndetit mendor shpesh mjaftueshëm për nevojat tuaja?	1.85	0.46	89.2
Në përgjithësi, në 12 muajt e fundit, a keni ndierë se jeni trajtuar me respekt dhe dinjitet nga shërbimet e shëndetit mendor?	1.90	0.37	92.6

Nga këto përgjigje shihet se në shumicën e çështjeve të ngritura rezultojnë vlera mbi mesataren që sugjerojnë një përvojë të themi deri diku të kënaqshme të këtyre pacientëve me shërbimet e shëndetit mendor. Siç shihet edhe nga tabela komponenti që ka munguar më së shumti është bështetja nga shërbimet e shëndetit mendor për t'u bashkuar me një grup ose për të marrë pjesë në një aktivitet (43% përgjigjen me PO), përfshirja nga shërbimet e shëndetit mendor e një anëtari të familjes tuaj ose dikujt tjetër afër të tyre aq sa ju dëshironit (56.3% përgjigjen me

PO), mosdija se kë të kontaktonin jashtë orarit të punës së QShM-së nëse do të kishin një krizë (61.2% përgjigjen me PO).

Janë sidomos pozitive dhe inkurajuese përgjigjet me PO që kalojnë 80% në rastin e marrjes së ndihmës/shërbimeve të shëndetit mendor dhe sidomos ndjesia e trajtimit me respekt dhe me dinjitet nga shërbimet e shëndetit mendor në një nivel prej 92.6%. Kemi shikuar nëse ka dallim në përgjigjet e familjarëve nga pacientët dhe të vetmin dallim sinjifikativ e gjejmë se familjarët japin më tepër përgjigje negative në pyetjen: *Në 12 muajt e fundit, a ndiheni se keni marrë shërbime të shëndetit mendor shpesh mjaftueshëm për nevojat tuaja.*

Kemi vërejtur dallim sinjifikativ edhe në rastin e plotësimit të pyetësorit nga psikologu i IAP-së me rastet kur janë plotësuar nga infermierët në QShM. Kështu në pyetjen: A e dinit kë të kontaktonit jashtë orarit të punës së QShM-ve nëse do të kishit një krizë?; Në 12 muajt e fundit, a e morët ndihmën që ju duhej kur u përpoqët të kontaktonit shërbimet e shëndetit mendor?; A kanë përfshirë shërbimet e shëndetit mendor një anëtar të familjes tuaj ose dikush tjetër afër jush aq sa ju dëshironit?, përgjigjet pozitive ishin më të ulëta kur intervistuesi ishte psikologu i IAP-së; kurse në pyetjen: Në 12 muajt e fundit, a ju kanë dhënë ndonjë ndihmë ose këshillë shërbimet e shëndetit mendor për të gjetur mbështetje financiare ose sociale?, përgjigjet pozitive ishin më të larta kur intervistuesi ishte psikologu i IAP-së.

QIRSPK në Shtime po ashtu ka lënguar ngase ka pasur zvogëlim të shërbimeve të ofruara dhe të realizuara, por jo ndërprerje. Treguesit e punës nga raportet e QShM-ve tregojnë një rënie të shërbimeve në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, rënie kjo që vazhdon edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021; kështu kemi një rënie të shërbimeve në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 (nga 14% për vizitat psikiatrike, deri në 56% për qëndrim ditor dhe 58% për vizitat psikologjike), rënie kjo që vazhdon edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Si përfundim, duke njohur kompleksitetin e temës së këtij raporti për të njohur ndikimin e pandemisë në shëndetin mendor në dritën e së drejtës për kujdes shëndetësor, vendosëm për një dizajn të përzier – cilësor dhe sasior, në të cilin u hetuan pikat thelbësore në disa nivele të shoqërisë kosovare: institucionet dhe përgjigjet e shtetit, shëndetin mendor të popullatës në përgjithësi, perceptimet e punëtorëve të shëndetit mendor si dhe përvojat e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor. Gjetjet tona janë të dobishme përkundër disa kufizimeve që mund të përvijohen në këtë raport.

Hulumtimi i plotësuar online tregon se përkeqësim të gjendjes psikike gjatë pandemisë kanë pasur rreth 44.4% (10.7 % PO dhe 33.7% DERI DIKU). Kjo gjetje është më e ulët se në studimin e Fanaj & Mustafa (2021)⁵⁶ dhe më afër niveleve të studimeve nga vendet e tjera të cituara po aty. Ky rezultat i gjetur është më i lartë se në një raport⁷⁵ të shqyrtuar këtu (23-36%). Edhe pse 21.9% kanë ndier nevojën e ndihmës psikologjike/psikiatrike, një numër i vogël i tyre (6.1%) kanë marrë ndihmë, mospasja e informacionit se ku ofrohet ndihma ceket si arsyeja kryesore që nuk kanë kërkuar ndihmë. Përderisa 31% ndihmën e kanë marrë nëpërmjet internetit, 21% nga mjekët privat; por 19.4% nuk kanë qenë aspak të kënaqur me ndihmën e

⁷⁵ Kombet e Bashkuara në Kosovë, “Vlerësimi i shpejtë i ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 në Kosovë -3”, korrik 2021, (linku: <https://kosovoteam.un.org/index.php/en/130632-rapid-socio-economic-impact-assessment-covid-19-kosovo-3>)

ofruar. Këto gjetje me një numër të vogël të respondentëve janë të vështira për t'i përgjithësuar dhe mund të na shërbejnë veç si një indikator i shpejtë.

Për të njohur gjendjen e shëndetit mendor në muajin e fundit para këtij hulumtimi, na tregojnë shifrat se 65.8% e respondentëve janë nën vlerën mesatare të distresit psikologjik; tek ankthi 67.4%; tek depresioni 64.1%, ndërsa tek Indeksi i Shëndetit Mendor vetëm 12% e respondentëve janë nën vlerën mesatare. Këto gjetje tregojnë për një nivel mesatar të distresit, ankthit dhe depresionit si dhe një nivel të kënaqshëm të indeksit të shëndetit mendor. Nuk ka ndonjë dallim sinjifikativ të këtyre rezultateve me një studim të vitit 2017 në Kosovë⁷⁶.

Ndoshta në vijë me këtë nivel të gjetur të distresit dhe çrregullimeve mund të jetë edhe fakti se çrregullimet e ankthit dhe ato depressive nuk tregojnë rritje (e hipotetizuar si pasojë e pandemisë) në kumulativin e shfrytëzimit të shërbimeve në shëndetin mendor bazuar nga raportet e QShM-ve.

Mund të themi se këto vlera janë më pozitive dhe jo në përputhje me gjetjet e studimeve të pakëta të realizuara për shëndetin mendor gjatë pandemisë në Kosovë.⁷⁷ Kjo mund të jetë e ndikuar edhe nga fakti se studimi kryhet në një fazë kur pandemia është në një nivel shumë të ulët dhe ka ndodhur një çlirim i madh në jetën e njerëzve.

Gjetja sipas perceptimit të punëtorëve të shëndetit mendor se mungesa e qasjes në mbështetjen e zakonshme nga shërbimet e shëndetit mendor, renditet e treta për nga rëndësia (67.5% e shohin shumë të rëndësishme) në vështirësitë që i kanë përjetuar personat me çrregullime mendore gjatë pandemisë, kjo është një tregues i cenimit të shërbimeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë.

Një tregues tjetër për vështirësitë e ballafaquara gjatë pandemisë janë gjetjet se sipas shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor, komponenti që ka munguar më së shumti është *Mbështetja nga shërbimet e shëndetit mendor për t'u bashkuar me një grup ose për të marrë pjesë në një aktivitet; Përfshirja nga shërbimet e shëndetit mendor e një anëtari të familjes tuaj ose dikujt tjetër afër tyre dhe Mosdija se kë të kontaktojnë jashtë orarit të punës së QShM nëse do të kishin një krizë*. Por nga ana tjetër është tregues për t'u lëvdur fakti se mbi 80% pozitivisht e vlerësojnë marrjen e ndihmës/shërbimeve të shëndetit mendor dhe sidomos ndjesinë e trajtimit me respekt dhe dinjitet nga shërbimet e shëndetit mendor në një nivel prej 92.6%.

Intervistat me zyrtarët publikë sjellin faktet se menaxhimi nga MSh/ShSKUK/institucionet ka dështuar që ta bënte integrimin e politikave dhe praktikave të të drejtave të njeriut në politikën dhe menaxhimin e përgjigjes ndaj pandemisë COVID-19; në të qenët e shëndetit mendor pjesë e mbulimit shëndetësor të përgjithshëm në menaxhimin e përgjigjes ndaj pandemisë COVID-19; konsultimin e ngushtë dhe përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese dhe të pasurit informacion ose material informativ të përshtatur

⁷⁶ Fanaj, N., Mustafa, S., Shkëmbi, F., Kabashaj, B., & Fanaj, B. (2017). "Shqyrtimi i problemeve të shëndetit mendor si tregues për vlerësimin e nevojave për shërbime të shëndetit mendor". *European Psychiatry*, 41(S1), S570-S571.

⁷⁷ Fanaj, N., & Mustafa, S. (2021). "Depresioni i matur me PHQ-9 në Kosovë gjatë shpërthimit të COVID-19: një sondazh online". *Psychiatria Danubina*, Vol. 33, No. 1, pp 95-100.

për specifikat e kategorisë së personave me sëmundje kronike psikiatrike. Këto janë ndër veprimet e kërkuara nga organizma ndërkombëtarë si OHCHR, WHO etj.⁷⁸

Në vijë me konstatimet e sipërme është edhe fakti se nuk ka pasur prioritizim në testimin e të sëmurëve kronikë psikiatrikë (të vendosur në kujdesin rezidencial) si popullatë e ndjeshme, përkundër faktit ata i kanë realizuar pa vështirësi këto kur ka pasur indikacione. Nuk ka pasur prioritet as në vaksinimin e të sëmurëve kronikë psikiatrikë (të vendosur në kujdesin rezidencial), ndonëse ata shumica janë vaksinuar tashmë, por ka ngecur vaksinimi i të sëmurëve kronikë psikiatrikë në komunitet si kategori e ndjeshme. Në aspektin e planifikimit dhe optimizimit të përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale (PPE) tek punonjësit shëndetësorë ka munguar komponenti i trajnimit/edukimit.

Qasja dhe mbështetja në marrjen e shërbimeve shëndetësore për kategorinë e personave me sëmundje kronike psikiatrike si dhe trajtimi në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër (Shtëpitë integruese dhe QIRSPK Shtime) është cenuar, ngase ka pasur zvogëlim të shërbimeve të ofruara dhe të realizuara, por jo ndërprerje. Treguesit e punës nga raportet e QShM-ve tregojnë një rënie të shërbimeve në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, rënie kjo që vazhdon edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021; kështu kemi një rënie të shërbimeve në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 (nga 14% për vizitat psikiatrike, deri në 56% për qëndrim ditor dhe 58% për vizitat psikologjike), rënie kjo që vazhdon edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Prandaj, marrë parasysh të gjeturat e trajtuara më lart, Avokati i Popullit vlerëson se përkundër niveleve të larta të çrregullimeve psikiatrike nga disa studime në Kosovë gjatë pandemisë së COVID-19, niveli i distresit psikologjik, i ankthit dhe i depresionit në kohën e hulumtimit tonë është mesatar. Edhe niveli i perceptuar i përkeqësimit psikologjik nga pandemia COVID-19, që arrin shifrat e gati gjysmës së pjesëmarrësve, është i krahasueshëm me gjetjet në shumë vende të tjera. Njëkohësisht, përgjigjet e shtetit (MSh/ShSKUK/institucionet) kanë dështuar në politikat e menaxhimit të pandemisë COVID-19 që të bënin integrimin e politikave dhe praktikave të drejtave të njeriut, në të qenët e shëndetit mendor pjesë e mbulimit shëndetësor të përgjithshëm, në konsultimin e ngushtë dhe përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese dhe të pasurit informacion ose material informativ të përshtatur për specifikat e kategorisë së personave me sëmundje kronike psikiatrike në përgjigjet ndaj pandemisë COVID-19. Kjo e bën më të lëndueshme popullatën e ndjeshme me sëmundje kronike psikiatrike në mundësinë e përjetimit të pabarazisë në marrjen e kujdesit shëndetësor dhe në respektimin e të drejtave të tyre njerëzore.

Po ashtu, qasja dhe mbështetja në marrjen e shërbimeve shëndetësore për kategorinë e personave me sëmundje kronike psikiatrike si dhe trajtimi në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër (Shtëpitë integruese dhe QIRSPK Shtime) ka qenë e kufizuar; ka pasur rënie në realizimin e shërbimeve nga 14% deri 58%. Përpos shifrave në raporte, këtë e tregon edhe perceptimi i punëtorëve të shëndetit mendor se *Mungesa e qasjes në mbështetjen e*

⁷⁸ Adhanom Ghebreyesus T. "Adresimi i nevojave të shëndetit mendor: një pjesë integrale e përgjigjes ndaj COVID-19". World Psychiatry 2020; 19: 129–30. 6 UN. *Përmbledhje e Politikës së Kombeve të Bashkuara: COVID-19 dhe nevoja për veprim në shëndetin mendor*. (linku: https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un_policy_brief-covid_and_mental_health_final.pdf (accessed May 24, 2020)).

zakonshme nga shërbimet e shëndetit mendor renditet e treta për nga rëndësia në vështirësitë e që i kanë përjetuar personat me çrregullime mendore gjatë pandemisë. Kufizimet në marrjen e shërbimeve të nevojshme ndihmëse/trajtuese përvijohet si një cenim i së drejtës në marrjen e kujdesit shëndetësor.

Ndërsa mosprioritizimi në testimin e të sëmurëve kronikë psikiatrikë, si kategori e ndjeshme, është neutralizuar deri diku me faktin se ata i kanë realizuar pa vështirësi testimet për personat e vendosur në kujdes rezidencial, këto kur ka pasur indikacione. Po ashtu, mosprioritizimi në vaksinimin e të sëmurëve kronikë psikiatrikë në komunitet përvijohet si një e drejtë e munguar për këtë grup të popullatës së ndjeshme dhe me rrezik të shtuar nga pandemia COVID-19.

Në anën tjetër, është inkurajuese se shfrytëzuesit e shërbimeve të shëndetit mendor pozitivisht e vlerësojnë marrjen e ndihmës/ shërbimeve të shëndetit mendor dhe sidomos ndjesinë e trajtimit me respekt dhe dinjitet nga shërbimet e shëndetit mendor gjatë pandemisë. Si dhe, investigime të mëtejshme imponohen në drejtim të përshkrimit sa më të detajizuar dhe të plotë të ndikimit të pandemisë në shëndetin mendor dhe në të drejtën për kujdes shëndetësorë.

Ndihma psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, pandemia ka çuar në rritje të nevojës për shërbime të shëndetit mendor, sepse izolimi, frika dhe humbja e të ardhurave shkaktuan ngarkesa shtesë psikologjike dhe kontribuan në depresion dhe në stres.

Gjatë karantinës, duke marrë parasysh çështjen e shëndetit mendor dhe nevojën për t'u ofruar njerëzve shërbime këshillimi falas, Ministria e Shëndetësisë bashkëpunoi me Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës për krijimin e shërbimeve falas të tele-këshillimit në shqip dhe serbisht për të gjithë qytetarët, të cilët kanë përjetuar shqetësim dhe ankth si pasojë e izolimit në karantinë, kjo linjë ishte në dispozicion edhe për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK).

Përveç kësaj linje për qytetarët, të cilët kanë përjetuar shqetësim dhe ankth si pasojë e izolimit në karantinë, shumë OJQ të specializuara, që merren me të drejtat e PAK-ut në Kosovë, ofruan këshillime psiko-sociale. Konkretisht, Forumi i Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë angazhoi psikologë nëpërmjet të cilëve ofroi këshillime psiko-sociale për PAK-un.⁷⁹

HANDIKOS gjithashtu ofroi ndihmë psikologjike në formën e “peer support”. Personat për të cilët dihej se janë me COVID-19, kontaktoheshin rregullisht. Gjithashtu mbështetje iu dha edhe familjeve dhe prindërve të tyre. Organizata mbajti këshillime online dhe aktivitete në internet për personat me aftësi të kufizuara.⁸⁰

Qasja në informacione e personave me aftësi të kufizuara gjatë COVID-19

Personat me aftësi të kufizuara gjatë COVID-19 nuk kanë pasur ndonjë informacion shtesë nga institucionet përkatëse të sistemit, përveç atyre të përgjithshme. Informacionet e nevojshme ata

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Takimi i përfaqësuesit të Avokatit të Popullit me drejtorin e OJQ-së HANDIKOS, i mbajtur më 8 korrik 2021, me qëllim të mbledhjes së informacioneve lidhur me pozitën e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, me fokusim të veçantë për pozicionin e personave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19, nevojat dhe sfidat, me të cilat ballafaqohen këta persona, në përgjithësi dhe gjatë pandemisë.

kryesisht i merrnin nga sektori civil. OJQ-ja HANDIKOS, si organizatë, përktheu dhe shpërndau informacione të veçanta të botuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për personat me aftësi të kufizuara dhe i informoi ata rreth manualeve përkatëse.

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë mori përgjigje nga Zyra e Qeverisjes së Mirë, më 5 korrik 2021, që në lidhje me qasjen në informacion dhe bazuar në Rregulloren e QRK-së 15/2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për periudhën janar-dhjetor 2020 janë ofruar 3498 orë shërbime në vlerën prej 34.980 € për përkthyesit që u ndihmuan personave të shurdhër.

Në bashkëpunim me Shoqatën e të Shurdhërve të Kosovës gjatë periudhës janar-maj 2021, Zyra e Qeverisjes së Mirë gjithashtu ofroi shërbime në gjuhën e shenjave. Gjatë kësaj periudhe kishte gjithsej 934 rezervime nga komuniteti i të shurdhërve dhe 1899 orë shërbime të interpretimit në gjuhën e shenjave në institucionet publike. Të dhënat u mblodhën nga lista e rezervimeve dhe lista e pagesave për shërbimet e ofruara.

Numri më i madh i shërbimeve u ofrua në rajonin e Prishtinës me gjithsej 398 rezervime ose 43%, Prizreni me 237 rezervime ose 25%, Mitrovica me 102 rezervime ose 11%, Gjakova me 73 rezervime ose 8%, Peja me 59 rezervime ose 6%, Gjilani me 51 rezervime ose 5%, ndërsa në Ferizaj ka pasur më së paku nevojë për shërbime, me 19 rezervime ose 2%.

Numri më i madh i shërbimeve në gjuhën e shenjave është ofruar për shërbimet në komuna me gjithsej 26%, qendrat e mjekësisë familjare 22%, në spitalet rajonale 10%, mbrojtja sociale 10%, Qendra Klinike Universitare e Kosovës 7%, e ndjekur nga gjykatat 4% , policia 3%, administrata tatimore 2% dhe të tjerat 10%.

Me vendim të Kabinetit të Kryeministrit, u formua një Trup Koordinues për procesin e bashkërendimit dhe monitorimit të certifikimit të interpretuesve të gjuhës së shenjave, i cili do të ketë për detyrë zhvillimin e standardeve të interpretimit, kurrikulës dhe akreditimin e tyre nga institucionet përkatëse dhe fillimin e ofrimit të kualifikimeve nga institucionet përkatëse.

Sipas sektorit të OJQ-ve, komuniteti i të shurdhërve kishte shumë pak informacione për COVID-19, pasi jo të gjitha publikimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës ishin në dispozicion në gjuhën e shenjave. Kështu, krahasuar me rajonin, Kosova kishte shumë pak qasje në gjuhën e shenjave në shfaqjet ditore ose të drejtpërdrejta të institucioneve përkatëse. Përfundimisht bën orfimi i shërbimeve në gjuhën e shenjave që u ofrohen qytetarëve për shërbime në institucionet publike dhe të lajmeve në gjuhën e shenjave në televizionin publik.⁸¹

Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës gjatë gjithë kohës ka ofruar informata për pandeminë, për masat parandaluese dhe për masat e marra nga qeveria dhe nga organet përkatëse, nëpërmjet ueb-faqes së vet www.shksh.org. Më shumë se 100 video janë publikuar në gjuhën e shenjave. Po ashtu janë mbështetur fëmijët duke u ofruar atyre ndihmë psikosociale gjatë izolimit.⁸²

⁸¹ Nga përgjigja e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, e datës 30 qershor 2021, në PyetëSORIN e Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë dërguar përmes postës elektronike më 21.06.2021.

⁸² Po aty.

Siç është përmendur, nuk ekzistojnë statistika zyrtare për numrin e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Por sipas regjistrimit të fundit, kur bëhet fjalë për komunitetin e të shurdhërve, ka rreth 5000 persona të shurdhër dhe rreth 4500 persona me dëmtime të dëgjimit.⁸³

Për sa i përket qasjes në informacione, të verbrit dhe personat me shikim të dobët informohen nëpërmjet alfabetit Louise Braille/Luis Braje (alfabeti për të verbrit). Gjatë pandemisë erdhi deri te një shkelje serioze e të drejtave të kësaj kategorie. Fletëpalosjet e shtypura për t'i informuar qytetarët lidhur me mbrojtjen nga COVID-19 nuk u shtypën në alfabetin Louise Braille dhe kështu të verbrit dhe personat me shikim të dobët u injoruan plotësisht.⁸⁴

Po ashtu, të verbrit dhe personat me shikim të dobët nuk kishin broshura të shtypura në alfabetin e Louise Braille (Luis Braje), d.m.th. një alfabet të veçantë për të verbrit dhe për personat me shikim të dobët. Kjo është një shkelje ligjore e Ligjit nr. 04/L- 092 për Personat e Verbër, përkatësisht neni 11 (Qasja në informacion), dhe natyrisht edhe e ligjeve të tjera për të drejtat e njeriut.⁸⁵

Sa i përket qasjes në informacione, është evidente nevoja për informim më të mirë lidhur me ndikimin e COVID-19 në shëndetin e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht për ata me forma specifike të aftësisë së kufizuar/sëmundje dhe është e nevojshme të informohen këta persona se në cilën mënyrë mund të mbrohen ata.

Informacionet publike lidhur me masat kundër COVID-19, në mënyrë sistematike nuk kanë qenë të shpërndara në masë të mjaftueshme, as nuk kanë qenë të shpërndara në formate dhe në mjete të qasshme, me qëllim që të arrinin te të gjithë personat që i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Është shumë i nevojshëm informimi më i madh i personave me aftësi të kufizuara në lidhje me COVID-19, parandalimin dhe trajtimin, është e rëndësishme që informacionet në fjalë të bëhen të qasshme në alfabetin Braille, por të shkruhen në mënyrën që informacionet të jenë të kuptueshme për të gjithë personat e kësaj kategorie. Në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë do të ishte mirë të krijohej një rubrikë që ka të bëjë me personat me aftësi të kufizuara gjatë periudhës COVID-19.

V. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (funksionimi i sistemit: gjyqësor, prokurorial, veprimet e policisë në shqiptimin e gjobave, procedura kundërvajtëse gjatë pandemisë COVID 19 në Kosovë)

Avokati i Popullit, në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19 në Kosovë e deri më tani, me një kujdes të shtuar ka ndjekur edhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi, në kuptim të respektimit të së drejtës së qytetarëve për qasje në drejtësi dhe të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Shteti i së drejtës është shtylla kryesore e demokracisë së një vendi. Me shtet të së drejtës kuptojmë një sistem ligjor që funksionon mirë, që është i lidhur me respektimin e hierarkisë së normave, ndarjen e pushteteve, barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Përgjigja e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës e datës 29 qershor 2021, në pyetësin e Institutit të Avokatit të Popullit në Kosovë dërguar përmes postës elektronike më 21.06.2021.

⁸⁵ Po aty.

plotë të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht. Në kuptim të kësaj, çdo veprim i shtetit duhet të bazohet në parimet e shtetit të së drejtës dhe me këtë rast krijohet dhe rritet besimi i qytetarëve në autoritetet shtetërore.

Pra, shteti i së drejtës është i lidhur ngushtë edhe me respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut. Padyshim, paraqitja e pandemisë COVID-19 dhe përhapja e saj e shpejtë edhe në Republikën e Kosovës, paraqiti nevojën e ndërmarrjes së masave mbrojtëse shtetërore për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Shëndetësisë, qysh në fillim aplikuan masa mbrojtëse dhe parandaluese nëpërmjet aplikimit të ligjeve në fuqi, sikurse: Ligji nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse dhe Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, për të gjitha institucionet publike dhe private, përfshirë gjykatat, prokuroritë dhe policinë. Ndërsa disa muaj më vonë, respektivisht në muajin gusht 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi ligjin special, përkatësisht Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës nxori vendime për gjendjen emergjente në shëndetin publik, me të cilat u kufizua puna e institucioneve publike, e në disa u ndalua plotësisht.⁸⁶ Këto vendime ndikuan edhe në funksionimin e sistemit gjyqësor të vendit.

Ndikimi i pandemisë në funksionimin e sistemit gjyqësor

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) është institucion kompetent për të vendosur për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave në territorin e Republikës së Kosovës sipas ligjit.⁸⁷ KGjK-ja, në kuadër të kompetencave ligjore dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse; në Ligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësinë; në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, gjatë kohës së emergjencës shëndetësore, për shkak të pandemisë COVID-19, ka ndërmarrë masa për funksionimin e sistemit gjyqësor. Por masat më të rëndësishme i ka ndërmarrë nëpërmjet vendimeve të veçanta e të cilat masa janë vendosur jashtë fushëveprimit të ligjeve të sipërcituara, por duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kështu, më 12 mars 2020, KGjK-ja, duke u bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nxori Vendimin 52/2020, me të cilin u kufizuan përkohësisht veprimet gjyqësore që kanë përfshirë praninë e publikut dhe qasja e publikut në të gjitha objektet e gjykatave të Republikës së Kosovës.⁸⁸

Ndërsa më 15 mars 2020, KGjK-ja nxori Vendimin 53/2020 me të cilin ishin reduktuar thelbësisht të gjitha aktivitetet në kuadër të KGjK-së dhe në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës.⁸⁹ Për më tepër, kryetarët e gjykatave caktuan gjyqtarët dhe stafin administrativ të mjaftueshëm për të kujdestaruar dhe për t'i realizuar vetëm punët e natyrës urgjente, ato të caktimit të masave për sigurimin e prezencës së të pandehurve-paraburgimit apo masave të

⁸⁶ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr.01/07, datë 15.3.2020, dhe Vendimi nr.01/11, datë 15.3.2020.

⁸⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

⁸⁸ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), Vendimi nr. 52/2020.

⁸⁹ Po aty, Vendimi nr.53/2020.

tjera, rastet e dhunës në familje, dhe rasteve të tjera urgjente që eventualisht mund të paraqiteshin.

Më 8 maj 2020, KGjK-ja nxori Vendimin nr.83/2020, me të cilin vendosi që gjykatat e Republikës së Kosovës, përveç rasteve urgjente, t'i trajtonin edhe çështjet në të cilat nuk është e domosdoshme në procedurë prezenca e palëve dhe e publikut.⁹⁰

Në fund të muajit maj 2020, KGjK-ja nxori Vendimin nr. 85/2020 me të cilin vendosi që nga 1 qershori 2020, të rifillonte puna në KGjK dhe në gjykatat e Republikës së Kosovës, në përputhje dhe me respektim të plotë të masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19, sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.⁹¹

Më 2 qershor 2020, KGjK-ja me Vendimin Nr. 86/2020, i datës 29 maj 2020, ka miratuar *“Planin e veprimit për menaxhimin e krizës”*. Qëllimi i këtij plani ishte që të siguronte vazhdimin e funksionimit të institucioneve gjyqësore në rrethanat e situatave emergjente dhe në përputhshmëri me vendimet e institucioneve kryesore, duke përfshirë masat e rrepta të emergjencës shëndetësore, relaksim të masave ose rikthimin eventual të situatës së emergjencës. Në kohën e tanishme të pandemisë COVID-19, ky plan bazohet në vendimet e institucioneve shëndetësore të Republikës së Kosovës për menaxhimin e kësaj pandemie, situatës së krijuar në terren dhe të vendimeve/udhëzimeve të nxjerra nga KGjK-ja.

Më 14 korrik 2020, KGjK-ja mori vendim që të mbaheshin vetëm seancat në rastet e natyrës urgjente, me rastet që kishin të bënin me lëndët e shenjëstruara për liberalizim të vizave, me rastet e dhunës në familje, me lëndët me paraburgim, me ato të caktimit të masave të sigurisë si dhe me lëndët ku rrezikohej procedimi i tyre nga fillimi.

Më 27 korrik 2020, Asambleja e kryetarëve të gjykatave dhe e gjyqtarëve mbikëqyrës kërkoi që gjatë kohës së pandemisë COVID-19, seancat gjyqësore të mbaheshin nëpërmjet platformës online⁹², ku edhe filloi mbajtja e seancave të para online në gjykatat e vendit⁹³.

Ndikimi i pandemisë në funksionimin e sistemit prokurorial

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) është institucion kompetent për të vendosur për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit.⁹⁴ Më 14 mars 2020, KPK-ja, duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës si dhe në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave pas konfirmimit të rasteve pozitive me COVID-19, miratoi vendimin për reduktimin esencial të aktiviteteve në kuadër të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit. Gjithashtu ishte autorizuar Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës që të caktonin prokurorët dhe stafin administrativ të mjaftueshëm për të kujdestaruar

⁹⁰ Po aty, Vendimi nr. 83/2020.

⁹¹ Po aty, Vendimi nr.85/2020.

⁹² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *“Asambleja e kryetarëve të gjykatave kërkon që të mbahen seancat gjyqësore përmes platformës online”*, korrik 2020, (linku: <https://www.gjyqesori-rks.org/2020/07/20/asambleja-e-kryetareve-te-gjykatavekerkon-qe-te-mbahen-seancat-gjyqesore-permes-platfomes-online/>)

⁹³ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Komunikatë për Media: *“Mbahet seancë Online: Gjykata Themelore në Prishtinë sot ka mbajtur seancë gjyqësore online”*, korrik 2020, (linku: <https://www.gjyqesori-rks.org/2020/07/30/mbahet-seance-gjyqesore-online/>)

⁹⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

dhe realizuar vetëm veprimtaritë e natyrës urgjente dhe veprimet e caktuara sipas afateve ligjore.

Më 29 maj 2020, KPK-ja miratoi Planin e Veprimit për Menaxhimin e Krizës (PVMK), sipas të cilit plan parashihej të krijohet një Ekip Qendror për Menaxhimin e Krizës (EQMK), i cili do t'i menaxhonte rreziqet e përditshme dhe raporton drejtpërdrejt te kryesuesi i KPK-së dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Roli kryesor i EQMK-së ishte që t'i menaxhonte shërbimet, punët në funksion të përmbushjes së mandatit ligjor të sistemit prokurorial. PVMK-ja ka përcaktuar edhe aktivitetet operative të EQMK-së, siç janë: planifikimi dhe veprimi me vendosmëri për të mbrojtur sistemin prokurorial, njerëzit e tij dhe publikun; të këshillojë kryeprokurorët për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me pandeminë ose me situatën tjetër emergjente; të përcaktojë prioritetet organizative dhe veprimtarinë jothelbësore; të sigurojë vazhdimësinë organizative brenda burimeve të mundshme etj. Për më tepër, PVMK-ja ka përcaktuar që EQMK-ja të përgatisë edhe planin për rimëkëmbje dhe planifikimin e ardhshëm, pra të përgatisë planin për fazën e rikuperimit dhe kthimin në aktivitet normal; të rishikojë vazhdimisht aktivitetet e ekipit të menaxhimit të krizave për të identifikuar mësimin që mund të integrohet në të ardhmen në planifikimin për menaxhimin e krizës. Përtej kësaj, PVMK-ja ka autorizuar EQMK-në që të menaxhonte në mënyrë aktive komunikimet me gjykatat dhe me KGJK-në, si dhe me hetuesit nga Policia e Kosovës dhe me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit; të përdorin komunikime efektive të brendshme dhe të jashtme për të garantuar siguri dhe stabilitet dhe për të marrë informacione për menaxhimin në mënyrë më të efektshme të krizës; të menaxhojë në mënyrë pro-aktive komunikimet me ministrinë e ndryshme. EQMK-ja, sipas PVMK-së, është e mbështetur edhe nga EQMK-ja pranë prokurorive rajonale, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit (ERMK).

Po ashtu, më 29 maj 2021, KPK-ja miratoi Vendimin nr. 244/20208, me të cilin përcaktoi, mes të tjerash, rritjen e veprimtarisë së punës së KPK-së dhe të Prokurorit të Shtetit, gjithashtu që kryeprokurorët e prokurorive ishin autorizuar t'i bashkërendonin veprimtaritë për një kthim të shtuar të prokurorëve në zyra dhe që stafi administrativ të kryente veprimtari prokuroriale, si dhe kthimi i plotë në punë i të gjithë punonjësve duhej të bëhej në bashkërendim me institucionet e shëndetit publik në Kosovë⁹⁵.

Më 6 prill 2021, kryesuesi i KPK-së dhe Kryeprokurori i Shtetit, duke u bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore, si dhe në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, kanë marrë Vendimin KPK/Nr.208/2021 & A.nr.105/2021 për reduktimin esencial të aktivitetëve në kuadër të KPK-së dhe të Prokurorit të Shtetit. Gjithashtu ishin autorizuar kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës që t'i caktonin prokurorët dhe stafin administrativ të mjaftueshëm për të kujdestaruar dhe realizuar vetëm veprimtaritë e natyrës urgjente dhe veprimet e caktuara sipas afateve ligjore dhe sipas ftesave të gjykatave.

Ndikimi i pandemisë në funksionimin e Policisë së Kosovës

Policia e Kosovës vepron në pajtim me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë. Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të

⁹⁵Këshilli Prokurorial i Kosovës, Vendimi nr. 244/2020, 29 maj 2020.

tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës. Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik ose nga gjyqtari kompetent. Gjithashtu Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së Prokurorit Publik, kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat Policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, Policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, me organizatat civile dhe me komunitetet lokale. Me kërkesë të institucioneve të qeverisjes qendrore ose lokale, Policia është e autorizuar t'u ofrojë ndihmë në kryerjen e detyrave publike.

Policia, gjatë emergjencës shëndetësore për shkak të pandemisë COVID-19, më 12 mars 2020 ka lëshuar Urdhër Operacional për gatishmëri dhe reagim. Për zbatimin e Udhëzimit Operacional janë angazhuar 6500 zyrtarë policorë, në: a) patrullimin parandalues 24/7, fillimisht me dy ndërrime, në orarin 12 orësh; b) ofrimin e sigurisë në Qendrën Studentore, si karantinë e detyrueshme, dhe në Klinikën Infektive, me prezencën e saj 24/7; c) 166 pika të kontrollit në hyrje-dalje te 63 zona komunale në karantinë; d) 71.745 pika të tjera të kontrollit; e) në inspektimin e 12.880 qytetarëve të cilët gjenden në vetizolim në shtëpi; f) 2.326 përcjellje policore; g) 5.994 asistime inspektorëve komunalë, si dhe h) 485 asistime të shërbimeve shëndetësore.⁹⁶

Pas Vendimit nr. 01/10 të qeverisë, i datës 5 korrik 2020⁹⁷, për shkak të numrit të vogël të inspektorëve dhe në pamundësi të mbulimit të çdo pike, Policia ofroi mbështetje në plotësimin e formave të kundërvajtjes dhe dorëzimi i tyre inspektorit sanitar, i cili pastaj vazhdoi me shqiptimin e masave ndëshkuese.⁹⁸

Lidhur me aktivitetet e saj brenda 24 orësh, Policia njoftoi publikun nëpërmjet komunikatave për shtyp.

Ndikimi i pandemisë në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Për të trajtuar nëse veprimet e sistemi të drejtësisë kundër pandemisë COVID-19 kanë ndikuar në shkeljen e të drejtave themelore të qytetarëve të vendit, duhet shikuar bazën ligjore si në vijim. Së pari, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]*.” Njëkohësisht, me nenin 31.1 garantohet e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm: “*Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*” Po ashtu mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parasheh: “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*”

Në anën tjetër, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dokument ligjor drejtpërdrejt

⁹⁶ Policia e Kosovës, “*Raporti vjetor 2021*”, (linku: <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2021/03/Raporti - Vjetor-Shqip 2020.pdf>)

⁹⁷ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Vendimet nga mbledhja e 10, (linku: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-10-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB-1.pdf>)

⁹⁸ Po aty.

i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, që ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së garanton: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.”*⁹⁹

Po ashtu Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton: *“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”* Ndërsa sipas nenit 7, paragrafi 5, të po këtij ligji, parashihet: *“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”*

Për të kaluar pastaj tek roli e Prokurorit të Shtetit, Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, neni 2, përcakton Prokurorin e Shtetit si institucion të pavarur, kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe të veprave të tjera siç ceken me ligj. Ndërsa neni 6 përcakton efikasitetin e Prokurorit të Shtetit, si njërin nga parimet: *“Prokurori i Shtetit ushtron funksionet e veta në mënyrë efikase dhe efektive dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet e zbatueshme dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht për mos-diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore”.*

Për ta trajtuar pastaj rolin e Policisë, Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës. Neni 2 përcakton parimet mbi të cilat punon Policia e Kosovës: trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave; respektimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore; paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave; integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik; transparenca - ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenët të hapur ndaj publikut; legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti; përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë.

Ndërkaq Kodi nr.06/L-074 Penal ka përcaktuar: *“Veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohet pa sanksione penale të shtetit ligjor.”* (neni 1, paragrafi 1). Po ashtu, nëpërmjet parimit të ligjshmërisë, ka rregulluar: *“Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.”* (neni 2, paragrafi 1); si dhe: *“Askujt nuk mund t’i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një vepër nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë vepër.”* (neni 2, paragrafi 2). Kodi Penal, në Kapitullin XXII, ka përcaktuar edhe veprat penale kundër shëndetit publik (neni 249 - Përhapja e sëmundjeve ngjitëse; dhe neni 250 - Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore

⁹⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

gjatë epidemisë). Në anën tjetër, Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (KPP) përcakton rregullat e procedurës penale, të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, Prokurorisë së Shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë kod. Në nenin 5 ka përcaktuar edhe gjykimin e drejtë dhe të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm.

Po ashtu duhet përmendur Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, i cili me nenin 2 e përcakton nocionin e kundërvajtjes, sipas të cilit: *“Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike, dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojta e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës.”* Ndërsa neni 3 ka përcaktuar parimin e ligjshmërisë, sipas të cilit: *“Askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje apo t’i shqiptohet sanksioni kundërvajtës për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës dhe për të cilën nuk ka qenë i përcaktuar sanksioni kundërvajtës.”*

Për më tepër, kundërvajtjet dhe sanksionet për kundërvajtje mund të përcaktohen me ligj dhe me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës.

Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi, neni 89, ka përcaktuar përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë:

- *Zbatimi i kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së emergjencës sigurohet nga ana e Ministrisë në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.*
- *Aktivitetet e kujdesit shëndetësor në rastet e emergjencës nga paragrafi 1. i këtij neni përfshijnë:*
 - 2.1. zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi;*
 - 2.2. adaptimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në përputhje me planin emergjent;*
 - 2.3. zbatimin e ndryshimeve në sistemin e referimit dhe të udhëheqjes;*
 - 2.4. sigurimin e shërbimit emergjent të kujdesit shëndetësor për qytetarët;*
 - 2.5. veprimin e institucioneve të përkohshme shëndetësore;*
 - 2.6. aktivizimin e kapaciteteve plotësuese dhe të rezervave.*
- *Gjatë gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje, do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre.*
- *Dinjiteti i qytetarit do të respektohet në tërësi dhe vazhdimisht, pavarësisht nga kufizimet që i përcakton paragrafi 3. i këtij neni.*

Po ashtu Ligji për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, në Kapitullin IV, ka përcaktuar masat e sigurisë për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse.

Me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës është rregulluar baza ligjore për institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Po ashtu ky ligj, në kohën sa zgjat pandemia COVID-19, përveç autorizimeve nga Ligji për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe nga Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në Kapitullin II, për Ministrinë

e Shëndetësisë ka përcaktuar edhe autorizimet e posaçme dhe kufizimet e lirive dhe të të drejtave kushtetuese.

Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t'i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut. Prandaj ky parim është imperativ dhe është bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës dhe duhet të respektohet nga të gjithë.

Bazuar në faktet e parashtruara me lart, Avokati i Popullit jua sjell në vëmendje se e drejta e qytetarëve për qasje në drejtësi si dhe e drejta për një proces të drejtë dhe të paanshëm janë të drejta themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku përcaktohet: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike...”*; dhe me nenin 102 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor), ku përcaktohet qasja e barabartë e qytetarëve në gjykata, si dhe garantohet e drejta e përdorimit të mjetit juridik kundër vendimeve gjyqësore.

E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për qasje në drejtësi në Kosovë duhet të zbatohet në pajtim me standardet me të larta ndërkombëtare, me theks të veçantë me ato kritere që përcakton KEDNJ-ja dhe vendimet e GjEDNJ-së, të cilat kanë prioritet në raport me legjislacionin e brendshëm. Ky standard definohet në nenin 22 të Kushtetutës, ku përcaktohet: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare ... garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike...”*

Përveç këtyre garancive kushtetuese, Avokati i Popullit rikujton se në lidhje me të drejtën për një proces të drejtë dhe të paanshëm ka një standard edhe me të avancuar, derisa është e detyrueshme që këto dispozita të interpretohen në pajtim me vendimet e GjEDNJ-së, siç përcaktohet në nenin 53 të Kushtetutës: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Përveç përcaktimit në Kushtetutë, e drejta për proces të drejtë dhe të paanshëm dhe qasje në drejtësi rregullohet në mënyrë më të plotë në kuadër të dispozitave të KPP-së. Avokati i Popullit gjithashtu rikujton se KPP-ja, në dispozitat e tij parimore i kushton një vëmendje të posaçme gjykimit të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm (neni 5).

Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor është njëri nga komponentët thelbësorë të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Publiciteti kontribuon në rritjen e besimit të qytetarëve në gjykata, e të cilët njëherësh kanë mundësinë të vëzhgojnë pavarësinë, paanësinë, objektivitetin e gjykatave me rastin e vendimmarrjeve.

KPP-ja ka përcaktuar publicitetin e shqyrtimit gjyqësor dhe përjashtimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor. Neni 293 i KPP-së përcakton: *“Shqyrtimi gjyqësor është i hapur; Në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë personat madhor; Personat e pranishëm në shqyrtim gjyqësor nuk mund të mbajnë armë ose mjete të rrezikshme, me përjashtim të zyrtarëve të policisë që ruajnë të akuzuarin, të cilët mund të jenë të armatosur.”* Ndërsa neni 294 përcakton

përrjashtimin e publikut: “Nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për: 1.1. ruajtjen e fshehtësisë zyrtare; 1.2. ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohet nga shqyrtimi i hapur; 1.3. ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit; 1.4. mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë; 1.5. mbrojtjen e interesave të fëmijëve; ose 1.6. mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të këtij Kodi.” Por KPP-ja nuk përmban asnjë dispozitë për shmangie nga procedurat e parapara me nenet 293 dhe 294, në situata të epidemive apo të pandemive.

Pandemia COVID-19 me të cilën ende vazhdon të ballafaqohet mbarë bota, ka shkaktuar sfida dhe pasoja të përgjithshme edhe në Kosovë, përfshirë edhe sistemin e drejtësisë. Avokati i Popullit vlerëson se institucionet përfaqësuese të sistemit të drejtësisë në Kosovë u ballafaquan me nxjerrjen e vendimeve të vështira dhe urgjente, gjithnjë duke pasur parasysh shëndetin dhe sigurinë publike dhe zbatimin e ligjit.

Por Avokati i Popullit thekson se marrja e këtyre vendimeve për t’i adresuar problemet që janë shfaqur gjatë kësaj kohe, paraqet një rëndësi nga sfidat e sistemit të drejtësisë e që është garantimi i së drejtës së qytetarëve për qasje në drejtësi, gjykim të drejtë dhe e paanshëm.

Në kuptim të kësaj, Avokati i Popullit vëren se KGjK-ja vendimet e saj i ka nxjerrë në bazë të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe duke pasur parasysh vendimet e marra nga Ministria e Shëndetësisë për aplikimin e masave parandaluese kundër pandemisë COVID-19 për të gjitha institucionet publike dhe private të mbështetura në Ligjin për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, në Ligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësi, dhe në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës. Për më tepër, vendimet e KGjK-së kanë përcaktuar masa që i përkasin funksionimit të sistemit gjyqësor, por vendimet e veçanta që kanë përcaktuar kufizime/ndalime për qasje në gjykata, apo ndalimin e pjesëmarrjes së publikut në seanca (publicitetin e seancave), që prekin edhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, por janë arsyeshme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të vendit në kohën e pandemisë.

Avokati i Popullit vlerëson se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës rregullon vetëm bazën juridike për kufizimin e domosdoshëm dhe legjitim të lirisë së lëvizjes, lirisë së tubimit dhe të privatësisë, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe marrjen e masave për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes, por nuk i adreson disa prej çështjeve juridike që dolën në pah nga pandemia.

Gjykatat sipas vendimeve të KGjK-së kanë punuar vetëm me staf esencial dhe për çështje të natyrës urgjente, seancat gjyqësore në çështjet e tjera penale janë ndërprerë në mes të muajit mars dhe qershor 2020. Me Kodin Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, neni 311, paragrafi 3, dhe neni 312, paragrafi 3, përcaktohet që gjykimet penale duhet të rifillojnë nëse për tre muaj rresht nuk mbahet asnjë seancë e shqyrtimit gjyqësor, atëherë këto dispozita ligjore u bën të aplikueshme pothuajse në të gjitha rastet penale që ishin në fazë të gjykimit në Kosovë. Për më tepër, gjykatat kanë aplikuar përshtatshmërinë e gjykimit duke i lexuar të gjitha deklaratat e mëparshme në dosje, praktikë kjo e papërcaktuar në mënyrë shprehimore me KPP-në dhe që

njëherësh krijon pasiguri juridike. Ky fakt është identifikuar nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), nëpërmjet monitorimit të shumicës së rasteve penale nëpër gjykata.¹⁰⁰

Qasja në drejtësi nuk nënkupton vetëm qasjen fizike në institucione, por edhe qasjen në informata, qasjen në shërbime cilësore dhe në mjete juridike. Avokati i Popullit vlerëson se në tremujorin e parë të shfaqjes së pandemisë COVID-19, qytetarëve u është vështirësuar edhe qasja në drejtësi, të cilët shpesh janë ballafaquar edhe me mungesë të informatave se si do të funksionojë sistemi i drejtësisë, shërbimet që do të ofrohen, përfshirë këtu edhe shërbimet e ndihmës juridike falas, çka do të ndodhë me rastet e tyre që janë duke u proceduar nëpër gjykata e për të cilat janë obliguar që t'i plotësonin me dokumente shtesë dhe shqetësimi i tyre se më këtë rast do ta humbnin mundësinë për realizimin e të drejtave të tyre etj.

Një shqetësim i tillë i qytetarëve ishte adresuar nga GLPS (OJQ që monitoron seancat gjyqësore me projektin “Drejtësia sot”) te kryesuesit i KGJK-së, i cili kishte potencuar se qytetarët e vendit, të cilët nuk kanë mundur të dorëzonin dokumentet në rastet e tyre, nuk do t'i humbin afatet ligjore për realizimin e të drejtave të tyre, ngase do të zbatohet instituti “*restitutio in integrum – kthimi në gjendje të mëparshme*”, i cili parashihet me të gjitha ligjet e aplikueshme.¹⁰¹

Avokati i popullit vlerëson se KGJK-ja, pavarësisht që është ballafaquar me sfida të mëdha gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, më 2 qershor 2020 kishte miratuar Planin Emergjent për Menaxhimin e Krizës,¹⁰² si dhe kishte ndërmarrë masa që me kohë të përcaktonte se cilat raste hynin në kuadrin e rasteve urgjente për t'u trajtuar si dhe lëndët ku rrezikohej procedimi i tyre nga fillimi,¹⁰³ por mbetet shqetësuese se gjyqësori është duke u ballafaquar me rënien e madhe të efikasitetit në trajtimin e lëndëve për shkak të kapaciteteve të kufizuara.

Megjithatë, Avokati i Popullit konstaton se vendimet e KGJK-së për të kufizuar përkohësisht veprimtarinë gjyqësore që kanë përfshirë praninë e publikut duke ua lënë në vlerësim kryetarëve të gjykatave dhe të gjyqtarëve të rasteve, si dhe kufizimin e qasjes së publikut në të gjitha objektet e gjykatave, ka lënë mundësinë e interpretimeve individuale sipas rasteve dhe hapësirë për pakënaqësi të qytetarëve.

Avokati i Popullit gjithashtu vëren se KPK-ja nëpërmjet vendimeve e ka bërë organizimin e punës nëpër prokuroritë e Kosovës. Më tutje Avokati i Popullit konstaton se KPK-ja as me vendimet e nxjerra dhe as me miratimin e Planit për Menaxhimin e Krizës, nuk ka dhënë udhëzime të qarta për prokurorët se cilat raste duhet të trajtohen me urgjencë, në cilat raste mund të shtyhen ndërmarrjet e veprimeve etj., edhe pse KPK-ja ka përcaktuar rastet që duhet të veprohet shpejt. Por të gjitha autorizimet për veprime u janë lënë ekipeve rajonale dhe qendrore për menaxhimin e krizës. Meqenëse pandemia COVID-19 ende nuk ka përfunduar

¹⁰⁰ Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), “Raporti special për ndikimin e COVID-19 në Sundimin e ligjit”, mars 2020-mars 2021.

¹⁰¹ Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Platforma Drejtësia Sot, “KGJK njofton qytetarët se nuk do t'i humbin afatet ligjore për realizimin e të drejtave të tyre”, mars 2020, (linku: <http://www.rolpik.org/kgjk-njofton-qytetarët-se-nuk-do-ti-humbin-afatet-ligjore-per-realizimin-e-te-drejtave-te-tyre/>).

¹⁰² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Plani emergjent për menaxhimin e krizës, 2 qershor 2020, Nr.01/267, (linku: <https://www.gjyqesori-rks.org/manuale-dhe-udhezues/>).

¹⁰³ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor i KGJK-së, 2020.

dhe ende nuk i dihet kohëzgjatja e saj, Avokati i Popullit vlerëson se kjo çështje e prioritizimit të rasteve gjatë pandemisë për të vepruar nga ana e prokurorëve duhet të rregullohet me qëllim të shmangies apo të mostrajtimimit të duhur dhe me kohë të rasteve.

Në kohën kur Kosova ende nuk kishte ligj për luftimin e pandemisë COVID-19, Policia e Kosovës ka plotësuar forma kundërvajtësve për personat të cilët nuk kanë respektuar masat mbrojtëse të përcaktuara me vendime të qeverisë, respektivisht të ministrisë, të cilat kanë qenë të mbështetura në Ligjin nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse dhe në Ligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, të cilat forma i janë dërguar Inspektoratit Sanitar për veprime të mëtutjeshme. Policia ka dërguar në Prokurorinë e Shtetit qindra kallëzime penale për shkak të veprave penale kundër shëndetit publik (të rregulluara me nenin 249 - Përhapja e sëmundjeve ngjithëse; dhe me nenin 250 - Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë). Përtej kësaj, Policia ka dhënë me mijëra vërejte për qytetarët për mosrespektim të masave kundër COVID-19. Por, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, Policia ka shqiptuar mijëra gjopa kundërvajtëse, të gjitha këto të pasqyruara në mënyrë të detajuar në Raportin vjetor të saj për vitin 2020. Avokati i Popullit vlerëson se Policia gjatë kësaj kohe të emergjencës shëndetësore nuk ka pasur kufizime në realizimin e mandatit të saj, por ka qenë e angazhuar në orar 12 orësh, edhe pse është ballafaquar me shumë sfida dhe probleme.

VI. Të drejtat e komuniteteve joshumicë dhe ndikimi i pandemisë Covid-19

Informimi i komuniteteve joshumicë lidhur me pandeminë Covid-19

Shpërndarja e saktë, e besueshme dhe në kohë e informacionit lidhur me situatën epidemiologjike dhe për masat e ndërmarra për ta parandaluar përhapjen e virusit pandemik COVID-19 nga autoritetet publike, në gjuhët zyrtare dhe në gjuhëve zyrtare në nivel komune, ka ndikim të drejtpërdrejtë në parandalimin e përhapjes së pandemisë te qytetarët e vendit, pa dallim. Marrja e informacionit me kohë është një faktor për t'ua mundësuar qytetarëve dhe zyrtarëve ta organizojnë sjelljen e tyre në përputhje me interesin publik dhe me rregullat ligjore në lidhje me pandeminë. Në këtë drejtim, dhe në situatë pandemie, rol kryesor dhe përgjegjësi të veçantë për sigurimin e informacionit në kohë, të saktë dhe të besueshëm për publikun kanë autoritetet publike, në veçanti ato funksionet e të cilave kanë të bëjnë me shëndetin publik, mediat dhe gazetarët profesionistë. Me shpalljen e gjendjes tremujore të emergjencës së shëndetit publik, në mes të marsit 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi masa të menjëhershme që synuan parandalimin e përhapjes së virusit.

Shpërndarja e informacionit në lidhje me situatën pandemike COVID-19 në përgjithësi, dhe për masat e miratuara në veçanti, në gjuhët e komuniteteve u karakterizua me mangësi. E gjendur para një situatë të paparashikuar, përkundër përpjekjeve të qeverisë, nën presion të kohës, dhe mungesës së kapaciteteve janë vërejtur vonesa në përkthim dhe lëshime në përkthim, duke krijuar mundësi për paqartësi dhe për keqinterpretim.

Në komunikimet e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit me përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë të Kosovës: serb, boshnjak, goran, kroat, turk dhe rom, ka treguar se çështja kryesore me të cilën u përballën gjatë urgjencës së shëndetit publik ishte pamundësia për të marrë informacion me kohë. Duke theksuar se çështjet e përkthimit në gjuhët e komuniteteve joshumicë janë çështje të përgjithshme dhe të vazhdueshme dhe nuk është një dukuri e izoluar e periudhës pandemike.

Problemet me përkthimin e informacionit në gjuhët e komuniteteve joshumicë, lidhur me pandeminë COVID-19, ishte gjithashtu çështje mbizotëruese e raportuar në IAP nga Komisionari i Gjuhëve,¹⁰⁴ përfaqësuesi boshnjak i Kosovës në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve, përfaqësuesit në zyrat komunale dhe për kthim në regjionet: Graçanicë, Prizren, Pejë, Gjiilan, si dhe OJQ “Aktiv”¹⁰⁵, kanë parashtruar ankesë në IAP. Duke parë se përkthimi i informacionit lidhur me pandeminë COVID-19 në gjuhët e komuniteteve joshumicë nuk ishte në nivelin e duhur, IAP-ja vërejtë se pas kontaktit me autoritetet përkatëse dhe ndërhyrjes së tyre, përkthimet u përmirësuan, por pas një periudhe kohore, për shkak të ndryshimeve dhe përkeqësimit të situatës me pandeminë, u paraqiten problemet e njëjta sa i përket informimit në gjuhën e komuniteteve.

Përkritazi me ankesën që kishte të bënte me mosarritjen e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) që t’i informonin qytetarët në gjuhën serbe lidhur me pandeminë, nëpërmjet faqes së tyre zyrtare në internet,¹⁰⁶ IAP-ja, në pajtim me nenin 5 (paragrafi 1) të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, i rekomandoi MSh-së dhe IKShPK-së që t’i informonin qytetarët dhe publikun përmes faqeve të tyre në internet në të dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.¹⁰⁷ Në përgjigjen e marrë nga IKShPK-ja dhe MSh-ja, më 15 prill 2020, respektivisht më 17 prill 2020, IAP-ja u njoftua: komunikimet e tyre bëhen në të dy gjuhët zyrtare; në komunikim medial ata përgjigjen në gjuhën serbe sa herë që pyetjet bëhen në këtë gjuhë; rrjetet e tyre sociale/profili në Facebook përmban informacion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe se bëjnë përpjekje që informacioni në lidhje me COVID-19 të jetë në gjuhët zyrtare.¹⁰⁸ Nga përgjigjja u kuptua se për shkak të situatës urgjente të pandemisë, autoritetet janë duke u ballafaquar me mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme për përkthime. Megjithatë, pas rekomandimit të IAP-së është vërejtur përmirësim i përkthimeve.

Vonesa në përkthim u vërejtën edhe gjatë shpërndarjes së informatave lidhur me masat të cilat përcaktonin kufizimet e lëvizjes së qytetarëve, të prezantuara në prill 2020, të cilat ndër të tjera, parashihnin që nën kushte saktësisht të përcaktuara, qytetarëve t’u lejohej të lëviznin jashtë shtëpisë së tyre gjatë 90 minutave, në veçanti paqartësi u paraqitën nëse numri përfundimtar ose i parafundit ishte përcaktues për lëvizje.

¹⁰⁴ Email i Komisionarit për Gjuhë, i datës 19 prill 2021.

¹⁰⁵ Shih po ashtu: “Covid-19 Ndërmjet Realitetit dhe Dezinformimit”, Grupi Qytetar i Përgjigjes së Shpejtë “Aktiv”, Mitrovicë 2020.

¹⁰⁶ Ankesa Nr.250/2020, Z. V. kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetësisë Publike të Kosovës, i datës 15 prill 2020.

¹⁰⁷ Po aty.

¹⁰⁸ Divizioni i Komunikimit me Publikun, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Ref. Nr. 280/2020, i datës 17/04/2020, dhe përgjigjja ndaj Ankesës Nr. 250/2021, Instituti i Shëndetësisë Publike i Kosovës, datë 15.4.2021.

Duke marrë parasysh se mosrespektimi i masave ka sanksione, pjesëtarët e komunitetit joshumicë, të cilët nuk kuptonin shqip, për shkak të mungesës së përkthimit dhe të informimit në kohë, u vendosën në një pozitë të pafavorshme.

Mosarritja e kohëpaskohshme e autoriteteve për ta zbatuar Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe për t'i publikuar me kohë masat/rregullat në ueb-faqet e tyre zyrtare në gjuhët zyrtare, ka mundur të rezultonte me efekt në gëzimin e ndihmës socio-ekonomike.

Ndihma ekonomike - procedurat për qasje në paketën fiskale emergjente

Mosarritja e herëpashershme e autoritetve për respektimin e të drejtave gjuhësore dhe për t'i përshatur procedurat e aplikimit për ndihma, në përputhje me nevojat dhe me aftësitë e anëtarëve të komuniteteve, ndikuan në pozicionin socio-ekonomik të qytetarëve të ndjeshëm, përfshirë komunitetet joshumicë.

Më 3 prill 2020, duke synuar zbutjen e pasojave ekonomike nga COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin Operacional për Paketën Fiskale të Emergjencës (PFE), masa që përfituesit do të përfitonin sipas kriterëve dhe procedurave rigoroze.¹⁰⁹ Pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që nuk flasin dhe/ose nuk i kuptojnë gjuhët zyrtare, pranuan me vonesë informacionin. Publikimi i informacionit në ueb-faqet zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Transfereve (MFT) dhe të Agjencisë së Punësimit ishte përkthim joadekuat.

Për më tepër, aplikimet për ndihmë pritej të plotësoheshin dhe të dorëzoheshin personalisht ose përmes një formati elektronik online, por për shkak të problemeve me përkthim të pjesshëm dhe të dobët, mungesë të pajisjeve elektronike ose mungesës së e-edukimit, qytetarët shpesh personalisht aplikonin në Qendrat për Punë Sociale (QPS)¹¹⁰ duke krijuar kështu turma dhe radhë të panevojshme që përbënin po ashtu edhe ambient potencial për infektim me virus.

Ministria e Financave dhe Transfereve, në përgjigjen për IAP-së sqaroi 15 masat e përgjithshme të PFE-së: Masa 1 – që synon dyfishimin e të hyrave për përfituesit e ndihmës sociale deri në 80 EUR për dy (2) muaj;¹¹¹ Masa 2 – që synon dhënien e kontributit shtesë prej 30 EUR për përfituesit e ndihmës sociale deri në 100 EUR për tre (3) muaj; dhe Masa 15 - që synon të ndihmojë kategoritë e qytetarëve/familjeve pa të ardhura financiare, të cilët gjithashtu nuk janë përfitues të skemës sociale dhe jetojnë në gjendje të rëndë shoqërore.¹¹² Për shqetësimet e ngritura se shpërndarja e dobët e informacionit për komunitetet joshumicë dhe sigurimi i përkthimit joadekuat i informacionit mund të kenë ndikuar në ndikimin e dëshiruar të PFE-së, MFT-ja shpjegoi se komunitetet pakicë ishin përfituese të PFE-së dhe ndihma financiare arriti efektet e saj. Më tutje shpjeguan “... nga një shumë totale e masës 15 Komuna e Leposaviqit përfitoi 2.5% megjithëse strehon 0.9% të familjeve në skemën e rregullt të ndihmës sociale”

¹⁰⁹ Vendimi 31/2020 i Ministrisë për Financa dhe Transfere, i datës 3.4.2020, e cila miratoi Planin Operacional të Paketës Fiskale Emergjente.

¹¹⁰ Mbi procedurën e aplikimit dhe rolin dhe detyrat e QPS-së në ekzekutimin e Masës 15 të Paketës Fiskale Emergjente, shih Vendimin Nr. 35/2020 të Ministrisë për Financa dhe Transfere, i datës 16.4.2020.

¹¹¹ Referuar përfituesve të skemës sociale, siç rregullohet me Ligjin nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale dhe me Ligjin nr.04 / L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale. Shikoni pikën 11 të parashtrimit të MFT-së ndaj IAP-së, siç përmendet në fusnotën më lart.

¹¹² Ministria për Financa dhe Transfere: “Memorandum Shpjegues në lidhje me ankesat e pranuar nga IAP lidhur me Paketën Fiskale Emergjente”, Nr.373/2020, i datës 26.6.2020. Në veçanti shih pikat 10 deri 16.

dhe “Komuna e Klllokotit përfitoi 0.5% nga shuma totale e masës 15, ndërsa familjet në skemën e ndihmës sociale janë saktësisht e njëjta, 0.5% e totalit të skemës sociale.”¹¹³

IAP-ja e nënvizon si një zhvillim pozitiv që qeveria, përmes Masës 9 të PFE-së ndau 2.000.000 EUR për fonde të veçanta për iniciativa dhe projekte që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve joshumicë të prekura nga gjendja emergjente e shëndetit publik. Masa u zbatua përmes Zyrës për Komunitete, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM).¹¹⁴ Kjo ndihmë u shpërnda në tri aranzhime: 900.000 EUR u ndan për organizatat e sektorit të shoqërisë civile (OJQ) përmes projekteve të shpërndarjes së paketave të ushqimit dhe higjienës për familjet sociale të rrezikuara, në të gjithë Kosovën; 800.000 EUR u alokuan si ndihmë për bizneset e vogla; dhe 300.000 EUR u alokuan si ndihmë për personat me nevoja të veçanta. Sipas informacionit të IAP-së, marrë drejtëpërdrejt nga Zyra për Komunitete në kuadër të ZKM-së, kjo ndihmë është zbatuar plotësisht.¹¹⁵

Në gusht 2020, autoritetet përmes mesazheve (SMS) informuan qytetarët për procedurat për përfitimin e ndihmës financiare. Më pas, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) lëshoi një deklaratë, vetëm në gjuhën shqipe, duke informuar se qytetarët mund të paraqesin ankesa në QPS-të kompetente deri më 31 gusht 2020, në rast se nuk kanë marrë një mesazh (SMS), duke krijuar përsëri turma dhe radhë përpara qendrave përkatëse. Situatë e ngjashme u vu re kur qytetarët aplikuan për ndihmën financiare prej 15 EUR, pasi ata përsëri aplikuan personalisht në QPS si dhe në Zyrën e Punësimit. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se në kohën e aplikimit për ndihmë, shumica e masave të kufizimit të lëvizjes ishin në fuqi, një numër i qytetarëve që nuk ishin në gjendje të regjistroheshin në mënyrë elektronike dhe nuk kishin një leje lëvizjeje gjatë orëve të punës së QPS-ve, vështirësoi aplikimin për këtë lloj ndihme.

Sipas OJQ-së “VoRAE”, gjatë periudhës së pandemisë, numri i familjeve romë, ashkali dhe egjiptiane, të ndjeshme nga aspekti social, është rritur, veçanërisht atyre jetesa e të cilëve varej nga industritë joformale duke grumbulluar lëndë të parë dytësore, pasi ato vareshin plotësisht nga ndihma e qeverisë ose nga organizatat humanitare.¹¹⁶ Në të njëjtën kohë, vështirësitë në ndjekjen e procedurave të aplikimit të asistencës së paketës PFE-së prekën kryesisht pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, për shkak të niveleve të ulëta të E-edukimit, mungesës së pajisjeve elektronike (telefonave të mençur, kompjuterëve etj.), mungesës së dokumentacionit të identifikimit, si dhe qasja e dobët në informacion dhe në shërbime për personat dhe familjet e pafavorizuara në shoqëri.

Ndikimi joproporcional i politikave të njëjta që mund të kenë mbi komunitetet e ndryshme, tregon rëndësinë që autoritetet publike të marrin parasysh situatën dhe nevojat e veçanta të komuniteteve të cilave u shërbejnë, sa herë që ata përgatisin politika publike dhe në veçanti në raste emergjencash të shëndetit publik.

¹¹³ Pikat 17 deri në 18 të Memorandumit Shpjegues, më lart.

¹¹⁴ Masa 9, Plani Operacional i Pakos Emergjente Fiskale. Kjo masë fokusohet posaçërisht për situatën e rënduar socio-ekonomike të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve pa përjashtuar komunitetet e tjera jo shumicë (paragrafi 2).

¹¹⁵ IAP e mori këtë informacion përmes postës elektronike nga një punonjës i Zyrës për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit më 29 qershor 2021; duhet të theksohet se nuk ishte specifikuar se çfarë lloji i ndihmës u ishte dhënë personave me nevoja të veçanta.

¹¹⁶ Të dhëna të pranuar nga OJQ "VoRAE", më 12 korrik 2021.

Sidoqoftë, si aspekt tejet pozitiv, IAP-ja vë re veprimet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), në mars dhe në tetor 2020, mbi shpërndarjen e paketave të ndihmës për të kthyerit më të rrezikuar dhe për anëtarët e komunitetit joshumicë.¹¹⁷ Kështu, nga 31 marsi deri më 10 prill 2020, në 22 komuna anembanë Kosovës, MKK-ja shpërndau mbi 606 pako që përmbajnë ushqime dhe artikuj higjienikë për të kthyerit dhe për familjet e rrezikuara nga të gjitha komunitetet. Për më tepër, MKK-ja, në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë, si pjesë e programit “Kthimi dhe Ri-integrimi”, bashkëfinancoi shpërndarjen e 253 paketave shtesë të ushqimit dhe higjienës, kryesisht për të kthyerit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.¹¹⁸ Ndërsa në tetor 2020, MKK-ja vazhdoi shpërndarjen e ndihmave për familjet dhe për individët më të rrezikuar: të kthyerit dhe personat e zhvendosur brenda vendit në zona të izoluar, të moshuarit, familjet e mëdha, personat e cenuar në shoqëri, si dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian që përballen me probleme ekzistenciale. Me anë të kësaj, ndihma për ushqimet dimërore dhe ushqimet themelore u shpërnda në 16 familje në gjashtë komuna.¹¹⁹

Një zhvillim tjetër pozitiv që IAP-ja vërejtë është se menjëherë pas periudhës së izolimit, komunitatet e Novobërdës, e Ranillugut, e Parteshit, e Killokotit, e Vitisë, e Kamenicës dhe e Shtërpçës shpërndanë burime financiare për projektet humanitare të sektorit joqeveritar, ku familjeve të cenueshme iu siguruan pako ndihmë (ushqim, maska dhe artikuj higjienikë), si dhe ndihmë për fermerët, për shkollat dhe për qendrat shëndetësore.

Qasja në arsim dhe në shërbimet shëndetësore

E drejta për arsimim, e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet dhe me instrumentet përkatëse të të drejtave të njeriut, në parim është e garantuar, edhe gjatë periudhave të emergjencave të shëndetit publik. Që nga mesi i marsit 2020, sistemi arsimor në Kosovë, në vazhdimësi është duke u zhvilluar duke iu përshtatur nevojave të imponuara për mbrojtjen e shëndetit publik. Karakteristikë e rëndësishme e një përshtatjeje të tillë është të sigurohet një vëmendje e veçantë për të siguar që të gjithë, përfshirë anëtarët e grupeve të cenueshme, të vazhdojnë të përfitojnë nga e drejta për arsimim dhe të kenë qasje të barabartë në mjetet dhe në materialet arsimore gjatë urgjencës shëndetësore.

Nga mesi i marsit deri në shtator 2020, sistemi arsimor i vitit shkollor 2019/2020 funksionoi përmes mësimit në internet (mësim në distancë). Përveç problemeve të përgjithshme të hasura veçanërisht në fillimin e organizimit të procesit të mësimit në distancë, studentët që vinin nga pjesa më e ndjeshme e komuniteteve joshumicë: romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët ishin kryesisht të ekspozuar ndaj vështirësive për të ndjekur arsimin për shkak të shumë faktorëve të ndërlikuar.

Avokati i Popullit vëren se edhe më tej fëmijët nga komunitetet serb dhe rom ndjekin mësimin sipas planprogrameve mësimore të Republikës së Serbisë, ndërsa fëmijët nga komuniteti

¹¹⁷ Shih: Raport mbi shpërndarjen e pakove ushqimore dhe dimërore në 16 komuna të cenueshme (Raporti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK)); Raport mbi paketat e dhëna të ndihmës për personat e pambrojtur gjatë pandemisë Virus COVID-19 në Kosovë, Faza I, dhe Faza II (Raporti i MKK-së).

¹¹⁸ Raporti i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit për paketat e ndihmave të dorëzuara të të cenuarve gjatë pandemisë së virusit COVID-19 në Kosovë, faza e parë dhe e dytë, prill 2020. “Raporti i paraqitur në IAP më 16 qershor 2021 përmes e-mailit.

¹¹⁹ Raporti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për shpërndarjen e paketave ushqimore dhe ushqimit dimëror për 16 familje të cenueshme, tetor 2020. Raporti i paraqitur në IAP më 16 qershor 2021 përmes e-mailit.

joshumicë, të cilët janë të integruar në planprogramet mësimore të Republikës së Kosovës (duke përfshirë këtu edhe një numër të fëmijëve të komunitetit serb) kanë ndjekur mësimin në distancë i transmetuar nga transmetuesi publik i Kosovës - RTK, mirëpo hasën në vonesa dhe në vështirësi në ndjekjen e mësimin. Si edhe të gjithë të tjerët, nxënësit boshnjakë dhe turq, sikurse edhe mësuesit, hasën në vështirësi për të kaluar në mësim përmes internetit; mungesë apo lidhje të dobët të internetit në zonat rurale; mungesë e paisjeve elektronike për ta ndjekur mësimin; vonesa në fillimin e regjistrimit të njësive mësimore; dhe në fillim një numër tejet i vogël i mësimdhënësve pranuan të merrnin pjesë në mësimdhënie të regjistruar. Komuniteti boshnjak i Kosovës pranoi një numër shumë të ulët të laptopëve dhe tabletëve, i pamjaftueshëm për të gjithë nxënësit të cilët kishin nevojë për këto mjete për ta ndjekur dhe për t'u angazhuar aktivisht në mësimin në distancë. Fëmijët e komuniteteve ashkali, egjptian dhe rom, në masë të madhe nuk e kanë ndjekur mësimin në distancë, tërësisht edhe për shkak të mungesës së mjeteve të teknologjisë informative.

Së bashku me këto probleme, veçanërisht në 2-3 muajt e parë të fillimit të mësimin në distancë, ka munguar informacioni i mjaftueshëm në lidhje me procesin e mësimdhënies në internet dhe organizimin e tij.¹²⁰

MAShTI ka informuar Avokatin e Popullit për masat që ka ndërmarrë kjo ministri për të krijuar kushte për nxënësit e komuniteteve joshumicë në periudhën e pandemisë:

- *Për shkak të situatës me pandeminë MAShTI ka organizuar dhe realizuar xhirrimet e njësive mësimore për mësimin në distancë edhe në gjuhën turke dhe gjuhën boshnjake që në fillim të pandemisë nga muaji mars kur ka kaluar procesi mësimor në formë online, por xhirrimet pastaj kanë vazhduar të realizohen edhe nga shtatori 2020 deri në fund të muajit shkurt 2021 kur edhe kanë përfunduar, gjithashtu janë realizuar edhe xhirrimet për mësimin në distancë të gjuhës rome që mësohet si mësim plotësues (në muajin janar 2021). Të gjitha janë transmetuar në kanalën televiziv RTK. Tani nxënësit mund ti ndjekin në youtube.*
- *OSBE dhe MAShTI ka ndarë donacion për nxënësit e arsimit të obligueshëm, janë ndarë 215 tablet e që 60% e tabletëve janë ndarë për nxënësit e komuniteteve.*
- *Për shkak të situatës me pandeminë në edukimin e hershëm MAShTI në bashkëpunim me Save the children dhe UNICEF kanë lansuar platformën online : “Edukimi në distancë - Kujdesi Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë hershme për moshën 0-6 vjeç.” Kjo platformë është edhe në gjuhën turke, serbe dhe rome.*

Sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pjestarët e komuniteteve joshumicë, të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë tregojnë se janë ndërmarrë masa që u mundësojnë marrjen e masave përkatëse sipas rrethanave dhe nevojave që janë paraqitur si pasojë e pandemisë:

- *Komunitetet jo-shumicë kanë qenë pjesë e aktiviteteve, duke filluar nga informimi përmes materialeve informuese që në fillim të pandemisë në disa gjuhë: shqip, serbisht, anglisht, turqisht dhe në gjuhën rome (materiale të përgatitura në bashkëpunim me*

¹²⁰ IAP-ja mori informacion në një bisedë telefonike me OJQ “VoRAE”, më 12 korrik 2021.

Zyrën e OBSH-së dhe UNKT), e deri te përfshirja e tyre në vaksinim, ku secilës komunë në Kosovë, i janë ofruar mundësitë e njëjta për vaksinim kundër COVID-19.

- Me qëllim të përfshirjes së komunitetit Rom, Ashkali, dhe Egjiptian në një shkallë më të lartë të vaksinimit, atyre u është ofruar vaksinimi edhe përmes ekipeve mobile të MSh-së dhe të QKMF-ve (komunave), derisa me përkrahjen e UNICEF-it, përmes vullnetarëve dhe pjesëtarëve të organizatave të shoqërisë civile është bërë dhe po bëhet edhe këtyre ditëve edhe fushatë “derë më derë” që grupet e cënueshme të popullatës për t’i bindur për vaksinim.
- MSh nuk ka pranuar asnjë ankesë nga komunitetet jo-shumicë për mos ofrim të ndonjë shërbimi që lidhet me COVID-19, përjashtimisht kërkesave të Komisionerit të gjuhëve që të ketë respektim të zbatimit të Ligjit për gjuhët zyrtare në republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit vlerëson se është me rëndësi që Ministria të vazhdojë me aplikimin e masave gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë pjestarët e komuniteteve joshumicë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

VII. Të drejtat e personave të privuar nga liria dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, nga këndvështrimi i MKPT-së

Që nga paraqitja e rasteve të para në vend me COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovë aprovoi kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për të ndërmarrë masat e para me qëllim të luftimit dhe parandalimit të COVID-19.¹²¹ Si rrjedhojë, në po të njëjtën kohë, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokatit të Popullit (më tutje: MKPT), për shkak të paraqitjes së rasteve me COVID-19 dhe duke u bazuar në parimin e mosshkaktimit të dëmit më të madh, vendosi t’i pezullonte vizitat në vendet e privimit nga liria, deri në ndryshimin e gjendjes. Njëkohësisht, Shërbimi Korrektues i Kosovës (në vijim: ShKK) mori vendim për të ndaluar për një kohë të caktuar të gjitha vizitat familjare në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit.

Më 12 mars 2020, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (në vijim: DShB), bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mori masa shtesë për parandalimin e COVID-19 në burgje. Njoftimi për këto masa shtesë iu dërgua ministrive relevante dhe institucioneve të tjera kompetente. Një ndër këto masa ishte edhe kufizimi i lëvizjeve të të burgosurve brenda dhe jashtë institucionit korrektues apo të paraburgimit, për aq sa kjo nuk e dëmtonte shëndetin e askujt. Këto masa u ndërmorën përmes urdhrave operacionalë.

Ndërsa në shtator 2020, MKPT-ja rifilloi vizitat në vendet e privimit nga liria. Nga muaji mars 2020 deri në gusht 2021 janë realizuar 53 vizita në të gjitha vendet e privimit nga liria, përfshirë këtu edhe Qendrën e Mbajtjes për të Huajt dhe qendrat për azilkërkues.¹²²

¹²¹ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 01/07, datë 11.3.2020.

¹²² Institucioni i Avokatit të Popullit, “Raportet e Mekanizmit Kombëtarë për Parandalim të Torturës”, të publikuara deri më tani mund të gjenden në: <https://oik-rks.org/raportet/raporte-mkpt-1/>.

Kufizimi i të drejtave dhe i lirive në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit

MKPT-ja, përmes komunikimeve të rregullta me DShB-në dhe me ShKK-në, në fillim të vitit 2020 u njoftua për planet operative të përgatitura dhe të zbatuara në të gjitha qendrat e paraburgimit dhe në ato korrektuese. Të gjitha këto masa u ndërmorën me qëllim të luftimit dhe të parandalimit të pandemisë COVID-19.

Me vendimin e ShKK-së, i datës 11 mars 2020, u ndaluan vizitat familjare në të gjitha qendrat korrektuese të paraburgimit. Ky ndalim zgjati nga 11 marsi 2020 deri më 26 maj 2020, kur u mor vendimi për t'i lejuar vizitat familjare për të burgosurit vetëm nga anëtarët e ngushtë të familjes. Me këtë vendim u kufizuan disa nga të drejtat e të burgosurve, të cilat garantohen me konventat ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, me Ligjin nr. 04/L-146 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në Republikën e Kosovës dhe me Kodin nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Po ashtu me këtë vendim u ndaluan përkohësisht vikendet për të burgosurit, vizitat e organizatave joqeveritare në institucionet e ShKK-së, me qëllim të monitorimit të respektimit të të drejtave të të burgosurve, si dhe vizitat nga avokatët mbrojtës, përveç në rastin e të paraburgosurve. Këto ndalesa ishin të vlefshme për një periudhë të caktuar. Më 15 maj 2020, OJQ-të sërish u lejuan që t'i vizitonin institucionet e korrektuese dhe të paraburgimit, ndërsa më 18 maj 2020 u lejuan vizitat nga avokatët mbrojtës.

Më 10 korrik 2020 u mor vendimi për ndalimin e përkohshëm të të gjitha vizitave familjare dhe të vizitave nga avokatët mbrojtës, për shkak të përkeqësimit të gjendjes me COVID-19. Më 18 gusht 2020, avokatët mbrojtës sërish u lejuan t'i vizitonin të mbrojturit e tyre. Po në të njëjtën datë u lejuan vizitat familjare dhe vizitat e lira. Më 10 shtator 2020 u ndërmorën masa lehtësuese me të cilat u lejuan vizitat familjare, vikendet dhe pushimi në shtëpi.

Më 19 tetor 2020 u mor vendimi për ndalimin e përkohshëm të vizitave familjare, të vikendeve dhe të pushimeve në shtëpi. Më 21 dhjetor 2020 u lejuan vizitat familjare me numër të kufizuar të anëtarëve të familjes dhe vikendet. Më 8 janar 2021 u ndaluan vikendet për të burgosurit. Më 22 janar 2021 u mor vendimi për lejimin e një numri të caktuar të të burgosurve për t'i shfrytëzuar vikendet, si dhe u lejua që më shumë se dy vizitorë t'i vizitonin të burgosurit. Më 2 prill 2021 sërish u ndaluan vikendet për të burgosurit dhe numri i anëtarëve të familjes të cilët mund ta vizitonin të burgosurin u kufizua në vetëm një anëtar.

Po ashtu, në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit u kufizuan edhe të drejtat e tjera, siç janë: të drejtat për aktivitete sportive, për punë, për trajnime dhe edukim, si dhe e drejta e lirisë fetare në aspekte të caktuara. Këto kufizime ishin të përkohshme, varësisht nga gjendja në vend me pandeminë COVID-19.

ShKK-ja më 17 qershor 2021, përmes një njoftimi zyrtar në ueb-faqe, njoftoi opinionin për lehtësimin e masave kundër COVID-19 në institucionet korrektuese dhe në të paraburgimit.¹²³ Këto masa përcaktonin se numri i vizitorëve për një të burgosur do të lejohej sipas rregullave për Rendin Shtëpiak, ndërsa bartja e maskave do të mbetej në fuqi gjatë vizitave; karantinau

¹²³ Shërbimi Korrektues i Kosovës, Komunikatë për media: "Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdon me lehtësimin e masave anticovid", korrik 2021, (linku: https://shkk.rks-gov.net/lajmi_single/2989).

hoq në të gjitha institucionet korrektuese, i burgosurit mund të veçohet nga të tjerët vetëm atëherë kur mjeku konstaton se i njëjti ka simptoma të COVID-19 apo ndonjë arsye tjetër shëndetësore; në institucionin e tipit të hapur lejoheshin të dënuarit që të punonin jashtë institucioneve korrektuese, sipas Udhëzimit Administrativ MD-NR 02/2019; dhe sistemi i komunikimit virtual SKYPE do të përdorej vetëm për rastet kur një i burgosur nuk ka vizita apo ishte shtetas i huaj dhe nuk mund të vizitohej nga familja.

Kufizimi i të drejtave dhe i lirive në institucionet e menaxhuara nga Ministria e Punëve të Brendshme

Nga informatat e grumbulluara përmes komunikimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe me Policinë e Kosovës, MKPT-ja vlerëson se nuk u mor ndonjë vendim për t'i kufizuar të drejtat themelore të personave të arrestuar dhe të ndaluar, siç janë: e drejta për avokat mbrojtës, e drejta për shërbime shëndetësore dhe e drejta për të njoftuar familjen për faktin e arrestit. Gjatë vizitave në vendet e privimit nga liria, MKPT-ja nuk mori ankesa nga personat e privuar nga liria e tyre për mosrespektim të të drejtave themelore të lartcekura.

Përdorimi i Qendrës së Mbajtjes për të Huajt si karantinë pas paraqitjes së COVID-19

Gjatë vizitës në këtë qendër, MKPT-ja vërejti se kjo qendër u përdor si karantinë pas paraqitjes së COVID-19. Në vitin 2020, mbi 100 të huajt u vendosën në karantinë në këtë qendër. Këto kufizime u ndërmorën bazuar në vendimet e qeverisë dhe në rekomandimet e IKShPK-së. Megjithatë, MKPT-ja konsideron se përderisa COVID-19 vazhdon të ekzistojë, dhe nëse autoritetet kompetente sërish detyrohen ta përdorin këtë qendër si karantinë për të huajt, duhet të zhvillohen protokolle të veçanta për t'i trajtuar të karantenuarit, pasi ky institucion është paraparë për t'i akomoduar personat që janë subjekt i kthimit me forcë nga territori i vendit.

Qendra Studentore në Prishtinë e përdorur si karantinë

Me Vendimin 01/13 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 18 mars 2020, u vendos që Qendra Studentore në Prishtinë të përdorej si karantinë. Me këtë vendim po ashtu u përcaktua që Qendra Studentore të kalonte nën menaxhim të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Shëndetësisë.

MKPT-ja, përmes komunikimit me organet kompetente dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, ka vërejtur se vendimet për vendosjen e personave në karantinë u morën nga Ministria e Shëndetësisë duke iu referuar nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 15 mars 2020.

Për të drejtat e tyre, personat e karantenuar u njoftuan me shkrim dhe me gojë (përfshirë këtu edhe udhëzime konkrete si të sillen në raport me masat higjienike). Të gjitha shërbimet mjekësore u dokumentuan në dosjet e tyre. Gjatë gjithë kohës ata kishin qasje në internet, në telefonata dhe në mundësinë për të parashtruar ankesat e tyre tek organet kompetente, përfshirë këtu edhe Avokatin e Popullit, përmes numrave të telefonit të cilët u vendosën në këtë qendër.

Gjatë kësaj kohë, të karantenuarit para se të futeshin në karantinë dhe gjatë periudhës së qëndrimit në karantinë, iu nënshtruan kontrolleve sistematike mjekësore. Në dhoma u vendosën vetëm nga një person. Po ashtu u furnizuan me materiale higjienike dhe veshje.

Gjatë periudhës sa kjo qendër u përdor si karantinë, ndodhi një rast vdekjeje. Lidhur me këtë, ende janë duke u zhvilluar hetime nga Prokuroria Themelore në Prishtinë. Po ashtu, për hetimin e kësaj çështjeje, Kuvendi i Republikës së Kosovës formoi një Komision Parlamentar hetues.

Avokati i Popullit konsideron se organet kompetente duhet të zhvillojnë hetime të pavarura, të shpejta, efektive dhe transparente në raport me mbikëqyrjen publike, për të ndriçuar rastin në fjalë. Po ashtu, duhet t'u jepet mundësi të afërme të të ndjerit që të kontribuojnë në hetime.¹²⁴

Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe nuk ka marrë ankesa nga personat në karantinë lidhur me trajtimin, me kushtet e akomodimit apo me sjelljet e zyrtarëve kompetentë, të cila do të përbënin shkelje të dinjitetit njerëzor.

Po ashtu Avokati i Popullit ka vërejtur se personeli i angazhuar në punë në këtë qendër u përball me mbingarkesë në punë, me orare të stërzgjatura të punës dhe me mungesë të personelit. Shërbimet shëndetësore u ndihmuan nga grupe të vullnetarëve (mbi 120). Gjatë takimit me zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë, MKPT-ja e Avokatit të Popullit u njoftua se Qendra Studentore pësoi dëmtime të shumta të inventarit gjatë periudhës sa u përdor si karantinë.

Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit

MKPT-ja përmes vizitave të deritanishme ka vërejtur se shërbimet shëndetësore në përgjithësi ishin adekuate, furnizimi me barna ishte në nivel të kënaqshëm, dhe personeli shëndetësor në dispozicion ishte në nivel të kënaqshëm. Autoritetet shëndetësore ndërmorën masa shëndetësore për të luftuar dhe parandaluar pandeminë COVID-19, të burgosurve iu siguruan udhëzime se si të respektoheshin këto masa, si dhe iu siguruan informata për COVID-19.

MKPT-ja ka vërejtur se ka pasur vonesa për të ofruar shërbime të caktuara shëndetësore, por këto vonesa dhe kufizime ndodhën si pasojë e paraqitjes së pandemisë COVID-19 dhe përcaktimit të emergjencave shëndetësore nga organet kompetente, si dhe mungesës së transportit deri te institucionet shëndetësore publike jashtë burgjeve. MKPT-ja nuk ka gjetur shkelje serioze të të drejtave shëndetësore të të burgosurve si pasojë e këtyre vonesave apo shtyrjeve të trajtimeve për data të mëvonshme. Gjatë kësaj periudhe u shtuan vizita mjekësore dhe pati teste për COVID-19.

Sfidat e organeve kompetente për të kryer punën gjatë COVID-19

Nga informatat e grumbulluara përmes vizitave dhe takimeve me zyrtarët kompetentë të ShKK-së, Avokati i Popullit u njoftua se deri më tani një zyrtar i ShKK-së humbi jetën si pasojë e COVID-19 dhe 237 të tjerë u infektuan. Si pasojë e infektiveve, autoritetet e burgjeve u detyruan t'i përdornin edhe zyrtarët e njësisë të tjera për t'i plotësuar nevojat e tyre me personel. Në radhët e të burgosurve pati 44 të infektuar dhe 5 të vdekur.

Lidhur me sfidat për kryerjen e punës dhe sfida të tjera, MKPT-ja, më 18 qershor 2021, pati takim me zyrtarët kompetentë të Policisë së Kosovës, ku u njoftua se si pasojë e pandemisë COVID-19, deri më tani 4109 zyrtarë policorë ishin në vetizolim, 1942 të infektuar dhe 22 zyrtarë policorë të vdekur. Në ditën e takimit u raportua për 5 zyrtarë policorë të infektuar.

¹²⁴ Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar (application no. 13071/87).

Bazuar në urdhrin operativ të Policisë së Kosovës, 75% të zyrtarëve policorë u angazhuan rreth çështjeve me COVID-19, ku përfshihen: angazhime gjithëpërfshirëse, asistencë inspektorateve kompetente, monitorime të respektimit të masës së vetizolimit, si dhe zbatim të masave të ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga organet e tjera kompetente.

Sfidë për Policinë e Kosovës ishte angazhimi i shumicës së personelit në këtë çështje, vendimet për hapësirën e caktuar në vende të punës (gjë që nënkupton reduktimin e personelit në një zyre sipas rekomandimeve të IKShP-së), si dhe lirimi i zyrtarëve të caktuar nga detyra për shkak të problemeve të caktuara shëndetësore (440). Po ashtu, për shkak të COVID-19, disa lëndë hetimore u pezulluan për kohë të caktuar.

Avokati i Popullit vëren se sfidat për institucionet kompetente për kryerjen e detyrave zyrtare ishin të mëdha për shkak të çështjeve të lartpërmendura. Prandaj Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ketë në dispozicion një strategji gjithëpërfshirëse për të përkrahur Policinë e Kosovës dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës në kryerjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutën e vendit, në rast të paraqitjes së ndonjë situatë të tillë si kjo me pandeminë globale COVID-19. Kjo përkrahje do të nënkuptonte përkrahjen logjistike, financiare, mjekësore, si dhe atë psikologjike.

Kufizimi i të drejtave dhe i lirive themelore të personave të privuar nga liria e tyre në kuptim të standardeve ndërkombëtare

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) në vitin 1948 dhe e përfshirë në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila u miratua në vitin 2008, përcakton se në ushtrimin e të drejtave dhe të lirive të veta, gjithkush do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe i lirive të tjerëve e që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.¹²⁵ Po ashtu, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i miratuar nga OKB-ja në vitin 1966, i cili hyri në fuqi në vitin 1976 dhe u përfshi në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila u miratua në vitin 2008, përcakton se të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë mund të kufizohen vetëm kur kjo parashihet me ligj dhe kur është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin ose moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si dhe kur këto kufizime janë në përputhje me të drejtat e tjera të njohura në këtë Pakt.¹²⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës është mekanizëm i Këshillit të Evropës, i cili monitoron zbatimin e Konventës Evropiane kundër Torturës në vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Më 20 mars 2020, KPT-ja publikoi Deklaratën e Parimeve për trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë globale COVID-19.¹²⁷ Përmes kësaj Deklarate, KPT-ja thekson se

¹²⁵ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar në vitin 1948 nga OKB-ja, neni 29, paragrafi 2. (linku: https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf.)

¹²⁶ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 12.

¹²⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, "Deklaratë e Parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e sëmundjes së virusit Corona: pandemisë (COVID-19)", përkthimi në gjuhën shqipe në: <https://rm.coe.int/16809d569f>. Versioni në gjuhën angleze në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/covid-19-council-of-europe-anti-torture-committee-issues-statement-of-principles-relating-to-the-treatment-of-persons-deprived-of-their-liberty->

paraqitja e sëmundjes COVID-19 për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës ka krijuar sfida të jashtëzakonshme në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Më tej KPT-ja në Deklaratë thekson:

“Duke njohur detyrimet e qarta për të ndërmarrë veprim të vendosur për të luftuar COVID-19, KPT-ja, duhet tua përkujtojë të gjithë akterëve natyrën absolute të ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzorë dhe degradues. Masat mbrojtëse asnjëherë nuk duhet të rezultojnë në trajtim çnjerëzorë dhe degradues të personave të privuar nga liria e tyre.”

Në këtë drejtim, në Parimin nr. 1 të deklaratës në fjalë, KPT-ja thekson:

“Parimi themelor duhet të jetë ndërmarrja e të gjitha veprimeve të mundshme për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e të gjithë personave të privuar nga liria. Ndërmarrja e një veprimi të tillë kontribuon gjithashtu në ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së personelit.”

Parimi nr. 2:

“Udhëzimet e OBSH-së për luftimin e pandemisë, si dhe udhëzimet klinike për shëndetin kombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duhet të respektohen dhe zbatohen plotësisht në të gjitha vendet e privimit të lirisë.”

Në Parimin nr. 4 shprehimisht theksohet:

“Çdo masë kufizuese e marrë ndaj personave të privuar nga liria për të parandaluar përhapjen e COVID-19 duhet të ketë një bazë ligjore dhe të jetë e nevojshme, proporcionale, në respektim të dinjitetit njerëzor dhe e kufizuar në kohë. Personat e privuar nga liria duhet të marrin informacion të plotë, në një gjuhë që ata kuptojnë, dhe për çdo masë të tillë”.

Parimi nr. 7:

“Ndërsa është e ligjshme dhe e arsyeshme të pezullohen aktivitetet jo thelbësore, të drejtat themelore të personave të ndaluar gjatë pandemisë duhet të respektohen plotësisht. Kjo përfshin në veçanti të drejtën për të ruajtur higjienë adekuate personale (duke përfshirë mundësinë për të pasur ujë të nxehtë dhe sapun) dhe të drejtën e daljes ditore në ajër në ambient të hapur (të paktën për një orë). Për më tepër, çdo kufizim në kontaktin me botën e jashtme, përfshirë vizitat, duhet të kompensohet me gjetjen e mundësive me mjetet alternative të komunikimit (të tilla si telefonisë komunikimi përmes protokollit të Zërit-ndërmjet-Internetit)”.

Parimi nr. 8:

“Në rastet e izolimit ose vendosjes në karantinë të një personi të ndaluar i cili është i infektuar ose dyshohet se është i infektuar nga virusi SARS-CoV-2, personit në fjalë duhet t'i jepet një kontakt njerëzor kuptimplote dhe çdo ditë.”

Parimi nr. 9:

“Garancitë themelore procedurale kundër keqtrajtimit të personave të cilët janë të ndaluar nga forcat e rendit (mundësimi i një avokati, mjeku, dhe njoftimi mbi ndalimin) duhet të respektohen plotësisht në të gjitha rrethanat dhe gjatë gjithë kohës. Masat paraprake (si detyrimi i vënies së maskave mbrojtëse për personat me simptoma) mund të konsiderohen të përshtatshme në disa rrethana.”

Nënkomiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Parandalim të Torturës (SPT), i cili ka për mandat realizimin e vizitave në vendet nënshkruese të Protokollit Fakultativ të Konventës së OKB-së kundër Torturës, qëllimi i vizitave është vlerësimi i trajtimit të personave të privuar nga liria në shtetet nënshkruese të protokollit të lartpërmendur. Më 25 mars 2020, Nënkomiteti i OKB-së për Parandalim të Torturës miratoi dokumentin me titull: “*Këshillë e Nën komitetit për Parandalim të Torturës për Shtetet Palë Nënshkruese dhe Mekanizmat Kombëtarë Parandalues në lidhje me pandeminë Korona virus*”.¹²⁸ Në dokumentin në fjalë, ndër të tjera ky organ i OKB-së kërkoi që të sigurohet që çdo kufizim ndaj regjimeve ekzistuese të jetë minimal, proporcional me natyrën e urgjencës shëndetësore dhe në pajtim me ligjin, të respektohet standardi minimal për dalje ditore në ajër të pastër duke pasur parasysh në të njëjtën kohë masat e domosdoshme për ta parandaluar dhe për ta trajtuar pandeminë. Më tej në këtë dokument kërkohet që aty ku vizitat janë ndaluar për arsye shëndetësore, të sigurohen mënyra të tjera të cilat u ofrojnë të burgosurve kontakte me familjet e tyre dhe kontakte me botën e jashtme, për shembull përmes telefonit, internetit/email, video-komunikimit dhe mjeteve të tjera elektronike të përshtatshme. Kontaktet e tilla duhet lehtësohen, të inkurajohen dhe të jenë të shpeshta dhe pa pagesë. Të sigurohet që garancitë themelore procedurale kundër keqtrajtimit (përfshirë të drejtën për këshillim të pavarur mjekësor, asistencë ligjore dhe të garantohet që palët e treta të njoftohen për burgimin) të mbeten në dispozicion dhe të jenë operuese pa marrë parasysh kufizimin e qasjes.

Penal International Reforme është organizatë joqeveritare, e cila punon globalisht në fushën e promovimit të sistemeve penale të drejtësisë, të cilat mbështeten në respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut. E njëjta më 16 mars 2020 publikoi ekspertizën: “*Korona virusi: Kujdesi shëndetësorë dhe të drejtat e njeriut të të burgosurve*”.¹²⁹ Në këtë ekspertizë, organizata në fjalë trajton çështjen e kufizimit të të drejtave dhe të lirive të personave të burgosur, më konkretisht të drejtën në kujdes shëndetësor dhe në higjienë, kontaktet me botën e jashtme, vendosjen në karantinë, izolimin dhe lëvizjen e lirë brenda institucionit korrektues apo të paraburgimit, si dhe rëndësinë e qasjes së organeve monitoruese. Sipas së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, çdo qenie njerëzore ka të drejtë të gëzojë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor. Kur një shtet e privon dikë nga liria, merr përsipër të kujdeset për të garantuar kujdesin mjekësor dhe që të promovojë dhe mbrojë shëndetin e tij/saj mendor dhe fizik, si dhe mirëqenien e tij saj.¹³⁰

Penal International Reforme thekson rëndësinë e barazisë së kujdesit mjekësor në burgje duke theksuar se në rastet e konfirmuara apo të dyshuara për COVID-19, të burgosurit duhet të kenë qasje urgjente në shërbimet e specializuara shëndetësore pa komplikime të panevojshme. Më tej Penal International Reforme thekson se çdo kufizim i kontakteve me botën e jashtme duhet të jetë proporcional, përfshirë edhe kufizimin në kohë të caktuar dhe masat e tilla të mos jenë diskriminuese. Përderisa kufizimet e kontakteve ballë për ballë apo kontakteve me personat në

¹²⁸ Nënkomiteti i OKB-së për Parandalim të Torturës, “*Këshillë e Nën komitetit për Parandalim të Torturës për Shtetet Palë Nënshkruese dhe Mekanizmat Kombëtarë Parandalues në lidhje me pandeminë Korona virus*”, (linku: <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/AdviceStatePartiesCoronavirusPandemic2020.pdf>).

¹²⁹ Penal International Reform, “*Korona virusi: Kujdesi shëndetësorë dhe të drejtat e njeriut të të burgosurve*”, (linku: <https://cdn.penalreform.org/wp-content/uploads/2020/03/FINAL-Briefing-Coronavirus.pdf>).

¹³⁰ Rregullat e Mandelës, Rregullat nr. 24 dhe 18. (linku: https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/C.3/70/L.3)

burg mund të jenë legjitime me qëllim të parandalimit të shpërthimit të COVID-19, autoritetet të cilat ndërmarrin masa të tilla duhet të kenë një politikë vendimmarrëse gjithëpërfshirëse dhe transparente. Njëkohësisht kjo organizatë përcakton se ndalimi apo kufizimi i vizitave familjare duhet të zëvendësohet me rritjen e mundësive të komunikimit me botën e jashtme, siç është komunikimi me telefon, me postë elektronike, si dhe përmes video-thirrjeve. Dhe kur merren vendime për të kufizuar vizitat apo ndaluar vizitat, duhet të merret parasysh që kontakti është esencial për mirëqenien mendore të të burgosurve dhe mund të reduktojë nivelin e dhunës në burgje.

Sa i përket izolimit apo vendosjes në karantinë, Penal International Reforme thekson se masat duhet të jenë proporcionale, të autorizuara me ligj dhe të mos rezultojnë me “de facto” vendosje në vetmi. Çdo vendim për të vendosur persona në karantinë duhet të merret vetëm bazuar në një vlerësim të pavarur dhe të jetë proporcional me rrezikun që përbën. Vendosja në karantinë bëhet vetëm nëse asnjë masë mbrojtëse alternative nuk mund të merret për të parandaluar përhapjen e infektimit. Gjatë vendosjes në karantinë apo në izolim, kushtet e akomodimit dhe regjimit së paku duhet t’i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregullat e Mandelës.

Masat mbrojtëse duhet të lejojnë pjesëmarrjen në seanca gjyqësore dhe të lejojnë marrjen e shërbimeve të avokatit mbrojtës. Çfarëdo kufizimi, nëse është i nevojshëm, duhet të individualizohet dhe të bazohet në gjetjet e pavarura mjekësore. Masat kufizuese totale dhe gjithëpërfshirëse janë në kundërshtim me parimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe për qasje tek avokati mbrojtës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, më 8 shkurt 2021, publikoi manualin për parandalimin e COVID-19 në burgje dhe në vende të tjera të paraburgimit.¹³¹ Në këtë udhëzues, OBSH-ja, duke njohur domosdoshmërinë që shteti të ndërmarrë masa për të parandaluar COVID-19, kërkon që të respektohen garancitë themelore procedurale të parapara në Rregullat e Mandelës, respektivisht që kufizimet të mos rezultojnë në torturë, trajtim poshtërues dhe degradues, vendimet klinike duhet të merren vetëm nga profesionistët mjekësorë, dhe që kontaktet me familjen të mos ndërpriten tërësisht.

Sa i përket trajtimit të personave të privuar nga liria e tyre, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar* përcaktoi garancinë absolute të ndalimit të torturës që parashihet në nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë e sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Gjatë vizitave në terren, komunikimit me personat të privuar nga liria e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes mundësive të tjera të komunikimit me personat e privuar nga liria e tyre, MKPT-ja nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues në qendra të paraburgimit apo në ato korrektuese.

Në rastin *Le Mailloux kundër Francës*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksoi obligimin pozitiv të shteteve për të ndërmarrë masa të domosdoshme për të mbrojtur jetën dhe integritetin fizik të personave nën juridiksionin e tyre, përfshirë edhe në fushën e shëndetit

¹³¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë, Udhëzues i Brendshëm, 8 shkurt 2021. (linku: <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/339830/WHO-EURO-2021-1405-41155-57257-eng.pdf?sequence=1&isAllowed=y>.)

publik. Në këtë rast, në ankesën e tij ankuesi u referohet dështimeve të autoriteteve franceze për të vepruar sipas obligimeve pozitive bazuar në disa dispozita të KEDNj-së, duke theksuar mungesën e veprimeve të shtetit sipas obligimeve në fjalë, siç është ndërmarrja e masave për të mbrojtur jetën e individit dhe integritetin fizik.

Vlerësimet e përgjithshme të Avokatit të Popullit

Siç u theksua edhe më lart, çdo kufizim i të drejtave dhe i lirive themelore në kuptim të standardeve ndërkombëtare dhe nacionale për të drejtat e njeriut, duhet të jetë i domosdoshëm, proporcional, i bazuar në ligj, të mos jetë diskriminues dhe të respektojë dinjitetin e njeriut, si dhe t'i nënshtrohen rishikimit të kohëpaskohshëm.

Paraqitja e pandemisë dhe shpallja e së njëjtës nga OBSH-ja si pandemi me përmasa globale, shtroi domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave konkrete nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të luftimit dhe parandalimit të COVID-19. Mbrojtja e shëndetit publik është obligim i të gjitha autoriteteve kompetente dhe i qytetarëve të një vendi. Kufizimet e të drejtave të të burgosurve, ndër të tjera, ishin subjekt i rishikimit të kohëpaskohshëm. Bazuar në gjendjen me COVID-19 dhe në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, masat e kufizimit u ashpërsuan ose u lehtësuan.

Bazuar në ekspertizën e paraqitur nga organizatat dhe nga institucionet e lartcekura ndërkombëtare pas paraqitjes së pandemisë COVID-19, kufizimi i kontakteve me botën e jashtëm duhet të kompensohet përmes mundësive të tjera të komunikimit në situata të tilla. MKPT-ja përmes vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, pas ndërprerjeve të vizitave familjare apo kufizimit të tyre, ka vërejtur se ShKK-ja ka vënë në dispozicion të të burgosurve dhomat për komunikim përmes SKYPE dhe po ashtu ka rritur numrin e telefonatave për të burgosurit.

Gjatë vizitave, MKPT-ja u njoftua nga drejtorë të caktuar të qendrave korrektuese dhe të paraburgimit se kanë marrë shqetësime nga prokurorët dhe gjyqtarët e caktuar lidhur me këtë komunikim, sidomos në rastin e të paraburgosurve. Këto shqetësime u referohen çështjeve të ndërlidhura me sigurinë dhe ndikimin eventual në procedurë hetimore.

Po ashtu është vërejtur se brenda qendrave korrektuese dhe të paraburgimit u morën vendime për të kufizuar lirinë e lëvizjes së të burgosurve deri në një shkallë të caktuar, me qëllim të luftimit dhe të parandalimit të COVID-19. Bazuar në informatat e grumbulluara, këto kufizime u zbatuan në raste të dyshimeve se ndonjë i burgosur i caktuar mund të jetë i infektuar me COVID-19 apo ka pasur kontakte me të infektuar të mundshëm.

Gjatë kësaj periudhe, të burgosurit të cilët u dërguan në institucione publike shëndetësore, në seanca gjyqësore apo në përgjithësi dolën nga qendra e paraburgimit apo nga qendra korrektuese, iu nënshtroan karantinimit për një periudhë dyjavore.

Avokati i Popullit vëren se në periudha të caktuara u kufizua e drejta për të kontaktuar me avokatin mbrojtës, përveç në rastin e të paraburgosurve. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit rithekson se e drejta për të kontaktuar me avokatin mbrojtës është e drejtë themelore e personit të privuar nga liria e tij, e garantuar me Kushtetutën e vendit, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të njeriut. Prandaj autoritetet

kompetente edhe në kohë pandemie duhet të sigurojnë që ky kontakt të vazhdohet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.

Vendimet e ShKK-së për t'i kufizuar liritë dhe të drejtat themelore të të burgosurve u referohen vendimeve të qeverisë për të kufizuar të drejta të caktuara të qytetarëve në përgjithësi. Dispozita të caktuara në këtë drejtim mund të gjenden në LESP dhe në Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak. Prandaj Avokati i Popullit konsideron se me rastin e marrjes së vendimeve të tilla, të cilat kufizojnë të drejtat dhe liritë e të të burgosurve, ShKK-ja duhet t'u referohet dispozitave të LESP-së dhe Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

Bazuar në çfarë u tha më lart, Avokati i Popullit konstaton se kufizimi i të drejtave dhe i lirive të caktuara të personave të privuar nga liria e tyre në parim ishte i domosdoshëm, proporcional, i bazuar në ligjet vendore, në rekomandimet e institucioneve kompetente shëndetësore të vendit dhe në rekomandimet e OBSH-së, si dhe të organizatave të tjera, të cilat monitorojnë respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria e tyre.

Vendimet për kufizime të të drejtave të të burgosurve, të cilat kufizojnë të drejtat themelore, nuk iu referuan dispozitave të LESP-së dhe as Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese. Kufizimet iu nënshtruan rishikimit të kohëpaskohshëm dhe varësisht nga gjendja në vend me pandeminë COVID-19, këto masa u ashpërsuan apo u lehtësuan. Ndërsa kufizimi i së drejtës për kontakte me botën e jashtme u kompensua përmes ofrimit të llojeve të tjera të komunikimit (SKYPE, shtimit të telefonatave). Po ashtu në periudha të caktuara pati kufizime të së drejtës për t'u takuar dhe komunikuar me avokatin mbrojtës.

VIII. Ndikimi i pandemisë në të drejtat sociale dhe ekonomike dhe në të drejtën e punës në sektorin publik dhe privat

Të drejtat ekonomike dhe sociale dhe e drejta e punës u ndikuan direkt nga vendimet qeveritare për luftimin e përhapjes së pandemisë COVID-19. Megjithatë, për shkak që situata epidemiologjike në vend filloi të stabilizohej gradualisht, në prill 2020, qeveria planifikoi të ndërmerre një sërë masash lehtësuese për bizneset dhe për qytetarë. Fillimisht, nga 4 maji 2020 u lejua pjesërisht hapja e industrive të caktuara, si për shembull ndërtimtaria dhe tregtia me pakicë. Nga 18 maji 2020 u hapën plotësisht tregtia me pakicë, ordinancat stomatologjike dhe shërbimet fizioterapeutike, tregjet e gjelbra etj. Ndërsa nga 2 qershori 2020 ekonomia e Kosovës filloi revitalizimin falë hapjes së plotë të shumë industrive, përfshirë edhe gastronominë (me përjashtim të ahengjeve) në përgjithësi. Mirëpo, edhe pse gjendja epidemiologjike e asaj kohe justifikoi masat lehtësuese, qeveria e pa të arsyeshme të vendoste masa të reja kufizuese në momentin kur u përkeqësua situata. Kështu, më 5 korrik 2020, qeveria urdhëroi që bizneset që ofronin shërbime të gastronomisë të operonin me kapacitete të zvogëluara (vetëm në hapësirat jashtë) dhe gjatë orarit 21:00 – 05:00 të mbyllen tërësisht, kurse disa ditë më vonë u urdhëruan edhe qendrat tregtare të mbylleshin në orën 21:00 si dhe u pezulluan tregjet publike. Qeveria vazhdoi t'i ndryshonte dhe t'i plotësonte masat kufizuese ndaj bizneseve duke lehtësuar apo shtrënguar ato varësisht prej situatës epidemiologjike, dhe, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2020 vendosi një sërë masash kufizuese të reja për qytetarë, sikurse edhe për biznese, varësisht prej nivelit të rrezikshmërisë së komunës ku

gjenden. Nga 13 nëntori, në komunat që u klasifikuan me rrezik të ulët, operatorët ekonomikë lejoheshin të punonin vetëm nga ora 05:00 deri 20:00, ndërsa shërbimet e gastronomisë dhe të hotelerisë lejoheshin të punonin pas atij orari përmes shërbimeve “merr me vete” apo me dërgesa. Në komunat të cilat u klasifikuan me rrezik të mesëm, orari i operimit të plotë i operatorëve ekonomikë u zvogëlua në 05:00 – 18:00, ndërsa në komunat të cilat u klasifikuan me rrezik të lartë, orari i operimit të operatorëve ekonomikë u lejua vetëm në periudhën 05:00-19:00, dhe këto kufizime vazhduan deri në muajin maj 2021, pasi numri i të infektuarve u ul dukshëm dhe u përmirësua situata epidemiologjike.

Korniza ligjore lidhur me të drejtat ekonomike dhe sociale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj realizimi i tyre praktik është në interes të funksionimit të sundimit të ligjit. Kushtetuta shprehimisht përcakton se është obligim i të gjitha organeve që t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe ky është parim imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë. Prandaj në vazhdim të këtij raporti do të flitet pikërisht për të drejtat ekonomike dhe sociale që parasheh Kushtetuta, siç janë, e drejta e punës, duke përfshirë: të drejtat ekonomike dhe sociale të punëtorëve, mbrojtja nga diskriminimi në raport me të drejtën në punë dhe nga mostrajtimi i barabartë i sektorëve publik dhe privat, shtyrja apo pezullimi i kredive nga bankat komerciale, të drejtat e konsumatorit dhe të drejtat ekonomike të bizneseve, Fondi i Kursimeve Pensionale dhe tërheqja deri në 10%, dhe gjithëpërfshirja në mbështetjen e masave mbështetëse të qeverisë. Pavarësisht gjendjes së jashtëzakonshme, në këtë rast pandemisë COVID-19, garancitë kushtetuese krijojnë obligim për shtetin që t'i mbrojë të drejtat në mënyrë të barabartë ndaj të gjithëve dhe të sigurojë respektimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit përkatës.

Me Ligjin e Punës janë rregulluar çështjet e punës dhe të të drejtave të punës, të cilat përveç asaj që garantojnë të drejtën për punë dhe rregullojnë që secili të ketë të drejtë në respektimin e dinjitetit të personalitetit të vet në punë, gjithashtu përcaktojnë dhe kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, mbrojtjen e nevojshme në punë, mënyrën e themelimit të marrëdhënies së punës, orarin e kufizuar të punës, pushimet ditore dhe javore, pushimin vjetor me pagesë, shpërblimin e drejtë për punë si dhe ofron mbrojtje ligjore në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi është i ndaluar diskriminimi në fushën e punës, përkatësisht shkelja e mundësive të barabarta për lidhjen e marrëdhënies së punës dhe gëzimi në mënyrë të barabartë i të gjitha të drejtave nga fusha e punës. Diskriminimi në fushën e punës është i ndaluar gjithashtu edhe me Ligjin e Punës. Sigurimin e punës së dinjitetshme e mundëson dhe zbatimi i dispozitave të shumta të ligjeve të tjera, si: Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, Ligji për Barazinë Gjinore etj.

E drejta për punë gjithashtu garantohet edhe me marrëveshje dhe me instrumente ndërkombëtare, të cilat janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë dhe kanë përparësi ndaj ligjeve të Kosovës. Prandaj detyrimi për respektimin e kësaj të drejte kërkon parandalimin e kryerjes së veprimeve joligjore, të cilat pengojnë ose parandalojnë gëzimin e së drejtës për punë të dinjitetshme dhe punësim dhe është detyrë e shtetit që këtë të drejtë ta sigurojë për të

gjithë nën kushte të barabarta, si dhe t'ua sigurojë të gjithëve zbatimin dhe respektimin e dispozitave të legjislacionit për të drejtën e punës.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës

Përkundër politikave mbështetëse, aktiviteti ekonomik sipas FMN-së vlerësohet të ketë rënë 6% për vitin 2020,¹³² përderisa sipas ASK-së, kjo rënie ka qenë 5.3%.¹³³ Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, rënia pritet të jetë 6.9% (Banka Botërore, 2021). Deficiti fiskal u rrit për 7.7% të PBB-së, duke pasur parasysh rënien e madhe nga mbledhja e të hyrave nga taksat dhe zbatimin e masave zbutëse dhe rigjeneruese prej 4.2% të PBB-së (FMN, 2021). Rritja pritet të rikthehet në vitin 2021 dhe aktiviteti real do të arrijë nivelet para pandemike vetëm në vitin 2022 (FMN, 2021; Banka Botërore, 2021). Rreth 4.3% e PBB-së janë alokuar për masat e ndërmarrja, për sistemin shëndetësor (0.4% e PBB-së), bonuset e pagave për punonjësit e shëndetësisë dhe sigurimit për orët shtesë të punës dhe për rrezikun e rritur me të cilin përballen në kryerjen e detyrave të tyre (0.5% e PBB-së), transferimet sociale dhe subvencionet për familjet në nevojë (1.6% e PBB-së), si dhe mbështetje për firmat në formë të subvencionimit të pagave dhe qasje më të lehtë për huazim (përfshirë NP dhe fermat me rreth 1.7% e PBB-së), dhe shpenzimet kapitale (më pak se 0.1% e PBB-së). për të stimuluar kërkesën agregate, Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike lejoi tërheqjen e 10% të mjeteve të kursyera në llogaritë personale të kursimeve pensionale në FKPK (2.6% e PBB-së), shumica e të cilave (1.8% e PBB-së) do të rimbursohen nga buxheti duke filluar në vitin 2023 (rimbursohen vetëm ata që me rastin e tërheqjes kanë pasur deri në 10.000 euro kursime në llogaritë e tyre). Sipas ATK-së, Kosova ka përjetuar një rënie të konsiderueshme të të hyrave në nëntë muajt e parë të vitit 2020, mbi 1 miliard euro më pak se në vitin 2019 (Raporti i Shoqërisë Civile, 2021).¹³⁴

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës në Kosovë

COVID-19 ka pasur ndikim negativ edhe në tregun e punës gjatë vitit 2020. Krahasuar me vitin 2019, ka rënie të shkallës së punësimit me 1.7%, ku kjo rënie të meshkujt ishte 3.4%, përderisa të femrat kemi rritje për 0.2 % (ASK, 2021). Indikatorët kryesorë të tregut të punës për tri vitet e fundit janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela 1. Indikatorët kryesorë të tregut të punës

Indikatorët kryesorë të tregut të punës			
Viti	2018	2019	2020
	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	40.9	40.5	38.3
Shkalla e joaktivitetit	59.1	59.5	61.7
Raporti i punësimit ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	28.8	30.1	28.4

¹³² Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2021, IMF Staff report for Republic of Kosovo, Volume 2021, Issue 041, <https://doi.org/10.5089/9781513569536.002>

¹³³ ASK, 2021, Bruto produkti vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve 2008 – 2020: <https://ask.rks-gov.net/media/6311/bpv-2008-2020.pdf>

¹³⁴ Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), “Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut Në Kosovë në Vitin 2020”, qershor 2020, (linku: <https://unmik.unmissions.org/file/158952/download?token=eZSA6ENf>)

Shkalla e papunësisë	29.6	25.7	25.9
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	55.4	49.4	49.1
Përqindja e të rinjëve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	30.1	32.7	33.6

Burimi: ASK, 2021

Indikatorët kryesorë tregojnë se shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ka pasur një rënie prej 2.2 për qind në krahasim me vitin 2019, derisa shkalla e joaktivitetit është rritur në 61.7% apo për 2.2 për qind. Shkalla e punësimit gjatë vitit 2020 ka qenë 28.4%, që është një rënie prej 1.7 për qind, derisa shkalla e papunësisë ka pasur një rritje të lehtë prej 0.2 për qind në 25.9 për qind. Pasojat e pandemisë së bashku me masat e ndërmarra nga qeveria për subvencionimin e pagave të atyre që kanë humbur vendin e punës kanë ndikuar në rritjen e numrit të personave që janë paraqitur në APRK si të papunë.

Tabela 2. Të regjistruar si të papunë dhe vendet e lira të punës, siç raportohet nga APRK-ja, individët

Viti	Numri i të papunëve të regjistruar	Numri i vendeve të lira të punës	Numri i ndërmjetësimeve (me përjashtim të ALMP-ve)	Pjesa e vendeve të lira të punës të plotësuara nga APRK-ja
2015	112 179	11 506	3 574	31%
2016	101 773	14 137	4 022	28%
2017	93 866	12 511	3 215	26%
2018	95 890	14 847	3 764	25%
2019	70 790	9 462	4 160	44%
2020	168 980		1 330	

Burimi: APRK 2019, Puna dhe fuqia punëtore 2018 dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me APRK-në për të dhënat për vitin 2019, 2020.


Të gjithë indikatorët e punës së bashku me të dhënat nga APRK-ja tregojnë për ndikimin që COVID-19 kishte në tregun e punës gjatë vitit 2020 ku në krahasim me vitin paraprak, më së shumti vërehet në numrin e madh të personave që u regjistruan në APRK si të papunë.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në varfëri

Nuk kemi hasur në ndonjë analizë të institucioneve vendore në lidhje me ndikimin e pandemisë në varfëri. Mirëpo sipas raportit të Bankës Botërore: *“Si shumë vende të botës edhe Kosova ka qenë e goditur nga pandemia Covid-19. Përkundër politikave mbështetëse, aktiviteti ekonomik vlerësohet të ketë rënë 6% për vitin 2020, (FMN, 2021) derisa sipas ASK-së kjo rënie ka qenë*

5.3% (ASK, 2021)¹³⁵. Sipas vlerësimeve preliminare të Bankës Botërore (2021), nga viti 2019 në vitin 2020, në Kosovë shkalla e varfërisë është projektuar të jetë rritur për rreth 5 pikë të përqindjes, përkatësisht nga 20 në rreth 25% e popullsisë me më pak se 4.74 Euro (5.5 USD) për ditë për kokë banori. Projektionet janë që shkalla e varfërisë të bie ndjeshëm në vitin 2021.”

Figura 1: Shkalla e varfërisë në Kosovë¹³⁶



Sipas të njëjtit raport, përderisa të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një skemë për pagesën e papunësisë, në Kosovë nuk ekziston një skemë e këtij lloji.

Të drejtat ekonomike dhe sociale dhe e drejta e punës

Avokati i Popullit thekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Po ashtu me Ligjin nr. 03/l-212 të Punës dhe me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është i ndaluar diskriminimi në fushën e punës, përkatësisht shkelja e mundësive të barabarta dhe gëzimi në mënyrë të barabartë i të gjitha të drejtave nga fusha e punës.

Për të diskutuar respektimin e të drejtave të punëtorëve gjatë pandemisë janë organizuar takime diskutimi me Bashkimin e Sindikatave të Punëtorëve të Kosovës (BSPK). Sipas njoftimit të kësaj sindikate, ajo nuk ka marrë asnjë ankesë dhe nuk ka realizuar ndonjë studim për këtë temë.

Të dhënat nga Inspektorati i Punës, të prezantuara në tabelë, tregojnë se në vitin 2020 Inspektorati ka realizuar 18.506 inspektime, por 2.419 kanë qenë lidhur me monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse të vendosura nga qeveria, që do të thotë nuk kanë pasur për qëllim të drejtat e punëtorëve. Nga 8.509 ankesa të pranuar, 84% kanë qenë nga sektori publik.

Nga tabela vihet re se numri i ankesave në vitin 2020 është dyfishuar nga 5.150 sa ishin në vitin 2019, në 10.455 në vitin 2020.

¹³⁵ ASK, 2021, Bruto produkti vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve 2008 – 2020: <https://ask.rks-gov.net/media/6311/bpv-2008-2020.pdf>

¹³⁶ Banka Botërore, 2021, Republic Of Kosovo: Systematic Country Diagnostic (SCD) Update Concept Note Summary: <https://thedocs.worldbank.org/en/doc/95f8830195f586ccd61873093723cd6f-0080012021/original/Summary-Kosovo-SCD-Update-for-Consultations-ENG.pdf>.

Tabela 2. Të dhënat nga raportet e Inspektoratit të Punës

	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2019/2020 në %
Inspektive	8,128	9,531	14,000	18,491	32%
Të rregullta	7,322	7,212	8,727	8,059	-8%
Bazuar në ankesa	727	1,742	5,150	10,432	103%
Numri i punëtorëve pa kontratë pune	1,750	1,251	1,557	460	-70%
Numri i punëtorëve të legalizuar	1,224	712	2,042	409	-80%
Çështjet lidhur me orarin e punës	172	30	290	18	-94%
Çështjet lidhur me pushimet	1,096	1,149	1,878	198	-89%
Çështjet lidhur me pagat	1,437	1,315	1,826	439	-76%

Informata lidhur me realizimin e të drejtave të punëtorëve të garantuara me legjislacionin në fuqi, i grumbulluam edhe nga takimi me Odën e Afarizmit të Kosovës. Përfaqësuesit e të dy odave theksuan se qeveria me masat e ndërmarra ka privilegjuar punëtorët në sektorin publik, të cilët janë liruar nga puna, ndërsa janë paguar 100%. Kjo nuk ka ngjarë me punëtorët e sektorit privat, disa nga të cilët kanë mbetur pa punë, disa nuk janë paguar për kohën e mbylljes së biznesit ku kanë punuar e të cilët nuk janë kompensuar sikurse punëtorët në sektorin publik - të paguar nga taksat e sektorit privat dhe punëtorët në sektorin privat. Nuk është vërejtur ndonjë përpjekje e qeverisë të balancojë pagat në sektorin privat me atë publik. Mbështetja e ofruar ka qenë e ulët, për periudhë më të shkurtër sesa mbyllja e bizneseve dhe ka pasur vonesa dhe ende vazhdon të ketë vonesa në zbatimin e masave të qeverisë.

Në anën tjetër, trajtim i pabarabartë është theksuar të ketë ekzistuar për punëtorët në sektorin publik. Një raport i shoqërisë civile (Raporti i Shoqërisë Civile, 2021) ka evidentuar se punëtorët në institucionet publike të Kosovës vazhduan të kenë detyrim ligjor të punonin gjatë gjithë pandemisë, megjithëse Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë disa vendime për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë që nga fillimi. Në disa raste, punonjësit e sektorit publik (infirmierët, zyrtarët policorë, mësime dhënësit, disa nga shërbyesit civilë) ishin të detyruar të punonin edhe nëse mjedisi i punës nuk ofronte mundësi për të mbajtur distancën e sigurt fizike dhe masat e duhura higjienike.

Po ashtu është raportuar se mësime dhënësit me probleme shëndetësore është dashur gjithashtu të punonin personalisht kur u rihapën shkollat në shtator, duke ngritur shqetësime të veçanta për të drejtën e tyre për siguri dhe shëndet në punë.

Sipas drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, 293 zyrtarë policorë ishin infektuar me COVID-19, 234 zyrtarë policorë ishin në karantinë dhe 12 zyrtarë policorë kanë vdekur për shkak të COVID-19, që nga 15 dhjetori, duke ngritur edhe një herë implikime për të drejtën e sigurisë në punë dhe shëndetin e një kategorie tjetër të punëtorëve.

Derisa bizneset kishin vështirësi në përpjekjet e tyre për të vazhduar punën si zakonisht, kriza COVID-19 preku në mënyrë të pabarabartë punëtorët të cilët përjetuan shkelje të së drejtës për kushte të drejta dhe të favorshme të punës, si: ndërprerja e paligjshme e kontratave, uljet e pagave, ngarkesa e shtuar e punës për shkak të zvogëlimit të numrit të punonjësve, pagesa të vonuara të kompensimeve për punën jashtë orarit dhe mungesa e rrjeteve adekuate të sigurimeve sociale për punëtorët. Disa punonjës të sektorit publik, siç janë zyrtarët policorë, të cilët kanë punuar me orë të zgjatura për shkak të pandemisë, pranuan me vonesë kompensimin për punën jashtë orarit.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka theksuar se si rezultat i izolimit dhe ndalimit të transportit publik, gratë me aftësi ndryshe nuk mund të shkonin në punë. Pas relaksimit të masave, gratë që kujdeseshin për fëmijë me aftësi të ndryshe thanë se mund t'i ekspozoheshin rrezikut për infeksion, gjë që do të rrezikonte dhe vështirësonte gjendjen e fëmijëve nën përkujdesje. Humbja e punës dhe vështirësitë ekonomike kanë përkeqësuar qasjen e tyre në ilaçe të kushtueshme, nga të cilat varen. RrGK-ja ka theksuar se inkurajon Avokatin e Popullit që përmes këtij hetimi të iniciuar ex-officio, të theksojë rëndësinë e diferencimit të nevojave të ndryshme të grave dhe të burrave, përgjatë kësaj pandemie, të cilat mbetën pa u adresuar dhe vazhdojnë të mos adresohen.

Të drejtat e punëtorëve shëndetësorë

Pandemia ka pasur ndikim të madh në të drejtat e punëtorëve shëndetësorë. Vendimi i qeverisë, i marrë në mars të vitit 2020, kur ka kërkuar lirim të njërit prind nga puna, nuk ka vlejtur për punëtorët shëndetësorë. Kjo situatë ka qenë e vështirë për shkak se në atë periudhë të gjitha institucionet arsimore dhe për përkujdesjen e fëmijëve kanë qenë të mbyllura. Sipas të dhënave të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, 37% e stafit shëndetësor kanë qenë bashkëshortë brenda sistemit shëndetësor, të cilët kanë qenë të obliguar të punonin dhe kanë hasur në vështirësi në kujdesin për fëmijët. Trajtim i pabarabartë është evidentuar lidhur me të drejtën për shtesat për punëtorët shëndetësorë. Shtesat e aprovuara në mars të vitit 2020 kanë përjashtuar nga kjo e drejtë punëtorët e ndihmës sanitar dhe ata për mbështetje teknike. Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në nenin 20 thekson se qeveria bën kompensime shtesë mbi pagën bazë për punonjësit e institucioneve shtetërore të angazhuar në betejën kundër pandemisë COVID-19. Sipas ligjit, kategoritë e përfituesve, lartësia e shumëve dhe kohëzgjatja e kompensimit të shtesave të punonjësve të institucioneve shtetërore të angazhuara në betejën kundër pandemisë COVID-19 caktohen me akt nënligjor i nxjerrë nga qeveria. Gjatë qeverisjes paraprake, FSSHK-ja ka arritur një konsensus për kategorizimin e personelit shëndetësor lidhur me shtesat, por ende nuk është nxjerrë akt nënligjor, duke lejuar hapësirë për caktim arbitrar të shtesave. FSSHK-ja vazhdimisht ka kërkuar hartimin e aktit nënligjor, por nuk ka gjetur mirëkuptim me qeverinë. Lartësia e shtesave është caktuar nga vetë qeveria dhe që nga fillimi i pandemisë është ndërprerë për 3 muaj. Lartësia e shtesave ka ndryshuar, e caktuar në vlerën 150, 250, 300 dhe së fundi është caktuar në vlerën 10% të pagës së punëtorëve shëndetësorë, afërsisht 60 euro në muaj. Kjo vlerë cilësohet shumë e ulët dhe aspak dinjitoze për punën dhe përgjegjësinë e punëtorëve shëndetësorë. Arsyetimi i qeverisë për FSSHK-në është se tanimë personeli shëndetësor është vaksinuar dhe rreziku është zvogëluar. Ky arsyetim konsiderohet i paqëndrueshëm, ngase rreziku për punëtorët

shëndetësorë qëndron ende. Jo të gjithë profesionistët shëndetësorë janë kompensuar, përfshirë punëtorët shëndetësorë në institucionet e përkujdesit të fëmijëve, stafi në institute shëndetësore etj., të cilët nuk janë kompensuar.

Siguria dhe shëndeti në punë ka qenë e cenuar për punëtorët shëndetësorë. Orari i zgjatur i punës është theksuar si një nga sfidat e tyre. Në fillim të pandemisë, punëtorët shëndetësorë, në mungesë të pajisjeve mbrojtëse personale, kanë qenë të rrezikuar nga COVID-19. Njëkohësisht të njëjtët janë sistematizuar në reparte e punë që nuk përkojnë me profesionin dhe përgatitjen profesionale të personelit shëndetësor. Për shembull ortopedi është dërguar në kujdes intensiv ose në infektologji. Vendimi për mosshfrytëzimin e pushimit vjetor për personelin shëndetësor gjatë vitit 2020 konsiderohet si një shkelje tjetër e të drejtave të punëtorëve, që garantohen me Ligjin e Punës.

Administrata Tatimore e Kosovës

Sa u përket politikave tatimore, Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT), në koordinim me ATK-në, ka zgjatur afatin për deklarimin dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe detyrimet dhe kontributet e pensioneve, deri më 30 qershor 2020. Një masë tjetër e përkohshme në lidhje me tatimet ishte heqja e TVSh-së në importe të grurit dhe të miellit, si dhe zgjatja e afatit të pagesave të shërbimeve publike, deri në fund të prillit. Krejt në fund, më 18 maj, MFT-ja mori edhe një vendim tjetër ku njoftoi se interesi për tatimet e pronave do të pezullohet deri në vitin 2021.

Nga raportet e ATK-së të viteve 2018-2020 vërehet se në vitin 2020, janë gjithsejtë 496 ankesa, domethënë ka pasur rënie të numrit të ankesave. Megjithatë në raport nuk prezantohen arsyet dhe ankuesit (punëtorët, qytetarët, bizneset etj.), kështu që analizë adekuate për efektin e pandemisë nuk mund të realizohet. Edhe pse gjatë programeve për rimëkëmbje dhe ndihmave të ofruara nga qeveria për bizneset është vërejtur një mungesë transparence, trajtim i pabarabartë në gjithëpërfshirje, mosqarim në ndarjen e subvencioneve dhe aplikimin për pagesën e punëtorëve dhe pagesën e qirasë, sepse bizneset nuk janë ndihmuar në të njëjtën kohë, ka pasur vonesa dhe refuzime të shumta, dhe për të gjitha këto, bizneset nuk kanë pasur se ku t'i adresonin ankesat e tyre. Edhe në momentin e përpilimit të këtij raporti, ka shumë nga ata që kërkesat e tyre nuk janë marrë parasysh.

Vendimi nr. 04/2021 i qeverisë, i datës 27 janar 2021, për lehtësimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik të të gjithë tatimpaguesve, si pasojë e gjendjes së vështirësuar ekonomike të krijuar nga pandemia, parashihte masat, si: Shtyhet bllokimi i llogarive bankare për të gjithë tatimpaguesit, që kanë obligime tatimore ndaj ATK-së, deri më 30 prill 2021; lirohen llogaritë e bllokuara të të gjithë tatimpaguesve, që kanë obligime tatimore, deri më 30 prill 2021; hiqen ndëshkimet për të gjithë tatimpaguesit që kanë detyrime të pashlyera ndaj ATK-së, nëse kryejnë pagesën e tatimit bazë dhe interesit, deri më 30 qershor 2021. Heqja e këtyre ndëshkimeve për tatimpaguesit bëhet nëse: Tatimpaguesit bëjnë pagesën e njëhershme të tatimit dhe të interesit; tatimpaguesit bëjnë marrëveshje me ATK-në për pagesë me këste; tatimpaguesit janë në marrëveshje me ATK-në dhe paguajnë tatimin dhe interesin.

Ndërsa obligohet ATK-ja që gjatë kësaj periudhe t'ua mundësojë tatimpaguesve t'i kryejnë obligimet tatimore bazuar në mundësitë financiare të tatimpaguesve, me qëllim të ruajtjes së

stabilitetit financiar. Megjithatë, u raportuan ankesa nga bizneset se në pamundësi për të paguar borxhin e akumuluar sipas marrëveshjes paraprake me ATK-në, për shkak të vështirësive financiare dhe për shkak të situatës me pandeminë, nga inspektorët e ATK-së vazhdimisht janë paralajmëruar se nëse nuk i paguajnë kështu me kohë, do t'u konfiskohet prona. Në përgjigjen e marrë nga ATK-ja theksohet se vendimi i qeverisë nuk i ndërpret procedurat e ATK-së për të realizuar të drejtën e vet sipas ligjit, përmes Departamentit të Menaxhimit të Mbledhjes së Borxheve.

Tabela 3. Ankesat në ATK

	Numri i ankesave	Burimi
2020	496	https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2021/04/RaportVjetor2020Neni8L03L-222.pdf
2019	612	https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/RAPORT-VJETOR-2019.pdf
2018	602	https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2019/04/ALBRaportiVjetor2018.pdf

E drejta për qasje në kursimet pensionale

Pamundësia e pensionistëve për tërheqjen e mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale

Tërheqja e mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) me arritjen e moshës së pensionimit është e përcaktuar me ligj¹³⁷ dhe me rregulloren¹³⁸ e BQK-së. Nëse bilanci i mjeteve të kursyera është deri në €3.000, atëherë FKPK-ja do të bëjë transferimin e këtyre mjeteve në cilëndo xhirollogari bankare që kontribuuesi e ofron. Nëse bilanci është më i lartë se €3.000, përfituesi do të kalojë në Programin për Tërheqje në Faza (PTF) të kursimeve pensionale. Aplikuesi do të ketë mundësinë që 20% të bilancit ta tërheqë përnjëherë, ndërsa pjesën tjetër çdo muaj prej minimumi €200 ose maksimumi 1% e bilancit total (kur shuma është mbi €20 mijë).¹³⁹ Përfituesit mund të zgjedhin njërin nga katër bankat që ofrojnë shërbimin PTF: TEB, NLB Prishtina, Banka për Biznes ose Banka Ekonomike, duke përfituar kështu nga një trajtim specifik, sipas kontratës së FKPK-së me këto banka. Në këtë llogari do të transferohet i gjithë bilanci i përfituesit. Çdo muaj, më së largu në ditën e dytë të punës të secilit muaj, banka do të bëjë pagesën e kështu mujor. Këto pagesa mujore do të vazhdojnë derisa të shteret i gjithë bilanci.¹⁴⁰ Sipas raportit të FKPK-së për vitin 2020, numri i llogarive të reja me tërheqje kursimesh ka qenë 7.078. Vlera e mjeteve të tërhequra për vitin 2020 ka qenë 49.608.754 euro. Prej 7.078 aplikacioneve të miratuara për tërheqje nga FKPK-ja, 4.997

¹³⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.

¹³⁸ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Rregullore mbi pagesën e Pensioneve Individuale të Kursyera.

¹³⁹ Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Raporti vjetor 2020, (linku: <http://www.trusti.org/sq/klientet/terheqja-e-kursimeve/>, vizituar me 01/07/2020).

¹⁴⁰ Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Raporti vjetor 2020, (linku: http://www.trusti.org/ep-content/uploads/2021/05/RaportiVjetor_2020_shq_ueb.pdf), vizituar me 01/07/2020.

persona e kanë arritur moshën e pensionimit; 1.110 tërheqje janë bërë nga trashëgimtarët e kontribuesve që kanë vdekur para moshës së pensionimit; 928 persona për arsye të invaliditetit si dhe 43 raste për kontribuues me status shtetas jorezident.

Personat e pensionuar nuk kanë mundur të përfitonin nga kjo mundësi pasi mjetet e tyre me rastin e pensionimit dhe me futjen në Programin për Tërheqje në Faza barten në bankën e autorizuar dhe nuk gjenden me në FKPK.

Rasti 2: Mostrajtimi i barabartë i personave që kanë tërhequr deri në 10% nga Fondi i Kursimeve Pensionale

Një nga masat e qeverisë për të mbështetur qytetarët dhe për të rritur kërkesën agregate ishte mundësia për tërheqjen e deri në 10% të kursimeve pensionale nga Fondi i Kursimeve Pensionale.¹⁴¹ Këtë të drejtë nga data 11 dhjetor 2020 deri më datën 31 dhjetor 2020 e kanë shfrytëzuar 397572 persona nga 644582 (Tabela X), do të thotë 61% e kontribuesve. Aplikimi ka vazhduar deri më 6 prill të vitit 2021, pas së cilës datë FKPK-ja do ta publikojë një raport të plotë.

Tabela 1. Aplikimet nga Fondi i Kursimeve Pensionale, 2020¹⁴²

Shuma për tërheqje	Numri i aplikantëve	Struktura e aplikantëve sipas madhësisë së kursimeve	Numri i personave me kursime pensionale	Përqindja e personave që kanë tërhequr kursimet
Deri €10	10,198	3%	99,800	10%
€11 deri €50	55,876	14%	135,211	41%
€51 deri €100	50,884	13%	80,547	63%
€101 deri €200	66,899	17%	88,495	76%
€201 deri €500	94,265	24%	109,791	86%
€501 deri €1,000	68,459	17%	73,026	94%
€1,001 deri €2000	39,277	10%	43,851	90%
€2,001 deri €4,000	9,790	3%	11,568	85%
Mbi €4,000	1,925	1%	2,293	84%
Gjithsej	397,573	100%	644,582	62%

Burimi: Fondi i Kursimeve Pensionale, 2021.

¹⁴¹ Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Raporti vjetor 2020, (linku: http://www.trusti.org/ep-content/uploads/2021/05/RaportiVjetor_2020_shq_ueb.pdf), vizituar me 01/07/2020.

¹⁴² Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Raporti vjetor 2020, (linku: http://www.trusti.org/ep-content/uploads/2021/05/RaportiVjetor_2020_shq_ueb.pdf), vizituar me 01/07/2020.

Sipas Ligjit nr.07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike, neni 5, parasheh që personat që kanë kursime deri në shumën 9.999 eurosh do të kompensohen në formë rimbursimi duke filluar nga viti 2023.¹⁴³ Shuma totale e përlogaritur për rimbursim, sipas FKPK-së, është 101.772.416 euro për 372.650 persona përfitues, të cilët e përmbushin kushtin e përcaktuar në Ligjin nr. 07/L-016, neni 5, paragrafi 1.144, nuk ekziston ndonjë sqarim për pragun prej 9.999 eurosh, prandaj edhe është kundërshtuar nga qytetarët me kursime mbi këtë tavan. Nga numri i përgjithshëm i kontribuesve, rreth 9% e kontribuesve kishin të kursyera më shumë se 9.999 euro, mirëpo vlera e përgjithshme e rimbursimit do të ishte e lartë.

Shtyrja e kredive nga bankat komerciale

Në përgjigjet që Avokati i Popullit ka pranuar nga BQK-ja, është raportuar se numri total i personave që kanë aplikuar për shtyrje të kredive deri në fund të muajit korrik 2020 ishte 77.629 persona, nga të cilët 57.443 ishin persona fizikë (29.229 të punësuar në sektorin privat) dhe 20.186 ishin persona juridikë. Pas vendimit për shtyrje, BQK-ja ka nxjerrë edhe dy udhëzime lidhur me ristrukturimin e kredive, njëri në shtator 2020 e tjetri në shkurt 2021 në bazë të të cilëve klientët kanë mundur të shfrytëzonin të drejtën e ristrukturimit të kredive. Sipas të dhënave të fundit, vlera aktuale e gjithsej kredive të ristrukturuara, përfshirë të gjitha fazat (vendimin dhe udhëzimet) në maj 2021 ishte 975.6 milionë euro, apo 28.8% e portofolit kreditor. Me këtë rast duhet cekur që pas ristrukturimit, klientët kanë vazhduar të paguanin këstet në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara me bankat dhe ka një stabilitet në kthimin e kësteve pas ristrukturimit.

Në pyetjen nëse janë shqyrtuar nga bankat të gjitha kërkesat e bizneseve dhe të individëve për pezullim të kredive, BQK-ja ka raportuar se bankat komerciale kanë shqyrtuar të gjitha kërkesat e bizneseve dhe të individëve për pezullimin e kredive dhe të gjitha kërkesat që kanë plotësuar kushtet sipas vendimit të nxjerrë nga BQK-ja dhe nga Shoqata e Bankave të Kosovës janë aprovuar. E njëjta përgjigje është ofruar edhe nga Shoqata e Bankave, e cila nuk ka ofruar të dhëna për ankesat, sepse numrin e vogël që e ka pranuar i ka referuar tek BQK-ja, ngase Shoqata e Bankave nuk ka mandat për trajtimin e ankesave të klientëve.

Për t'i mbështetur qytetarët dhe bizneset, në muajin mars 2020 BQK-ja, në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave, më 16 mars 2020 ka nxjerrë vendim¹⁴⁵ për shtyrjen e kredive, i cili vendim është zbatuar nga të gjitha institucionet kredidhënëse në Kosovë. Fillimisht, kreditë u shtynë për një muaj e pastaj u shtynë edhe për dy muaj të tjerë, do të thotë u shtynë për 3 muaj. Deri në maj të vitit 2020, 1.95 miliard euro ose 63.5% e tërë portofolit kreditor aplikuan për moratorium të kredive, ndërsa shkalla e aprovimit të këtyre aplikimeve ishte mbi 95% apo 1.87 miliard euro (BQK, 2021). Pas përfundimit të periudhës së moratoriumit, BQK-ja ka publikuar udhëzuesit për ristrukturimin e kredive me qëllim të vendosjes së kriterëve në të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredive për huamarrësit që kanë hasur në vështirësi financiare si pasojë e pandemisë. Udhëzuesit për ristrukturimin e kredive kanë bërë të mundur që t'u

¹⁴³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr.07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike, neni 5.

¹⁴⁵ Banka Qendrore e Kosovës, Vendim nr. 12-09/2020, datë 16.3.2021.

lehtësohet barra kreditore kredimarrësve pa implikuar ndonjë përkeqësim të klasifikimit të tyre në regjistrin kreditor të Kosovës.

Deri në muajin gusht 2021, BQK-ja deri më tani ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 816 ankesa që ndërlidhen me shtyrjen e pagesave të kësteve të kredive. Nga 816 ankesa, 619 janë lidhur me aplikimin e interesit shtesë dhe 197 ankesa lidhen me kërkesat për shtyrje të pagesës së kësteve të kredive. Nga 619 ankesa se bankat kanë aplikuar interes shtesë me rastin e shtyrjes së pagesave të kësteve të kredive, vetëm 21 ankesa janë aprovuar në favor të konsumatorit, meqenëse është vërtetuar se bankat kanë gabuar në llogaritjen e kamatave, por që kanë ardhur si pasojë e problemeve teknike në sistemet e bankave. Bankat kanë adresuar këto raste duke bërë korrigjimet dhe rregullimet e nevojshme, përderisa 598 ankesa të tjera janë refuzuar për shkak se është aplikuar vetëm interes i rregullt me rastin e shtyrjes së pagesave të kësteve të kredive, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet planit të pagesave. Sa u përket ankesave lidhur me kërkesat për shtyrje të afatit të pagesave të kësteve të kredive, nga 197 ankesa, 113 ankesa (57%) janë aprovuar. Pas analizës së ankesave, bankat kanë aprovuar kërkesat e 113 kërkesave për shtyrje të pagesave të kësteve të kredive, dhe 84 ankesa janë refuzuar për shkak se nuk kanë përmbushur kushtet për shtyrje të kësteve të kredive.

Përfaqësuesit e BQK-së sqaruan se shumica e ankesave të konsumatorëve kanë qenë të lidhura me interesin që bankat kanë aplikuar edhe për periudhën e moratoriumit. Edhe pse BQK-ja dhe bankat komerciale e kanë sqaruar se gjatë periudhës së moratoriumit nuk do të aplikohet interes ndëshkues dhe interesi për periudhën e moratoriumit do të paguhet përgjatë muajve pas fillimit të kthimit të kredive (shih të dhënat për disa banka më poshtë), klientët e kanë keqkuptuar duke menduar se gjatë periudhës së moratoriumit bankat nuk do të llogarisin interesin për kreditë. Kjo evidencë tregon se ka pasur nevojë për shpërndarje më të madhe të informimit të saktë dhe eksplícit të publikut. Tabela në vijim prezenton njoftimet e bankave që kemi identifikuar në ueb-faqet përkatëse.

Tabela 2. Kushtet për shtyrjen e kredive

Banka	Udhëzimet	Linku
Banka Procredit	Banka ju njofton se nuk do të aplikojë kamatë ndëshkuese për pagesat e kësteve të shtyra. Pagesa e interesit të rregullt për muajt që kërkoni shtyrje do të ngarkohet në këstin e parë pas përfundimit të periudhës së shtyrjes, ndërsa, pagesa e kryegjësë së kësteve të shtyra do të ngarkohet në këstet e ardhshme të kredisë.	https://www.procreditbank-kos.com/shq/lajme/aplikacion-online-per-shtyerje-te-pageses-se-1343/
Raiffeisen Bank Kosovo	Në procesin e shtyrjes së kësteve nuk aplikohet kosto shtesë. Në rastin e shtyrjes së kredisë për tre muajt që bëhet shtyrja e këstit, interesi i kalkuluar	https://www.raiffeisen-kosovo.com/Uploads/Richtext/Files/FAQ%20-

	<p>paguhet në këstin e parë (në muajin qershor/korrik 2020).</p> <p>Për tre muajt e fundit të kredisë, banka Raiffeisen nuk aplikon fare interes, tri këstet e fundit janë vetëm principal.</p> <p>Pas 3 muajve pauzë, këstet nuk do të paguhet në total, pasi afati i marrëveshjes së kredisë do të zgjatet për 3 muaj.</p>	%20shtyrje%20te%20kesteve.pdf
TEB Bank	<p>Për periudhën e pauzës (një ose dy muaj) të kredisë, TEB nuk do të aplikojë interes ndëshkues.</p> <p>Po ashtu, për periudhën e njëjtë të pauzës (një ose dy muaj) të kredisë, TEB nuk do të aplikojë provizione shtesë, por vetëm interes të rregullt, i cili do të paguhet në muajin e parë pas periudhës së pauzës, kurse në muajin vijues klienti do të fillojë me pagesë të kësteve të rregullta”, njofton banka TEB.</p>	https://klankosova.tv/bqk-pagesa-e-kesteve-pezullohet-vetem-per-kredimarresit-me-veshtiresi-financiare/

Pa dyshim, shtyrja e pagesës së kredive ka mbështetur qytetarët dhe bizneset dhe ka pasur përparësinë sepse nuk ka reflektuar në klasifikimin e tyre në regjistrin kreditor të Kosovës. Megjithatë, në total, klientët të cilëve u është aprovuar kërkesa për shtyrjen e kësteve, kanë paguar më shumë kamatë sesa kamata e llogaritur në momentin e nënshkrimit të kredisë. Megjithatë, përfaqësuesit e BQK-së kanë theksuar se kjo informatë ka qenë e ditur për klientët të cilëve u është aprovuar kërkesa.

Të drejtat e konsumatorit

Përveç ndikimit negativ në rritjen ekonomike, të hyrat tatimore dhe në tregun e punës, gjatë pandemisë, Kosova përjetoj edhe rritje të çmimeve, kryesisht në artikujt esenciale dhe në artikujt farmaceutikë, që për shkak të pandemisë u rrit në masë të madhe kërkesa në treg, duke cenuar kështu të drejtat e konsumatorit, që parashihen në nenin 4 të Ligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit. Sipas ASK-së, Indeksi i tërësishtëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2020 ishte më i lartë në një mesatare prej 0.2 për qind, krahasuar me vitin 2019 (ASK, 2021). Të dhënat e prezantuara në tabelë tregojnë se në përgjithësi ngritje të çmimeve gjatë vitit 2020 kishte në grupet dhe nëngrupet e konsumit, si: bukë dhe drithëra (2.3%); mish (1.8%), qumësht, djathë dhe vezë (1.8%); pemë (5.0%); kafe, çaj dhe kakao

(5.4%); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (1.7%) si dhe produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (4.4%); shërbime telefonike (2.2%); shërbime hoteliere (2.3%); sigurime (15.7), sheqer dhe ëmbëlsira (3.4%); duhan (1.3%); pajisje shtëpiake (1.0%); shërbimet ambulatore (5.8%); kujdes personal (1.3%) si dhe gjërat personale (3.2%) (ASK, 2021).

Tabela 3. Ndryshimet mesatare vjetore të IÇK/IHÇK-Burimi ASK 2021

Ndryshimet mesatare vjetore të IÇK/IHÇK			
	2018	2019	2020
Gjithsej IÇK - IHÇK	1.1	2.7	0.2
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	1.5	5.4	1.7
Pijet alkoolike, duhani	2.5	2.6	0.4
Veshje dhe këpucë	-0.6	0.3	-0.9
Strehimi, uji, rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	-2.8	0.1	0.2
Mobilieri, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0.3	1.2	0.5

Nga të dhënat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, në vitin 2020 ka pasur 1.107 ankesa nga konsumatorët, që është dyfishi i ankesave në krahasim me vitin 2019. Deri më 23 korrik 2021, Departamenti ka pranuar 618 ankesa, duke tejkaluar numrin e ankesave të tërë vitit 2019. Ankesat lidhur me tregtinë përbëjnë 44% të ankesave të vitit 2019, ndërsa 55% të atyre të vitit 2020 (nga të cilat 27% lidhen me rritjen e çmimeve). Nga përgjigjet e Departamentit është theksuar se në javën e dytë të marsit 2020 kanë pranuar ankesa për abuzime, ngritje çmimesh dhe mungesë artikujsh të ndryshëm që lidheshin me shkeljen e të drejtave të konsumatorit. Përveç rritjes së çmimeve, ka pasur edhe mungesë të produkteve esenciale në treg, kryesisht: miell, vaj, dorëza, maska etj. Nga 1.107 ankesa të vitit 2020, 48% prej tyre janë zgjidhur.

Tabela 4. Të dhënat nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, 2018, 2019 , 2020 dhe deri më 23.7.2021.

Ankesat/Kategoritë	2019 - Lloji i ankesave		2020 - Lloji i ankesave		Deri më 23.7.2021 - Lloji i ankesave	
	Total	Ngritje e çmimeve	Total	Ngritje e çmimeve	Total	Ngritje e çmimeve
	509		1,017		618	
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Tregti	222	0	563	154	293	1
		Shërbim jociësor		Shërbim jociësor		Shërbim jociësor

Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Telekomunikacion	134	89	115	61	82	40
		Faturim i padrejtë		Faturim i padrejtë		Faturim i padrejtë
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Ujësjetës	2	1	6	4	2	1
		Shërbime jociësore		Shërbime jociësore		Shërbime jociësore
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Energjia Elektrike	8	8	15	11	10	6
		Matje e dyshimtë		Matje e dyshimtë		Matje e dyshimtë
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Metrologji	2	2	5	2	9	8
		Produkt i dyshimtë		Produkt i dyshimtë		Produkt i dyshimtë
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Shëndetësi	5	4	20	7	15	4
		Shërbime jociësore		Shërbime jociësore		Shërbime jociësore
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Shërbime Financiare	17	13	26	21	19	15
		Afat i skaduar		Afat i skaduar		Afat i skaduar
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Ushqim	89	22	129	56	52	14
		Mashtrim i konsumatorit		Mashtrim i konsumatorit		Mashtrim i konsumatorit

Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Blerje Online	22	15	93	74	65	60
		Kupon fiskal		Kupon fiskal		Kupon fiskal
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Administrata Tatimore e Kosovës	8	8	44	44	21	21
		Kartel		Kartel		Kartel
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Konkurrence			1	1	11	8
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Inspektorati i Arsimit					2	
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Agjencia për Informim dhe Privatësi					2	
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë / Të refuzuara në mungesë dëshmive					35	

Burimi: <https://konsumatori.rks-gov.net/statistics.php>

Të drejtat ekonomike të bizneseve

Gjithëpërfshirja në mbështetjen e masave mbështetëse të qeverisë

Në mungesë të ligjit për pandeminë, vendimet e qeverisë kanë qenë të jashtëligjshme, është një nga komentet kryesore nga përfaqësuesit e bizneseve. Po ashtu është theksuar se bizneset dhe përfaqësuesit e tyre nuk kanë qenë të përfshirë në procesin e hartimit të Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, i aprovuar në gusht të vitit 2020.

“Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve shtetërore, institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësiave gjatë pandemisë COVID-19. 2. Ligji përcakton masat dhe sanksionet të cilat do të ndërmerren ndaj personave fizik dhe juridik, shtetas të Republikës së Kosovës apo të huaj me qëndrim në Republikën e Kosovës, të cilët i shkelin rregullat, vendimet dhe udhëzimet e

nxjerra nga organet kompetente, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit, pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.”

Përfaqësuesit e bizneseve të intervistuar theksuan se në mungesë të të dhënave për ndikimin e pandemisë, masat e qeverisë nuk kanë ndihmuar sektorët më të prekur. Shtyrja nga ATK-ja e deklaramit të qarkullimit konsiderohet se ka qenë i panevojshëm dhe dështim për të siguruar qasje në të dhëna që do të shërbenin për të matur ndikimin e pandemisë dhe dizajnuar masat mbështetëse. Në mungesë të të dhënave, masat mbështetëse kanë mbështetur bizneset në pozitë më të mirë: për shembull masa e shpërndarë për kokë punëtori ka favorizuar ndërmarrjet të cilat kanë qenë në pozitë më të mirë financiare për t'i mbajtur punëtorët, ndërsa më pak bizneset që kanë pësuar rënie në numrin e punëtorëve.

Qeveria e Republikës së Kosovës ndërmori një seri hapash për të adresuar sfidat e paraqitura nga shpërthimi i COVID-19. Fillimisht, në mars 2020, qeveria nxiti Paketën Emergjente Fiskale, një paketë stimuluese në vlerën prej 179 milionë eurosh. Paketa synonte të sigurote mbështetje për segmentet e shoqërisë më në nevojë. Një qasje më sistematike u krijua në gusht 2020 me zhvillimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (Ministria e Financave, 2020), i cili ka zgjeruar masat thelbësore të parashikuara nga Paketën e Urgjencës. Miratimi i Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike u pasua nga një vendim i qeverisë, i cili përshkruan masat specifike të synuara dhe planin e ndërhyrjeve për rimëkëmbjen ekonomike. Paketa arriti në mbi 350 milionë euro. Ndërsa stimulimi i emergjencës mbështetej vetëm në fondet qeveritare, Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike përfitoi gjithashtu nga mbështetja e Komisionit Evropian, nga Banka Botërore dhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Një komponent i rëndësishëm i Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike ishte miratimi (pas shumë tentimesh në Parlament) i Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19, në dhjetor 2020. Ligji i dha mundësi qeverisë t'i ndryshonte përkohësisht një seri ligjesh për ta zbatuar Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike dhe të përdorte burimet që përndryshe qeveria nuk do të kishte qasje. Për të siguruar qasje më të lehtë në financim, janë bërë ndryshime në Ligjin për Themelimin e Fondit të Garantimit të Kredisë. Qasja në 10% të kursimeve të pensioneve u dha me ndryshimet në Ligjin për Fondet e Pensionit. Për të siguruar lehtësime tatimore u miratuan disa ndryshime në ligjet ekzistuese, përfshirë Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Ligjin për Administratën dhe Procedurat Tatimore. Për të mbështetur furnitorët vendas, u bënë ndryshime në Ligjin për Prokurimin Publik. Por edhe pas miratimit të ligjit dhe gjithë këtyre ndryshimeve, kishte ngecje dhe pakënaqësi në gjithëpërfshirje të bizneseve.

Oda Ekonomike e Kosovës theksoi se mbështetja e ofruar e qeverisë nuk ka qenë në përputhje me shkallën e ndikimit të pandemisë nëpër sektorë. Po ashtu u theksua se ka pasur ankesa nga bizneset se mbikëqyrja për zbatimin adekuat të masave mbrojtëse kundër COVID-19 ka qenë selektive. Bizneset kanë theksuar se ka pasur më shumë monitorim në Prishtinë sesa në vendet e tjera dhe po ashtu ka pasur ankesa se brenda të njëjtit vend ka pasur kontrolle selektive tek bizneset.

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, në nenin 25, përcakton se personi juridik që organizon aktivitete të ndaluara me vendim të Organit Kompetent, dënohet me gjobë prej 2.000 eurosh dhe ndalimin e aktivitetit, ndërkaq personi përgjegjës i personit

juridik dënohet me gjobë prej 2.000 eurosh. Megjithatë, përfaqësuesi i Shoqatës së Gastronomëve theksoi se sipas legjislacionit në fuqi, në rast të ndonjë shkeljeje, subjektit juridik së pari i shqiptohet qortimi, e nëse bën shkelje pas kësaj, mund të urdhërohet mbyllja e subjektit. Kjo nuk është zbatuar në kohën e pandemisë, posaçërisht në muajin shtator kur inspektorët qysh në shkeljen e parë kanë paditur dhe mbyllur bizneset. Për gastronominë, inspektorët nuk kanë zbatuar definimin e hapësirës së hapur sipas Ligjit për Kontrollin e Duhanit. Është theksuar se ka pasur keqkuptime në mesin e inspektorëve për këtë aspekt, që ka shpirtë në shqiptimin e gjobave dhe mbylljen e bizneseve. Përfaqësuesit e sektorit të gastronomisë kanë theksuar se rritja e rasteve gjatë sezonit së verës ka ardhur si rezultat i mosinspektimit të respektimit të masave nga institucionet qeveritare (është përmendur ndërprerja e kontratave nga qeveria aktuale për inspektorët me kontratë mbi vepër) dhe mosaplikimi i kushteve për vaksinim dhe testim për diasporën. Mungesa e bashkëpunimit të sektorit privat me qeverinë është përmendur si një pengesë për menaxhimin e mirë të situatës pandemike, ndërsa kjo pastaj është reflektuar në kufizim të aktivitetit ekonomik për sektorë të caktuar.

Të drejtat ekonomike të grave në biznes

Në shkresën e drejtuar nga Avokati i Popullit dhe pyetjet e parashtruara Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), ndër të tjera është theksuar një analizë e mbështetur nga UN Women, ku është konstatuar se masat e qeverisë për masat mbështetëse e as për shkurtimet buxhetore nuk ka integruar perspektivën gjinore. Gjetje e njëjtë është raportuar nga RrGK-ja i reflektuar edhe në raportin e tyre “*Pandemia nuk njeh gjini*”. Në përgjigjet e ofruara nga RrGK-ja në shkresën e Avokatit të Popullit është theksuar se qeveria ka organizuar shumë pak konsultime substanciale me organizata të shoqërisë civile. Si rrjedhojë e kësaj, shoqëria civile nuk ka qenë mjaftueshëm e angazhuar në dizajnimin e masave mbështetëse nga qeveria. RrGK-ja është ftuar vetëm dy herë të komentonte në hartimin e masave të qeverisë, përkatësisht nga Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë (kryesuar nga kryeministri), për Programin e Qeverisë për Rimëkëmbje Ekonomike – COVID-19 (qershor 2020) për dhe Pakon Fiskale, në fillim të janarit 2021. Rekomandimet e dhëna nuk janë marrë parasysh dhe procesi konsultativ ka qenë vetëm formal. Kur u pyetën për përfshirjen e tyre në sigurimin e informacionit për të informuar reagimin e qeverisë ndaj COVID-19, 83% e të anketuarve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC) thanë se nuk u ishte dhënë asnjë mundësi për t’u përfshirë, 9% thanë se u ishte dhënë mundësia për përfshirje të vogël, 7% thanë që ata ishin të përfshirë mesatarisht, dhe vetëm një organizatë deklaroi që ishin të përfshirë në mënyrë thelbësore¹⁴⁶. Përgjigjet e të anketuarve nga OShC-të ishin të ngjashme kur u pyetën për përfshirjen e OShC-ve të tjera në planifikimin dhe hartimin e reagimit të qeverisë. Sidoqoftë, më shumë OShC tentuan të besonin se organizatat e tjera kishin pak më shumë mundësi për të dhënë kontribut sesa ata vetë.

Ndërkohë, disa OShC morën iniciativën për t’ia dërguar rekomandime qeverisë. Më 22 mars, përpara se qeveria të vendoste për Pakon Fiskale Emergjente, 12 OShC ia paraqitën qeverisë rekomandimet e tyre për masat për të luftuar pasojat ekonomike të pandemisë. Letra nuk përmbante asnjë perspektivë gjinore, mbase pjesërisht për shkak të faktit se asnjë nga

¹⁴⁶ Po aty.

organizatat nënshkruese nuk ishte OShCG. Menjëherë pasi u miratua Pakoja Fiskale Emergjente, RrGK-ja kërkoi nga qeveria ta konsideronte më mirë një perspektivë gjinore në reagimin e saj ndaj COVID-19.

RrGK-ja i kërkoi qeverisë që urgjentisht të kryente analizën gjithëpërfshirëse gjinore për të informuar dhe drejtuar masat e mëtejshme qeveritare, duke përfshirë një vlerësim ex-ante të ndikimit gjinor, në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore. RrGK-ja gjithashtu kërkoi që qeveria të përfshinte më shumë gra në hartimin e programeve dhe të politikave në lidhje me COVID-19 dhe në propozimin e masave afatshkurtra dhe afatgjata, veçanërisht në lidhje me çështjet sociale, ekonomike dhe shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore. RrGK-ja i rekomandoi Ministrisë së Financave që të rishikonte buxhetin afatmesëm duke përdorur parimet më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe duke u bazuar në gjetjet e vlerësimeve të ndikimit gjinor për t'i marrë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.

Megjithatë, disa masa janë përfshirë në masat e qeverisë për mbështetje për fuqizimin ekonomik të grave dhe adresimin e dëmeve të shkaktuara nga pandemia. Në kuadër të Pakos Emergjente nuk kishte asnjë masë të dedikuar specifiku për t'i adresuar nevojat e grave, ndërsa vetëm një nga masat në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike përpiqet të adresojë në mënyrë specifike nevojat e grave si masë afirmative: Masa 10 – Sigurimi i mbështetjes financiare për projekte dhe iniciativa që synojnë përmirësimin e pozitës së grave në shoqëri dhe ekonomi, në vlerën prej 2.000.000 euros dhe 470.000 euro për mbështetjen e bizneseve në pronësi të grave - e përfshirë në Buxhetin e Rishikuar të vitit 2020. Po ashtu në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, në kuadër të buxhetit për Fondin e Garantimit të Kredive, ka parashikuar një dritare të veçantë për mbulimin deri në 80% të kolateralit për bizneset në pronësi të grave.

Vonesat, zvarritja e pagesave të masave mbështetëse të qeverisë

Kriza emergjente shëndetësore e shkaktuar nga pandemia COVID-19 ka prekur direkt tregun e punës pothuajse në të gjitha vendet e botës. Kufizimi i lëvizjes ka shkaktuar rënie drastike të veprimtarive afariste në njërin anë, kurse mbyllja e plotë e shumë industrive ka lënë pa punë shumë punëtorë. Shkalla e papunësisë në Kosovë kanë qenë në nivele të larta edhe para pandemisë, në veçanti papunësia e të rinjve, papunësia e grave dhe papunësia e të diplomuarve. Përfundimisht, tregu i punës mund të mos jetë më i njëjti sikurse në kohën e para pandemisë, dhe periudha pas pandemisë mund të jetë një fillim i ri dhe sfida për ekonominë e brishtë të Kosovës.

Ashtu si në shumë vende të botës, edhe në Kosovë kjo pandemi dhe masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së saj, kanë bërë që bizneset dhe qytetarët, por edhe institucionet, pra qeveria vetë të ndikohej nga këto zhvillime. Duke qenë se shumica e bizneseve, fillimisht për një periudhë tremujore, pastaj me kohë më të shkurtër dhe me kufizime të ndryshme, kanë qenë pothuajse komplet të mbyllura, shumë prej punëtorëve nuk kanë arritur t'i marrin pagat e plota, disa prej tyre edhe nuk kanë marrë fare nga punëdhënësit e tyre. Për më tepër, pagesat për qytetarët dhe bizneset nga pakot ndihmëse nga qeveria ende nuk janë realizuar në tërësi, dhe shumë punëtorë dhe biznese e kanë pasur të paqartë se si të aplikojë dhe ka pasur paqartësi se ku të drejtohenin për këshilla apo ku të drejtohenin për ankesë të mëtutjeshme për realizimin

e së drejtës se tyre, do të thotë ka munguar komunikimi me biznese dhe transparenca nga MFPT-ja dhe ATK-ja. Si pasojë e kësaj kanë mbetur pezull shumë aplikacione për ndihmë të bizneseve. Sipas Shoqatës së Gastronomëve, në mes të një të tretës dhe gjysmës së bizneseve kanë mbetur të pambështetura: për shembull nga masa e fundit mbështetëse për sektorin e gastronomisë (mbulimi 50% i qirasë dhe i pagave të punëtorëve), vetëm 33% kanë përfituar.

Tabela 9 prezanton të dhënat për buxhetin dhe shpenzimet për menaxhimin dhe Pakon Emergjente dhe të Rimëkëmbjes Ekonomike për vitin 2020 dhe gjashtëmujojin e vitit 2021. Në këtë periudhë kohore, qeveria ka ndarë 393 milionë euro për menaxhimin e pandemisë dhe zbatimin e Pakos Emergjente Fiskale dhe Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike. Nga këto mjete, 94% janë shpenzuar gjatë së njëjtës periudhë. Nga vlera totale e shpenzuar në vitin 2020, 80% kanë qenë për transfere dhe subvencione, ndërsa kjo kategori ekonomike përbënte 74% të buxhetit të shpenzuar në gjashtëmujojin e vitit 2021.

Tabela 9: Buxheti dhe shpenzimet për menaxhimin e pandemisë dhe paket mbështetëse, viti 2020 dhe gjashtëmujoji i vitit 2021

<i>Viti 2020</i>	Buxheti	Shpenzimet	Realizimi
Pakoja Emergjente	172,163,254	168,037,902	98%
Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike 2020	122,402,469	117,509,114	96%
<i>Gjashtëmujoji i vitit 2021</i>			
Pakoja për Menaxhimin e Pandemisë	8,913,539	1,191,845	13%
Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike 2021	89,933,157	82,401,027	92%
Gjithsej	393,412,419	369,139,888	94%

Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Raportet financiare¹⁴⁷

Të dhënat sipas masave, për numrin e punëtorëve dhe bizneseve përfituese nga masat mbështetëse të qeverisë janë pasqyruar në *Tabelën 10*. Të dhënat tregojnë se mbështetje kanë pranuar bizneset për mbulimin e 50% të qirasë, për punëtorët ekzistues dhe për punëtorët e rinj që kanë punësuar. Janë mbështetur punëtorët që kanë qenë të ekspozuar ndaj rrezikut duke punuar gjatë pandemisë. Në kuadër të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike të vitit 2020, me nga 290 euro për punëtorët janë kompensuar rreth 40.000 biznese, me buxhet prej 59.5 milionë eurosh për gjithsej 205.231 punëtorë.

¹⁴⁷ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/73392B53-4800-4015-911D-5CC17E511EB0.pdf>; [04E85A56-B508-41C1-A6D6-427A0C091EF0.pdf](https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/04E85A56-B508-41C1-A6D6-427A0C091EF0.pdf) (rks-gov.net)

Tabela 10: Përfituesit nga Pakoja Emergjente Fiskale, 2020

Masa	Numri i përfituesve	Shuma në euro	Përshkrimi
3a	137,469	49,144,777	Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore në shumën prej 170 eurosh për muajt mars dhe prill 2020
3b	10,081	5,864,717	Subvencionimi i qerasë 50% për muajt prill dhe maj 2020
6	25,508	14,787,285	Paga shtesë për punëtorët shëndetësorë, policët, gardianët, zjarrfikësit, personelin ushtarak, inspektorët e punës, inspektorët e Doganës, të ATK-së, për muajt prill dhe maj.
7	14,776	2,561,124	Pagesë shtesë 100 euro në pagë për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave të bukës, barnatoreve, për muajt prill dhe maj 2020
8	804	322,140	Pagesa e asistencës mujore prej 130 eurosh për qytetarët që kanë humbur vendet e tyre të punës.
14	14,463	3,820,821	Mbështetje financiare për bizneset që regjistrojnë punëtorë me kontratë pune për së paku një vit, në shumën prej 130 eurosh për dy muajt pasues në vitin 2020

Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, shtator 2021

Sa u përket ankesave të punëtorëve dhe bizneseve, nga takimi me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht me Departamentin e Thesarit, u theksua se ka pasur raste kur për shkaqe teknik, siç është: mospërputhja e të dhënave personale me të dhënat e llogarisë bankare, ofrimi i llogarisë bankare në emër të subjektit fizik për masat që janë zbatuar tek subjektet juridike, rastet kur aplikuesi për masë mbështetëse ka qenë edhe përfitues i skemave sociale dhe përfituesve të tjerë socialë. Ministria ka analizuar ankesat dhe ka raste që ankesa është pranuar por nuk është paguar në vitin 2021, ngase masa ka qenë e vitit 2020. Kjo është një çështje që është duke u analizuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe ende nuk është vendosur se si të zgjidhet.

Pensionet, përfitimet sociale dhe përfitimet e veçanta gjatë COVID-19 për personat me aftësi të kufizuara

Lidhur me skemat e pensioneve, bazuar në Vendimin nr. 06/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 14 janar 2021, Masa 16, pika 1.16.1 - Mbështetje për skemat e pensioneve për individë që fitojnë më pak se 100 euro në muaj; dhe bazuar në propozimin - vendimi i ish-Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për të aprovuar një pagesë shtesë në vlerën prej 30 € për muajt janar-mars 2021, e cila është bërë, dhe nga prilli 2021 deri më tani, shuma e përfitimeve në skemat e mëposhtme është barazuar në shumën prej 100 €, shtesat për ta bërë barazimin e shumës së specifikuar në skema janë si më poshtë: Pensioni bazë - është 90 € +10 = 100 €; Pension familjar - është 90 € +10 = 100 €; Pensioni për personat me aftësi të kufizuara - është 75 € +25 = 100 €; Pensioni invalidor i punës - është 90 + 10 € = 100 €.

Masat e veçanta për personat me aftësi të kufizuara, me përjashtim të një pagese shtesë prej 30 eurosh, janë që atyre nuk u kërkohet t'u nënshtrohen procedurave të rregullta para Komisionit Mjekësor për Rivlerësim, Raportim dhe Njoftim.¹⁴⁸

Akti ligjor i qeverisë për rrjetin e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë është Vendimi nr. 06/58 i qeverisë, i datës 14.1.2021, dhe Vendimin nr. 17/2021, i datës 8.4.2021, si dhe Vendimin 01/07 i qeverisë, i datës 11.3.2020, për periudhën prill, maj, qershor 2020. Duke vepruar kështu, të gjitha masat e veçanta financiare janë zbatuar brenda paketës së skemave të pensioneve.¹⁴⁹

Në anën tjetër, Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, në përputhje me mandatin e vet, lidhur me hartimin e ligjeve nuk ka marrë asnjë akt juridik nga ministrinë përkatëse për shqyrtim dhe përpunim për aprovim nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me mbështetjen gjatë pandemisë COVID-19 për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu Zyra Ligjore e qeverisë nuk është në dijeni për masat e posaçme, të cilat i ka miratuar qeveria gjatë pandemisë COVID-19 për personat me aftësi të kufizuara dhe nuk e di nëse personat me aftësi të kufizuara kishin ndonjë privilegj në lidhje me lirinë e lëvizjes gjatë kohëzgjatjes së masave lidhur me kufizimet në lëvizjen e popullsisë. Për më tepër, për këtë zyrë nuk është e njohur nëse janë marrë masa të veçanta financiare brenda paketave të parashikuara të ndihmës ekonomike për personat me aftësi të kufizuara, gjatë pandemisë COVID-19.¹⁵⁰

Mund të nxirret konkluzioni se nga ana e shtetit nuk u është ofruar ndonjë mbështetje e veçantë personave me aftësi të kufizuara, përveç mbështetjes së përgjithshme, të cilën ata e morën nga ndarjet si për të gjithë qytetarët.

Sa i përket ndihmës nga sektori i OJQ-ve të Kosovës, me ndihmën e Komunës së Prishtinës, përkatësisht Departamentit të Mbrojtjes Sociale, Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës dy herë shpërndau pesëdhjetë paketa higjienike dhe pesëdhjetë thasë me miell prej njëzet e pesë kg. Gjithashtu nëpërmjet ndihmës islamike, Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës shpërndau

¹⁴⁸ Përgjigjja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 9 korrik 2021, të cilën e ka dërguar Ministria e Financave, Punës dhe Transferit në pyetësin e Institutit të Avokatit të Popullit në Kosovë dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

¹⁴⁹ Përgjigjja e Zyrës Ligjore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 9 korrik 2021, në pyetësin e Institutit të Avokatit të Popullit në Kosovë dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

¹⁵⁰ Po aty.

pesëdhjetë pako me ushqim dhe mish për tri festat e Kurban Bajramit gjatë pandemisë.¹⁵¹ Shoqata “Bereqeti” gjithashtu ndihmoi me pesëdhjetë pako ushqimore për anëtarët e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës.¹⁵²

Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës gjatë pandemisë COVID-19, me ndihmën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të Komunës së Prishtinës dhe të Rrjetit të Grave të Kosovës, arritën të kryenin aktivitete të ndryshme gjatë kësaj kohe, gjithmonë duke respektuar masat mbrojtëse.¹⁵³

Gjatë pandemisë u mbajt një manifestim me rastin e Javës Ndërkombëtare të Kallamit të Bardhë (e cila manifestohet në të gjithë botën). Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës arriti të festonte 7 dhe 8 Marsin dhe avokoi e lobi te institucionet përkatëse për ta përmirësuar Ligjin nr. 04/L- 092 për Personat e Verbër. Në faqen zyrtare dhe në atë Facebook, Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës ka bërë një seri regjistrimesh audio ku personat e verbër dhe me shikim të dobët janë informuar për të drejtat që gëzojnë dhe ku duhet të drejtohen në rast se mendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur, vëmendje e veçantë iu kushtua informimit të grave për të drejtat e tyre.¹⁵⁴

Gjithashtu, në lidhje me qasjen në përfitimet sociale dhe në shërbimet, të verbrit dhe personat me shikim të dobësuar nuk kanë qenë përfitues të ndonjë shërbimi social. Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës kërkoi nga ish-ministri i Financave që ta rriste kompensimin për të verbrit dhe për personat me shikim të dobët, por nuk u mor ndonjë përgjigje për kërkesën, përkundër përsëritjes së kërkesës. Gjithashtu u kërkua një subvencion i punëtorëve të kësaj organizate.¹⁵⁵

Gjithashtu, OJQ HANDIKOS siguroi për personat me aftësi të kufizuara, të cilët iu drejtuan asaj, maska mbrojtëse, material dezinfektues, material inkontinencë, si dhe ushqim. Kjo ndihmë u siguroi nga organizata përmes donatorëve.

IX. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe përgjegjësia për mjedisin jetësor

Duke marrë parasysh specifikat e zhvillimeve mjedisore në vend dhe ndikimin e degradimit të mjedisit në të drejtat e njeriut, në veçanti në të drejtën për jetë, analiza në vazhdim ka për qëllim të vlerësojë se sa ka arritur shteti që të përfshijë integrimin e masave për respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit në masat reaguese ndaj pandemisë COVID-19.

Kjo pjesë e raportit analizon atë se sa është arritur që brenda situatës së krijuar, qeveria t'i përshtatë politikat për funksionimin e organeve për mbrojtje të mjedisit me përpjekje për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e zyrtarëve, në përputhje me rregullat për mbrojtje nga COVID-19, në mënyrë që të respektohen parimet kryesore mjedisore (parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, i integritetit dhe i parandalimit, i vlerësimit të ndikimit në mjedis, vlerësimit

¹⁵¹ Përgjigjja e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës, e datës 29 qershor 2021, në pyetësin e Institutit të Avokatit të Popullit në Kosovë dërguar nëpërmjet postës elektronike, më 21.6.2021.

¹⁵² Po aty.

¹⁵³ Po aty.

¹⁵⁴ Po aty.

¹⁵⁵ Po aty.

strategjik mjedisor, parimi i qasjes në informata, i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, i qasjes në drejtësi etj.)

Krahas institucioneve të tjera në vend, edhe organet kompetente për mbrojtjen e mjedisit u gjenden para një situatë të panjohur, përballë vendimeve të vështira dhe urgjente të cilat ngërthenin në vete prioritetin për mbrojtje të shëndetit dhe të sigurisë publike. Përderisa shteti ishte përqendruar që nëpërmjet masave kufizuese të mbronte dhe të garantonte të drejtën për jetë dhe të drejtën për shëndet, ndikimi në mjedis nga veprimtaritë e ndryshme kishte vazhduar.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në vazhdim: MMPHI), si organ kompetent për hartimin dhe zbatimin e legjisllacionit për menaxhimin e përgjithshëm të fushës së mjedisit, të ujërave, të planifikimit hapësinor dhe të ndërtimit e banimit, në periudhën mars 2020 - mars 2021 është gjendur para një situatë të komplikuar dhe me shumë paqartësi. Rezultat i mospërfshirjes në prioritetet e politikave shtetërore, të kapaciteteve të pamjaftueshme, mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk u gjet as në vendimet e qeverisë për mbrojtje nga pandemia.

Komisioni i parë i cili kishte për qëllim parandalimin e përhapjes së virusit, i përbërë nga 22 përfaqësues, nuk kishte të përfshirë në vete asnjë përfaqësues të autoriteteve që merreshin me mbrojtjen e mjedisit, i cili nëpërmjet ekspertizës do të mundë të ndihmonte në garantimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.¹⁵⁶ Po ashtu, përkundër gjendjes së brishtë në mjedis dhe ndikimin e pandemisë në këtë fushë, vendimet e qeverisë fillimisht urdhëruan që të gjitha institucionet të funksiononin vetëm me staf esencial, në përjashtim të stafit të sektorit të shëndetësisë dhe të sektorit të sigurisë, duke mos bërë asnjë përpjekje për të gjetur zgjidhje nën masat mbrojtëse për funksionimin e stafit mbikëqyrës të organeve për mbrojtje të mjedisit.

Qeveria, përkundër mungesës së funksionimit të organeve mbikëqyrëse dhe inspektorateve, nëpërmjet vendimeve për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik, lejoi operimin dhe funksionimin e operatorëve më të mëdhenj me ndikim në mjedis, si: ndërtimi, prerja e drurëve, nxjerrja e qymyrit, e xeheroreve dhe e gurorëve, veprimtaritë lidhur me mbeturinat etj.¹⁵⁷ MMPHI-ja, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të IAP-së nëpërmjet postës elektronike, shkresave dhe thirrjeve telefonike, nuk arriti të dëshmonte që nëpërmjet vendimeve të veta ka vendosur politika të balancuara me të cilat do t'i ushtronte kompetencat në përputhje me masat e Qeverisë për mbrojtje nga pandemia.

Si rezultat i ndryshimeve të qeverive, dhe në ministri brenda periudhës shkurt 2020 - mars 2021 si dhe në ndryshimin e strukturës së ministrisë, ka pasur vështirësi që kanë ndikuar në përshtatjen e veprimeve të ministrisë me situatën. Fillimisht MMPH-ja është fuzionuar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe është emërtuar (Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit), nga muaji qershor në Ministrinë e Ekonomisë (Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit), dhe në mars 2021 në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), janë

¹⁵⁶ Komisioni i krijuar me Vendimin nr. 01/08 të Qeverisë, datë 12 mars 2020, ishte i përbërë nga 22 përfaqësues, përfshirë kryeministrin, 6 ministri, përfaqësues të agjencive të pavarura, Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, inspektorateve etj.

¹⁵⁷ Urdhëresa e MEPTINS, nr. 01/05, datë 23 mars 2020.

tregues i mungesës së politikave të qëndrueshme, të cilat do t'i balanconin drejt interesat në gjendje pandemie.

Vendimet e Qeverisë për parandalimin e pandemisë COVID-19 dhe ndikimi i tyre në mjedis

Qeveria me vendimin e datës 12 mars 2020, në përjashtim të stafit të sektorit të shëndetësisë dhe të sektorit të sigurisë, reduktoi aktivitetet publike dhe private vetëm me staf esencial, nuk parashikoi asnjë masë e cila do të rregullonte mënyrën e funksionimit të organeve mbikqyrëse të cilat merren me mbrojtjen e mjedisit. Më 15 mars 2020, Qeveria shpalli gjendje emergjente të shëndetit publik.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nëpërmjet Urdhëresës nr. 01/04, datë 20 mars 2020, për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik, urdhëroi të gjithë operatorët ekonomikë që t'i zbatonin vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datave 13 dhe 15 mars 2020, dhe lejoi prodhuesit, përpunuesit dhe ndërtimtarët për të ushtruar veprimtarinë e tyre pa kufizime kohore.

Në vazhdim Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nëpërmjet Urdhëresës nr. 01/05, datë 23 mars 2020, për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik, e cila urdhëroi operatorët ekonomikë që t'i zbatonin vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datave 13 dhe 15 mars 2020, listës së operatorëve që u është lejuar ushtrimi i veprimtarisë, përveç prodhuesve, përpunuesve dhe ndërtimtarëve, ia shtoi edhe një numër të konsideruar të veprimtarive me ndikim në mjedis. Sipas listës NACE (klasifikimi i veprimtarive ekonomike), ndër veprimtaritë e lejuara, janë: prodhimtaria bimore dhe shtazore, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to, pylltaria dhe prerja e drurëve, nxjerrja e qymyrit dhe e linjiteve, nxjerrja e xehes së metalit, xeheroret dhe guroret e tjera, veprimtaritë e shërbimeve mbështetëse të xeheroreve, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave, veprimtaritë e riparimit dhe menaxhimit të mbeturinave, ndërtimi i ndërtesave, dhe veprimtaritë e ndërtimit të specializuar.

Përkundër diskrecionit ekzekuziv për të vendosur, vendimet e lartpërmendura të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, edhe pse synonin mosndërprerjen e zinxhirit funksional ekonomik, nuk arritën të shqyrtonin me kujdes balancimin e interesave ekonomike dhe të atyre për mbrojtjen e mjedisit. Ekzekutivi nëpërmjet këtyre vendimeve nuk ka parashikuar funksionin e mekanizmave mbikëqyrës/inspektorateve nëpërmjet politikave dhe masave të ndërmarra në nivel shtetëror për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia.

Me Vendimin nr. 02/06, i datës 17 qershor 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës obligoi të gjitha institucionet publike dhe private që të organizonin punën me stafin e tyre (në distancë apo online), në funksion të kryerjes së detyrave të tyre dhe të përgjegjësive ligjore, nën kontroll rigoroz dhe në përputhje me masat e parapara në Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19. Mirëpo, ministria, si organ kompetent për mbrojtjen e mjedisit nuk nxori vendim me të cilin do ta adaptonte punën e organeve, në përputhje me nevojat të cilat njëherësh do të ishin në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

Me nenin 8 të Vendimit nr. 02/38 të Qeverisë, datë 31 maj 2020, u shfuqizua pika 9 e Vendimit nr. 01/09, i datës 13 mars 2020, me të cilin u reduktuan veprimet esenciale dhe stafi esencial

për çdo institucion publik. Më tutje, vërehet se Vendimi nr. 01/10 i Qeverisë, datë 5 korrik 2020, në nenin 6 ka urdhëruar institucionet publike dhe private në vend, pa asnjë dallim, të reduktonin numrin e punëtorëve vetëm në staf të domosdoshëm dhe të sqaronin nëpërmjet qarkoreve se çka paraqet stafi i përgjithshëm, dhe që sipas kërkesave të Inspektoratit Sanitar, të gjitha inspektoratet e tjera t'i vënë në dispozicion kapacitetet e veta për t'i mbikëqyrur masat në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përkundër obligimit të dalë nga vendimi në fjalë, ministria nuk arriti të dëshmonte se ka bërë përpjekje që me akt të veçantë, nëpërmjet sqarimeve, të konkretizonte mënyrën e punës së stafit esencial, posaçërisht të Inspektoratit, si organ i rëndësishëm së veçantë për mbikëqyrjen e mjedisit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit nëpërmjet Vendimit 02/414, datë 21 shkurt 2021, përveç rikonfirmimit të vendimit të Qeverisë për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtje nga pandemia, parashikoi masa të tjera proporcionale, të cilat do të reflektonin në mbrojtjen në mjedisit. Nga analiza e vendimeve të lartpërmendura të Qeverisë vërehet se në masat e ndërmarra nuk është arritur të integroheshin dispozita nëpërmjet të cilave do të respektohej përgjegjësia për mbrojtje të mjedisit nëpërmjet politikave dhe masave të ndërmarra në nivel shtetëror për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Madje edhe ministria kompetente, pavarësisht diskrecionit të plotë për të vepruar, nuk ka arritur të dëshmonte se ka krijuar plan veprimi, i cili do të qartësonte mënyrën e funksionimit në situata të ngjashme.

Ligjet dhe aktet nënligjore të planifikuara dhe të miratuara gjatë periudhës së pandemisë që trajtojnë çështje të mjedisit

Gjendja e krijuar me pandeminë, funksionimi me staf të reduktuar, ndryshimet politike ndikuan që nga 13 projektligje të planifikuara sipas programit Legjislativ 2020, që prekin çështje mjedisore, të miratohej vetëm një. Në program ishin të përfshira projektligjet të rëndësishëm së veçantë për mbrojtje të mjedisit, si: Projektligji për Ujërat e Kosovës, Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Mbrojtjen nga Zhurma, Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-233, Mbrojtjen e Natyrës, Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për Kimikate, Mbeturinat, Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Mbeturinat nga Industria e Nxjerrjes së Mineraleve etj.

Rrjedhimisht, nga 44 akte nënligjore të planifikuara me planin legjislativ për vitin 2020, nga ministria janë miratuar vetëm 4.

Mospërfshirja në prioritete e fushës së mjedisit shihet edhe nga Vendimi nr. 04/38, datë 30 tetor 2020, i Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2020, i cili Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ujërat e Kosovës, për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, dhe për Mbeturina i vendosi në grupin e projektligjeve të cilave u është shtyrë afati i miratimit.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në qasjen në informata

Kushtetuta dhe legjislacioni mjedisor i vendit tonë i kanë të integruara parimet e Konventës Aarhus (edhe pse kjo konventë nuk është e ratifikuar në vendin tonë), si: qasja në informata mjedisore, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi.

Parimi i qasjes në informata, i cili i garanton secilit qasje në dokumente publike, është i paraparë me nenin 41 të Kushtetutës.¹⁵⁸ Po ashtu, obligimi i institucioneve të pushtetit publik për t'ia garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton, nënkupton me automatizëm se edhe informimin paraprak i qytetarëve garantohet me Kushtetutë.¹⁵⁹

Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në nenin 6, paragrafi 12, ka paraparë saktësisht: *“Parimin e qasjes së publikut në informata”*, duke i garantuar secilit person juridik ose fizik të drejtën që të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje.

Përkundër gjendjes së krijuar me pandeminë, kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe funksionimit me staf të domosdoshëm, vërehet se ministria kompetente për mbrojtjen e mjedisit nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të përmirësuar publikimin e informacioneve mjedisore në ueb-faqen zyrtare.¹⁶⁰ Për më tepër, bashkimi i ministrisë me resorin e infrastrukturës dhe të ekonomisë, ndryshimet e emërtimeve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, nga muaji qershor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, dhe në fund në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kanë bërë që informatat të publikohen në ueb-faqe të ndryshme, duke krijuar qasje të vështirësuar proaktive.¹⁶¹

Pavarësisht ndikimit pozitiv të mjedisit të pastër, e në veçanti ajrit të pastër në raport me shëndetin e qytetarëve në situatën e krijuar, nuk u vërejt që organet kompetente ndërmorën masa shtesë për të përmirësuar informimin e publikut për gjendjen e mjedisit.

Mungesa e transparencës dhe vështirësia e qasjes në informata të ministrisë vërehet edhe në raport me IAP-në. Përgjigjet e ministrisë ofruar Avokatit të Popullit, në përgjithësi janë sipërfaqësore, të paargumentuara, të pamjaftueshme, përkundër obligimit kushtetues dhe ligjor për t'iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ndikoi posaçërisht në të drejtën e publikut në vendimmarrje. Qeveria, po ashtu edhe operatorët, u gjendën para një situatë e ndjekur me paqartësi mes obligimeve për distancim social dhe obligimit për të siguruar pjesëmarrje efektive gjithëpërfshirëse, pavarësisht nga nevojat e paraqitura nga pandemia, ku do të përfshiheshin interesat, nevojat dhe ekspertiza. Edhe pse sipas ministrisë: *“Është bërë përshtatje e rregullave të cilat “hibride” duke ju përmbajtur rekomandimeve të IKSHP dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe operatori ka organizuar takimet në lokacion afër vendit të realizimit të Projektit (me prezencë fizike) kurse stafi përgjegjës i MMPHI e ka përcjellë takimin përmes platformës virtuale ku ka dhënë sugjerimet dhe rekomandimet e veta”*,¹⁶² ajo

¹⁵⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], *“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike”*.

¹⁵⁹ Po aty, Neni 52, paragrafi 2, [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

¹⁶⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, Neni 5.

¹⁶¹ Po aty, neni 4, Neni 4 *“Parimet themelore të së drejtës në qasje në dokumente publike, 2. Qasja në dokumente publike bëhet përmes publikimit proaktiv nga ana e institucioneve publike të dokumenteve publike dhe përmes kërkesës së personit për qasje në dokumente publike”*.

¹⁶² Informatë e pranuar nga MMPHI, Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, në bazë të pyetjes së parshtruar nga Avokati i Popullit, më 25 gusht 2020.

nuk ka arritur të dëshmonte asnjë formalizim të formës së organizimit të debateve publike nëpërmjet akteve juridike në përputhje me masat e pandemisë.

Përkitazi me paqartësitë në organizimin e debateve publike në procesin e operacionalizimit të hidrocentraleve në vend, Avokati i Popullit, në Raportin me rekomandime ex officio nr. 365/2018¹⁶³ vlerësoi se organizimi i dëgjimeve publike, si garanci e vetme e respektimit të së drejtës për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe hapi i vetëm nëpërmjet të cilit qytetarëve u mundësohet të informohen lidhur me vendimet e institucioneve që prekin mjedisin ku ata jetojnë ose punojnë dhe të drejtave e tyre, është përcjellë me shumë paqartësi nga organet kompetente. Prandaj Avokati i Popullit rithekson rëndësinë e respektimit të së drejtës së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në çështjet mjedisore.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në qasjen në drejtësi për çështje mjedisore

Situata me pandeminë solli në pikëpyetje respektimin e parimit të qasjes në drejtësi lidhur me çështje mjedisore, përkundër garancisë së dhënë: “Çdo personi fizik apo juridik për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”; dhe së drejtës së dhënë për: “Të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”¹⁶⁴ Kjo për faktin se sipas vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)¹⁶⁵ dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK),¹⁶⁶ shumica e veprimtarive gjyqësore, që përfshijnë praninë e publikut, u kufizuan përkohësisht, qasja e publikut në objektet e gjykatave po ashtu u kufizua ekskluzivisht për veprimtaritë e natyrës urgjente. Kjo situatë thelloi sfidën e respektimit të së drejtës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në realizimin e të drejtave lidhur me problemet mjedisore.¹⁶⁷ Situata po ashtu ndikoi në parashkrimin, hedhjen poshtë¹⁶⁸ dhe zvarritjen e lëndëve lidhur me mjedisin.

Mbikëqyrja inspektuese

Ministria e Mjedisit, përkundër diskrecionit për veprim, nuk ka treguar ndonjë interesim për të bërë plan të veprimit për mënyrën e funksionimit të inspektoratit në situatën e pandemisë. Inspektorati në fjalë ka vazhduar të operonte pa plan konkret të veprimit, pa ndonjë koordinim të veçantë, me staf të reduktuar dhe me rrotacion, pavarësisht gjendjes dhe nevojave në terren. Në këtë drejtim nuk janë siguruar as masa shtesë mbrojtëse për punën e inspektorëve. Përveç

¹⁶³ Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, Raport me rekomandime Ex officio 365/2018 kundër Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjes në dokumente përkitazi me hidrocentralet, shkurt 2021, (linku: <https://oik-rks.org/2021/02/03/raport-me-rekomandime-ex-officio-3652018-kunder-ministrise-se-ekonomise-dhe-ambientit-lidhur-me-ceshtjen-e-ligjshmerise-se-procedurave-qe-kane-te-bejne-me-hidrocentralet-ne-vend-dhe-qasjes-ne-dokum/>)

¹⁶⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2.

¹⁶⁵ Vendimi nr. 52/2020 i KGJK-së, datë 12 mars 2020: “Shumica e veprimtarive gjyqësore që kanë përfshirë praninë e publikut janë kufizuar përkohësisht, dhe qasja e publikut në objektet e gjykatave po ashtu u kufizua.” Vendimi 53/20204 i KGJK-së, datë 15 mars 2020: “Urdhëroi zvogëlimin domethënës të veprimtarive të KGJK dhe gjykatave, dhe e kufizoi punën e gjykatave ekskluzivisht për veprimtaritë e natyrës urgjente”.

¹⁶⁶ Vendimi Nr./2020 i KPK-së, datë 14 mars 2020: “Miratoi një vendim për zvogëlimin domethënës të veprimtarive të këtij organi dhe atyre të Zyrës së Prokurorit të Shtetit.”

¹⁶⁷ Raporti i Avokatit të Popullit 2020.

¹⁶⁸ A. 198/2015, Kallëzimit penal PPN 154/2015, i hedhur poshtë nga Prokuroria Themelore në Prishtinë më 17 qershor 2020. Rasti është iniciuar më 10 mars 2015, ka ushtruar kallëzim penal kundër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkeljen e procedurave në dhënien e lejes mjedisore të integruar.

Kërkesa e K.nr. 48/I e Inspektoratit të Mjedisit i MMPHI-së për fillimin e procedurës kundërvajtëse, e iniciuar kundër Shar Cem.

dezinfektuesve, maskave dhe dorëzave, nuk janë siguruar uniforma mbrojtëse për Inspektoratin.

Përderisa në vitet e kaluara një inspektor ka realizuar mesatarisht 80-110 inspektime me procesverbal, në vitin 2020 janë realizuar mesatarisht rreth 20-30 inspektime. Të gjitha këto kanë ndikuar mjaftueshëm që Inspektorati të mos arrinte t'i përmbushte obligimet e veta ligjore dhe as realizimin e planit të punës për realizimin e inspektimeve për mbikëqyrjen e të gjitha ligjeve në sferën e mjedisit, të ujërave, të natyrës, të ndërtimit dhe të planifikimit hapësinor. Reagimet kanë qenë kryesisht në bazë të ankesave.¹⁶⁹

Edhe pse faktet e renditura janë tregues të mjaftueshëm për të faktuar mosarritjen e shtetit për të respektuar përgjegjësinë e vet për mbrojtjen e mjedisit, mungesa e të dhënave të organizuara të organit në fjalë e bën edhe më të vështirë vlerësimin e situatës. Inspektorati qendror, nuk ka arritur të jepte informata me kohë lidhur me numrin e inspektimeve, me numrin e ankesave dhe as me numrin e rasteve.

Operimi i minierave

Ndikimi arbitrar në mjedis nga gurthyesit, madje duke mos e kursyer edhe trashëgiminë kulturore¹⁷⁰, ka vazhduar edhe gjatë periudhës mars 2020 - mars 2021. Ndër veprimtaritë e pakta të cilave nuk u është ndërprerë aktiviteti gjatë periudhës së emergjencës së shëndetit publik ishin veprimtaritë për nxjerrjen e qymyrit, linjiteve, nxjerrjes së xehes së metalit, xeheroreve dhe guroreve. Edhe pse Urdhëresa nr. 01/05 e MEPTINS, datë 23 mars 2020, për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik, sipas listës NACE, lejoi edhe veprimtaritë e nxjerrjes së qymyrit, linjiteve, nxjerrja e xehes së metalit, xeheroret dhe guroret e tjera dhe veprimtaritë e shërbimeve mbështetëse të xeheroreve, ajo nuk parashikoi masa parandaluese, mbikëqyrëse dhe as ato inspektuese.

Nga muaji mars 2020 puna në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), organ kompetent për rregullimin e aktiviteteve minerare në Kosovë, në fillim të pandemisë është zhvilluar me staf esencial.¹⁷¹ KPMM-ja, përveç dezinfektuesve, maskave dhe dorëzave, për Inspektoratin nuk ka siguruar uniforma mbrojtëse. Nuk ka hartuar plan veprimi për zhvillimin e aktiviteteve nën masa kundër pandemisë dhe vazhdon të mos ketë.

Edhe pse KPMM-ja, brenda periudhës raportuese, ka vepruar sipas masave të Qeverisë dhe vetëm me staf esencial,¹⁷² ka arritur t'i kryente 307 inspektime, të shënonte ngritje në evidentimin e ndërmarrjeve ilegale të nxjerrjes së resurseve minerale, në iniciimin e procedurave penale, lëshimin e licencave të shfrytëzimit, në inspektimet e rregullta, në urdhrat për ndalim të veprimtarisë etj. Ndërsa janë shënuar rënie në inspektime të përgjithshme, inspektimeve ndaj operatorëve legalë, procedimeve të rasteve administrative, lëshimin e licencave të hulumtimit dhe lejeve për aktivitete të veçanta, identifikimin e shkeljeve të projektit të shfrytëzimit, ndalimit të garancioneve bankare për ndërmarrjet që nuk e kanë kryer

¹⁶⁹ Informatë e pranuar nga Inspektorati i Mjedisit, MMPHI, më 8 shtator 2021.

¹⁷⁰ Preportr, "Gërryerja e trashëgimise kulturore", 13 shtator 2021, (linku: http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Gerryerja-e-trashegimise-kulturore-346?fbclid=IwAR1eqwohKqea-2PsMEZgudFaFRoSRZ88_6_QeOVGow4_caMxqeGhdDUMhbY "Gërryerja e trashëgimise kulturore").

¹⁷¹ Informatë e pranuar nga KPMM-ja, më 1 shtator 2021.

¹⁷² Po aty, në periudhën mars-qershor 2020, kanë punuar vetëm 6 inspektorë nga 21 të tillë.

rikultivimin. Në vitin 2020, sipas KPMM-së, nuk ka pasur raste të evidentimit të mosrespektimit të infrastrukturës ligjore në raport me distancën prej 500 m, dhe po ashtu nuk ka pasur raste të sekuestrimit të kamionëve me thëngjill, përderisa në vitin 2019 janë sekuestruar 13 kamionë.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në menaxhimin e mbeturinave

Në 8 impiantet për sterilizimin e mbeturinave spitalore, në vitin 2020 janë sterilizuar 185488.86 kg mbeturina spitalore, më shumë se në vitin paraprak.¹⁷³ Mbeturinat në vazhdim kalonin në mbeturina komunale dhe e njëjta sasi deponohej në depot sanitare. Ndërsa 110.680.18 kg mbeturinat patologjike dhe barna me afat të skaduar, si dhe rreth 32 000 paketime me kapsula dhe përmbajtje të lëngshme i janë nënshtruar procesit të asgjësimit.¹⁷⁴

Këtë çështje e bën më serioze fakti i ngritjes së importit të produkteve mjekësore në vitin 2020, sidomos materialeve mbrojtëse për një përdorim. Sasia e importuar e dorëzave në vitin 2020 ka qenë 424.548.18 kg, apo 40% më e lartë në krahasim me vitin paraprak; e maskave 121.868.02 kg, më e lartë për 14138% në krahasim me vitin paraprak; e uniformave 58.632.25 kg, më e lartë për 109%. Këtu duhet shtuar sasinë e importit të alkoolit, i cili ka shënuar ngritje për 300%, apo 303.803.50 kg; dhe medikamenteve për 4.567.559.76.¹⁷⁵

Përkundër ndikimit negativ në mjedis të gjenerimit të sasisë së madhe të mbeturinave mjekësore, vërehet se ngritja e menjëhershme e sasisë të mbeturinave spitalore në situatën COVID-19 nuk mori vëmendjen e autoriteteve kompetente, për shkak se nuk u ushtrua kontroll në trajtimin e këtyre mbeturinave, që rezultojn nga fakti se as Inspektorati Mjedisor, në kuadër të MMPHI-së, nuk arriti të jepte përgjigje në pyetjet lidhur me inspektimin e depove të vendit,¹⁷⁶ të cilat do të dokumentonin ushtrimin e kompetencave të tyre në këtë lëmë, e gjithashtu Inspektorati Shëndetësor në kuadër të Ministrisë e quajti veten jokompetent për këtë çështje. Ndërsa sipas informatave të pranuar nga Inspektorati Sanitar i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës¹⁷⁷, ky organ për arsye të mbingarkesës nuk ka arritur të mbikëqyrte zbatimin e obligimeve ligjore që dalin nga Ligji nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës.¹⁷⁸

Nga analiza e çështjes rezultojn se ministria, pavarësisht rrezikut që këto mbetje kanë ndikim në mjedis, nuk arritën ta kryenin rolin e tyre parandalues dhe mbikëqyrës në këtë drejtim, në mënyrë që t'i përmbushnin obligimet e tyre.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në cilësinë e ajrit

Masat e ndërmarra nga Qeveria si përgjigje ndaj COVID-19, kanë ndikuar në rënien e qarkullimit rrugor, po ashtu në dinamikën e disa veprimtarive ekonomike, të cilat kanë qenë faktorë të vazhdueshëm të ndotjes së ajrit. Të dhënat flasin për ulje të ndotjes në shkallë deri

¹⁷³ Për vitin 2019 janë sterilizuar 790245.95 kg mbeturina spitalore, ndërsa në vitin 2020 janë 975734.81 kg.

¹⁷⁴ Informatë e pranuar nga MMPHI-ja, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, në bazë të pyetjes së parashtruar nga Avokati i Popullit, më 25 gusht 2021.

¹⁷⁵ Informatë e pranuar nga Doganat e Kosovës, datë 23 gusht 2021.

¹⁷⁶ Kërkesa e Avokatit të Popullit drejtuar MMPHI-së, datë 5 gusht 2021.

¹⁷⁷ Informatë e pranuar nga shefi i Sektorit Sanitar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, datë 18 gusht 2021.

¹⁷⁸ AUV-i është organ ekzekutiv i specializuar, që kontrollon zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare në sektorët shtetërorë, publikë e privatë, veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridikë, në objektet shëndetësore, dhe bën mbikëqyrjen sanitare të qendrave spitalore dhe të qendrave klinike universitare.

në 50% në nivel të vendit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar¹⁷⁹, sidomos me ndotjet që shkaktohen nga transporti rrugor. Sipas të dhënave të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, vërehet ulje e përqendrimeve të disa ndotësve të ajrit, në veçanti të përqendrimeve të dioksidit të azotit (NO₂) dhe grimcave të pluhurit PM_{2.5}.¹⁸⁰

Periudha vjeshtë-dimër 2020-2021 ka rezultuar më ndotje më të lartë në krahasim me periudhat e tjera të vitit. Janë regjistruar parametra me vlera me të larta në ajër të grimcave të pluhurit PM₁₀/PM_{2.5}, si dhe shkarkime mbi vlerën e lejuar nga termocentralet A dhe B të SO₂ dhe NO_X.¹⁸¹

Sa i përket sektorit të energjisë, vendi u rendit në mesin e gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor¹⁸², të cilat në vitin 2020 rritën emetimet, në vend se t'i zbrisnin ato. Sa i përket pluhurit, në rajon emetuesi absolut më i lartë në vitin 2020 ishte Kosova B, duke lëshuar 6.6 herë më shumë pluhur se sa që është e lejuar. Po ashtu, Kosova është renditur në vendet të cilat kanë tejkaluar emetimin e oksideve të azotit, për dy herë më shumë se sa që është e lejuar, emetimet e SO₂ ishin 1.8 herë mbi tavanin kombëtar në vitin 2020, ndërsa shkelja e tavanit të NO_X ishte 1.65 herë më shumë se sa që është e lejuar. Edhe pse raporti evidenton se Kosova A ka mungesë të pajisjeve të monitorimit të vazhdueshëm dhe pajisjet e monitorimit të Kosovës B nuk janë kurrë funksionale¹⁸³, MMPHI-ja nuk ka sqaruar nëse kanë raportuar në baza mujore gjatë vitit 2020 operatorët lidhur me shkarkimet në ajër.¹⁸⁴

Monitorimi i ajrit, siç është paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja¹⁸⁵, është mbuluar gjatë tërë vitit, përfshirë edhe periudhën mars-qershor 2020.¹⁸⁶ Ndërsa Inspektorati i Mjedisit nuk ofroi dëshmi për përmbushjen e obligimeve të veta ligjore për mbikëqyrjen inspektuese.¹⁸⁷ MMPHI-ja nuk ofroi informata nëse gjatë vitit 2020 ka mbikëqyrur zbatimin e Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, sa ankesa janë pranuar lidhur me ndotjen e ajrit dhe sa inspektime janë kryer.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ujërat

Problemet me ujëra vazhduan edhe gjatë periudhës raportuese. Urdhëresa Nr. 01/07 e MEPTINS, datë 23 mars 2020, e cila ndaloi veprimtarinë e ndërtimit të projekteve të ujit, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve ujore, porteve, punimeve lumore, ndërtimin e pritave dhe pendave/digave, devijimet e rrjedhave ujore, dhe ndërtimet e tjera që kanë ndikim të

¹⁷⁹ Republika e Kosovës, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, “*Pandemia dhe cilësia e ajrit në Kosovë*”, (linku: <https://www.ammk-rks.net/?page=1.7.550>)

¹⁸⁰ Po aty.

¹⁸¹ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, AMMK, Raport vjetor për gjendjen e ajrit 2020.

¹⁸² Rrjetit Balkanwatch për Evropën Qëndrore dhe Lindore, “*Si termocentralet e qymyrit në Ballkanin Perëndimor shkelin ligjet e ndotjes së ajrit dhe shkaktojnë vdekje, dhe çfarë duhet të bëjnë qeveritë në lidhje me to?*”, shtator 2021, (linku: <https://www.balkangreenfoundation.org/uploads/files/2021/September/07/AI-PERMBAJU-OSE-MBYLL1631004379.pdf>).

¹⁸³ Po aty, fq. 25.

¹⁸⁴ Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtaur MMPHI-së, datë 5 gusht 2020.

¹⁸⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja: 1. Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet nga Ministria, e cila siguron monitorimin e përhershëm të cilësisë së ajrit dhe ndikimin në mjedis dhe në shëndetin e popullatës.

¹⁸⁶ Informatë e pranuar nga Instituti hidrometeorologjik i Kosovës, më 25 gusht 2021.

¹⁸⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-160 Për Mbrojtjen E Ajrit Nga Ndotja.

drejtpërdrejtë në burimet ujore dhe natyrore dhe në pellgjet lumore, u shfuqizua pa vendim formal nga ministri i MEPTINS, më 26 qershor 2020.¹⁸⁸

Në përjashtim të muajve mars – qershor 2020, për arsye të karantinimit dhe mosarritjes së gjetjes së formave të përshtatshme për funksionim të stafit të IHK-së, nuk ka pasur mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit të mbikëqyrjes së ujërave nga IHK-ja. Nuk ka të dhëna nëse Inspektorati Mjedisor i MMPHI-së ka mbikëqyruar zbatimin e Ligjit për Ujërat gjatë vitit 2020, sa ankesa janë pranuar lidhur me çështjen e hidrocentraleve dhe sa inspektime janë kryer në vitin 2020.

Konkluzion

Avokati i Popullit, nga analiza e vendimeve të Qeverisë, veprimeve të ndërmarra nga organet kompetente në vend dhe gjendjes në terren vëren se mospërfshirja e ekspertëve mjedisorë brenda grupeve punuese të Qeverisë, të cilët do të mbikëqyrnin dhe këshillonin lidhur me pajtueshmërinë e masave kufizuese si reagime ndaj pandemisë me të drejtën mjedisore, nuk ka arritur të garantonte respektimin e parimit të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Mungesa e ekspertizës mjedisore ka reflektuar në mosarritjen e mjaftueshme të Qeverisë për të ndërmarrë masa proporcionale, të cilat do të balanconin drejtë format e mbrojtjes së shëndetit me ndikimin më të vogël në mjedis.

Mungesa e planeve konkrete të cilat do të kishin udhëzime të qarta për operim nën kushtet e pandemisë, mosangazhimi i mekanizmave në përputhje me udhëzimet e IKShPK-së për të organizuar punën e organeve mbikëqyrëse, si dhe mungesa e dëshmimeve që inspektorateve dhe organeve të tjera mbikëqyrëse u janë ofruar mjete shtesë mbrojtëse për të vepruar në terren, tregon mungesën e përkushtimit për ta vënë nën kontroll këtë resor.

Po ashtu, në këtë drejtim vlen të përmendet mungesa e mekanizmave që vlerësojnë masat emergjente, si garanci kundër abuzimit,¹⁸⁹ të cilat do të përkujdeseshin që të siguronin që masat e propozuara do të zgjidhnin, përmirësonin apo së paku nuk do të përkeqësonin çështjet për të cilat ishin nxjerrë dhe ndikimin e tyre në mjedis.

Mungesa e informatave për ushtrimin e kontrollit në zbatim të ligjeve për çështjet mjedisore dhe të kontrollit nga inspektorët në trajtimin e mbeturinave dhe të mbetjeve të tjera shëndetësore paraqet shqetësim dhe në të ardhmen duhet të njoftohet publiku për këto çështje.

X. Dhuna në familje gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë

Me ndërmarrjen e masave për parandalimin e COVID 19 janë rritur rastet e dhunës në familje. Këto masa kanë vështirësuar punën institucionale në parandalimin, trajtimin dhe kujdesin e grupeve të rrezikuara, siç janë edhe viktimat të dhunës në familje. Në këtë drejtim Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) në Kosovë, luan rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimeve të shtetit në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje gjatë periudhës së pandemisë.

¹⁸⁸ KosovaPress, “Kuçi: Nuk ka pasur vendim nga asnjë qeveri për ndaljen e hidrocentraleve”, shtator 2020, (linku: <https://kosovapress.com/kuci-nuk-ka-pasur-vendim-nga-asnje-qeveri-per-ndaljen-e-hidrocentraleve/>).

¹⁸⁹ Civil Rights Defenders, Covid-19 dhe impakti mbi të Drejtat e Njeriut, “Garancitë kundër Abuzimit”, fq. 159

Sipas informatave të siguruar nga Policia del se rastet e dhunës në familje gjatë pandemisë janë rritur, duket qartë se në vitin 2020 kishte rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje në krahasim me vitin 2019. Gjatë vitit 2019, sipas informatave janë të regjistruar 1915 raste, ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar në Polici 2069 raste të dhunës në familje. Ndërsa, deri në muajin maj të vitit 2021, në Policinë e Kosovës ishin të regjistruar 897 raste të dhunës në familje. Këto statistikat tregojnë se gjatë vitit 2020, gjatë pandemisë janë paraqitur 154 raste të dhunës në familje më shumë se në vitin 2019.

Lidhur me dhunën në familje, Avokati I Popullit i është drejtuar me pyetje edhe Ministrisë së Drejtësisë, respektivisht Zyrës së Koordinatorit Nacional për Parandalimin e Dhunës në Familje brenda kësaj Ministrie. Koordinatorja nacionale, Nita Shala, ka pohuar se në vitin 2020, atëherë edhe kur ka filluar zyrtarisht pandemia Covid-19 në Kosovë, Ministria e Drejtësisë nuk ka pasur Strategji Kombëtare për Parandalimin e Dhunës në Familje (sepse kishte skaduar), si dokument shumë i rëndësishëm i cili ka për qëllim që palët përgjegjëse t'i trajtojnë me prioritet të gjitha rastet e dhunës në familje, të sigurojnë qasje në shërbime të integruara cilësore, të garantojnë drejtësi dhe përgjegjësi për viktimat, të sigurojnë rehabilitim dhe riintegrim të viktimave/mbijetuarve të dhunës në familje dhe të rrisin vetëdijesimin e mbarë shoqërisë sonë. Mirëpo, sipas koordinatorës, Ministria e Drejtësisë është në përgaditje e sipër të një dokumenti të tillë.

Nga përgjigjet e Ministrisë vërehet se institucioni në fjalë nuk ka program të vecantë për dhunën në familje, por për aktivitete të Zyrës së Koordinatorit Nacional, Ministria zakonisht ndanë mjete nga nën-programet e Ministrisë së Drejtësisë, sikurse, në fakt, edhe ka bërë, ku gjatë vitit 2020, për fushatën e dhunës në familje, e ka mbështetur UN Woman dhe Eulex-in.

Përndryshe, ashtu sikurse nga Policia, edhe në të dhënat e siguruar nga Ministria e Drejtësisë paraqitet rritja e rasteve të dhunës në familje. Statistikat për fenomenin në fjalë, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë të rënditura si më poshtë në formë tabelare:

Rastet e dhunës në familje	
Muaji	Janar-Tetor 2021
Janar	169
Shkurt	148
Mars	169
Prill	206
Maj	206
Qershor	209
Korrik	243
Gusht	261
Shtator	190
Tetor	173

Totali	1974
---------------	-------------

Nr.viktimave sipas kategorisë LGBTI	
2019	0
2020	3
2021	2

Nr. viktimave sipas moshës /Të mitur	
2019	26
2020	121
2021	185

Urdhërat-Mbrojtës në Polici	Urdhërat-Mbrojtës të rregullt në Gjykatë
2021	12
	292

Kjo tabela është gjeneruar nga databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje.

Avokati i Popullit lidhur me dhunën në familje, poashtu ka kontaktuar edhe Qendrat për Mirëqenien e Gruas (QMG), ku ka marrë informacione lidhur me gratë e strehuara në këto qendra gjatë kohës së pandemisë, si në vijim:

Në komunën e Pejës, nga 1 mars 2020 deri më 25 qershor 2021, në QMG në Pejë janë strehuar 98 gra dhe fëmijë, ndërsa nga muaji janar 2019 deri në muajin dhjetor 2019, strehimorja ka pranuar dhe strehuar 94 gra dhe fëmijet. Numri i rasteve të dhunës është rritur sidomos gjatë muajve mars-maj 2020, ku ishte kufizuar levizja e popullates, ndërsa stafi i strehimores ka punuar 24 orë pa asnjë ditë ndërprerje. Gjithashtu, vështirësitë financiare gjatë pandemisë COVID-19 ishin të shumta. Kontratat me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) nuk ishin të nënshkruara për një vit por për tetë (8) ose nëntë (9) muaj. Gjatë vitit 2021 QMG ka nënshkruar kontratën me MPMS për financim të strehimores e cila e ka kohëzgjatjen deri më 15 janar 2022. Pasiguria financiare ndikon në ofrimin e shërbimeve dhe në gjendjen psikologjike të grave dhe fëmijëve si viktimat e dhunës në familje.

Gjithashtu, sfida tjetër ka qenë edhe mos koordinimi i rregullt i strehimores me institucione tjera siç janë QPS, Mbrojtësi i viktimave dhe gjykatat, për shkak të orarit të reduktuar të punës gjatë pandemisë.

Në Komunën e Prizrenit sipas të dhënave nga QMG në Prizren, në vitin 2020 janë strehuar gjithsej 53 viktima të dhunës në familje, ndërsa që krahasuar me vitin 2019, kur janë strehuar gjithsej 37 raste, rezulton se në periudhën e pandemisë ka pasur rritje të numrit të viktimave të strehuara në këtë qendër.

Në Komunën e Prishtinës sipas të dhënave nga Qendra për Mbrojtje të Grave dhe Fëmijeve (QMGF) në Prishtinë del se kjo qendër ishte në rinovim, ndërsa shërbimet për viktima ofroheshin në një objekt jo adekuat për strehimore. Sipas tyre nga fillimi i pandemisë në QMGF në Prishtinë janë strehuar 122 raste, ndërsa keshilla psiko-sociale përmes telefonave dhe rrjeteve sociale kanë kërkuar 22 raste. Ndërsa gjatë vitit 2019, në strehimoren e Prishtinës janë strehuar 114 raste.

Sipas Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë numri i rasteve të dhunës në familje të trajtuara në QPS Prishtinë ishte si në vijim: Viti 2019 - gjithsej 104 raste, 99 femra dhe 5 meshkuj, 183 fëmijë viktima apo dëshmitar të dhunës në familje; Viti 2020 – gjithsejtë 166 raste, 143 femra, 23 meshkuj, 226 fëmijë viktima apo dëshmitar të dhunës në familje; Vitit 2021 – Janar – Maj gjithsej 69 raste, 66 femra dhe 3 meshkuj, 103 fëmijë viktima apo dëshmitar të dhunës në familje.

Në Komunën e Ferizajit, sipas të dhënave të Qendrës për Mbrojtje të Grave dhe Fëmijeve (QMGF) nga Ferizaji del se në këtë qendër numri i rasteve të dhunës në familje të trajtuar, gjatë vitit 2019 janë gjithsej 47 raste, 20 femra të rritura, 27 fëmijë viktima apo dëshmitar të dhunës në familje, ndërsa nga 1 janari 2020 deri në muajin qershor 2021 janë strehuar 62 raste; 25 femra të rritura dhe 37 fëmijë.

Në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas të dhënave, në vitin 2019 kanë qenë 26 raste të viktimave të dhunës në familje të strehuara në strehimoren e Mitrovicës, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 48 raste.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Avokati i Popullit ka pranuar gjatë vitit 2020 dymbëdhjetë (12) raste, ndërsa në vitin 2021 njëzet e një (21) raste lidhur me dhunën në familje. Disa nga rasteve të pranuar kanë qenë kërkesa për monitorimin e rasteve në Gjykatave Themelore në bazë të të cilave përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë monitoruar proceset gjyqësore për viktimat e dhunës në familje.

Gjatë vitit 2020, Avokati i Popullit, në pajtueshmëri me mandatin e tij kushtetues dhe ligjor, ka publikuar mendimin juridik A.nr.385/2020 në çështje të mikut të gjykatës, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin ka konstatuar shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut dhe deshtimin e Policisë së Kosovës në detyrimet pozitive ligjore për të mbrojtur ankuesen nga ushtruesi i dhunës në familje.

Gjatë vitit 2021, Avokati i Popullit ka pranuar njëzet e një (21) raste të lidhura me dhunën në familje. Gjithashtu, edhe në këtë periudhe raportuese disa raste kanë qenë kërkesa për monitorimin e proceseve gjyqësore në gjykatat themelore në Kosovë, të cilat janë realizuar nga ana e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Avokati i Popullit ka publikuar raportin Ex-officio nr.150/2021, përkthim me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga

dhuna në familje. Në këtë raport Avokati i Popullit konstatoi se kishte munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve, gjë që shtrou nevojën e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të secilit institucion, prej momentit të paraqitjes së rasteve të dhunës në familje e deri në përfundimin e tij. Avokati i Popullit ka dalë me rekomandime konkrete për autoritetet gjegjëse lidhur me përmirësimin e gjendjes nga perspektiva e të drejtave të njeriut, me qëllim të ndërtimit të një sistemi në pajtim me parimet e sundimit të drejtës.

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNÏ)

Sipas Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNÏ), stafi punonte me reduktime dhe me staf esencial megjithatë viktimat e dhunës në familje trajtoheshin me prioritet, asnjë viktimë që ka kërkuar ndihmën e tyre nuk ka mbetur pa u përfaqësuar edhe pse numri i rasteve të dhunës në familje ishte në rritje nga 1353 në vitin 2019 në 1524 në vitin 2020.

Nga kjo situatë, Avokati i Popullit vlerëson se zbatimi i kornizës ligjore që është në fuqi, si bazë për mbrojtje nga dhuna në familje, do të ishte një garanci që shteti t'i ofronte mbrojtje efektive edhe viktimave të dhunës në familje gjatë pandemisë COVID-19. Veprimet konkrete që do të ndërmerreshin nga institucionet përgjegjëse në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, do të ndikonin drejtpërdrejt në respektimin e urdhër-mbrojtjes së shqiptuar nga gjykata ndaj kryerësve të dhunës në familje, në parandalimin e veprimeve të mëtejme të dhunës, si dhe në parandalimin e përfundimit me fatalitet të rasteve të dhunës në familje.

Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave të paraqitura dhe të fakteve të mbledhura, si dhe analizimit të ligjeve relevante, të cilat e përcaktojnë të drejtën e ofrimit të shërbimeve për viktimat të dhunës në familje gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, konstaton se kishte shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore kundrejt qytetarëve dhe kjo kishte implikime negative drejtpërdrejt për viktimat të dhunës në familje.

Avokati i Popullit konstaton se ndër sfidat kryesore gjatë periudhës së pandemisë mars-shtator 2020, ishin: rritja e numrit të rasteve të dhunës në familje, infektimi i stafit, mungesa financiare për menaxhim të rasteve të dhunës në familje, numri i vogël i stafit, izolimi gjatë pandemisë i cili ka pamundësuar lëvizjen dhe paraqitjen e rasteve të dhunës në familje gjatë pandemisë COVID-19, dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që veprojnë gjatë paraqitjes së rasteve të dhunës në familje nga ana e viktimave.

XI. Liria e tubimit, liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, si dhe kufizimet e këtyre të drejtave gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë

Liria e tubimit

Duke qenë se liria e tubimit është një prej të drejtave themelore të një shoqërie demokratike, si e tillë, kjo e drejtë është e përcaktuar qartë edhe në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë sipas Kushtetutës¹⁹⁰. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut parasheh: “*Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit*

¹⁹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

*paqësor.*¹⁹¹ Gjithashtu edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike njih të drejtën e mbledhjes paqësore dhe kufizimin e kësaj të drejte me ligj, aq sa është e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe në rastet në interes të sigurisë kombëtare, të qetësisë dhe të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve¹⁹².

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 11, përcakton: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor [...], ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike [...]” Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime, në protesta dhe në organizime të tjera, të përcaktuara në nenin 11 të Konventës, është e lidhur ngushtë me nenin 10 – Liria e shprehjes, ku qëllimi për të ushtruar lirinë e tubimit është shprehja e mendimeve, e debateve publike dhe e protestave.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i ka dhënë rëndësi faktit që ata që marrin pjesë në tubime, nuk kërkojnë vetëm të shprehin mendimin e tyre, por këtë mendim ta shprehin së bashku me të tjerët. Këtu përfshihet edhe shprehja e mendimeve politike, filozofike a fetare. Kështu, liria për t’u tubuar dhe organizuar lidhet ngushtë edhe me nenin 9 të KEDNj (Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë).

Megjithatë, ngjashëm me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, KEDNj-ja lejon vendosjen e kufizimeve mbi këtë të drejtë, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, por këto kufizime duhet të përcaktohen me ligj, të kenë një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale¹⁹³. Pra kufizimet e vendosura duhet të jenë në përputhje me rrezikshmërinë, në njërën anë, dhe në anën tjetër, këto kufizime u aplikuan gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Vendosja e masave kufizuese natyrisht se është e nevojshme në një shoqëri demokratike, por autoritetet duhet të vërtetojnë se nuk ka pasur rrugë tjetër, shqiptimi i sanksioneve në rast të shkeljes së kufizimeve të vendosura duhet të jetë proporcional me shkeljen.

Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës përdorën të drejtën që buron nga neni 15 i KEDNj-së, duke dorëzuar në Sekretariatit e Këshillit heqjen dorë nga një pjesë e të drejtave të Konventës, përfshirë këtu edhe lirinë e tubimit. Megjithatë kjo heqje dorë nuk do të thotë se shteti duhet t’i shmanget përgjegjësisë së respektimit të këtyre të drejtave në tërësi.

Ligji për Tubimet Publike rregullon të drejtën për tubime publike, protesta e manifestime si dhe mënyrën e lajmërimit për to, organizimin, të drejtat dhe përgjegjësitë e organizatorëve.¹⁹⁴ Një ndër aspektet e rregullimit të tubimeve publike të parapara me ligj është edhe kufizimi dhe ndalimi i atyre tubimeve: “Kur ato rrezikojnë rendin, qetësinë dhe sigurinë publike, sa i përket lirisë, dhe të drejtave të njerëzve të tjerë, moralit dhe shëndetit publik.”¹⁹⁵

Sipas Ligjit për Tubimet Publike, tubimet publike duhet detyrimisht të lajmërohen nga organizatori, duke respektuar kushtet dhe afatin e paraparë nga policia. Barra e përgjegjësisë

¹⁹¹ OKB, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 20, paragrafi 1.

¹⁹² OKB, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 2.

¹⁹³ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 11(2).

¹⁹⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L-118 për Tubimet Politike, neni 2.

¹⁹⁵ Po aty, neni 4.

së pjesëmarrjes dhe mbajtjes së rendit bie mbi organizatorin. Lajmërimi bëhet 72 orë para se të mbahet tubimi, ndërsa policia është e obliguar që brenda 48 orësh të lajmërojë organizatorin për lejimin ose jo të tubimit publik. Nëse brenda kësaj kohe policia nuk shpall vendim për ndalim, tubimi konsiderohet i lejuar. Të lejohet një tubim, duhet të ofrohen informata se për çfarë qëllimi do të mbahet, kohën, vendin dhe ditën e mbajtjes së tubimit; të dhëna mbi organizatorin, numrin e pjesëmarrësve; numrin e kujdestarëve etj.

Bazuar në Urdhrin Operativ: “*Për gatishmëri dhe reagim për COVID-19*”,¹⁹⁶ Policia e Kosovës (PK) ka filluar koordinimin, planifikimin dhe zbatimin në terren të detyrave të policisë, sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19¹⁹⁷, sipas vendimeve të Qeverisë si dhe sipas vendimeve dhe rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të IKShPK-së. Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 ka paraparë që kufizimi i lirisë së tubimit duhet të ndiqet me arsyetime të bollshme dhe të detajuara. Këto arsyetime duhet të dëshmojnë që ekziston lidhja e drejtpërdrejtë mes kufizimit, në njërin anë, dhe masave të ndërmarra për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19, në anën tjetër¹⁹⁸. Megjithatë, edhe pas vendosjes së masave dhe ndalimit të grumbullimit të më shumë se dy personave, sipas informatave të siguruar nga PK-ja, në polici janë paraqitur 155 kërkesa për lejimin e mbajtjes së tubimit, prej të cilave janë aprovuar 151 kërkesa.

Sipas Ligjit për Tubimet Publike, policia duhet të angazhohet në monitorimin e tubimeve publike, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe të qetësisë publike, si dhe ndërmarrjen e të gjitha masave në rast se tubimi publik rrezikon të prishë ose të shkatërrojë të mirat e përgjithshme. Sipas statistikave të siguruar nga PK-ja, 253 tubime/organizime janë monitoruar nga PK-ja, prej tyre 4 tubime politike, dhe në të gjitha ato raste që nuk janë përfillur rregullat zgjedhore, janë raportuar tek institucionet përkatëse. Gjithnjë sipas statistikave të siguruar nga PK-ja për periudhën e kufizimeve, janë mbajtur 71 tubime publike, 180 protesta dhe 10 marshime.

Ky ligj parasheh edhe lloje të tjera të tubimeve të cilat mund të mbahen pa u lajmëruar, siç janë: tubime që mbahen në lokale të mbyllura apo në lokale të parapara për qëllime të ngjashme, si: tryeza, mbledhje etj.; tubime që mbahen në stadione, teatro, salla të kinemave, etj. dhe të cilat nuk kërkojnë masa shtesë të sigurisë. Tubimet publike mund të mbahen në çdo vend të përshtatshëm. Tubime të tilla, pa paraqitje të kërkesës në PK, janë mbajtur 110 tubime/organizime.

Policia ka të drejtë të refuzojë mbajtjen e tubimit nën kushtet e përcaktuara me ligj dhe atë 24 orë para mbajtjes së tubimit. Në situata kur ka nevojë urgjente për mbajtjen e tubimit, pa respektuar afatin e parashikuar prej 72 orësh, detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim tri orë para mbajtjes së tubimit, duke shpjeguar arsyen e urgjencës dhe natyrisht duke përmbajtur edhe informatat e tjera, të parapara me këtë ligj.¹⁹⁹

¹⁹⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, “*Procedura Standarde të Operimit*”, miratuar me 01.10. 2020, Ref:DDO-04-023/2020

¹⁹⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovë miratoi Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, datë 25 gusht 2020. Ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësisë gjatë pandemisë COVID-19.

¹⁹⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, neni 4(1.5).

¹⁹⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-118 për Tubimet Publike, neni 6, paragrafi 4.

“Tubimet si: ritet fetare, dasmat, varrimet si dhe tubimet e tjera të ngjashme nuk lajmërohen”, parashihet në paragrafin 1 të nenit 20 të Ligjit për Tubimet, por përjashtim nga paragrafi 1, kur këto tubime “kërkojnë të ndërmerren masa shtesë të sigurisë jashtë angazhimit normal nga ana e policisë”, atëherë lajmërimi “bëhet më së voni 12 orë para mbajtjes së tubimit.”²⁰⁰

Ligji parasheh edhe masat ndëshkuese në situatat kur tubimet nuk janë lajmëruar në pajtim me ligjin, kur janë mbajtur, pavarësisht që janë ndaluar nga policia etj.²⁰¹

Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

Masat kufizuese dhe ndalimi i tubimit kanë ndikuar edhe në lirinë e ushtrimit të fesë. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë është e paraparë në nenin 38 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

- *“Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë është e garantuar.*
- *Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ndërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.*
- *Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.*
- *Liria e manifestimit të fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik, të shëndetit, ose të të drejtave të personave të tjerë.”*

Më tutje, Ligji për Liritë Fetare shtjellon: *“Çdo njëri ka të drejtë të gëzojë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetarë. Kjo e drejtë përfshinë lirinë për të pasur ose për të mos pasur fe, për të mbajtur apo për të ndërruar fenë ose besimin, dhe lirinë për të manifestuar fenë ose besimin, çoftë si individ ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht, përmes adhurimit, predikimit, praktikimit dhe ceremonive.”²⁰²*

Edhe pse Ligji parasheh se askush nuk duhet të diskriminohet në asnjë mënyrë dhe as të pengohet për të kryer ritualet dhe ceremonitë fetare, megjithatë, situata në të cilën u gjend Kosova dhe mbarë bota, pas shpërthimit të pandemisë COVID-19, bëri që të kufizohej ushtrimi i kësaj të drejte. Bazuar në vendimet e Qeverisë, të cilat në periudha të caktuara, bazuar në situatën dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit të përgjithshëm, kjo e drejtë është kufizuar dhe ndaluar në disa periudha të caktuara.

Më 23 mars 2020, Ministria e Shëndetësisë mori vendim me të cilin u vendos ndalimi i qarkullimit të qytetarëve dhe të automjeteve për periudhë të caktuar, si dhe u ndalua lëvizja e më shumë se dy personave në rrugë.²⁰³

²⁰⁰ Po aty, neni 20.

²⁰¹ Po aty, neni 21.

²⁰² Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr.02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, neni 1(1).

²⁰³ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 01/15, datë 23.03.2020.

Liritë dhe të drejtat e bashkësive fetare që janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës²⁰⁴, në mënyrë të pavarur rregullojnë organizimin e vet të brendshëm, veprimtarinë fetare dhe ritualet. Disa herë janë bërë përpjekje për të draftuar Ligjin për Liritë Fetare, me të cilin do të mundë të zgjidhej çështja e pozitës juridike të bashkësive fetare në mënyrë institucionale. Nxjerrja e këtij ligji do të kontribuonte në respektimin e lirive fetare, të besimit dhe të ndërgjegjes, që garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)²⁰⁵, do të rregullonte mënyrën e regjistrimit të bashkësive fetare si dhe obligimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të rendin kushtetues.

Në Republikën e Kosovës, edhe pse nuk ka statistika zyrtare lidhur me përkatësinë fetare të popullsisë, konsiderohet se pjesa më e madhe e popullsisë i takon besimit mysliman, rreth 90%, ndërsa 6% konsiderohet se i takojë besimit ortodoks, 3% i takojnë besimit katolik dhe 1% i takon u takon besimeve të tjera²⁰⁶.

Sipas Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës²⁰⁷, masat e kufizimit nga Qeveria janë mirëpritur dhe konsideruar si masa të arsyeshme, në drejtim të ruajtjes së shëndetit publik. Masat e vendosura kanë ndikuar në kryerjen e riteve fetare, pasi për shkak të ndalimit të tubimit, janë mbyllur xhamitë dhe besimtarët janë privuar nga mundësia që të faleshin në xhami. Gjithashtu kufizimet kanë ndikuar edhe në ndalimin e manifestimit për festën e Bajramit, për festën e Mevludit, të Mirazhit e të tjera të ngjashme. Duke qenë se situata e krijuar ka qenë sfiduese për tërë globin, besimtarët myslimanë të të gjitha vendeve kanë qenë të privuar nga e drejta për të shkuar në Haxh. Mësimi i besimit nëpër xhami dhe në institucione të tjera të Bashkësisë Islame, ashtu si edhe në shkollat publike, nuk është mbajtur. Kufizimet e vendosura nga Qeveria më së shumti kanë dëmtuar bazën materiale të Bashkësisë Islame të Kosovës, pasi nuk kanë pasur mundësi të zhvilloheshin aktivitetet e rregullta tradicionale.

Në përgjigjen e Kishës Katolike thuhet se i kanë respektuar të gjitha vendimet e Qeverisë dhe nuk kanë pasur asnjë problem²⁰⁸; kurse Kisha Ortodokse Serbe²⁰⁹, Kisha Protestante Evangjelistë²¹⁰ dhe Bashkësia Hebraike²¹¹ nuk janë përgjigjur në pyetjen tonë se sa dhe si ka ndikuar pandemia gjatë kohës së kufizimit të përgjithshëm.

Mungesa e infrastrukturës ligjore ka vështirësuar punën e PK-së në kryerjen e detyrave dhe në shqiptimin e ndëshkimeve, mungesa e trajnimeve për mjedisin epidemiologjik/pandemik,

²⁰⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 39, [Bashkësitë fetare]: „1. Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë e të gjitha bashkësive fetare dhe monumenteve brenda territorit të vet. 2. Bashkësitë fetare janë të liraqë në mënyrë të pavarur rregullojnë organizimin e vet të brendshëm, veprimtarinë fetare dhe ritualet fetare. 3. Bashkësitë fetare kanë të drejtë në themelimin e shkollave fetare dhe organizatave humanitare, në pajtim me këtë Kushtetutë dhe ligj.“

²⁰⁵ KEDNJ, neni 9, [Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë]: “1. Secili ka të drejtë në lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, kjo e drejtë përfshinë të drejtën e lirisë së ndërrimit të fesë apo besimit dhe lirinë e njeriut që, vetë apo së bashku me të tjerët, publikisht apo privatisht, të shprehë fenë apo besimin përmes lutjes, predikimit, praktikës dhe respektimit. 2 Liria e predikimit të fesë apo besimit mund t'i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që janë të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit dhe moralit, apo mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

²⁰⁶ Portali Shtetëror i Republikës së Kosovës.

²⁰⁷ Përgjigje e pranuar përmes postës elektronike, datë 16 korrik 2021.

²⁰⁸ Përgjigje e pranuar përmes postës elektronike, 25 qershor 2021, nga Don Fran Sopi.

²⁰⁹ Email, datë 21 korrik 2021;

²¹⁰ Email, datë 3 gusht 2021;

²¹¹ Email, datë 3 gusht 2021.

mungesa e pajisjeve mbrojtëse për zyrtarët policorë që kanë qenë të angazhuar në mbikëqyrjen e ceremonive të varrimit dhe përcjelljen e kufomave, kanë qenë sfidë për PK-në. Mungesa e sistemit të integruar të bazës së të dhënave të agjencive përgjegjëse për menaxhimin e përbashkët të operacioneve.

Gjatë situatës sa nuk janë respektuar kushtet e mbajtjes së tubimit, PK-ja ka shqiptuar 107 fletëparaqitje, sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19.

Vlerësimet e përgjithshme të Avokatit të Popullit

Bazuar në çka u tha më lart, Avokati i Popullit vlerëson se kufizimi i të drejtave dhe i lirive të njeriut për t'u tubuar/organizuar ishte i domosdoshëm, proporcional dhe i bazuar në ligjet vendore dhe ndërkombëtare si dhe rekomandimet e dala nga Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19; në vendimet e Qeverisë, në vendimet dhe në rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të IKShPK-së.

Vendimet për kufizimet e lirisë së tubimit/organizimit, varësisht nga situata, janë rishikuar vazhdimisht dhe masat janë ashpërsuar apo lehtësuar por edhe janë ndaluar tubimet në tërësi.

Avokati i Popullit ka vërejtur se Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdimisht ka nxjerrë vendime me të cilat ka ndërmarrë masa proporcionale me situatën e krijuar, me qëllim të mbrojtjes nga pandemia COVID-19.

XII. Liria e shprehjes, liria e mediave, e drejta e privatësisë dhe të drejtat zgjedhore gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë

Liria e shprehjes dhe liria e mediave

Masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të parandaluar dhe kontrolluar përhapjen e pandemisë kanë tejkaluar kufijtë e vendosur me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë një periudhe të tillë, ashtu që masat e marra nga Qeveria për t'iu kundërvënë rreziqeve ndaj shëndetit publik, kanë ndikuar në përgjithësi në kufizimin e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të mediave. Kufizimet në shprehjen dhe në informacionin e lirë dhe kufizimet në pjesëmarrjen e publikut janë bërë tejet të shprehura, duke qenë se pandemia ka vazhduar t'i sfidonte kërcënimet ndaj lirisë së shprehjes dhe qasjes në informata në të gjithë botën.

Pandemia COVID-19 ka ndikuar gjithashtu edhe në rritjen e keqinformimit dhe të dezinformimit, ashtu që Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) një fenomen të tillë e përkufizoi si "infodemia", pasi shkalla e informacionit të pasaktë ose çorientues në qarkullim paraqet rrezik serioz për shëndetin publik, dhe si reagim ndaj kësaj, shumë shtete kanë ndërmarrë masa për ta luftuar përhapjen e dezinformatave.

Ndërhyrjet në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe medias të shkaktuara nga masat e ndërmarra si reagim ndaj pandemisë COVID-19, kanë rrezikuar të shkelnin mbi funksionet esenciale që kryejnë mediat dhe gazetarët për të siguruar lehtësimin e shkëmbimit të informacionit të saktë gjatë një emergjence të shëndetit publik, sepse kapaciteti i tyre për t'i kryer këto funksione shpesh është penguar nga mungesa e qasjes efektive në informacione. Prandaj masat e ndërmarra me qëllim të parandalimit, kontrollimit dhe luftimit të pandemisë COVID-19 kanë

prekur një sërë aspektesh të së drejtës për lirinë e shprehjes, të mbrojtura sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kufijtë dhe kufizimet e lirisë së shprehjes duke mos cenuar të drejtat e njeriut

Liria e shprehjes, si e drejtë themelore, është një e drejtë më vete si dhe një komponent i të drejtave të tjera të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), e cila luan rol qenësor në mbrojtjen e këtyre të drejtave. Liria e shprehjes përbën një nga themelet kryesore të lirisë demokratike ashtu që në rastin *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj-ja deklaroi: “*Liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike, si një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimi e çdo qenieje njerëzore.*” Ndërsa në rastin *Castelles kundër Spanjës*, GjEDNj-ja deklaroi: “*Shtypi luan një rol të spikatur në një vend të qeverisur nga shteti ligjor.*” Nuk ka vend të lirë dhe demokraci pa pasur një garantim të gjerë të së drejtës së lirisë së shprehjes²¹² dhe si e tillë përkon me vetë konceptin e demokracisë dhe barazinë e të gjithë njerëzve. Liria e shprehjes kryesisht realizohet nëpërmjet mediave ashtu që në masë të konsiderueshme edhe identifikohet me lirinë e mediave.

Liria e shprehjes dhe liria e mediave në vendet demokratike, përveç me instrumente ndërkombëtare, janë të garantuara edhe me Kushtetutë dhe me ligj, me të cilat përcaktohen edhe limitet e ushtrimit të kësaj të drejte për të shmangur abuzimin potencial apo cenimin e të drejtave të tjera.

Kufizimi i të drejtave, edhe i lirisë së shprehjes, me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të të drejtave të tjera, përcaktohet me nenin 29 të DUDNj-së, si në vijim:

“1. Gjithkush ka detyrime vetëm ndaj asaj bashkësie në të cilën është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij. 2. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, gjithkush do t’u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve e që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike. 3. Këto të drejta dhe liri nuk mund të zbatohen në asnjë rast kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.”

Një sistem të kufizimeve mbi ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes e përcakton edhe KEDNj-ja, e cila në nenin 8, paragrafi 2, përcakton:

“Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Rrjedhimisht KEDNj-ja, në nenin 18 definoi: “*Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave*”, duke përcaktuar:

²¹² Jochen Abr.Frowein, “*Liria e Shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”, Këshilli i Evropës.

“Kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.”

Kushtetuta në nenin 40, paragrafi 2, përcakton kufizimin e së drejtës së lirisë së shprehjes, si në vijim:

“Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”

Kufizimet e lirisë së shprehjes sipas legjislacionit të Kosovës konsistojnë me qëllim të shmangies së gjuhës së urrejtjes, nxitjes së dhunës, gjuhës diskriminuese, fyese dhe shpifjes. Në këtë drejtim nxitja e urrejtjes është përcaktuar edhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPK), i cili në nenin 147 të tij përcakton veprën penale të *“Nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.”*

Sipas Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në nenin 1, përcaktohet: *“b) Rregullat që kanë të bëjnë me shpifjen dhe fyerjen të mos vënë kufij të paarsyeshëm mbi lirinë e shprehjes duke përfshirë edhe publikimin dhe diskutimin e çështjeve me interes të rëndësishëm për publikun: dhe d) “që mjetet e informimit publik të kenë rol të rëndësishëm në procesin demokratik si vëzhgues publik dhe transmetues i informatave të publiku.”²¹³*

Sipas Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në nenin 3, definohet: *“a) Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër. b) Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.”* Në nenin 5 të këtij ligji përcaktohet *“përgjegjësia për shpifje dhe fyerje”,* si në vijim: *“5.1. Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.5.2. Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj. 5.3. Kur shpifja ose fyerja ka të bëjë me një çështje të interesit publik ose kur personi i shpifur ose fyer është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për një pozitë publike, mund të ketë përgjegjësi për shpifje ose fyerje vetëm nëse autori ka ditur se informacioni ka qenë i rrejshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij.5.4. Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publikë mund të paraqesin kërkesë për kompensim e dëmit nga shpifja apo fyerja privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal.”*

Ndërsa sa u përket deklaratave me interes publik, ky ligj në nenin 7 përcakton: *“Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mirë, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla.”*

²¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Civil nr. 02/L-65 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, nenin 1.

Udhëzuesit ndërkombëtarë për ruajtjen e lirisë së shprehjes gjatë pandemisë

Zyra e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, duke u thirrur në solidaritet dhe bashkëpunim për të ndaluar përhapjen e COVID-19, dhe në respektimin e të drejtave të njeriut, më 20 prill 2020 ka publikuar Udhëzimet për COVID-19 [Të drejtat e njeriut në zemër të përgjigjes]. Nëpërmjet këtij udhëzuesi, Zyra e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, përveç të tjerash, bën thirrje për sigurimin e informimit të saktë për pandeminë COVID-19 dhe për pjesëmarrje në vendimmarrje:

“Informacionet relevante për pandeminë COVID – 19 duhet të arrijnë tek të gjithë njerëzit, pa përjashtim. Kjo kërkon që informacionet të jenë të disponueshme në formate dhe gjuhë lehtësisht të kuptueshme, duke përfshirë edhe gjuhët vendëse dhe ato të pakicave nacionale, etnike dhe religjioze, dhe informacionet të përshtaten për njerëzit me nevoja të veçanta, duke përfshirë ato me dëmtime të shikimit dhe dëgjimit, dhe të arrijnë tek ata të cilët kanë pak apo aspak aftësi për të lexuar apo që nuk kanë qasje në internet.

Qasja në internet është esenciale për të siguruar që informacioni arrin tek ata që janë të ndikuar nga virusi. Qeveritë duhet t'i japin fund çfarëdo ndërprerjeje të internetit dhe ai duhet të jetë gjithmonë i lëshuar. Shtetet gjithashtu duhet të punojnë për të siguruar qasje sa më të gjerë të mundshme në shërbimet e internetit, duke ndërmarrë hapa për lidhjen e ndarjeve digjitale, duke përfshirë edhe zbrazëtirën gjinore.

Njerëzit kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje që ndikon në jetën e tyre. Të qenit të hapur dhe transparent, dhe përfshirja e atyre që ndikohen nga vendimmarrja është kyçe për të siguruar që njerëzit të marrin pjesë në masat e përcaktuara për mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe të popullatës së gjerë.

Profesionistët e mjekësisë dhe ekspertët relevantë, duhet të jenë në gjendje të flasin lirshëm dhe të ndajnë informacione me njëri tjetrin dhe me publikun. Gazetarët dhe mediat duhet të jenë në gjendje të raportojnë për pandeminë, duke përfshirë reportazhe që kritikojnë reagimet e qeverisë, pa frikë dhe censurim. Duhet bërë përpjekje të bashkërenduara në nivel ndërkombëtar dhe në nivel nacional, për të kundërshtuar informacionet e rrejshme dhe ato çorientuese që nxisin frikë dhe paragjykime.

Përfshirja e perspektivave, e zërit dhe e dijes së grave në përgatitjen dhe reagimin ndaj shpërthimit është esenciale, duke përfshirë edhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre dhe rolin e tyre udhëheqës në hapësirat globale, regjionale dhe nacionale me COVID-19.”²¹⁴

Më 7 prill 2020, Këshilli i Evropës nxori Dokument Informativ nr. SG/Inf(2020)11, si paketë për shtetet anëtare, për respektimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, në të cilin sqaron ushtrimin efikas të lirisë së shprehjes dhe kufizimin e lejueshëm të kësaj të drejte në kohë pandemie:

“E drejta e jetës private, liria e ndërgjegjes, liria e shprehjes, liria e organizimit

Ushtrimi efikas i të gjitha këtyre të drejtave dhe lirive të garantuara nga Nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Konventës përbën një standard bazë të shoqërive moderne demokratike. Kufizimi i tyre

²¹⁴Zyrja e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara, “Udhëzime për COVID-19”, prill 2020, “linku: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/alb_ohchr_covid-19_guidance.pdf)

është i lejueshëm vetëm nëse vendoset me ligj dhe nëse është në raport të drejtë me qëllimin legjitim për të cilin është vendosur ky kufizim, duke përfshirë edhe mbrojtjen e shëndetit. Kufizimet e konsiderueshme të aktiviteteve të zakonshme sociale, duke përfshirë aksesin në vendet publike të adhurimit, organizimet publike dhe ceremonitë e martesave apo funeraleve, mund të çojnë në mënyrë të pashmangshme në ankesa të argumentuara në kuadrin e parashikimeve të mësipërme. U takon autoriteteve të marrin masat që çdo kufizim i tillë, qoftë i bazuar në derogim apo jo, të jetë i përcaktuar qartë me ligj, në përputhje me garancitë relevante kushtetuese dhe në raport të drejtë me qëllimin për të cilin është marrë 22 . Ndonëse kufizimet e shtuara të të drejtave të sipërpërmendura mund të jenë plotësisht të justifikuar në kohë krize, sanksionet e ashpra penale çojnë në shqetësime dhe mund të jenë objekt i një mbikëqyrjeje të rreptë. Situatat përjashtuese nuk duhet të çojnë në rritjen e rrugëve kriminale. Një ekuilibër i drejtë mes detyrimit dhe parandalimit është ai më i përshtatshmi, në mos rruga e vetme, për përmbushjen e kërkesës për proporcionalitet të Konventës.

Liria e shprehjes dhe informimit, liria e medias, aksesin në informacione zyrtare

Liria e shprehjes, duke përfshirë qarkullimin e lirë dhe në kohë të informacionit, është faktor kritik për mundësinë e medias për të raportuar mbi çështje që lidhen me pandeminë. Media dhe gazetarët profesionistë, veçanërisht transmetuesit publikë, kanë një rol kryesor dhe një përgjegjësi të posaçme për ofrimin e informacioneve të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur për publikun, por edhe për parandalimin e panikut dhe nxitjen e bashkëpunimit të popullatës. Ata duhet të veprojnë në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe etike të gazetarisë së përgjegjshme, duke përçuar mesazhe në lidhje me krizën dhe duke mos publikuar apo amplifikuar lajme të paverifikuara, për të mos përmendur materiale sensacionale ose të papranueshme. Rrethanat e jashtëzakonshme mund t'i detyrojnë gazetarët e përgjegjshëm të mos nxjerrin informacione qeveritare të destinuara për përdorim të kufizuar – si p.sh. informacione mbi masat e ardhshme për zbatimin e një politike edhe më të rreptë izolimi²³ .

Aksesin e publikut në informacione zyrtare duhet të menaxhohet mbi bazën e parimeve ekzistuese të parashikuara në jurisprudencën e Gjykatës. Çdo kufizim i aksesit në informacione zyrtare duhet të jetë përjashtues dhe në raport të drejtë me qëllimin e mbrojtjes së shëndetit publik. Konventa për Akses në Dokumente Zyrtare (“Konventa e Tromsø”) thekson nevojën për transparencë dhe parashikon që autoritetet publike, me iniciativën e tyre dhe aty ku është e përshtatshme, të marrin masat e nevojshme për bërjen publike të dokumenteve zyrtare për inkurajimin e një pjesëmarrjeje të informuar të publikut në çështje me interes të përgjithshëm.

Në të njëjtën kohë, komunikimet zyrtare nuk mund të jenë të vetmet kanale informimi për pandeminë. Kjo do të çonte në censurë dhe në shtypjen e shqetësimeve legjitime. Gazetarët, media, profesionistët e fushës së mjekësisë, aktivistët e shoqërisë civile dhe publiku në përgjithësi duhet të jenë në gjendje të kritikojnë autoritetet dhe të mbikëqyrin reagimin e tyre ndaj krizës. Çdo kufizim i mëparshëm i temave të caktuara, mbyllja e organeve mediatike apo bllokimi i menjëhershëm i aksesit në platforma të komunikimit online kërkon mbikëqyrjen më të kujdesshme dhe justifikohet vetëm në rrethanat më të jashtëzakonshme.

Pandemia nuk duhet të përdoret për t'u mbyllur gojën sinjalizuesve (ëhistle-bloëers) (shih Rekomandimin CM/Rec(2014)7 për mbrojtjen e sinjalizuesve), apo kundërshtarëve politikë. Përhapja dashakeqe apo dezinformimi mund të adresohen me sanksione ex post dhe përmes fushatave qeveritare të informimit. Shtetet duhet të punojnë bashkë me platformat online dhe me median për të parandaluar manipulimin e opinionit publik, si dhe për t'u kushtuar më shumë vëmendje burimeve përgjithësisht të besuara të lajmeve dhe informacioneve, sidomos atyre që komunikohen nga autoritetet e shëndetit publik.”

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, në prill të vitit 2020, publikoi një përmbledhje politikash “COVID-19 dhe të Drejtat e Njeriut- *We are all in this together*”²¹⁵, i cili synon të shndërrojë thirrjet për të vepruar për të drejtat e njeriut gjatë pandemisë, në veprime konkrete. Në këtë publikim përveç të tjerash rekomandohet garantimi i lirisë së shprehjes dhe sigurimi i informacionit të besueshëm, si në vijim:

“Sigurohuni që informacioni i besueshëm dhe i saktë i arrin të gjithë, duke e bërë të disponueshëm në formate dhe gjuhë të kuptueshme lehtësisht, duke përfshirë gjuhët autoktone dhe ato të pakicave, duke përshtatur informacionin për njerëzit me nevoja specifike, përfshirë personat me shikim dhe dëgjim, dhe duke arritur tek ata me aftësi e kufizuar ose pa aftësi për të lexuar, ose që nuk kanë qasje në internet dhe burime të zakonshme mediatike.

Të garantohet liria e shprehjes, përfshirë lirinë e shtypit, në mënyrë që informacioni të shpërndahet pa shtypje. Qeveritë, si dhe kompanitë e medias dhe teknologjisë, duhet të kundërshtojnë dezinformimin me informacion të saktë, të qartë dhe të bazuar në prova, dhe të shmangin përpjekjet e huaja që mund të rezultojnë në censurimin e fjalës së mbrojtur.”

Gjithashtu, Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, më 21 prill 2020, për të vlerësuar rolin kritik që Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj) mund të luajnë në përgjigje ndaj rrethanave të jashtëzakonshme, publikoi “*Librin e ndihmës: IKDN-të, Të Drejtat e Njeriut dhe COVID-19*”, nëpërmjet së cilës përveç të tjerash vlerësoi rëndësinë e qasjes në informacion dhe pjesëmarrje, duke potencuar rolin e IKDNj-së për të monitoruar dhe ndihmuar në shpërndarjen e informacionit të saktë, të bazuar në prova, është thelbësor në të gjitha fazat e krizës:

“Aksesi në informacion dhe pjesëmarrja: Roli i NHRIs për të monitoruar dhe ndihmuar në shpërndarjen e informacionit të saktë, të bazuar në prova, është thelbësor në të gjitha fazat e krizës. Informacioni mbi parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të sëmundjes duhet të jetë i arritshëm dhe i disponueshëm për të gjithë, i transmetuar në gjuhë të ndryshme dhe i përshtatur nevojave specifike, përfshirë ato të personave me aftësi të kufizuara, pakicave gjuhësore, indigjenëve dhe migrantëve. Criticalishtë gjithashtu kritike që publiku të ketë qasje në informacion në lidhje me masat parandaluese dhe shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe se si të kenë akses në shërbimet thelbësore të shëndetit seksual dhe riprodhues gjatë pandemisë.

²¹⁵ Kombet e Bashkuara, “COVID-19 dhe të drejtat e njeriut: Jemi të gjithë së bashku”, prill 2020, (linku: https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un_policy_brief_on_human_rights_and_covid_23_april_2020.pdf).

Aksesi në informacion gjithashtu lehtëson pjesëmarrjen: Masat e gatishmërisë mund t'i lejojnë popullatat të marrin pjesë në mënyrë të konsiderueshme në vendimmarrje dhe të krijojnë mekanizma që mundësojnë konsultime, reagime dhe ankesa. Qeveritë dhe NHRI-të duhet të synojnë të mbajnë hapësirën qytetare sa më të hapur të jetë e mundur në rrethana, pasi një shoqëri civile e gjallë që kontribuon në masa dhe siguron reagime mbi efektivitetin e tyre është thelbësore gjatë pandemisë, përfshirë sigurimin e besimit në sistemin shëndetësor.

Të gjitha masat e shëndetit publik duhet të zbatohen pa diskriminim të çfarëdo lloji, me theks në transparencën dhe shkëmbimin e informacionit që mund t'i fuqizojë njerëzit të marrin pjesë në mënyrë të konsiderueshme në mbrojtjen e shëndetit. Informacioni i saktë, i qartë dhe i mbështetur në prova është gjithashtu i rëndësishëm për zhdukjen e stigmes, diskriminimit, racizmit dhe ksenofobisë”.²¹⁶

Zhvillimet gjatë kësaj periudhe sa u përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, më 9 korrik 2021, zhvilluan takim pune me zëvendësdrojtorin e përgjithshëm të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) rreth ndikimit të pandemisë COVID-19 në lirinë e mediave, përkatësisht rreth informimit publik gjatë kohës emergjencës shëndetësore dhe pandemisë COVID-19 dhe në përgjithësi rreth sfidave të transmetuesit publik me të cilat është ballafaquar gjatë kësaj kohe. Ai njoftoi se RTK-ja pas një periudhe shumë të shkurtër nga shfaqja e COVID-19, ka filluar me transmetimin e një emisioni special “Infopandemia”, i cili është transmetuar çdo natë nga ora 12:30 deri 23:00 në RTK, nëpërmjet të cilit janë dhënë vazhdimisht informata për qytetarët rreth situatës me pandeminë, përfshirë numrat e rasteve të infektuar dhe raportimet direkt nga mjeku kujdestar në QKUK. Përveç këtij emisioni, RTK-ja ka zhvilluar edhe debate në studio përkitazi me situatën e pandemisë COVID-19.

Sipas zëvendësdrojtorit të përgjithshëm të RTK-së, që nga shfaqja e rasteve të para ka rezultuar mungesë e transparencës për numrin e testeve për COVID-19 dhe për numrin e rezultateve, duke qenë se si të tilla janë publikuar vetëm nëpërmjet ueb-faqes zyrtare të IKShPK-së në Facebook; me mosdhënie të qasjes në informacion lidhur me prejardhjen e rezultateve, posaçërisht rreth përfshirjes potenciale të rezultateve nga laboratorët e licencuarë privatë, dhe të tjerë të testuar jashtë vendit. Andaj sipas tij, rezultatet nuk ishin të kategorizuara sipas prejardhjes së testeve. Ai theksoi se gazetarët e RTK-së, të cilët janë angazhuar në trajtimin e temave në lidhje me menaxhimin e situatës me pandeminë, janë përballuar me presion nga ana e autoritetit publik. Njërit prej tyre i është ndaluar qasja në informata dhe marrja e prononcimeve për media në Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), shkaku i transmetimit të emisionit hulumtues lidhur me rastin e blerjes së bombolave të oksigjenit nga kjo e fundit. Ai shtoi se gazetarët gjatë gjithë kohës kanë punuar me orar të rregullt të punës, ndërsa pjesa tjetër e stafit kanë punuar me rotacion. Sa i përket lëvizjes së lirë të punonjësve medialë, ai deklaroi se të njëjtët kanë hasur në pengesa nga Policia e Kosovës gjatë kohës së masave të izolimit, përfshirë edhe mysafirët e ftuar në studio, kjo deri sa të njëjtët janë pajisur me leje zyrtare të qarkullimit. Për shkak të ndjeshmërisë së situatës, ai theksoi se RTK-ja ka treguar konsideratë

²¹⁶ Zyra e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara, *Aide memoire*, (linku: <https://www.ohchr.org/Documents/Press/HCCOVID19lettertoNHRIs.pdf>).

për mungesën e hapjes së temave të ndryshme në një situatë të rëndë për popullatën, ndërsa shtoi se në procesin e vaksinimit, mediat nuk janë përfshirë në kategorinë e grupeve me prioritet, e që do duhej të ishin në atë kategorizim. Në lidhje me çështjen e dezinformimit dhe keqinformimit gjatë kohës së pandemisë, ai deklaroi se gazetarët e RTK-së në vazhdimisht marrin trajnime kundër lajmeve të rrejshme, andaj edhe nga shfaqja e rasteve të para me COVID-19, gazetarët e transmetuesit publik janë bazuar në informatat e marra nga burimet zyrtare, në këtë rast nga IKShPK-ja dhe nga MSh-ja.

Më 14 korrik 2021, përfaqësuesit e IAP-së zhvilluan takim me drejtorin ekzekutiv të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës²¹⁷ (KMSHK), me të cilin biseduan lidhur me atë se sa janë respektuar standardet e etikës nga mediat dhe nga transmetuesit e shtypur gjatë raportimeve në situatën e krijuar pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, si dhe për ankesat që KMSHK-ja i ka pranuar dhe trajtuar përkitazi me këtë çështje. Ai njoftoi se sa i përket respektimit të standardeve të etikës së mediave dhe transmetuesve të shtypur gjatë pandemisë, mediat në përgjithësi janë treguar jashtëzakonisht korrekte në informimin e qytetarëve, sepse të njëjtat i kanë shfrytëzuar kryesisht burimet zyrtare për informim (kryesisht MShnp dhe IKShPK-në). Përjashtim bëjnë rastet në fillimet e shfaqjes së COVID-19, ende pa u konfirmuar asnjë rast infektimi në Kosovë, është evidentuar se disa portale të lajmeve kanë manipuluar me burime të besueshme që në të vërtetë ishin prodhues paniku. Gjithashtu ka pasur dezinformata të shpërndara në rrjete sociale kryesisht nga faqe të paverifikuara, por pavarësisht kësaj, raportimi i gazetarëve në vend është cilësuar i saktë. Ai deklaroi se gjatë kësaj kohe kishte edhe raportime me informata të ndryshme të përkthyer nga mediat ndërkombëtare, në cilësinë e kurioziteteve, por të njëjtat nuk janë ekzagjeruar kur është kuptuar se të dhënat e tilla, përveç se ishin të panjohura, ato nuk ishin të sakta. Nga perspektiva e KMSHK-së, ai theksoi se nuk kishte shkelje të etikës së mediave gjatë pandemisë COVID-19. Gjithashtu ai përmendi se KMSHK-ja në fillim të situatës me pandeminë u ka bërë thirrje mediave të respektonin në përpikëri parimet etike të kodit të KMSHK-së. Gjithashtu anëtarët e KMSHK-së kanë bërë thirrje tek të gjitha mediat dhe transmetuesit e shtypur dhe online për të respektuar standardet e etikës në raportimin për situatën e krijuar pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, dhe kanë dhënë rekomandime për mënyrën e raportimit në lidhje me COVID-19, si në vijim:

1. *“KMSHK bënë thirrje që informacionet për përhapjen e pandemisë të verifikohen nga burimet zyrtare në mënyrë që mos të përhapet paniku tek popullata.*
2. *Në rast të përhapjes së lajmeve të rreme KMSHK u bënë thirrje mediave që të publikojnë demante dhe materiale të cilat i denoncojnë si të pavërteta informacionet e rreme.*
3. *KMSHK bënë thirrje që privatësia e pacientëve të ruhet në mënyrë strikte dhe në asnjë rrethanë mos të zbulohet identiteti i të infektuarve.*
4. *Në rastet kur viktimat dëshirojnë të japin deklarata mediat të sigurohen që mbulojnë identitetin e tyre.*

²¹⁷ Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara dhe misioni i tij mbështetet mbi bindjet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Fjala e lirë, e drejta e qytetarëve për t'u informuar plotësisht, me kohë, dhe respektimi në tërësi i kodit etik të gazetarisë janë baza mbi të cilën vepron KMSHK. Qëllimi i KMSHK-së është ta mbrojë qytetarin nga shkrimet e pavërteta si dhe ta mbrojë gazetarin nga ankesat e pambështetura. (linku: <https://presscouncil-ks.org/rreth-nesh/>)

5. *Fotografitë dhe video materialet ilustruese për virusin mos të ekspozojnë pamje të qytetarëve të rëndomta.*
6. *KMShK u bënë thirrje mediave që të publikojnë sa më shumë informacione me përmbajtje të këshillave për parandalimin e përhapjes së pandemisë.*
7. *KMShK kërkon nga mediat që këshillat të jenë të thirrura në burime kredibile shkencore e jo në staf joprofesional e jo të thirrur shkencërisht.”*

Në lidhje me Indeksën për vitin 2021 të Reporterëve pa Kufij, sipas të cilit, për vitin 2021 Kosova ka pësuar rënie për 8 vende në Indeks, në krahasim me vitin 2020, në raport me lirinë e shprehjes dhe mediave. Ai deklaroi se në këtë raport nuk janë vlerësuar raportimet e gazetarëve, por janë vlerësuar segmentet në lidhje me kushtet e gazetarëve, sigurinë e tyre fizike dhe juridike, ndikimin financiar, kontratat etj., andaj në këtë drejtim në masë të madhe ka ndikuar situata me pandeminë. Ai shtoi se pandemia gjithashtu ka ndikuar në humbje mjaft të madhe në aspektin e informimit duke qenë se mediat e shtypura, 4 gazetat ditore të vendit, u hoqën nga tregu, andaj sipas KMShK-së, kjo përbën cenim të së drejtës për informim për të gjithë qytetarët që nuk e kanë të mundur të informohen nëpërmjet mjeteve elektronike, sidomos ata të një moshe më të shtyrë. Sipas tij, komunikimi me institucionet publike nuk ishte i kufizuar, por i kujdesshëm në raport me qasjen në informata për gazetarët. Qasja në informata në raport me Qeverinë ishte e kanalizuar kryesisht nëpërmjet IKShPK-së dhe MSh-së, ndërsa institucionet e tjera në shumë raste hezitonin t’i jepnin, për shkak të pasigurisë së saktësisë së informacionit duke pasur parasysh se situata me pandeminë COVID-19 ishte e pa precedent dhe e panjohur në të gjithë botën. Në këtë aspekt ai thekson se janë sfiduar edhe institucionet, sepse nuk ishin të përgatitura si t’i qaseshin mediave në dhënien e informacioneve, gjithashtu ka munguar një organizim i mirëfilltë. Ai theksoi se është me rëndësi të ceket se gjatë pandemisë COVID-19 në masën më të madhe mediat kanë raportuar për atë çfarë është interes i publikut, por jo për atë çfarë është interesimi i publikut. Sa i përket pyetjes në lidhje me adresimin e ankesave, ai deklaroi se KMShK-ja ka marrë dy ankesa që lidhen me situatën e pandemisë, por të njëjtat nuk kanë të bëjnë me raportimin e mediave në lidhje me COVID-19 apo me lirinë e shprehjes. Sipas tij, ndikimi më i madh i COVID-19 tek mediat ishte ai në aspektin financiar, duke ndikuar në uljen drastike të të hyrave nga marketingu, ndërsa shtoi se gjatë viti 2021 kjo gjendje është përmirësuar, por do të lë një vragë të madhe në vitet e ardhshme edhe në kuptimin e mediave si biznes, por edhe në kuptimin e mediave që janë në funksion të informimit të publikut.

Më 14 korrik 2021, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takim me udhëheqësen e Divizionit të Monitorimit si dhe me udhëheqësen e Divizionit për Ankesa dhe Përfaqësim në Komisionin e Pavarur të Mediave²¹⁸ (KPM), me të cilat biseduan në përgjithësi mbi vlerësimin e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, përkitazi me lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim gjatë kohës së pandemisë. Përfaqësueset e KPM-së deklaruan se në mars 2021 KPM-

²¹⁸ Komisioni i Pavarur i Mediave, sipas nenit 141 të Kushtetutës është “[...] organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera me ligj. Ndërsa Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

ja ka publikuar një raport monitorimi, me titull: Monitorimi i Lajmeve Qendrore të OShMA-ve” (Ofruesit i Shërbimit Medial Audiovizuel) për periudhën e monitorimit shkurt-mars 2020, me qëllim të vlerësimit dhe të analizimit të përmbajtjeve të lajmeve që ofroheshin për qytetarët e Kosovës nga OShMA-t, përfshirë mbulimin e situatës pandemike në edicionet e lajmeve qendrore. Sipas këtij raporti, vlerësohet se hapësira e dhënë në kronikat që kanë trajtuar temën e COVID-19 është vlerësuar si e konsiderueshme (me një mesatare mbi 50%), në të cilën janë përfshirë edhe ndikimi i pandemisë në fusha të ndryshme shoqërore. Sa i përket adresimit të ankesave, ato theksojnë se KPM-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë me përmbajtje të situatës në lidhje me ndikimin e pandeminë COVID-19.

Më 30 korrik 2021, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takim me drejtorin e bordit dhe drejtoreshën ekzekutive të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës ²¹⁹(AGK), me të cilët biseduan lidhur me gazetarinë cilësore dhe të hapur dhe të drejtat e gazetarëve gjatë pandemisë COVID-19. Ata theksuan se që nga marsi 2020, kur u shfaq rasti i parë me COVID-19 në Kosovë, gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, me lejen e autoriteteve qeveritare, vazhduan punën e rregullt në kushtet e izolimit të përgjithshëm, përkundër rrezikshmërisë nga infektimi me COVID-19, duke bërë punë profesionale dhe gazetari cilësore, në shërbim të informimit të qytetarëve. Sipas AGK-së, pandemia shpërfaqti të gjitha problemet strukturore ekzistuese në fushën e gazetarisë. Sipas monitorimit dhe hulumtimit të cilat i ka bërë AGK-ja, COVID-19 ka ndikuar negativisht në sektorin e medias në vend, pikërisht në gjendjen ekonomike të mediave private, në sigurinë e gazetarëve, në rënien e gjendjes ekonomike të punonjësve medialë, në largime nga puna, në zvogëlim dhe vonesa në paga, në kundërshtim me të drejtat e garantuara të punës. Largimi nga puna i mbi 20 punonjësve medialë nga kompania mediale “Zëri” u cilësua ndër rastet më të rënda të ndikimit të pandemisë COVID-19 në ekonominë e punonjësve medialë. Përveç presionit financiar, gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, gjatë raportimit në periudhën e pandemisë, shpesh u përballën edhe me mungesë të mjeteve mbrojtëse kundër COVID-19. Ata theksuan se pandemia COVID-19 ndryshoi edhe dinamikën e punës së mediave, duke qenë se shumë nga emisionet dhe kontaktet për qasje në informacion u zhvilluan përmes platformave online, në përpjekje për t’i respektuar masat e kërkuara të distancimit fizik. Për më tepër njoftuan se në fillim të emergjencës shëndetësore, mediat u përfshinë në Pakon Fiskale Emergjente²²⁰ në kategorinë e bizneseve, por gazetarët, fotoreporterët dhe kameramanët, duke marrë parasysh raportimin e vazhdueshëm në pandemi nga vija e parë e frontit dhe nën hijen e rrezikut potencial për infektim, nuk u përshinë në kategorinë e punonjësve esencialë në këtë pako dhe shtuan se një numër i punonjësve medialë nuk kanë përfituar në asnjë formë nga pakoja, për shkak të paqartësisë së duhur të instruksioneve nga MSh-ja dhe të disa prej tyre për shkak të mungesës së kontratave të punës. Sipas tyre, punonjësit medialë hezitonin t’i raportonin shkeljet e të drejtave të tyre në vendin e punës për shkak të viktimizimit dhe frikës së largimit nga puna. Për më tepër, përfaqësuesit e AGK-së theksuan se gjatë vitit 2020 u rrit numri i kërcënimeve dhe i sulmeve ndaj gazetarëve. Në vitin 2020 janë regjistruar 24 raste të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe ndaj punëtorëve të tjerë medialë, prej tyre 4 raste ishin sulme fizike ndaj tyre. Ajo çka shihet

²¹⁹ Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, është organizatë joqeveritare që ka për mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e gazetarëve, promovimin, inkurajimin dhe përmirësimin e gazetarisë cilësore dhe të hapur në Kosovës.

²²⁰ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr.01/19, datë 30 mars 2020, për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale.

më pozitive gjatë kësaj kohe në vend, pikërisht në kohë pandemie, është hapja e dy mediave të reja, konkretisht hapja e dy televizioneve, të cilat për një kohë të shkurtër kanë hyrë në skemën mediale të Kosovës. Ndërsa njoftuan se AGK-ja ka regjistruar dy ndalime të gazetarëve në detyrë nga Policia e Kosovës, njëra në Qendrën e Karantinimit në Prishtinë, dhe tjetra në Veri të Mitrovicës. Kjo e fundit raportohet se është arrestuar dhe më pas është liruar. Sa i përket çështjes së informimit të saktë gjatë pandemisë COVID-19, vlerësuan se në kohën kur gjithë bota është përballur me të panjohurën, përfshirë edhe OBSH-në, gazetarët në Kosovë i kanë luftuar lajmet e rrejshme, d.m.th. përpos që kanë mirinformuar, në të njëjtën kohë i kanë luftuar lajmet e pasakta. Presioni më i madh, sipas tyre, për gazetarë ishte në kohën e rrëzimit të Qeverisë, në kohë pandemie, pasi gazetarët në të njëjtën kohë janë obliguar të raportonin edhe nga QKUK-ja edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sa i përket qasjes në informata, përfaqësuesit e AGK-së theksuan se ka raste kur gazetarët janë penguar në lidhje me qasjen në informata, njëra prej tyre është pengesa për qasje në informata në lidhje me kontratën me kompaninë “Pfizer” për blerjen e vaksinave. Në tetor të vitit 2020, AGK-ja njoftoi se ka publikuar raport hulumtues, të titulluar: “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, të kameramanëve dhe të fotoreporterëve”, i cili adresoi disa sfida me të cilat punonjësit e mediave janë përballur gjatë pandemisë COVID-19.²²¹

Më 4 gusht 2021, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takim me drejtoreshën ekzekutive të organizatës joqeveritare “Youth Ecological and Security Zone-EcoZ”, me të cilën biseduan rreth ndikimit të pandemisë COVID-19 në punën e tyre, në aktivitetet dhe në informimin me interes publik. Ajo theksoi se stafi i organizatës gjatë kohës në të cilën janë aplikuar masat e izolimit të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kanë punuar nga distanca, ndërsa disa nga aktivitetet i kanë adaptuar në sistemin online dhe të tjerat i kanë konvertuar në aktivitete relevante. Ajo theksoi se sfida kryesore gjatë pandemisë për organizatat joqeveritare ishte pengesa në komunikim dhe qasja në informacione dhe në dokumente zyrtare në institucionet publike, me arsyetimin e mungesës së stafit dhe aplikimin e punës nga distanca. Për më tepër, ajo theksoi se gjatë aplikimit të masave të izolimit dhe në pjesën më të madhe të vitit 2020, e kishin të pamundur t’i zhvillonin aktivitetet në lidhje me avokimin dhe lobimin. Sipas saj, shumica e institucioneve publike kanë dështuar në organizimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe kishte mungesë të informimit dhe të organizimit të dëgjimeve publike. Disa institucione dëgjimet publike i kanë shtyrë për vitin 2021, ndërsa disa të tjera dëgjimet publike i kanë organizuar në formë virtuale. Për më shumë, ajo pohoi se organizata të cilën e përfaqëson, informimin rreth aktiviteteve kryesisht e ka aplikuar nëpërmjet platformave online dhe të rrjeteve sociale.

Në prill të vitit 2021, organizata “Reporterët pa Kufij”²²² ka publikuar indeksin për vitin 2021, në bazë të së cilit në mesin e 180 shteteve të botës, Kosova është renditur në vendin e 78-të, në raport me lirinë e shprehjes dhe mediave. Sipas këtij raporti, për vitin 2021 Kosova ka pësuar rënie për 8 vende në Indeks, në krahasim me vitin 2020. Raporti evidenton rritje të

²²¹ AGK, ‘Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Gjendjen Ekonomike të Gazetarëve, Kameramanëve dhe Fotoreporterëve’ tetor 2020.

²²²Reporterët pa Kufij (RSF), me seli në Paris, është një organizatë joqeveritare e pavarur me status konsultativ me Kombet e Bashkuara, me UNESCO-n, me Këshillin e Evropës dhe me Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë (OIF).

paqëndrueshmërisë të mediave në vend, si pasojë e krizës së koronavirusit, duke theksuar se media në Kosovë mbetet e ndarë në vija etnike; qasja në informacione të caktuara shpesh është e kufizuar në një grup etnik ose politik dhe se shumica e mediave priren t'i mbulojnë dhe përqendrohen në çështjet që lidhen me kombësinë e tyre. Për më tepër, raporti vlerëson se gazetarët dhe mediat në Kosovë janë të ekspozuar ndaj një mjedisi armiqësor, duke përfshirë sulmet fizike dhe verbale ndaj gazetarëve, sulmet kibernetike ndaj mediave online si dhe mungesa e transparencës sa i përket pronësisë së mediave. Në raport theksohet se mediat financiarisht të paqëndrueshme janë të brishta përballë ndikimit politik dhe se si rezultat i pandemisë, shumë gazeta u desh t'i jepnin fund botimit.

Sipas drejtorit menaxhues të “Reporterëve pa Kufij”, z. Ch. M., në një intervistë dhënë për Deutsche Welle, ka theksuar: “*Pandemia korona intensifikon dhe konsolidon tendencat shtypëse në të gjithë botën dhe situata është përkeqësuar pak a shumë në të gjitha kontinentet, siç mund të shihet nga analiza e lirisë së shtypit në vitin 2021.*”²²³

Media të ndryshme në vend kanë raportuar se si pasojë e kufizimit të përgjithshëm të lëvizjes dhe të vështirësive financiare, botuesit që nga muaji mars 2020 pezulluan shtypjen dhe shitjen e gazetave ditore, ndërsa filluan ta informonin publikun vetëm përmes gazetave në formatin elektronik dhe portaleve. Sipas një artikulli të datës 26 maj 2020 të portalit Kosovalive: “*Situata e krijuar nga COVID-19 u ka pamundësuar katër gazetave²²⁴ të përditshme kosovare që të botohen, andaj të njëjtat aktualisht po funksionojnë online. Udhëheqësit e këtyre gazetave kanë deklaruar se janë dëmtuar financiarisht për shkak të ndërprerjes së kontratave të marketingut që i kanë pasur me bizneset. Kjo ka shkaktuar dëme financiare te këto gazeta për shkak se bizneset i kanë ndërprerë kontratat e reklamimit. Në anën tjetër të hyrat u kanë mbetur minimale edhe nga reklammat në portale. Disa nga ato kanë pushuar një pjesë të punëtorëve nga puna, ndërsa disa ua kanë ulur pagat.*”²²⁵

Liria për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide

Liria për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide ka rëndësi të veçantë, sidomos për jetën politike dhe strukturën demokratike të një vendi, duke qenë se një ushtrim i plotë i lirisë për të dhënë informacione dhe ide i jep rrugë kritikës së lirë të Qeverisë, që përbën indikatorin kryesor të një qeverie të lirë e demokratike. GjEDNj-ja, në rastin *Lingens kundër Austrisë*, 1986, ka theksuar si në vijim: “*Të japë informacione dhe ide mbi çështjet politike ashtu si mbi ato në fushat e tjera të interesit publik. Jo vetëm shtypi ka detyrën të japë informacione të tilla dhe ide: edhe publiku ka një të drejtë për t'i marrë ato.*”

Liria për të dhënë informacione dhe ide është plotësuese e lirisë për të marrë informacione dhe ide, sidomos sa i përket mediave të shkruara dhe mediave transmetuese. Në lidhje me këtë të fundit, GjEDNj-ja, në rastin *Groppera Radio kundër Zvicrës*, 1990, dhe *Casado Coca kundër Spanjës*, 1994, është shprehur se shtetet nuk duhet të ndërhyjnë midis transmetuesit dhe

²²³ Deutsche Welle, 20 prill 2021, (linku: <https://www.dw.com/sq/korona-murtaj%C3%AB-edhe-p%C3%ABr-lirin%C3%AB-e-shtypit/a-57263988>).

²²⁴ Koha Ditore, Zëri, Bota Sot dhe Epoka e Re.

²²⁵ Kosova Live, “*Pasojat e pandemisë në mediat e shkruara*”, korrik 2021, (linku: <https://kosovalive.org/2020/05/26/pasojat-e-pandemise-ne-mediat-e-shkruara/>).

marrësit, duke qenë se ata kanë të drejtën për të hyrë në kontakt të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin sipas dëshirës së tyre.

Meqenëse liria për të cilën po diskutojmë i referohet dhënies, si të informacionit, ashtu edhe të ideve, bëhet i rëndësishëm dallimi që ka përcaktuar GjEDNj-ja në një fazë të hershme. Duke bërë një dallim të qartë midis informacionit (fakteve) dhe mendimeve (gjykimet mbi vlerat), GjEDNj-ja, në rastin *Lingens kundër Austrisë*, 1986, është shprehur: “*Ekzistenca e fakteve mund të demonstrohet, kurse e vërteta e vlerave nuk është e prekshme si provë...Në lidhje me gjykimet mbi vlerat kjo kërkesë është e pamundur të përmbushet dhe dhunon vetë lirinë e mendimit, e cila është një pjesë themelore e të drejtës së siguruar nga Neni 10 i Konventës.*”

Edhe liria e shprehjes dhe e drejta për të marrë dhe shpërndarë informacione janë të kufizuara. Gjithsesi, në vendosjen e këtyre kufizimeve duhet mbajtur parasysh rëndësia specifike e së drejtës së informacionit në një situatë pandemie ku rrezikohet shëndeti i gjithsecilit. Shumë shtete kanë marrë një sërë masash për të luftuar përhapjen e informacionit “të rremë” apo “të dëmshëm”, ose informacione që mund të shkaktonin panik dhe trazira sociale gjatë pandemisë. Marrja e masave për ndalimin e shpërndarjes së informacioneve që keqinformojnë publikun merr një rëndësi të madhe gjatë një pandemie, por aq e rëndësishme është që këto masa të jenë proporcionale. Përndryshe, shtetet rrezikojnë të cenojnë funksionet thelbësore të shërbimit të gazetarisë gjatë një emergjence mbi shëndetin publik, përfshirë garantimin e përgjegjshmërisë së Qeverisë dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit të dobishëm.²²⁶

Aktivitetet e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës rregullohen me Ligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, i cili ka për qëllim rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregulluese të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës (neni 1). Duke marrë parasysh zhvillimin e teknologjisë elektronike në aspektin e shkëmbimit të informacionit dhe atë të komunikimit, edhe gjatë kohës së pandemisë, qasja dhe shfrytëzimi i shërbimit të komunikimit nëpërmjet platformave elektronike dhe të rrjeteve sociale është shfrytëzuar pa pengesa. Gjatë kohës së pandemisë nuk është raportuar asnjë përpjekje nga autoritetet shtetërore për ta kufizuar të drejtën e qasjes në internet apo për ta bllokuar apo filtruar përmbajtjen e publikuar në internet.²²⁷

Që nga përhapja e krizës shëndetësore në fund të vitit 2019 dhe zgjerimi i saj i mëvonshëm në shumicën e vendeve të botës, shtetet janë sfiduar dhe janë përballur me rritjen e shpejtë të dezinformatave të lidhura me COVID-19. OBSH-ja këtë rritje të dezinformimit e përshkroi si një “*infodemi*”, koncepti i së cilës përkufizohet si një “*tepricë informacioni, disa të sakta dhe disa jo, që e bën të vështirë për njerëzit të gjejnë burime të besueshme ose udhëzime të besueshme kur kanë nevojë.*” Pothuajse të gjitha vendet e botës kanë ndërmarrë masa dhe kanë

²²⁶ COVID-19 dhe Ndikimi tek të Drejtat e Njeriut, The Aire Centre, Advice on Individual Rights in Europe, 28 prill 2020. <https://www.rolplatform.org/wp-content/uploads/2020/05/Covid-19%20and%20the%20WB%20-%20ALB.pdf>

²²⁷ Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës “*Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve*”, 2020.

publikuar udhëzime dhe rekomandime për luftimin e dezinformimit dhe të keqinformimit duke u thirrur në mbrojtjen e lirisë së shprehjes gjatë pandemisë COVID-19.

Organizata ndërkombëtare “Access Now”²²⁸, në prill të vitit 2020 publikoi udhëzuesin: “*Luftimi i keqinformimit dhe mbrojtja shprehjes së lirë gjatë COVID-19: rekomandimet për shtetet*”, nëpërmjet të cilit ka konstatuar dëmin që mund të shkaktojë dezinformimi dhe keqinformimi, duke theksuar fuqinë që kanë për të përforcuar ndarjet ekzistuese dhe për të frymëzuar frikë dhe panik të pajustificuar brenda shoqërive. Sipas konkluzioneve të dala nga ky raport, gjatë krizës shëndetësore COVID-19, qasja e papërshtatshme në të dhënat objektive në lidhje me COVID-19 ka krijuar hapësirë për informacion mashtrues dhe të pasaktë që disa qeveri të abuzonin për të çuar më tej objektivat e tyre politike dhe për të shtyrë masat shtypëse, duke thelluar stigmatizimin shoqëror të grupeve të cënueshme dhe gjithashtu për të shtypur gazetarinë objektive dhe informacionin shkencor. Nëpërmjet këtij udhëzuesi janë dhënë një sërë rekomandimesh specifike dhe të përgjithësuara për shtetet për luftimin e keqinformimit dhe mbrojtjen e shprehjes së lirë gjatë pandemisë COVID-19.²²⁹

Duke qenë se në disa shtete të botës, gazetarët që kanë mbuluar informimin rreth pandemisë janë përballur me një sërë sanksionesh ligjore për përhapjen e “informacionit të rremë”, në Kosovë është vlerësuar se në këtë aspekt gazetarët kryesisht kanë respektuar parimet e etikës së gazetarisë duke u mbështetur vetëm në burimet të besueshme zyrtare, me përjashtim të disa rasteve në fillim të shfaqjes së pandemisë për të cilën nuk ishin të përgatitur. Sipas KMSHK-së, në fillimet e shfaqjes së COVID-19, ende pa u konfirmuar asnjë rast infektimi në Kosovë, është evidentuar se disa portale të lajmeve kanë manipuluar me burime të besueshme që në të vërtetë ishin prodhues paniku. Gjithashtu ka pasur dezinformata të shpërndara në rrjete sociale kryesisht nga ueb-faqe të paverifikuara, por pavarësisht kësaj, raportimi i gazetarëve në vend është cilësuar i saktë. Me këtë rast, përveç mekanizmave ndërkombëtarë, gjithashtu edhe mekanizmat vendorë të sektorit medial, u kanë bërë thirrje mediave në Kosovë t’i respektonin parimet e etikës së gazetarisë duke u mbështetur vetëm në burime të besueshme zyrtare.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në raportin e tij vjetor për vitin 2019, ka përmendur se në Kosovë gjatë vitit 2019 kanë operuar 19 stacione funksionale televizive, 86 radiostacione, 41 operatorë të shpërndarjes dhe 97 ofrues të shërbimeve audio-vizuele mediale. KPM-ja kishte vlerësuar se ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuele në vend kanë dhënë hapësirë të konsiderueshme mediale për informim në lidhje me pandeminë COVID-19 në të cilën janë përfshirë edhe ndikimi i pandemisë në fusha të ndryshme shoqërore. Gjithashtu KPM-ja ka deklaruar se nuk ka marrë asnjë ankesë me përmbajtje të situatës në lidhje me ndikimin e pandeminë COVID-19. Gjatë vitit 2020 janë shtuar edhe dy ofrues të shërbimeve audio-vizuele, të cilat për një kohë të shkurtër kanë hyrë në skemën mediale të Kosovës.

Aktorë të ndryshëm të mediave kanë vlerësuar se gazetarët dhe punonjësit e tjerë medialë, që nga shfaqja e pandemisë COVID-19, kanë raportuar vazhdimisht dhe në mënyrë cilësore për

²²⁸ Access Now është organizatë ndërkombëtare me seli në New York, e cila mbron dhe promovon të drejtat digjitale të përdoruesve në rrezik në të gjithë botën, si përveç të tjerash mbron të drejtën e lirisë së shprehjes, shtypit dhe të drejtat e njeriut. (linku: <https://www.accessnow.org/>).

²²⁹ Access Now, “*Luftimi i keqinformimit dhe mbrojtja shprehjes së lirë gjatë Covid-19: rekomandimet për shtetet*”, 2020, (linku: <https://www.accessnow.org/cms/assets/uploads/2020/04/Fighting-misinformation-and-defending-free-expression-during-COVID-19-recommendations-for-states-1.pdf>)

t'i mbajtur të informuar qytetarët mbi zhvillimet e situatës me pandeminë, duke marrë parasysh kushtet në të cilat punuan gjatë pandemisë dhe kushtet e përgjithshme në sektorin e medias në Kosovë, që lë ende për të dëshiruar.

Ndër ndikimet negative të pandemisë COVID-19 në të drejtën e lirisë së mediave është raportuar ndërprerja e shtypit të gazetave ditore²³⁰ në vend. Në raportin për vitin 2021 të "Reporterëve pa Kufij" theksohet: "*Mediat në Kosovë janë financiarisht të paqëndrueshme dhe janë të brishta përballë ndikimit politik dhe se si rezultat i pandemisë, shumë gazeta u desh t'i jepnin fund botimit.*" Kosova është vendi i parë në rajon dhe më gjerë ku është ndërprerë botimi i shtypit të vetëm ditor pas masave të marra nga Qeveria për parandalimin e përhapjes së COVID-19 dhe rikthimi i tyre nuk është duke u konsideruar si pasojë e ndikimit financiar, përkatësisht kostos më të lartë të botimit të gazetave në krahasim me ato gjeneruar nga shitja. Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e mediave të shkruara në vend shënon rënie në të drejtën e informimit, duke qenë se jo të gjithë mund t'i përdorin mediat online, dhe se sipas të dhënave zyrtare, 93% e qytetarëve kanë qasje në internet. Pavarësisht zhvillimit të teknologjisë dhe përdorimit të internetit në masë të madhe, një pjesë e qytetarëve kanë deklaruar se u mungon shtypi ditor tradicional.²³¹ Andaj Avokati i Popullit konsideron se do të ishte në interes që shteti të vlerësojë mundësinë e ofrimit të mbështetjes në rikthimin e tyre.

Pandemia e shkaktuar nga COVID-19 ndikoi negativisht në gjendjen ekonomike të mediave private, gjë që ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në rënien e gjendjes ekonomike të punonjësve medialë, andaj një numër i konsiderueshëm i punonjësve medialë u përballën me zvogëlim dhe vonesa në paga si dhe largim nga puna. Mospërfshirja e gazetarëve, e fotoreporterëve dhe e kameramanëve në kategorinë e punonjësve esencialë, në Pakon Fiskale Emergjente²³², duke marrë parasysh raportimin e vazhdueshëm dhe me rrezikshmëri në pandemi, thelloi edhe më shumë rënien e gjendjes ekonomike të tyre. Disa nga ta nuk përfituan në asnjë formë nga kjo pako, shkaku i mungesës së kontratave të punës. Ashtu siç ceket më lart, rasti më i rëndë në kohë pandemie u cilësua largimi nga puna i 20 punonjësve medialë nga kompania "Zëri". Sipas AGK-së, disa prej tyre janë ende në shfrytëzim të mjeteve juridike.

Kufizimi i plotë i lëvizjes së qytetarëve në muajt e parë të pandemisë, në disa raste krijoi pengesa në lirinë e lëvizjes së gazetarëve, të fotoreporterëve dhe të kameramanëve, derisa të njëjtët u pajisën me leje zyrtare qarkullimi. Një numër i gazetarëve kanë raportuar se janë ndaluar nga Policia e Kosovës derisa ishin në lëvizje për të marrë informata dhe për të raportuar për gjendjen me pandeminë COVID-19. "Reporterët pa Kufij" në indeksin për vitin 2021 raportuan se policia shfrytëzoi orën e ndalimit të lëvizjes, një nga masat për parandalimin e COVID-19, si shkas për arrestimin e redaktores së gazetës në internet "KoSSev", T. L.

Pengimi i gazetarëve për qasje në informata, si dhe kryerjen e detyrave të tyre, gjithashtu pengesat për pjesëmarrje në ngjarjet publike (siç janë raportuar në disa raste gjatë pandemisë) përbëjnë presion jo vetëm në punën e tyre, por kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në lirinë e shprehjes dhe në lirinë e mediave, veçanërisht në të drejtën për të marrë dhe për të dhënë

²³⁰ "Koha Ditore", "Epoka e Re", "Zëri" dhe "Bota Sot".

²³¹ Epoka e Re, "Kosova pa asnjë gazetë të shtypur", korrik 2021, (linku: <https://www.epokaere.com/kosova-pa-asnje-gazete-te-shtypur/>)

²³² Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr.01/19, datë 30 mars 2020, për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale.

informacione. Pengesa e gazetarëve në punën e tyre bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me instrumentet vendore dhe ndërkombëtare dhe me udhërrëfyesit ndërkombëtarë për ruajtjen e lirisë së shprehjes gjatë pandemisë COVID-19.

Në lidhje me obligimet e kësaj natyre, me qëllim të krijimit të një ambienti të sigurt për punën e gazetarëve, Avokati i Popullit rikujton në veçanti detyrimet e shtetit, që sigurinë e gazetarëve ta ketë në prioritetet të punës së tij, si bazë fundamentale e zhvillimit të demokracisë dhe jetësimit të të drejtave të njeriut në vend. Andaj shteti në këtë mënyrë, përveç të tjerash, do të përmbushte edhe detyrimet ndaj qytetarëve që të jenë të informuar, duke garantuar lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve.

Nga sa u tha më sipër, udhërrëfyesit ndërkombëtarë për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mediave gjatë pandemisë COVID-19 shpërfaqin standardet që duhet të respektohen nga shtetet sa i përket parandalimit të cenimit të lirisë së shprehjes dhe të mediave me theks të veçantë në kohë krizash. Ato japin udhëzime të qarta për veprimet që duhen të ndërmerren nga shtetet për këto të drejta të garantuara me standarde vendore dhe ndërkombëtare.

Siguria e gazetarëve

Duke qenë se një nga parakushtet specifike për lirinë e shprehjes është garantimi i sigurisë së gazetarëve nga kërcënimet dhenga sulmet ndaj tyre si dhe pengimi i ushtrimit të lirë të profesionit, andaj ky garantim përbën bazë fundamentale të zhvillimit të demokracisë dhe të jetësimit të të drejtave të njeriut në vend.

“Reporterët pa Kufij” në indeksin për vitin 2021 raportuan se gazetarët dhe mediat në Kosovë janë të ekspozuara ndaj një mjedisi armiqësor, duke përfshirë sulmet fizike dhe verbale ndaj gazetarëve, sulmet kibernetike ndaj mediave online si dhe mungesa e transparencës sa i përket pronësisë së mediave.

Avokati i Popullit e konsideron shqetësuese rritjen e numrit të kërcënimeve dhe të sulmeve ndaj gazetarëve, të cilat janë raportuar gjatë vitit 2020, dhe tërheq vëmendjen mbi domosdoshmërinë e rritjes së efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e kryerësve të veprave penale kundër gazetarëve, trajtimin me prioritet të rasteve të tilla, efikasitet dhe rezultate konkrete. Duke qenë se këto vepra kryhen me motive të pengimit të lirisë së shprehjes dhe të informimit të publikut, andaj të njëjtat duhet të cilësohen me rrethana rënduese, dhe ndaj kryerësve të zbatohen dispozitat e Kodit Penal në lidhje me ashpërsimin e dënimit.

Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit rikujton se edhe agjenda e Qeverisë së Republikës së Kosovës në procesin e anëtarësimit në BE është e lidhur ngushtë me plotësimin e standardeve për lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve. Për më tepë, Avokati i Popullit gjithashtu rikujton Rekomandimin (2016) 4 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe të tjerë aktorë të medias, në të cilin thekson rëndësinë e madhe që gazetarët të jenë në gjendje të punojnë në kushte të sigurta, pa frikë për ngacmin apo sulme ndaj tyre.

Gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, gjatë raportimit në periudhën e shfaqjes së pandemisë, në disa raste u përballën edhe me mungesë të mjeteve mbrojtëse kundër COVID-19, gjatë raportimit në përgjithësi, si dhe në veçanti gjatë raportimit nga QKUK-ja. Mungesa e mjeteve mbrojtëse nga COVID-19 i bëri ata më të ekspozuar me virusin, gjë që vuri në rrezik

shëndetin e tyre, gjithashtu të familjarëve dhe të rrethit të tyre. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se me qëllim dhe në funksion të garantimit të informimit sa më të drejtë të publikut dhe kryerjes pa pengesa të misionit të gazetarëve, u takon institucioneve të Kosovës që të krijojnë një ambient të përshtatshëm dhe të sigurt për këtë qëllim.

Vlerësimet e përgjithshme të Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave të paraqitura në këtë raport, si dhe analizimit të ligjeve relevante, sjell në vëmendje rëndësinë e lirisë së shprehjes si e drejtë themelore e njeriut dhe si shtyllë bazike e demokracisë si dhe respektimin e të drejtave të tjera të njeriut, me theks të veçantë rëndësinë dhe rolin që ka liria e shprehjes dhe e mediave edhe në situata emergjente, siç është rasti me pandeminë COVID-19, ku e drejta për informacion si dhe gazetaria e pavarur dhe profesionale u cilësua esenciale dhe jetike në luftimin e përhapjes së COVID-19.

Avokati i Popullit e konsideron pozitive sigurimin e hapësirës së konsiderueshme mediale për informimin mbi gjendjen e pandemisë, gjithashtu vlerësimin pozitiv të menaxhimit dhe luftimit të dezinformatave dhe keqinformimit nga gazetarët në kohë pandemie, megjithatë mbetet ende shqetësuese manipulimi me burime të besueshme nga disa portale për të krijuar konfuzion dhe panik te qytetarët, si dhe shpërndarja e informatave dhe e lajmeve në rrjete sociale nga ueb-faqe të paverifikuara.

Me këtë rasti Avokati i Popullit bën thirrje të rregullohet infrastruktura e duhur ligjore dhe efektive mbi përdorimin e rrjeteve sociale në vend me qëllim të luftimit të keqinformimit dhe shpërndarjes së lajmeve të paverifikuara si dhe ndërtimi i një standardi që në mënyrë të balancuar garantohet liria e shprehjes duke vendosur kufijtë e domosdoshëm për mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të tjera të njeriut.

Avokati i Popullit konstaton se pengimi i gazetarëve për qasje në informacionet publike dhe ushtrimin të lirë të profesionit, përbën shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes dhe të lirisë së mediave. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se gjendja emergjente e shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës si pasojë e pandemisë COVID-19 nuk duhet të paraqitet si pengesë në drejtim të dhënies së informacionit për media dhe për publikun.

Avokati i Popullit konstaton se kërcënimet, sulmet dhe cenimi i sigurisë së gazetarëve si dhe pengimi i ushtrimin të lirë të profesionit të tyre, përbën një nga problemet kryesore të cenimit të lirisë së shprehjes dhe të lirisë së mediave në vend.

Avokati i Popullit konstaton se zbatimi i së drejtës për qasje në dokumente publike, si një nga parakushtet për realizimin e së drejtës së lirisë së shprehjes, ende mbetet sfidë për institucionet publike në vend, duke u përkeqësuar edhe më tej që nga shfaqja e pandemisë COVID-19.

Avokati i Popullit konsideron se duhet angazhim i përgjithshëm në ofrimin e informacionit në gjuhën e përshtatshme apo në gjuhën e tyre amtare edhe për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, në lidhje me të gjitha informacionet përkatëse përkitazi me situatën e pandemisë COVID-19. Me këtë rast Avokati i Popullit rikujton udhëzimet e Zyrës së Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut për të ndaluar përhapjen e COVID-19, me ç'rast përveç të tjerash, bën thirrje: *"...informacionet të jenë të disponueshme ...lehtësisht të kuptueshme...dhe informacionet të përshtaten për njerëzit me nevoja të veçanta, duke përfshirë*

ato me dëmtime të shikimit dhe dëgjimit, dhe të arrijnë tek ata të cilët kanë pak apo aspak aftësi për të lexuar apo që nuk kanë qasje në internet.”

E drejta e privatësisë gjatë pandemisë COVID-19

Mes pasojave të shkaktuara nga masat kundër pandemisë kanë qenë edhe shkeljet e të drejtave të njeriut, të cilat shpesh janë konsideruar edhe të arsyeshme dhe të domosdoshme për të frenuar përhapjes e virusit. Një nga këto të drejta të ndikuara nga masat antiCOVID-19 ka qenë edhe e drejta në privatësi, e cila në Kosovë e gëzon statusin e së drejtës kushtetuese. Ndryshimet radikale në praktikën e aktiviteteve komerciale, qeverisjen korporative dhe organizimin e ngjarjeve përmes platformave online kanë shtuar edhe rrezikun për të drejtën e privatësisë. Kosova, përkundër qasjes më të kufizuar në integrimin global, nuk ka qenë përjashtim nga ndryshimet rrënjësore të shpejta që e kanë karakterizuar botën që nga fillimi i pandemisë.

Për ta parandaluar dhe minimizuar shkeljen e privatësisë, BE-ja e kishte miratuar Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (e njohur si: Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave/GDPR),²³³ përmes së cilës ishte revolucionarizuar mbrojtja e të dhënave. Kjo rregullore është materializuar në Kosovë përmes Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.²³⁴ Sidoqoftë, zbatimi i këtij ligji ka mbetur sfidë për shkak të mungesës së gjatë të Komisionarit të Agjencisë për Privatësi dhe Informim.

Sfidë paraqet edhe mosnxjerrja e akteve që parashohin masa mbrojtëse për mbledhjen, përpunimin, transferimin dhe shkatërrimin e të dhënave, e që në këtë kontekst pandemia ka ndikuar në përkeqësimin e situatës, për shkak të publikimit të të dhënave personale të pacientëve të diagnostikuar dhe subvencionimit të pacientëve që kanë qenë të diagnostikuar me virusin.

Shkelja e privatësisë ka qenë dhe vazhdon të mbetet brengë për secilën shoqëri. Prej se kishte filluar pandemia, më datën 30 mars 2020, Kryesuesja e Komitetit të Konventës 108²³⁵ dhe Komisionari për Mbrojtjen e të Dhënave i Këshillit të Evropës e kishin lëshuar Deklaratën e Përbashkët për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave në kontekst të pandemisë COVID-19. Në këtë deklaratë, mes të tjerash, theksohet: *“Është e rëndësishme të kujtojmë se mbrojtja e të dhënave nuk mund të jetë në asnjë mënyrë pengesë për të shpëtuar jetë dhe se parimet e zbatueshme lejojnë gjithmonë një ekuilibrim të interesave në fjalë.”* Për më tepër, në këtë deklaratë theksohet: *“Në përputhje me Konventën 108+ është thelbësore që edhe në situata veçanërisht të vështira, parimet e mbrojtjes së të dhënave të respektohen dhe për këtë arsye sigurohet që subjekteve të të dhënave të u bëhet me dije për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me to; përpunimi i të dhënave personale kryhet vetëm nëse është e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin e qartë, të specifikuar dhe legjitim të ndjekur; kryhet një vlerësim i ndikimit para se të fillojë përpunimi; sigurohet privatësia sipas modelit dhe miratohen masat e duhura për të mbrojtur sigurinë e të dhënave, veçanërisht kur lidhen me kategori të veçanta*

²³³ Bashkimi Evropian, “Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave/GDPR”, (linku:<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32016R0679&from=EN>)

²³⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

²³⁵ Teksti i Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, i datës 28.1.1982, i qasshëm në linkun vijues <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/0900001680078b37>

të të dhënave siç janë të dhënat e lidhura me shëndetin; subjektet e të dhënave kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre.”

Për më shumë, Këshilli i Evropës, në Dokumentin Informativ SG/Inf(2020) 11, i datës 7 prill 2020: *“Respektimi i Demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare COVID-19”*, u ofron qeverive një paketë për trajtimin e krizës aktuale sanitare të paprecedent dhe masive në mënyrë të tillë që t’i respektojnë vlerat themelore të demokracisë, shtetit e së drejtës dhe të drejtat e njeriut²³⁶. Në këtë dokument, pos të tjerash, trajtohen edhe e drejta e jetës private, liria e ndërgjegjes, liria e shprehjes, liria e organizimit. Për të drejtën e jetës private dhe për këto liri, theksohet: *“Ushtrimi efikas i të gjitha këtyre të drejtave dhe lirive të garantuara nga Nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Konventës përbën një standard bazë të shoqërive moderne demokratike. Kufizimi i tyre është i lejueshëm vetëm nëse vendoset me ligj dhe nëse është në raport të drejtë me qëllimin legjitim për të cilin është vendosur ky kufizim, duke përfshirë edhe mbrojtjen e shëndetit. Kufizimet e konsiderueshme të aktiviteteve të zakonshme sociale, duke përfshirë qasjen në vendet publike të adhurimit, organizimet publike dhe ceremonitë e martesave apo funeraleve, mund të çojnë në mënyrë të pashmangshme në ankesa të argumentuara në kuadrin e parashikimeve të mësipërme. U takon autoriteteve të marrin masat që çdo kufizim i tillë, qoftë i bazuar në derogim apo jo, të jetë i përcaktuar qartë me ligj, në përputhje me garancitë relevante kushtetuese dhe në raport të drejtë me qëllimin për të cilin është marrë.”*²³⁷

Këshilli i Evropës i ka të qasshme edhe burimet për mbrojtjen e të dhënave nga COVID-19, ku përfshihen instrumentet relevante si dhe dokumente të tjera që ndërlidhen për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë periudhës së pandemisë.²³⁸

Përpos Këshillit të Evropës, dokumente përkatëse për të drejtat e njeriut gjatë pandemisë janë lëshuar edhe nga Kombet e Bashkuara si dhe nga Zyra e Komisionarit të Lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, e cila e kishte publikuar Udhëzuesin për COVID-19. Në mesin e çështjeve që përfshihen në këto udhëzime është edhe privatësia. Udhëzimi për privatësinë i Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara thekson: *“Monitorimi i shëndetit përfshin një sërë mjetesh që gjurmojnë dhe monitorojnë sjelljen dhe lëvizjet e individëve. Vëzhgimi dhe monitorimi i tillë duhet veçanërisht të lidhet me qëllimet specifike të shëndetit publik dhe të shfrytëzohet për ato, dhe duhet të kufizohen në kohëzgjatje dhe fushëveprim sipas kërkesës në situatën e caktuar. Duhet zbatuar masa mbrojtëse të ashpra për të siguruar që masat e tilla nuk keqpërdoren nga qeveritë apo kompanitë në grumbullimin e informacioneve private konfidenciale për qëllime që nuk ndërlidhen me krizën e shëndetit publik.”*²³⁹

Në këtë kontekst rëndësi të veçantë ka pasur edhe dokumenti i Kombeve të Bashkuara “COVID-19 dhe të Drejtat e Njeriut”, i cili ishte publikuar qysh në fillimet e shpërthimit të pandemisë, përkatësisht në prill të vitit 2020. Në këtë dokument trajtohen një mori të drejtash

²³⁶ Këshilli i Evropës, *“Dokumenti Informativ SG/Inf(2020)1”*, i datës 7 prill 2020, faqe 1, (linku: <https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/16809e1d91>)

²³⁷ Po aty, faqe 6.

²³⁸ Këshilli i Evropës, *“COVID-19 dhe Mbrojtja e të Dhënave”*, (linku: <https://www.coe.int/en/web/data-protection/covid-19-data-protection-resources>)

²³⁹ Zyra e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara, *“Udhëzuesi për COVID-19”*, 13 maj, 2020, faqe 6, (linku: https://www.ohchr.org/Documents/Events/COVID-19_Guidance.pdf)

dhe lirish, ndërsa jepen edhe rekomandimet përkitazi me to. Një nga këto rekomandime ka të bëjë me privatësinë dhe me mbrojtjen e të dhënave dhe rekomandohet: *“Të sigurohet që të ekzistojnë masa mbrojtëse ku teknologjitë e reja përdoren për mbikëqyrje në përgjigje ndaj COVID-19, duke përfshirë kufizimet e qëllimit dhe mbrojtjen e duhur të privatësisë dhe të dhënave.”*²⁴⁰

Nga masat kundër luftimit të pandemisë, të cilat janë ndërmarrë nga shumica e shteteve në botë dhe Evropë, shumë të drejta dhe liri potencialisht janë shkelur, përfshirë edhe të drejtën e privatësisë. Megjithatë, nga dokumentet e mësipërme, shteteve u rekomandohet dhe udhëzohen që shkeljet potenciale të jenë në përputhje me qëllimin për ta mbrojtur një të mirë publike, pra shëndetin publik dhe të mos tejkalojnë masat qëllimin për të cilin janë ndërmarrë ato, përfshirë moscenimin e së drejtës për privatësi, për të cilën ekziston konventë e veçantë e Këshillit të Evropës.

Zhvillimet gjatë kësaj periudhe sa i përket së drejtës së privatësisë

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit më 17 maj 2021 realizuan takim pune me udhëheqësin e Departamentit Ligjor në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), me të cilin diskutuan për mbrojtjen e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjatë pandemisë COVID-19. Ai informoi se që nga shfaqja e pandemisë COVID-19, AIP-ja nuk e ka marrë asnjë ankesë në lidhje me publikimin, përpunimin apo menaxhimin e të dhënave personale, gjithashtu pohoi se raste të tilla nuk i janë adresuar as gjykatës. Ai deklaroi se lidhur me ndikimin dhe pasojat e përpunimit të të dhënave personale në kushte pandemie, IKShPK-ja është konsultuar me AIP-në për menaxhimin e mbrojtjes së të dhënave personale, e cila në mënyrë të sintetizuar ia ka paraqitur disa orientime në drejtim të drejtë dhe të arsyeshëm të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave për parandalimin dhe menaxhimin e COVID-19. Sipas tij, deri më tani asnjë institucion nuk ka nxjerrë akt të brendshëm, siç është i detyruar sipas ligjit, për të menaxhuar përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave (përfshirë transferimin e të dhënave si dhe procedurën e shkatërrimit të të dhënave të marra pasi qëllimi për mbledhjen e tyre pushon së ekzistuari). Ai pohoi se AIP-ja ka lëshuar një Opinion Ligjor siç kërkohej nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera shëndetësore në lidhje me përpunimin e të dhënave, nëpërmjet të cilit të gjitha detajet ishin shpjeguar siç parashikohet me ligj. Sipas tij, rasti më serioz ndodhi me rastin e liritimit nga detyrimi për t'u vënë në karantinë 4 persona për shkak të problemeve të shëndetit mendor, emrat e të cilëve janë vënë në një vendim të vetëm, që do të duhej të ishin siguruar vendimet individuale të tyre për të mbrojtur të dhënat personale të secilit.

Avokati i Popullit ka gjetur se më 28 tetor 2020, portali informativ “KosovaLive” ka publikuar artikullin me titull: *“Kosova dështon për mbrojtjen e identitetit të testuarve me COVID-19”*²⁴¹, nëpërmjet të cilit shpalo disa raste kur media të ndryshme, që nga paraqitja e rasteve të para me COVID-19, kanë publikuar lista me emrat e personave që i janë nënshtruar testimi për

²⁴⁰ Kombet e Bashkuara, *“COVID-19 dhe të drejtat e njeriut: Jemi të gjithë sëbashku”*, i prillit 2020, (linku: https://www.un.org/victimsofterrorism/sites/www.un.org.victimsofterrorism/files/un_-_human_rights_and_covid_april_2020.pdf)

²⁴¹ Kosovalive, *“Kosova dështon për mbrojtjen e identitetit të testuarve me COVID-19”*, tetor 2020, (linku: <https://kosovalive.org/2020/10/28/kosova-desh-ton-per-mbrojtjen-e-identitetit-te-testuarve-me-covid-19/>)

COVID-19, si dhe kanë publikuar edhe identitetin e personave që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.

Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykim në rastin KO 54/20, theksoi se edhe pse përveç Avokatit të Popullit, asnjëra nga palët nuk e ka kanë përmendur faktin që Vendimi i kontestuar “ndërhyn” edhe në të drejtën e privatësisë të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se një ndërhyrje e tillë ka ndodhur edhe për sa i takon kësaj të drejte.²⁴² Sipas Gjykate Kushtetuese, kufizimi i kësaj të drejte në fjalë është bërë nga Qeveria në pikën 4 të vendimit të kontestuar, ku specifikisht thuhej se ndalohen tubimet në të gjitha mjediset “private”, qofshin ato “të hapura dhe të mbyllura”, përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyra të punës për “parandalim dhe luftimin të pandemisë” si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët.²⁴³ Më tej gjykata theksoi: “...Një lexim literal i këtij kufizimi nënkupton që Qeveria, përmes Vendimit të kontestuar ka ndaluar të gjitha tubimet në mjediset private, respektivisht edhe në familje dhe shtëpi ose banesa private të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përveç nëse ato tubime në mjediset private janë të domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalimin dhe luftimin e pandemisë...” Sipas këtij aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese theksoi se një kufizim i tillë nuk është i paraparë me ligjet e Kuvendit të cilat Qeveria i ka cituar në vendimin e kontestuar si bazë për ta nxjerrë atë, sepse askund në ato dispozita ligjore nuk përmenden kufizimet që mund të bëhen në “mjediset private”.²⁴⁴ Duke qenë se rrethanat e krijuara nga pandemia kishin krijuar një realitet të ri edhe në rrafshin legjislativ, me dy ligjet e reja të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për luftimin dhe parandalimin e pandemisë, vërehet se tanimë është krijuar baza ligjore duke autorizuar MSh-në për kufizimin e së drejtës kushtetuese të privatësisë, në kuadër të masave të ndërmarra për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19.

Bazuar në paragrafin 4 të nenit 36 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e secilit person të gëzojë të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë së individit. Përmes këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Ky ligj përcakton që AIP-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe përkufizon të drejtën në kompensim të çdo personi, i cili ka pësuar dëm material ose jomaterial, si rezultat i një shkeljeje të këtij ligji nga kontrolluesi ose përpunuesi i të dhënave personale.

Duke marrë shkas se nga situata e paprecedent e krijuar në nivel nacional dhe ndërkombëtar, si rezultat i shpërthimit të pandemisë COVID-19, janë krijuar të nevojshme orientime dhe udhëzime shtesë në drejtim të interpretimit të drejtë dhe të arsyeshëm të anës legjislative në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të trajtimit shëndetësor si dhe masave për parandalimin dhe kontrollimin nga përhapja e mëtejshme të COVID-19. Në këtë drejtim AIP-ja ka njoftuar se bazuar në legjislacionin relevant u ka ofruar këshilla dhe udhëzime MSh-së dhe IKShPK-së për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë ushtrimit të mandatit dhe të

²⁴² Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykim nr. KO 54/20, 6 prill 2020.

²⁴³ Po aty, paragrafi 266.

²⁴⁴ Po aty, paragrafi 267.

përgjegjësi të tyre përkitazi me procedurat përkatëse për trajtimin e rasteve me COVID-19, megjithatë këto udhëzime nuk janë bërë publike.

Duke qenë se gjatë vitit 2020 dhe deri në qershor të vitit 2021, AIP-ja ka funksionuar në mungesë të komisionarit, mungesa e komisionarit gjatë periudhës së lartcekur përveçse ka paraqitur pengesa në realizimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, ajo gjithashtu ka ndikuar edhe në mosnxjerrjen e akteve nënligjore për organizimin e brendshëm të AIP-së, akte këto të domosdoshme për funksionimin e AIP-së, që sipas të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duhet të nxirren 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Përveç AIP-së, Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale obligon të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave²⁴⁵ të kujdesen që të dhënat të mbrohen dhe përpunohen sipas mënyrës së përcaktuar me këtë ligj dhe gjithashtu të njëjtët obligohen të përshkruajnë, në aktet e tyre të brendshme, procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale. Ky obligim ligjor garantohet me nenin 40 të këtij ligji [Obligimi për nxjerrjen e akteve të brendshme], i cili shprehimisht përcakton si në vijim:

“1. Kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave duhet të kujdesen, në çdo kohë, që të dhënat të mbrohen dhe përpunohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj. 2. Kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave duhet të përshkruajnë, në aktet e tyre të brendshme, procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale dhe duhet të emërojnë, në formë të shkruar, personat kompetentë që janë përgjegjës për të zbatuar rregullat sipas këtij ligji.”

Në këtë drejtim AIP-ja ka njoftuar se për atë aq sa është në dijeni, asnjë institucion publik në Republikën e Kosovës nuk i ka përcaktuar në aktet e veta të brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale, në përjashtim të asaj që disa institucione kanë emëruar personat kompetentë që janë përgjegjës për të zbatuar rregullat sipas ligjit relevant.

Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e rregullimit të akteve nënligjore për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, përveçse vazhdon të paraqesë sfida në zbatimin efektiv të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e njëjta ka thelluar ndikimin negativ sa i përket zbatimit efektiv të këtij ligji në situatën aktuale pandemike, posaçërisht në kuadër të zbatimit të masave për parandalimin dhe kontrollimin nga përhapja e mëtejshme e COVID-19. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e vlerëson të domosdoshme që AIP-ja, për të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, të nxjerrë udhëzues për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19. Një udhëzues i tillë do të ishte i domosdoshëm, posaçërisht për sektorët, si: punësimi, telekomunikacioni, shëndetësia dhe arsimiti.

²⁴⁵ Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në nenin 3, paragrafi 1.2, përcakton: “Përpunim - çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi.” Në paragrafin 1.11. përcakton: “Kontrollues i të dhënave - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.” Ndërsa në paragrafin 1.14. përcakton: “Përpunues i të dhënave - çdo person fizik ose juridik, nga sektori publik ose privat, i cili përpunon të dhëna personale për dhe në emër të kontrolluesit të të dhënave.”

Sa u përket gjetjeve të IAP-së në lidhje me publikimin e të dhënave personale nga media të ndryshme të shkruara, për personat që i janë nënshtruar testimit për COVID-19, si dhe për zbulimin e identitetit të personave që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19, Avokati i Popullit rithekson se lëshime të tilla nga ana e mediave janë të papranueshme, duke qenë se si të tilla janë në kundërshtim me nenin 36 Kushtetutës, me nenin 8 të KEDNj-së, me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe me Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës. Avokati i Popullit rikujton rekomandimet e Këshillit të Mediave të Shkuara të Kosovës për mënyrën e raportimit në lidhje me COVID-19, ku ndër të tjera u rekomandohet të gjitha mediave dhe transmetuesve të shtypur dhe online, si vë vijim: *“Gazetarët gjatë raportimit të tyre duhet të synojnë të mos cenojnë dhe ndërhyjnë në privatësinë e personave për të cilët raportojmë. Duke tentuar mbulimin sa më të detajuar të rasteve, gazetarët nuk guxojnë të ekspozojnë informacion të detajuar shëndetësor në lidhje me personat për të cilët raportojmë, me përjashtim të rasteve kur ata vetë ekspozojnë informacionin e detajuar mjekësor dhe rastet për të cilat ka interes publik për t’u informuar duke pasur parasysh edhe profilin publik të personit.”*

Për më tepër rikujtojmë se më 4 prill 2020 Avokati i Popullit, nëpërmjet një komunikate publike, ka reaguar duke e konsideruar shqetësues publikimin e disa lajmeve nga portale që kanë publikuar lista me tabela që përmbanin të dhëna personale për personat të cilët ishin obliguar të izoloreshin në karantinë për parandalimin e COVID-19. Avokati i Popullit theksoi se publikimet e tilla bien në kundërshtim me instrumentet vendore dhe ndërkombëtare si dhe me rregulloret që i dedikohen vërtetë të mediave. Me këtë rast Avokati i Popullit u ka bërë thirrje mediave t’i mbronin në përpikëri të dhënat personale të personave në vetizolim, në karantinë, të diagnostikuar me COVID-19, dhe të hospitalizuar, përveç kur ato jepen me pëlqimin e personit.

Vlerësimet e përgjithshme të Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave të paraqitura në këtë raport, si dhe analizimit të ligjeve relevante, sjell në vëmendje rëndësinë e mbrojtjes, respektimit dhe përmbushjes të së drejtës së privatësisë, si e drejtë themelore e njeriut e garantuar me instrumentet vendore dhe ndërkombëtare.

Avokati i Popullit e konsideron si hap me rëndësi nxjerrjen e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, përfshirë bazën ligjore për kufizimin e arsyeshëm të së drejtës kushtetuese të privatësisë.

Njëkohësisht, Avokati i Popullit e konsideron se është e domosdoshme që Qeveria e Republikës së Kosovës, përveç zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet me karakter të brendshëm, të respektojë edhe zbatimin e udhërrëfyesve ndërkombëtarë për mbrojtjen e së drejtës së privatësisë gjatë pandemisë COVID-19, të cilat shpërfaqin standardet që duhet të respektohen nga shtetet sa i përket parandalimit të cenimit të kësaj të drejte.

Po ashtu, Avokati i Popullit e konsideron tejet shqetësues çdo publikim të të dhënave personale, pa pëlqimin dhe dijeninë e personit relevant, duke qenë se një veprim i tillë përbën shkelje të

të drejtave të njeriut, në rastin konkret shkelje të së drejtë së privatësisë, e cila është e garantuar me instrumente vendore dhe ndërkombëtare.

Avokati i Popullit konsideron se sipas detyrimit ligjor (Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), secili kontrollues dhe përpunues i të dhënave duhet të veprojë me kujdes që të dhënat të mbrohen dhe të përpunohen sipas mënyrës së përcaktuar me këtë ligj dhe gjithashtu të njëjtët obligohen të përshkruajnë në aktet e tyre të brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale.

Së fundmi, Avokati i Popullit e konsideron relevante për situatën aktuale me pandemi, publikimin e një udhëzuesi për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19, i cili vlerësohet i domosdoshëm posaçërisht për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID19, për sektorët, si: punësimi, telekomunikacioni, shëndetësia dhe arsimi.

Të drejtat zgjedhore në periudhën e pandemisë COVID-19

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ka pasur refleksione në të gjitha sferat e jetës duke përfshirë edhe të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes. Avokati i Popullit ka ndjekur me kujdes të veçantë procesin e zgjedhjeve të parakohshme qendrore të mbajtura më 14 shkurt 2021. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka ndërmarrë veprime të caktuara para procesit zgjedhor, e po ashtu ka mbikëqyrur këtë proces zgjedhor.

Më 13 janar 2021, Avokati i Popullit ka publikuar deklaratë nëpërmjet së cilës u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe partive politike që ta kenë parasysh situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, dhe gjatë aktiviteteve që ndërlidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që priteshin të mbaheshin më 14 shkurt 2021, t'i respektonin në mënyrë rigorozë rekomandimet e IKShPK-së dhe masat e vendosura nga Qeveria dhe nga Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e pandemisë COVID-19.

Më 8 shkurt 2021, Avokati i Popullit ka publikuar deklaratën e dytë përmes së cilës ka shfaqur shqetësimin e tij lidhur me zbatimin selektiv të masave të Qeverisë për parandalimin e pandemisë COVID-19, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme 2021. Avokati i Popullit ka vërejtur se që nga fillimi i fushatës parazgjedhore nuk janë respektuar masat antiCOVID nga partitë politike, ndërsa në anën tjetër institucionet që kanë për obligim t'i zbatojnë këto masa nuk kanë reaguar. Këto veprime Avokati i Popullit i ka konsideruar si standarde të dyfishta që nuk mund të tolerohen dhe cenojnë barazinë e qytetarëve para ligjit. Përveç kësaj, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij për rrezikimin e jetëve të qytetarëve për shkak të mosrespektimit të masave.

Avokati i Popullit ua ka rikujtuar obligimin që kanë të gjitha institucionet dhe partitë politike për respektimin e masave për parandalimin e pandemisë, ndërsa ka ftuar autoritetet kompetente që të ndërmerrin veprime konkrete për respektimin e këtyre masave nga subjektet politike. Në periudhën parazgjedhore, Avokati i Popullit ka pranuar shumë ankesa nga qytetarët, përfshirë verifikimin e aplikacioneve jashtë vendit, vështirësitë për shkarkim të formularëve të fletëvotimeve nga ueb-faqja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), mospërfshirja në listën e votuesve e qytetarëve me të drejtë vote, si dhe mospranimi përmes e-mailit të ankesave

nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP). Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit i ka udhëzuar palët që për rastet e tilla t'i drejtohen PZAP-së.

Duke e ditur rëndësinë e madhe që kanë zgjedhjet e përgjithshme për vendin, Avokati i Popullit ka vëzhguar për së afërmi zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14 shkurt 2021, gjithmonë duke pasur parasysh se e drejta për të votuar është thelbësore për demokracinë e bazuar në vullnetin e popullit. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit përmes përfaqësuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit ka monitoruar procesin zgjedhor në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Nga ajo që është raportuar nga terreni, Avokati i Popullit konsideron se në tërësinë e vet, procesi zgjedhor është zhvilluar në një atmosferë të sigurt, i qetë, i lirë e demokratik. Pjekuria e qytetarëve në një rënë anë, angazhimi maksimal të cilin KQZ-ja e ka treguar në tërësinë e vet në përgatitjet dhe në organizimin e këtyre zgjedhjeve, kanë shënuar moment jashtëzakonisht të rëndësishëm për respektimin e vullnetit të lirë të qytetarëve dhe nivelin e demokracisë në vend. Prandaj nga perspektiva e respektimit dhe e ushtrimit të kësaj të drejte politike, Avokati i Popullit shpreh konsideratën dhe vlerësimin e tij maksimal. Po ashtu Avokati i Popullit vlerëson Policinë e Kosovës për mbështetjen profesionale që ka ofruar përgjatë gjithë ditës së zgjedhjeve nëpër të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke garantuar siguri dhe mbarëvajtjen e procesit elektoral.

Gjithsesi, duke e pasur parasysh vështirësinë që ka një proces zgjedhor, ka pasur segmente specifike nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut që kanë tërhequr vëmendjen e vëzhguesve të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit vlerëson se realizimi i zgjedhjeve në situatë pandemie ka imponuar kërkesa specifike përkitazi me masat antiCOVID. Mundësitë e zbatimit të distancës ndërmjet votuesve nuk kanë ekzistuar në secilën qendër votimi, në radhë të parë, por as ndërmjet administruesve të procesit. Ky problem është shfaqur veçmas në qendra të mëdha votimi (kryesisht në qytete), ku fluksi i votuesve ka qenë më i madh. Megjithatë ka pasur respektim sa i përket bartjes së maskave dhe përdorimit të dezinfektuesve.

Në anën tjetër, shumica e shkollave që shërbenin si qendra votimi nuk ofronin kushte të përshtatshme infrastrukturore (mungesa e pjerrinave, ashensorëve etj.) për personat me aftësi të kufizuara në të ecur dhe për personat e moshës së tretë. Në të shumtën e herëve, vendvotimet ishin në katet e dyta apo në të treta dhe kjo ka paraqitur vështirësi në realizimin e së drejtës së tyre për të votuar. Ndërkaq, pothuajse të gjitha qendrat e votimit kanë qenë të pajisura me fletëvotime me alfabet të Brajlit, për rastet kur votuesit mund të ishin persona të verbër.

Po ashtu, bazuar në mandatin specifik që ka Avokati i Popullit, ka monitoruar për së afërmi institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria, si: qendrat e paraburgimit, qendrat korrektuese dhe Burgun e Sigurisë së Lartë. Vëzhguesit e IAP-së gjatë monitorimit kanë vërejtur se për shkak të bartjeve që kanë ndodhur me të (para)burgosurit, pasi janë dërguar të dhënat përkitazi me ata që kanë të drejtë vote, ka pasur raste kur persona të privuar nga liria nuk kanë pasur mundësi të votonin, sepse emri i tyre nuk ka qenë në listat e ekipit mobil, ndërkaq nuk janë verifikuar aty për aty edhe me listën e përgjithshme të votuesve.

Po ashtu, nën monitorimin e vëzhguesve nga IAP-ja ishin edhe shtëpitë për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, shtëpitë integruese në bashkësi, Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë (QIRSKP) dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK). Në këto institucione, administrimi i votimit është bërë nga

ekipet mobile të KQZ-së. Në fund Avokati i Popullit vlerëson se procesi zgjedhor i mbajtur më 14 shkurt 2021 ka pasur ecuri normale dhe nuk është identifikuar ndonjë pengesë serioze e cila do të reflektohej në cenimin e së drejtës zgjedhore ose të pjesëmarrjes. Pra, përveç disa problemeve të natyrës teknike, në përgjithësi procesi zgjedhor mund të konsiderohet si i rregullt dhe i suksesshëm.

XIII. Të drejtat e fëmijëve, ndikimi i emergjencës shëndetësore në jetën e fëmijëve, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar, dhe vështirësitë e hasura gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë

Pandemia COVID 19 dhe masat për parandalim kanë pasur ndikim direkt në jetën dhe në të drejtat e fëmijëve. Ndikimi më i madh është vërejtur tek fëmijët me aftësi të kufizuar dhe te grupet e cenueshme të fëmijëve në aspektin etnik, socio-ekonomik dhe kulturor.

Bazuar në gjendjen e krijuar, Avokati i Popullit ka hapur hetimet ex-officio në lidhje me ndikimin e COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës. Në kuadër të këtij hetimi natyrisht që janë përfshirë edhe të drejtat e fëmijës, për të kuptuar se si ka ndikuar emergjenca shëndetësore në jetën e fëmijëve, me theks të veçantë fëmijët me aftësi të kufizuar dhe vështirësitë e hasura gjatë pandemisë. Ndonëse aktualisht është vështirë për të vlerësuar saktë nivelin dhe vëllimin e këtij ndikimi në të drejtat e fëmijës, ky hetim dhe raport është një veprim i duhur në këtë drejtim. Përpos analizës së ndikimit të pandemisë, ky kapitull gjithashtu analizon edhe nëse masat dhe vendimet e ndërmarra gjatë pandemisë janë në proporcion me kufizimin e të drejtave dhe të lirive themelore të fëmijës.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve

Siç është thënë në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2020, të drejtat e fëmijëve janë pjesë e integruar e të drejtave të njeriut. Pra, fëmijët dhe të rinjtë kanë të njëjtat të drejta të përgjithshme njerëzore si të rriturit dhe gjithashtu të drejta specifike që u përshtaten nevojave të tyre të veçanta si fëmijë. Fëmijët konsiderohen si bartës të të drejtave dhe pjesëmarrës aktiv në realizimin e tyre, andaj edhe realizimi i këtyre të drejtave u mundëson fëmijëve që të zhvillojnë dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë, duke ua njohur dinjitetin themelor njerëzor dhe urgjencën për të siguruar mirëqenien e tyre. Pa dyshim, jeta, shëndeti, edukimi dhe mbrojtja e fëmijës janë themele mbi të cilat varet edhe e ardhmja e shoqërisë dhe e shtetit tonë. Duke qenë se fëmijët janë të varur nga trajtimi dhe mbikëqyrja e prindërve apo e kujdestarëve, çdo ndryshim që prek këta të fundit ndikon në të njëjtën kohë edhe tek fëmijët. Andaj veprimet ose mosveprimet e prindërve, të komunitetit dhe të institucioneve mund të ndikojnë tek fëmijët më shumë se tek çdo grup tjetër shoqëror. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që këto veprime ta kenë parasysh interesin më të mirë të fëmijës gjatë hartimit të politikave dhe të legjislacionit.

Në Kosovë rreth 40% e popullatës është nën moshën 25 vjeçe, ndërsa rreth 30% janë fëmijë nën moshën 18 vjeçe.²⁴⁶ Duke parë rëndësinë e të rinjëve dhe të fëmijëve në të ardhmen e Kosovës, si dhe nevojën për të përcaktuar dhe mbrojtur interesin e tyre, shteti i Kosovës është

²⁴⁶ Agjencioni i Statistikave të Kosovës: Regjistrimi i fundit i popullsisë dhe i ekonomive familjare 2011.

përkujdesur që ta rregullojë këtë çështje në aspektin politik dhe juridik, duke përfshirë të drejtat e fëmijëve në nivel të Kushtetutës dhe nxjerrjen e ligjeve të tjera përkatëse.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e të drejtave të fëmijëve, zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë. Në rast konflikti, dispozitat e KDF-së kanë prioritet ndaj legjislacionit vendor²⁴⁷. Po ashtu, Kushtetuta ka paraparë një nen të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe kujdesin e domosdoshëm për mirëqenien e tyre. Për më tepër, të gjitha veprimet e ndërmarra nga institucionet private dhe publike duhet të kenë parasysh interesin më të mirë të fëmijëve.²⁴⁸ Ky parim përbën edhe një nga parimet kryesore të përcaktuara edhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF). LMF-ja është ligji i parë në Kosovë i cili adreson specifikisht të drejtat e fëmijëve dhe ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2020²⁴⁹, disa muaj pas fillimit të pandemisë. Si i tillë, ky ligj është një ndër ligjet më të rëndësishme për të drejtat e fëmijëve dhe përbën shtyllën kryesore ligjore në Kosovë. Gjithsesi, ekzistojnë edhe ligje të tjera në fuqi në Kosovë, të cilat po ashtu rregullojnë aspektet e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre që ndërlidhen me të drejtat për: jetë, mbijetesë dhe zhvillim, arsimim dhe edukim, shëndetësi, mirëqenie sociale, dhe mbrojtjen.

Situata e krijuar me COVID-19 si asnjë herë më parë ka prekur dhe ka ndikuar në realizimin apo mosrealizimin e drejtave të fëmijëve të garantuara nga Kushtetuta, nga konventat, nga instrumentet ndërkombëtare dhe nga legjislacioni në fuqi. IAP-ja edhe më herët ka vënë në pah se pandemia ka thëlluar pabarazitë ekzistuese në Kosovë dhe ka përkeqësuar mangësitë shoqërore dhe institucionale për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Pandemia si dhe masat e ndërmarra për menaxhimin dhe parandalimin e saj kanë pasur efekte socio-ekonomike dhe rrjedhimsht kanë ndikuar në mirëqenien e fëmijëve, në shëndetin e tyre, në sigurinë dhe në arsimin. IAP-ja ka theksuar se këto efekte socio-ekonomike potencialisht mund të ndikojnë edhe në rrezikun nga varfëria. Përgjatë çdo analize IAP-ja i kushton rëndësi të veçantë faktorëve të ndryshëm të cilët ndërveprojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve, siç janë: gjinia, etniteti, dhe/apo aftësia e kufizuar. Në një shembull konkret, gjatë pandemisë IAP-ja ka vërejtur se në kalimin nga mësimi në shkolla në mësimin online, shumë fëmijë nuk kishin qasje në pajisje teknologjike dhe në internet. Mirëpo, veçanërisht fëmijët ashkalinj, romë, e egjiptianë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara ishin të prekur nga ky proces. Për më tepër, mësimi dhe qasja ishte më e vështirë për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku në fillim të pandemisë nuk kishte planprograme online të përshtatshme për nevojat e tyre.²⁵⁰

Në nivel global, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, si autoritet interpretues i KDF-së, dhe njëherësh një ndër trupat më me ndikim në këtë fushë, qysh në fillim paralajmëroi shtetet palë për efektet serioze fizike, emocionale dhe psikologjike tek fëmijët të shkaktuar nga pandemia COVID-19 si dhe u bëri thirrje shteteve palë të ndërmerrnin masa për të mbrojtur të drejtat e fëmijës.²⁵¹ Komiteti në këtë deklaratë më 11 rekomandime, përveç të tjerash, shpreh edhe shqetësimin e tij rreth situatës së fëmijëve në nivel global, veçanërisht për fëmijët që janë në

²⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

²⁴⁸ Po aty, neni 50.

²⁴⁹ Republika e Kosovës, Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 66.

²⁵⁰ IAP, Raporti vjetor 2020, fq. 55.

²⁵¹ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve paralajmëron për efektin e rëndë fizik, emocional dhe psikologjik të pandemisë COVID-19 te fëmijët dhe u bën thirrje shteteve që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve, Deklaratë më 20 prill 2020.

situata të cenueshme, për shkak të pandemisë si dhe vendimeve të qeverive për të shpallur gjendjen e emergjencës dhe mbylljes së obliguar.

Nga analiza e vendimeve të Qeverisë dhe vetë nxjerrja e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, përkundër qëllimit pozitiv dhe neneve specifike që përcaktojnë veprimet e institucioneve shtetërore për parandalimin dhe luftimin e pandemisë, vërehet që mungon referenca dhe udhëzimi i saktë, ose nuk është marrë në konsideratë në aspektin e duhur interesi më i mirë i fëmijës përgjatë hartimit të vendimeve apo përcaktimit të dispozitave ligjore.

Si rrjedhojë e këtyre dispozitave edhe vendimet pasuese që janë bazuar në këtë ligj, kanë pasur ndikim në realizimin të drejtave të fëmijës në përgjithësi, e me theks të veçantë të fëmijëve në nevojë dhe të atyre me aftësi të kufizuar, që ndërlidhen me mbylljen e plotë për periudha të caktuara, kufizimin e lirisë së lëvizjes, kufizimet në vijimin e rregullt të shkollës dhe mbylljen e shkollave, pezullimin e shërbimeve bazike shëndetësore, të shërbimeve sociale, dhe të shërbimeve minimale për mbrojtje. Ndikimi i këtyre masave ka krijuar pasoja shumë dimensionale të cilat do të jenë prezente për një kohë të gjatë, varësisht nga shkalla e cenimit të të drejtave dhe reagimit institucional dhe shoqëror për t'i eliminuar apo minimizuar këto pasoja.

Fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilët edhe para pandemisë kanë qenë të cenueshëm dhe me shumë pengesa në kuptimin e realizimit të të drejtave të tyre, pandemia ua ka vështirësuar dhe pamundësuar edhe më tepër ato pak mundësi dhe të drejta që i gëzonin. Fëmijët me aftësi të kufizuar, për shkak të nevojave specifike si dhe mosrealizimit të shërbimeve të caktuara, janë vënë para vështirësive dhe rreziqeve për abuzim, keqtrajtim, rritje të stigmës, rrezikimin e shëndetit dhe jetës, thellimit të dallimeve sociale për shkak të varfërisë si dhe vështirësisë për rehabilitimin dhe aftësimin për jetë.

Pavarësisht ndikimit që mund të ketë patur një veprim apo mosveprim i autoriteteve dhe i institucioneve karshi një të drejte apo një grupi të të drejtave të caktuara të fëmijës, si dhe shkeljes apo cenimit të supozuar të asaj të drejte, autoritetet dhe institucionet përgjegjëse, ndikimin e pandemisë duhet kuptuar dhe trajtuar nga qasja gjithëpërfshirëse, kjo për faktin që të drejtat e fëmijës janë të drejta të pandara dhe të ndërlidhura, shkelja apo cenimi i një të drejte ka ndikim dhe ndërlidhet me realizimin e një apo shumë të të drejtave tjera.

Duke marrë parasysh faktin që të drejtat e fëmijës janë shkelur apo cenuar, autoritetet dhe institucionet përgjegjëse duhet pa vonesa të planifikojnë dhe veprojnë në drejtim të eliminimit të pasojave që ka shkaktuar pandemia. Planifikimi dhe veprimi duhet të jetë gjithëpërfshirës duke tejkuluar qasjen e deritanishme të fokusit vetëm në rimëkëmbjen ekonomike. Këto masa duhet të përfshijnë, por duke mos u kufizuar, sigurimin e mirëqenies, trajtimin dhe rehabilitimin adekuat të pasojave të shkaktuara nga pandemia.

E drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim

E drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim është një ndër të drejtat kryesore të fëmijëve mbi bazën e të cilave ndërtohen dhe rrjedhin edhe të drejtat e tjera. Fëmijët kanë të drejtën për t'u imunizuar, ushqyer shëndetshëm dhe në sasi të mjaftueshme, për t'u regjistruar, për emër, shtetësi, si dhe për kujdesje nga prindërit dhe mosndarjen e tyre nga familja. Këto dhe të drejtat

e tjera të garantuara nga Konventa dhe ligjet në fuqi duhet të mbrohen nga autoritetet dhe institucionet përgjegjëse nëpërmjet ofrimit të shërbimeve bazike për të siguruar jetën dhe zhvillimin e fëmijës.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës në nenin 6 përcakton: “Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar” dhe se “shtetet duhet të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.” Duke komentuar dhe dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë nen, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, thekson: “Neni 6 përcakton të drejtën e pandashme të fëmijës për jetë dhe obligimin e shtetit për të siguruar në maksimumim e mundshëm mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.” Shtetet palë duhet nxituar për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar kujdesin para lindjes për nënat dhe për bebet, ulur vdekshmërinë e foshnjave dhe të fëmijëve, si dhe krijimin e kushteve që promovojnë mirëqenien e fëmijëve përgjatë kësaj faze kritike të jetës së tyre.²⁵² Kequshqyerja dhe sëmundjet parandaluese vazhdojnë të jenë pengesat më të mëdha për realizimin e të drejtave të fëmijës gjatë fëmijërisë së hershme. Sigurimi i mbijetesës dhe i shëndetit fizik janë prioritete, mirëpo shteteve palë iu bëhet me dije që neni 6 përfshin të gjitha aspektet e zhvillimit, sepse shëndeti dhe mirëqenia psiko-sociale e fëmijës së porsalindur në shumë aspekte janë të ndërlidhura. Të dyja këto mund të vihen në rrezik nga kushtet jo të favorshme të jetës, neglizhimi, trajtimi shpërfillës dhe abuziv dhe kufizimet për të arritur realizimin e potencialit njerëzor. Fëmijët e vegjël që rriten në kushte specifike kërkojnë një vëmendje të veçantë. Komiteti ua kujton shteteve palë (dhe të tjerëve të shqetësuar) që e drejta për mbijetesë dhe zhvillim mund të zbatohet vetëm në mënyrë gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zbatimit të të gjitha dispozitave të tjera të Konventës, e që përfshin të drejtën për jetë, ushqyeshmëri të duhur, siguri sociale, standard adekuat të jetesës, ambient të sigurt dhe të shëndetshëm, edukim dhe lojë (nenet 24, 27, 28, 29 dhe 31), si dhe nëpërmjet respektimit të përgjegjësive të prindërve dhe ofrimit të asistencës për shërbime kualitative (nenet 5 dhe 18).²⁵³ Nga mosha e re, fëmija duhet vetë të përfshihet në aktivitete që promovojnë ushqyeshmërinë e mirë si dhe stilin e jetës së shëndetshme dhe me parandalim sëmundjesh.

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton të drejtën për jetë:

“Secili individ gëzon të drejtën për jetën.”

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka përfshirë dhe rregulluar në nivel të parimeve të ligjit të drejtën në jetë dhe zhvillim të fëmijës,²⁵⁴ si dhe ka përcaktuar dispozita të veçanta udhëzuese dhe obligative nëpër tërë Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

Ministria e Shëndetësisë, më 16 mars 2020, ka marrë vendim për pezullimin e të gjitha shërbimeve joemergjente në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private, duke fokusuar dhe koncentruar të gjitha resurset njerëzore dhe infrastrukturore në parandalimin dhe luftimin e COVID-19 dhe pasojave të shkaktuara nga pandemia. Padyshim që ndërprerjet e shërbimeve kanë pasur ndikim te fëmijët dhe te prindërit e tyre në sigurimin e këtyre

²⁵² United Nation Committee on the Rights of the Child - GENERAL COMMENT No. 7 (2005) ‘Implementing child rights in early childhood’ CRC/C/GC/7/Rev.1 20 September 2006.

²⁵³ United Nation Committee on the Rights of the Child - GENERAL COMMENT No. 7 (2005) ‘Implementing child rights in early childhood’ CRC/C/GC/7/Rev.1 20 September 2006.

²⁵⁴ Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 4.

shërbimeve. Kjo për faktin që shtyrjet dhe vonesat e intervenimeve të planifikuara kirurgjike, kontrolleve rutinë, apo ofrimi i shërbimeve shëndetësore terapeutike ka mundur të përkeqësonte gjendjen shëndetësore të fëmijëve dhe në rastet me ekstreme edhe të rrezikonte edhe jetën e tyre. Situata më e përkeqësuar ka qenë tek grupi i fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilëve ndalimi i shërbimeve shëndetësore në mënyrë të drejtpërdrejtë ua ka pamundësuar marrjen e terapive të përcaktuara dhe pa të cilat gjendja e tyre shëndetësore shënon regres dhe pasoja të cilat janë në raste të caktuara edhe të pariparueshme.

Gjendja e kujdesit dhe shërbimet për nënat shtatzëna dhe për të porsalindurit edhe përkundër faktit që ka vazhduar pa ndërprerje, nga shtatzënat e intervistuar pohohej se ishte rritur niveli i frikës dhe stresit nga mundësia e infektimit me virus dhe pasojave fatale që do të vinin nga një infektim i tillë, dhe si rrjedhojë edhe vizitat e rregullta të planifikuara nganjëherë i shtynin apo nuk i realizonin fare.

Ndalimi i aktiviteteve ekonomike ka dëmtuar dhe prekur të hyrat e përgjithshme të familjeve, dhe kjo pashmangshëm ka ndikuar në mundësinë e ofrimit të ushqyeshmërisë kualitative në atë nivel që fëmijët e kishin para pandemisë. Sipas vlerësimit të shpejtë të ndikimit ekonomik të realizuar nga UNDP-ja, nga UN Women dhe nga UNFPA-ja raportohet që për shkak të pandemisë, 56% të 202 bizneseve kosovare të intervistuar janë dashtur të mbylleshin, përdërisa gjysma apo 49% e 1412 shtëpiakëve të intervistuar, kanë përjetuar rënie të të hyrave. Në këtë aspekt gjendja është rënduar edhe më tepër tek fëmijët me aftësi të kufizuar, të cilëve për shkak të nevojave të tyre, u duhet nivel tjetër i kualitetit të ushqimit dhe i vlerave ushqyese. Përveç ushqimit, gjendja e rënduar ekonomike ka ndikuar edhe në sigurimin e shërbimeve bazike të kujdesit, trajtimit, terapisë, si dhe sigurimin e mjeteve parandaluese higjienike dhe pajisjeve të veçanta.

Përfaqësuesit e organizatave të personave me aftësi të kufizuar kanë theksuar se pandemia COVID-19 ka ndikuar drejtpërsëdrejti tek personat me aftësi të kufizuar e në veçanti edhe te familjet e tyre. Kjo ngase një pjesë e konsiderueshme e prindërve, si pasojë e COVID-19, kanë mbetur pa punë dhe rrjedhimisht është vështirësuar edhe qasja e fëmijëve në shërbime.²⁵⁵

Cenimit të fëmijëve për realizimin e së drejtës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, përgjatë pandemisë dhe në periudha të konsiderueshme kohore, i ka kontribuar edhe mungesa e barnave nga lista esenciale, të cilat fëmijët dhe familjarët e tyre i marrin falas nga institucionet publike shëndetësore. Rasti më i rëndë ka qenë me mungesën e insulinës dhe barnave për trajtimin e fibrozës cistike, si dhe barit surfaktant. Përveç faktit që këto barna kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe vetë jetën e fëmijëve, prindërit e fëmijëve janë detyruar që edhe nëpër forma ilegale t'i siguronin këto barna vetëm e vetëm që fëmijët e tyre të mos u ekspozoheshin rreziqeve nga mungesa e këtyre barnave.

Një rrezik potencial në jetën dhe zhvillimin e shëndetshëm ka pasur edhe pezullimi i përkohshëm për dy muaj (mars-prill) i programit të vaksinimit të fëmijëve në Kosovë. Disa nga prindërit e intervistuar pohuan që nga frika e infektimit me virus nuk i kanë dërguar fëmijët e

²⁵⁵ Ekonomia online, Pandemia ka rënduar shëndetin mendor të fëmijëve me nevoja të veçanta, 15 shkurt 2021, në: <https://ekonomiaonline.com/nacionale/pandemia-ka-renduar-shendetin-mendor-te-femijeve-me-nevoja-te-vecanta/> .

tyre për t'i vaksinuar sipas programit të rregullt të vaksinimit, ndërsa edhe kur kanë filluar vaksinimin, nuk e kanë kryer sipas afateve të parapara në program të vaksinimit.

Përveç sfidave me programin e vaksinimit të rregullt të fëmijëve, një sfidë tjetër lidhet me vaksinimin kundër COVID-19. Edhe pse akoma nuk ka një vaksinë të aprovuar për moshat e fëmijëve nga autoritetet shëndetësore të shteteve dhe as nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), besimi dhe perceptimi i përgjithshëm i grup-moshave të fëmijëve në lidhje me vaksinën nuk është premtues, kjo për faktin e qarkullimit të shumë informatave që janë pro apo kundër vaksinimit. Në këtë aspekt, Zyra e UNICEF-it në Kosovë, së bashku me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), në kuadër të platformës U-REPORT, kanë lansuar një sondazh online në lidhje me perceptimin e grup-moshave (15-24 vjeç) rreth vaksinës dhe marrjes së vaksinës. Nga 1.454 respondentë që kanë marrë pjesë në këtë sondazh dhe në pyetjet e ndryshme të formuluar, 43% e konsiderojnë vaksinën si të sigurt, 62% mendojnë se vakcina është efektive në parandalimin e sëmundjes. Ndërsa rreth aspektit të marrjes së vaksinës, 40% e respondentëve do ta merrnin vaksinën nëse ajo do të ishte e mundur, 25% nuk do ta merrnin, dhe 35% ishin të pavendosur. Arsyet kryesore të ofruara për mosmarrjen e vaksinës ndërlidhen me mungesën e informatave apo me shqetësimet rreth sigurisë.

Përveç rasteve kur nuk është realizuar e drejta për zhvillim, ekzistojnë edhe raste të suksesit që kanë ndikuar në realizimin e kësaj të drejte, siç është rasti i zhvillimit të platformës online për Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme dhe Edukimin për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, e cila ishte dizajnuar dhe lansuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së bashku me UNICEF-in në Kosovë dhe me Save the Children. Kjo platformë ka për qëllim të mundësojë realizimin e së drejtës për zhvillimin e fëmijës dhe për të siguruar vazhdimësinë e mësimin dhe rritjen e përfshirjes së prindërve në aktivitete me fëmijë. Pas lansimit të kësaj platforme online, ajo ka arritur rreth 2.7 milionë shikime dhe 220.000 përdorues gjatë muajve prill-nëntor 2020.

Njëra prej vendimeve²⁵⁶ që ka pasur ndikim pozitiv në realizimin e së drejtës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, ka qenë lirimi i njërit prind nga puna për t'u kujdesur për fëmijët në shtëpi. Ky vendim, edhe pse i mirëseardhur, nuk krijoi barazinë dhe mundësinë e njëjtë edhe për prindërit që punonin në sektorin privat, andaj edhe fëmijët e këtyre të fundit nuk e kishin të njëjtin përfitim.

E drejta për shërbime shëndetësore dhe sociale

E drejta për shërbime shëndetësore dhe sociale është një e drejtë e rëndësishme nga e cila varet edhe realizimi i të drejtave të tjera, zhvillimi i qëndrueshëm i fëmijëve dhe eliminimi i situatave që cenojnë mirëqenien e tyre. Për t'i përmbushur këto të drejta, Qeveria dhe institucionet e tjera kanë marrë veprime duke plotësuar kuadrin ligjor dhe politik që fëmijës t'i garantohet dhe mundësohet të rritet, të mbijetojë dhe të zhvillohet; të ketë një nivel të përshtatshëm jetese; të ketë nivelin minimal të mundshëm shëndetësor dhe të shërbimeve shëndetësore; për kujdes të posaçëm edhe kur është me paaftësi, që i siguron dinjitet dhe i lehtëson pjesëmarrjen aktive në familje, në shoqëri dhe në komunitet; për shërbime sociale që ndihmojnë fëmijët dhe familjet në nevojë.

²⁵⁶ Vendimi nr.01/07 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 11.3.2020.

Rëndësinë e këtyre të drejtave e ka paraparë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ku përcakton obligimin e shtetit për të rregulluar me ligj kujdesin shëndetësor dhe sigurimin social. Po ashtu parasheh që të rregullohet me ligj siguri social themelor për të papunët, të sëmurët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për të moshuarit.²⁵⁷

KDF-ja kërkon nga shtetet palë: *“Të njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit.”*²⁵⁸ Ndër të tjera, shtetet duhet të bëjnë përpjekje që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta në shërbime të kujdesit shëndetësor, të marrin masa për të ulur vdekshmërinë e foshnjave dhe të fëmijëve, të luftojnë sëmundjen dhe keqshqyrjen, t’u sigurojnë nënave kujdesin shëndetësor para dhe pas lindjes, si dhe të ofrojnë informata, këshilla dhe edukim të duhur.²⁵⁹

Ky nen reflektohet edhe në LMF, ku masat e parapara në KDF shtjellohen edhe më detajisht dhe fëmijës i garantohet edhe e drejta në kujdes shëndetësor falas.²⁶⁰ Kjo e drejtë rregullohet edhe me një mori ligjesh tjera, si: Ligji për Shëndetësi,²⁶¹ Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjithëse,²⁶² Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës në Sistemin Shëndetësor,²⁶³ Ligji i Familjes dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.²⁶⁴

Shërbimet Shëndetësore

Shërbimet shëndetësore për fëmijë duhet të ofrohen falas, të jenë të shpejta, lehtë të qasshme dhe t’u përshtaten nevojave të fëmijëve. Edhe pse fëmijët në përgjithësi janë më pak të prekur nga sëmundja e COVID-19, ekziston rreziku që fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe ata që janë me sëmundje kronike (astma apo fibroza cistike), apo ata që kanë sistem imunitar të dobësuar të jenë të prekur dhe si rrjedhojë të kërkojnë shërbime shëndetësore për trajtimin dhe shërimin e tyre.

Vendimi për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik dhe vendimet pasuese pa dyshim që kanë ndikuar rëndë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët në përgjithësi e më së tepërmi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në veçanti vendimet e Qeverisë për mbylljen e disa shërbimeve shëndetësore publike dhe private ua kanë pamundësuar fëmijëve me aftësi të kufizuara vazhdimin e terapive të caktuara fizioterapeutike, këshillimin psiko-social, marrjen e barnave të caktuara, rehabilitimin dhe shërbimet e tjera. Organizatat dhe shoqatat që ofrojnë

²⁵⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 51.

²⁵⁸ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 24.

²⁵⁹ Po aty.

²⁶⁰ LMF, neni 42.

²⁶¹ Ligji nr. 02/1-78 për Shëndetësi Publike, ndër të tjera, rregullon identifikimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore, parandalimin e sëmundjeve, hulumtimin e etiologjisë së sëmundjeve, promovimin e shëndetit, rehabilitimin dhe riadaptimin e të hendikepuarve, edukimin shëndetësor dhe çështjet sociale. Ky ligj ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor.

²⁶² Ligji nr. 02/1-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjithëse ka për qëllim që të përcaktohen sëmundjet ngjithëse si dhe të rregullohen aktivitetet për zbulimin në kohë, evidencimin e shfaqjes, parandalimin, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre.

²⁶³ Ligji nr. 02/1-38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës në Sistemin Shëndetësor, ndër të tjera, përcakton edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve në kujdesin shëndetësor dhe mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe përgjegjësi.

²⁶⁴ Ligji nr. 02/1-081 i Familjes dhe Ligji nr. 04/L-081 për Shërbime Sociale dhe Familjare, ndër të tjera, rregullon aspektet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara kanë theksuar që situata është shumë alarmante, për shkak se edhe ato pak shërbime shëndetësore dhe rehabilituese që i kanë pranuar deri para pandemisë, janë ndaluar me vendimet që ishin nxjerrë pas shpalljes së pandemisë.

Barra e sigurimit të shërbimeve shëndetësore publike që ishin ndaluar me vendim, por që deri atëherë ofroheshin falas, tani ka rënë mbi prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilëve ua ka vështirësuar në masë të madhe mundësinë e financimit të këtyre shërbimeve. Një brengë shtesë e prindërve ishte edhe kualiteti i shërbimeve të organizuara nëpërmjet sistemit online, ku kualiteti ndikon në aftësimin dhe në rehabilitimin afatgjatë të fëmijëve.

Përgjatë hulumtimit është vërejtur se ekziston mungesa e informimit adekuat rreth virusit, si dhe informatat e udhëhequra nga teori konspirative kanë ndikuar në masë të madhe edhe në hezitimin e prindërve për të kërkuar ndihmë dhe shërbime shëndetësore për fëmijët e tyre. Mosadresimi i duhur dhe me kohë i shqetësimeve shëndetësore, si dhe mostrajtimi i duhur në institucione shëndetësore mund të vë në rrezik shëndetin dhe jetën e fëmijëve.

Vizitat dhe intervistat e realizuara nga IAP-ja

Duke parë situatën e rënduar nga pandemia globale, me qëllim të monitorimit të të drejtave të fëmijëve dhe për të parë më afër punën dhe vështësitë e hasuara nga institucionet dhe organizatat, IAP-ja ka realizuar vizita në terren dhe u ka dërguar pyetje me shkrim atyre.

Më 18 mars 2021, përfaqësuesit e IAP-së vizituan Qendrën e Kujdesit Ditor “Pema” në Prishtinë, ku u njoftuan për së afërmi me punën e kësaj qendre, veçmas gjatë kohës së pandemisë. Përfaqësueset e Qendrës i kanë informuar përfaqësuesit e IAP-së, ndër të tjera, se ofrojnë: Shërbime psiko-sociale dhe rehabilituese për fëmijë me aftësi të kufizuara, përmes Qendrave të Kujdesit Ditor; këshillime psikologjike për prindërit/kujdestarët e fëmijëve në nevojë; ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të punëtorëve të Qendrave të Kujdesit Ditor, përmes trajnimeve dhe supervizimit klinik; vetëdijesimin dhe fuqizimin e prindërve për të avokuar për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara; monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe të politikave kombëtare që trajtojnë të drejtat e fëmijëve; organizimin e seminareve dhe të konferencave që adresojnë nevojat dhe të drejtat e fëmijëve nga kategoritë më të cënueshme. Në këtë qendër ishin duke marrë shërbime 254 fëmijë me aftësi të kufizuara, të organizuara nëpërmjet zyrës qendrore në Prishtinë dhe katër qendrave të tjera (Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan). Pandemia ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në punën e kësaj qendre për ofrimin e shërbimeve të planifikuara. Përveç vështirësive gjatë mbylljes, një ndër sfidat kryesore të saj mbetet qëndrueshmëria financiare. Meqë shumica e mbështetjeve për organizata me bazë në komunitet është 6-mujore, 8-mujore deri në 1 vit, apo kontrata 1-vjeçare, kjo situatë nuk garanton qëndrueshmëri tek ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare për grupet e cënueshme të popullatës.

Ndërsa në përgjigjet e dërguara, Shoqata “Down Syndrom Kosova” ka prezantuar punën e vet dhe sfidat me të cilat është përballur gjatë pandemisë. Shoqata ka njoftuar IAP-në që në kuadër të fushëveprimtarisë së vet: ofron shërbime terapeutike për fëmijët me sindromë Down, përfshirë shërbimin e psikologut, logopedit, egroterapisë dhe fizioterapisë. Përfaqësuesit e shoqatës theksuan që edhe këta, sikurse edhe organizatat që mbulojnë fushën e aftësisë së kufizuar, janë përballur me sfida të ngjashme. Ajo tregoi që sfidat kryesore janë: “*Të natyrës*

financiare, si pasojë e mos mbështetjes të vazhdueshme nga institucionet publike për ofrimin e shërbimeve, shërbime të cilat i ofron shoqata janë brenda katër qendrave regionale. Nga informatat nga tereni vështirësitë që janë identifikuar janë shpenzimet financiare për terapinë që është dashur të blejnë fëmijët dhe të rriturit me sindromën Doën (rastet të cilat kanë qenë të prekura nga COVID-19).”²⁶⁵ Përfaqësuesit kanë ngritur shqetësimin lidhur me vaksinimin e personave mbi moshën 16-vjeç me sindromën Down, të cilët nga ekspertë ndërkombëtarë janë përcaktuar si grup me rrezik të lartë të komplikimeve, në rast infektimi me COVID-19. Kjo pasi ata kanë imunitet shumë më të dobët sesa pjesa tjetër e popullatës dhe se në shumicën e rasteve sindroma shoqërohet me sëmundje kardiovaskulare, respiratore, sëmundje endokrine, obezitet etj. Sipas shoqatës, shumica e shteteve evropiane kanë përcaktuar në grupin e parë për vaksinim personat me sindromë Down.²⁶⁶ Shoqata tha se deri më tani i ka dërguar dy kërkesa tek institucionet përkatëse që personat me sindromë Down të vendosen në grupin e parë për vaksinim, por fatkeqësisht nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Që nga hapja e Repartit për COVID-19 në fillim të pandemisë e deri në fund të vitit 2020, në Klinikën e Pediatriisë janë hospitalizuar 64 raste. Ndërsa prej janar-qershor të vitit 2021 janë hospitalizuar 67 raste²⁶⁷. Gjendja e këtyre pacientëve ka qenë mesatare, por për disa prej tyre ka qenë më e rëndë, sepse kanë qenë me sëmundje shoqëruese kronike. Trajtimi i këtyre rasteve është bërë në përputhje me protokollet e OBSH-së dhe me rekomandimet e IKShPK-së. Sipas Klinikës, nuk ka pasur ndonjë pengesë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për trajtimin e këtyre fëmijëve. Reparti COVID-19 posedon 9 shtretër që kanë qenë të mjaftueshëm për trajtimin e këtyre fëmijëve. Fillimisht vështirësitë e hasura kishin të bënin me diagnostikimin e rasteve në mungesë të strishove për PCR, mungesën e materialit harxhues (dezinfektues, maska, dorëza etj). Më vonë vështirësitë kishin të bënin me mungesën e infermierëve, meqë 51 prej 128 infermierëve të Klinikës së Pediatriisë kanë shërbyer në klinikat COVID-19 me rekomandim të menaxhmentit të ShSKUK-së. Në përgjithësi, përfaqësuesit e Klinikës ishin vlerësonin se sëmundja COVID-19 nuk ka pasur ndikim në jetën shëndetësore të fëmijëve.

Shëndeti mendor

Shëndeti mendor është shumë i rëndësishëm dhe i barasvlershëm me shëndetin fizik dhe biologjik në zhvillimin e fëmijës, sidomos gjatë fëmijërisë së hershme dhe përgjatë tërë jetës së fëmijës. Zhvillimi jo i duhur i shëndetit mendor, fëmijëve do t’u kushtojë me përballje me probleme dhe me vështirësi që ndërliidhen me aftësitë e tyre arsimore, të sjelljes dhe të aftësive për t’i kontrolluar emocionet e tyre.

Problemet kryesore me të cilat fëmijët janë përballur përgjatë pandemisë përfshijnë: pikëllimin, frikën, pasigurinë, izolimin shoqëror, rritjen e kohës para ekranit dhe lodhjen e prindërve dhe të anëtarëve të familjes për të adresuar nevojat dhe për të kaluar kohën e nevojshme me fëmijët.

Vendimet e Qeverisë për mbyllje, izolim në shtëpi, kalimi në sistemin e shkollimit online, mungesa e ndërveprimit me shoqërinë, qëndrimi për kohë të gjatë pranë ekraneve televizive, përdorimi i tepërt i internetit dhe video-lojërave, marrja e informatave të ndryshme rreth rrezikut të COVID-19, informatave të pa censuruara rreth mënyrës së vdekjes dhe shumë

²⁶⁵ Shoqata “Down Syndrome Kosova”, Përgjigjet në pyetjet e IAP-së, 21 prill 2021.

²⁶⁶ Po aty,

²⁶⁷ Klinika e Pediatriisë, Përgjigje në pyetjet e IAP-së, 22 qershor 2021.

lajmeve të pavërteta (fake news) rreth pandemisë, të gjitha këto pashmangshëm kanë ndikuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në shëndetin mendor të fëmijëve. Nga raportimet dhe informatat e ndryshme që qarkullojnë në internet në nivel global vërehet një tendencë e rritjes së rasteve të fëmijëve që kanë probleme me shëndetin mendor me simptoma të theksuara të ankthit, të depresionit e deri te tendenca e vetëlëndimit dhe e vetëvrasjes.

Ndikimi i pandemisë në shëndetin mendor pritet të jetë afatgjatë dhe i gjerë dhe vështërsitë janë vërejtur në veçanti te fëmijët dhe te të rinjtë.²⁶⁸ Ky konstatim mbështetet edhe nga politika reaguese e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), ku theksohet se shëndeti mendor i të rinjve 15-24 vjeç është përkeqësuar seriozisht gjatë dy vjetëve të pandemisë. Për më tepër, përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara tërheqin vëmendjen se gjendja emocionale apo shëndeti mendor i fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë ka qenë shumë i rënduar dhe ka afektuar drejtpërsëdrejti në shëndetin e tyre.²⁶⁹ Izolimi në shtëpi konsiderohet si një ndër faktorët më me ndikim në rëndimin e shëndetit mendor të personave me aftësi të kufizuara.

Shërbimet sociale

Gjendja e rënduar financiare dhe vështirësitë e panumërta me të cilat ishin përballur organizatat/shoqatat në kuptimin e ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara, evidentohet edhe në raportin e publikuar nga KOMF-i, ku theksohet: *“Bazuar në të dhënat e monitorimit, situata e krijuar nga COVID-19 ka rënduar në masë të madhe sidomos grupet e cenueshme dhe kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve në nevojë për shërbime sociale. Shumë shërbime të ofruara nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe organizatat jo qeveritare për grupet e cenueshme kanë qenë të kufizuara gjatë kësaj periudhe për shkak të vendosjes së masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Qeveritë qendrore dhe komunale, këtë vit janë fokusuar në menaxhimin e pandemisë COVID-19, duke lënë anash shërbimet sociale.”* Duke u ndërlidhur me sfidën financiare dhe paqëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve sociale për grupet e cenueshme, ku bëjnë pjesë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, në të njëjtin raport evidentohet fakti: *“Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe komunat edhe këtë vit dështuan në krijimin e një skeme të qëndrueshme të blerjes së shërbimeve sociale. Ato vazhduan mbështetjen përmes subvencionimit të ofruesve të shërbimeve sociale, e cila nuk konsiderohet si një formë e qëndrueshme e financimit. Pjesa më e madhe e organizatave të licencuara në fushën e shërbimeve sociale mbetën pa financim përgjatë gjithë vitit 2020 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo si pasojë e shpalljes me vonesë të thirrjes së rregullt vjetore të MPMS për subvencionimin e ofruesve të shërbimeve sociale.”*

Pandemia, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në realizimin e të drejtave të fëmijës, kishte edhe ndikim indirekt për shkak që shumë procese në aprovimin e ligjeve përkatëse ishin ndërprerë. Mosaprovimi i këtyre ligjeve do të ketë ndikim në sigurimin e shërbimeve të nevojshme sociale për fëmijët dhe familjet që janë në nevojë, e veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.²⁷⁰

²⁶⁸ Takimi i nivelit të lartë-Samiti për shëndetin mendor, i mbajtur në Athinë nga data 22-23 korrik 2021.

²⁶⁹ Ekonomia online, Pandemia ka rënduar shëndetin mendor të fëmijëve me nevoja të veçanta, 15 shkurt 2021, në: <https://ekonomiaonline.com/nacionale/pandemia-ka-renduar-shendetin-mendor-te-femijeve-me-nevoja-te-vecanta/>.

²⁷⁰ Ky realitet potencohet edhe në raportin e sipërcituar të KOMF-it, ku: *“Gjatë vitit 2020 nuk pati ndonjë progres sa i përket decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale. Projekt Ligji për Financat e Pushtetit Lokal edhe pse u hartua që në vitin 2019, nuk arriti të dërgohet për miratim në Qeveri dhe Kuvend dhe si pasojë nuk u krijua Granti Specifik për Shërbime Sociale,*

Një sfidë tjetër e evidentuar në aspektin e ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe për familjet në nevojë ishte edhe vendimi i Qeverisë për autorizimin e Qendrave për Punë Sociale për zbatimin e Pakos së Emergjencës Fiskale. Ky autorizim krijoi ngarkesë të jashtëzakonshme për QPS-të edhe ashtu të mbingarkuara me punë që rridhnin nga mandati ligjor, dhe si rrjedhojë QPS-të nuk kishin hapësirën e duhur për t'i mbuluar të gjitha detyrat që ndërlihdeshin me shërbimet sociale.

E drejta për mbrojtje nga dhuna

Fëmijët kanë të drejtë për të jetuar një jetë të lirë nga dhuna, e garantuar nga Kushtetuta²⁷¹, kurse Qeveria dhe institucionet përgjegjëse kanë për detyrë të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e fëmijëve nga çfarëdo lloj i dhunës dhe i dëmit. Dëmi duhet të nënkuptohet dhe përfshin: dhunën, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhencën, si në aspektin psikologjik, fizik dhe socio-ekonomik. Mbrojtja është detyrim për të gjithë dhe përfshin të gjitha nivelet, duke filluar nga rrethi dhe mjedisi familjar, komuniteti e deri tek instancat e nivelit qeveritar. Po ashtu edhe KDF-ja parasheh në detaje dispozitat me të cilat u bëhet thirrje shteteve palë: *“...të marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.”*²⁷²

Kjo e drejtë është e përfshirë dhe e rregulluar edhe në LMF, i cili ndër të tjera ka për qëllim: *“Të mbrojtë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës.”*²⁷³

Mbyllja në shtëpi apo në banesë për kohë të caktuar e të rriturve dhe e fëmijëve ka rritur mundësitë e shtimit të dhunës qoftë fizike, emocionale apo mendore. Andaj autoritetet dhe institucionet përgjegjëse duhet të kenë parasysh nevojën për shtimin e aktiviteteve dhe të veprimeve që mbrojnë fëmijën nga të gjitha format e dhunës. Nëse dhuna nuk adresohet si duhet ose në rast se vonohet zbatimi i një përgjigjeje të koordinuar, vuajtja e fëmijëve mund të shtohet, atyre mund t'u shkaktohet dëm i pakthyeshëm dhe mund ta marrin veten me vonesë.

i cili do të mundësonte financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Formula e financimit për shërbime sociale e cila filloi të hartohet në vitin 2019, nuk arriti të finalizohet. E njëjta gjë ndodhi edhe me Projekt Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili pavarësisht parashikimeve dhe punës së grupit punues për ta finalizuar gjatë 2020, vijon të mbetet në proces të hartimit.”

²⁷¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 50 (3).

²⁷² KDF, neni 19.

²⁷³ LMF, neni 1(1).

Privimi nga liria

Fëmijët e privuar nga liria përbëjnë një grup të ndjeshëm të fëmijëve të cilët kërkojnë mbrojtje të posaçme. Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse duhet të sigurohen që të të respektohen drejtat e çdo fëmije të privuar nga liria, të mbrohen dhe të përmbushen plotësisht. Kjo përfshin edhe ofrimin e kujdesit të duhur, mbrojtjen nga dëmtimi, marrjen e masave për uljen e mbipopullimit në të gjitha mjediset ku ata mund të mbahen të mbyllur, për kthimin e tyre në siguri të plotë pranë familjeve, apo nëpërmjet të ndonjë forme alternative të mbikëqyrjes. Po ashtu është e rëndësishme që autoritetet dhe institucionet përgjegjëse të marrin parasysh që për të gjitha vendimet që ndërliken me privimin nga liria të fëmijës, të udhëhiqen nga parimi i interesit më të mirë, nga e drejta e fëmijës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, parimi i gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme si dhe e drejta për t'u dëgjuar.²⁷⁴

Për të lehtësuar zbatimin e së drejtës për mbrojtje të fëmijës në aspektin e privimit nga liria, UNICEF-i ka publikuar një udhëzues rreth veprimeve që duhet t'i ndjekin autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për fëmijët që ishin privuar nga liria apo atyre që për arsye ligjore do të mundë t'i nënshtroheshin vendimeve për privim nga liria. Sipas këtij udhëzuesi, autoritetet dhe institucionet përgjegjëse duhej ndërmarre veprime për: vendosjen e një moratoriumi për hyrjet e reja të të miturve në mjedise të privimit nga liria; lirimin e të gjithë atyre të miturve që mund të lirohen në siguri të plotë; dhe mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së të gjithë atyre të miturve që u duhet të mbeten në burgim.

Duke u bazuar në këtë udhëzim global dhe në gjendjen e krijuar nga pandemia, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), së bashku me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë dhe me Koalicionin e Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), kanë dërguar një deklaratë të përbashkët për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së të miturve të dënuar, drejtuar: presidentes, kryeparlamentares, Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial dhe Ministrisë së Drejtësisë.²⁷⁵ Deklarata u bën thirrje institucioneve për shqyrtimin e mundësive që janë në kuadër të ligjeve në fuqi, në afat sa më të shpejtë të mundshëm, aty ku janë plotësuar kushtet ligjore, të ndërmerren vendimet, qoftë për zëvendësim apo për shqyrtim të masave edukative institucionale, zëvendësim të paraburgimit, lirim të parakohshëm, lirim me kusht, apo edhe për falje të dënimeve. Kjo deklaratë kishte marrë për bazë udhëzimin global dhe përfshinte një arsyetim të detajuar. Kjo ngase duke marrë për bazë mundësitë në kuadër të ligjeve në fuqi dhe duke qenë të vetëdijshëm se iniciativat për të bërë ndryshime ligjore janë të vështira dhe të tej zgjatura në këtë kohë, si dhe faktin se çdo vonesë në këtë aspekt mund të ndikojë në shëndetin dhe në sigurinë e përgjithshme të të miturve që janë në vuajtje të paraburgimit apo ndonjëres prej masave edukative institucionale apo të burgimit, është kërkuar që në afat sa më të shpejtë të mundshëm, aty ku janë plotësuar kushtet ligjore, të ndërmerren vendime, qoftë për zëvendësim apo shqyrtim të masave edukative institucionale, zëvendësim të paraburgimit, lirim të parakohshëm, lirim me kusht, apo edhe falje të dënimeve. Në të gjitha këto rrethana, ndërmarrja menjëherë e këtyre vepimeve është në

²⁷⁴ Po aty, Kapitulli II.

²⁷⁵ Shih: Deklaratë e përbashkët e Avokatit të Popullit, UNICEF-it dhe KOMF-it (Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve) – Thirrje për veprim “T”u japim një shans të miturve”, 2020, në: <https://www.oikrks.org/2020/05/22/deklarate-e-përbashkete-avokatit-te-popullit-unicef-dhe-komf/>.

harmoni dhe në përputhje me kërkesat që rrjedhin prej Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës për respektimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe parimit të sigurisë së jetës, mbijetesës dhe zhvillimit. Nga informatat e grumbulluara dhe nga intervistat e zhvilluara kuptohet se situata e fëmijëve në këtë aspekt nuk ka ndryshuar. Këtij shqetësimi i shtohet edhe brenga për të kuptuar rreth nivelit të vendimeve për privim nga liria për të miturit gjatë pandemisë si dhe kushteve të përgjithshme për të miturit në qendrat e mbajtjes dhe në të paraburgimit.

Sipas një studimi të realizuar nga EULEX-i tregohet për rënien e numrit të të burgosurve duke përfshirë në këtë numër edhe të miturit, ku numri u ul nga 44 në 39. Sidoqoftë, fakti se korniza juridike nuk e mundëson shtyrjen, pezullimin apo ndërprerjen e dënimeve për shkak të arsyeve të ndërlidhura me pandeminë, mbetet çështje e cila meriton vëmendje, sepse rreziqet e infektimit me COVID-19 në institucionet korrektuese janë më të larta dhe se gjendjet shëndetësore paraprake apo mungesa e imunitetit tek të burgosurit e caktuar mund të shpijnë në simptoma më të rënda.

Mbrojtja e fëmijës pa përkujdesje prindërore

Fëmijët kanë të drejtë të rriten me kujdes dhe mbrojtje që u ofrohet nga prindërit. Kjo e drejtë është universale dhe i garantohet çdo fëmije nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës. Në rastet kur kjo e drejtë nuk mund të realizohet, fëmijës duhet t'i ofrohet mbrojtje nëpërmjet formave alternative të kujdesit duke e vendosur fëmijën në ambiente të ngjashme me familjen dhe tek të afërmit e fëmijës. Në rastet kur nuk është e mundur vendosja tek të afërmit, apo në ndonjërin prej formave të kujdesit alternativ, atëherë si përjashtim, fëmija duhet të vendoset në kujdes institucional, me kusht që kjo vendosje të jetë sa me e shkurtër dhe sipas një programi strikt të kontrolluar për të shmangur stigmatizimin, dhunën apo format e ndryshme abuzuese ndaj fëmijës.

Pandemia ka pasur një ndikim të theksuar edhe në mbrojtjen e interesit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore edhe atë në dy aspekte: në njërin anë ka vështirësuar realizimin e të drejtave të fëmijëve që janë përkujdes prindëror, ndërsa në anën tjetër ka ndikuar në shtimin e rasteve të fëmijëve pa përkujdes prindëror, kjo për faktin e vdekjes së prindërve, apo edhe të kufizimeve shëndetësore për t'i ushtruar të drejtat prindërore për periudha të caktuara. Sikurse tek grupet e tjera të mbrojtjes, situata është edhe më e përkeqësuar dhe me pasoja më të mëdha tek grupet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të vendosur në ndonjërin prej formave të kujdesit alternativ.

Përveç sfidave të shumta të cilat ishin të pranishme para pandemisë, siç janë: mosnjohja e stazhit të punës familjeve strehuese, mosvazhdimi i përkrahjes së fëmijëve dhe i familjeve pas arritjes së moshës 18 vjeç, mungesa e mbështetjes me shërbime të specializuara, fëmijët dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit alternativ gjatë pandemisë janë përballur edhe me sfida të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në jetën dhe në zhvillimin e tyre. Tek fëmijët në përgjithësi, e në fëmijët me aftësi të kufizuara në veçanti, të vendosur në ndonjërin prej formave të kujdesit alternativ, pandemia, respektivisht masat që janë ndërmarrë nga Qeveria, kanë ndikuar shumë rëndë në realizimin e të drejtave të tyre për jetë, zhvillim, shëndet, arsim dhe mbrojtje. Kjo për faktin që këta fëmijë, sikur fëmijët e tjerë, gjatë kohës së pandemisë në periudha të caktuara kanë qenë të detyruar të qëndronin të izoluar, kanë pasur mungesë të

ndërveprimit me bashkëmoshatarë, u është pezulluar apo ndërprerë kohë pas kohë dhënia e shërbimeve, zgjidhja e statusit të tyre ligjor apo e kalimit në ndonjë formë tjetër të mbrojtjes etj.

Këto sfida dhe të tjera janë evidentuar edhe gjatë intervistave të zhvilluar me profesionistë të kësaj fushe, të cilët ndër të tjera kanë theksuar që pandemia ka ndikuar tej mase në përkeqësimin e situatës së fëmijëve pa përkujdes prindëror e të vendosur në ndonjë formë të kujdesit alternativ. Profesionistët e kësaj fushe kanë radhitur një varg sfidash me të cilat ata janë përballur gjatë punës së tyre, si: *“Ndërprerja e aktiviteteve me prezencë fizike dhe kalimi online në disa prej këtyre aktiviteteve ka ndikuar në cilësinë e ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në planet e punës, në këtë aspekt ndikim shumë të madh ka pasur edhe mungesa e pajisjeve (kompjuterëve apo telefonave) si dhe mungesa apo rrjetit të dobët të internetit.”* Ata më tutje kanë shtuar: *“Fëmijët dhe familjet kanë pësuar edhe për shkak të pamundësisë së vazhdimin të ndihmës financiare për fëmijët dhe familjet strehuese. Këtu hyjnë rastet e fëmijëve që i kanë mbushur 18 vjet, atyre iu është ndërprerë ndihma menjëherë. Kjo ka ndikuar dhe ka rënduar edhe me tutje barrën financiare të mbajtjes nga ana e familjeve strehuese për këta fëmija. Gjatë periudhës së pandemisë kanë qenë disa raste ku familja strehuese me burimet e veta financiare ka vazhduar përkrahjen dhe mbrojtjen e fëmijëve, sidomos atyre me aftësi të kufizuar me të vetmin qëllim që këta fëmijë të mos vendosen në Institucionin Special në Shtime.”* Një ndikim tjetër ndërlidhet me aspektin shëndetësor të fëmijëve pa përkujdes prindëror, ku *“Fëmijët që kanë pasur probleme shëndetësore kronike (rasti i fëmijut me probleme me zemër) i është vonuar gati 1 vit aspekti i transferit jashtë shtetit për intervenim kirurgjik.”*

Pandemia ka pasur ndikim edhe në aspektet procedurale ligjore të zgjidhjes së statusit formal juridik të fëmijëve pa përkujdes prindëror, sidomos rastet e kalimit nga njëra formë e përkujdesjes në format e tjerë të saj (nga strehimi familjar në adoptim), kjo për faktin se gjykatat në periudha të caktuara nuk kanë punuar dhe në disa raste është vonuar trajtimi i rasteve të proceduara për adoptim, apo edhe heqje, njohje së të drejtës prindërore.

Vizitat dhe intervistat e realizuara nga IAP-ja

Më 12 mars 2021, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituan Qendrën Ditore të Fëmijëve në Prishtinë, ku u njoftuan më për së afërmi me shërbimet e ofruara për fëmijët në rrezik, veçmas për fëmijët në situatë rruge. Përfaqësuesit e IAP-së u njoftuan lidhur me procesin arsimor të këtyre fëmijëve, ofrimin e shërbimeve psikologjike, shëndetësore etj. Po ashtu u njoftuan se në aspektin shëndetësor kanë një bashkëpunim shumë të mirë me Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF), ku i referojnë rastet sa i përket pjesës shëndetësore.

Ndërsa në pyetjet e dërguara nga IAP-ja tek organizata “SOS”, ajo më 20 prill 2021, nëpërmjet përgjigjeve ka prezantuar punën e vet dhe sfidat me të cilat është përballur gjatë pandemisë. Ata kanë pohuar, ndër të tjera: *“Normalisht pandemia ka afektuar emocionet, sjelljet dhe mendimet e fëmijëve ku është nevojitur përkrahja e stafit psiko-pedagogjik në kontiunitet në mënyrë që të ruhet balansi psikologjikë. Qysh nga viti i kaluar ne kemi hartuar protokoll të brendshëm reagimi ku çdo muaj Familjet SOS janë furnizuar me vitamina adekuate, maska, dezinfektues dhe preparate tjera preventive për tu mbrojtur nga virusi.”* Për më shumë, ata kanë theksuar faktin se për periudhën e izolimit mars-prill 2020, pacientët kronikë kanë pasur sfida të merrnin shërbime të shpejta.

Ndërsa në pyetjet e dërguara nga IAP-ja tek organizata “Shpresa dhe Shtëpi”, ajo më 21 prill 2021, nëpërmjet përgjigjeve ka prezantuar punën e vet dhe sfidat me të cilat është përballur gjatë pandemisë. Përfaqësuesi i “Shpresa dhe Shtëpi” e ka informuar përfaqësuesin e IAP: (...) *Strehimorja e Shpresa dhe Shtëpitë e fëmijëve-Kosovë, ofron shërbime sociale dhe rezidenciale të përkohshme për fëmijët në nevojë për mbrojtje. Shërbimet që përfshihen në kuadër të pakos së shërbimeve janë: strehim, ushqim, veshmbathje, pako hixhinike, organizimin e shërbimeve shëndetësor dhe medikamente, programe psiko-sociale, shkollim në komunitet, aktivitete rekreative dhe sportive etj. Shërbimet shëndetësore nuk ofrohen nga strehimorja por në rastet kur paraqitet nevoja të fëmijët për shërbime të tilla strehimorja organizon këto shërbime dhe personeli i shoqëron fëmijët për te mjeku (Institucionet publike). Për fat të mirë fëmijët kanë gëzuar shëndet të mirë dhe nuk ka pas nevojë për shërbime shëndetësore të shpeshta mirëpo edhe në rastet kur ka pas nevojë jemi drejtuar në Qendrat e Mjekësisë Familjare. Gjatë muajit Dhjetor 2020 kemi bërë kërkesë në IKSHPK për testim për COVID-19 për të gjithë fëmijët dhe personelin dhe na janë përgjigjur me shumë korrektësi.(...)*”

Ndërsa në pyetjet e dërguara nga IAP-ja tek organizata “Terre des Hommes” (TDH), ajo më datën 22 prill 2021, nëpërmjet përgjigjeve ka prezantuar punën e vet dhe sfidat me të cilat është përballur gjatë pandemisë. Përfaqësuesi i TDH-së e ka informuar përfaqësuesin e IAP-së se ndër shërbimet e ofruara gjatë pandemisë COVID-19, janë: *“Mësim mbështetës për fëmijët e Qendres Ditore përfshire: mësimet në baze të nevojës së fëmijut, mësimi bazik duke filluar nga shkronjat dhe numrat, lexim, shkrim, dhe baza e gjuhës Angleze. Aktivitetet psikosociale-lojërat. Këshillim psikologjik -individual dhe grupor. Programi i mbështetjes së prindërimit. Vizitat në familje për vlerësimin e situatës së fëmijës dhe familjareve të tyre. Aktivitetet për kampanja të vetëdijesimit. Monitorimi dhe identifikimi i fëmijëve në situatë rruge. Referimi i rasteve të institucionet adekuate. Shërbimet shëndetësore për fëmijët në varësisht nga nevoja dhe vlerësimi i Punëtorit Social. Mbështetje emergjente me pako ushqimore, higjienike e didaktike. Mbështetje me kyçje të internetit për familjet e fëmijëve për tu bërë të mundur dhe lehtësuar përfshirjen në aktivitetet online. Mbështetje me mjete teknologjike për lehtësim të kyçjes në aktivitetet online. Mbështetje administrative në hapjen e llogarive e plotësimin e aplikacioneve për përfitim nga pakoja emergjente nga qeveria për COVID-19. Referim dhe mbështetje në shërbimet shëndetësore sipas nevojës në bashkëpunim të ngushtë me QMF Prishtinë, Fushe Kosovë e QKUK; Mbështetje me medikamente si dhe për marrjen e shërbimeve: -Kontrolle mjekësore-Analize laboratorike,-CT-Kontrolle të stomatologu-Kontrolle të oftalmologot dhe blerja e syzave (...).”*

Ndërsa në lidhje më sfidat dhe vështirësitë, përfaqësuesi i “TDh” informon për këto sfida: (...) *“Sfidat të shpeshta janë për shkak të qasjes diskriminuese dhe përjashtuese që kanë personat me të cilit ballafaqohen fëmijët e qendres ditore (pra edhe në marrjen e shërbimeve shëndetësore). Mungesa e informatave për gjendjen reale dhe për të drejtat të cilit ju takon secilit fëmijë pa asnjë dallim. Është për t’u theksuar ndryshimi në qasje ndaj këtyre fëmijëve kur janë të shoqëruar nga stafi i qendrës(..).”*

Konkluzionet

Avokati i Popullit konstaton se vendimet e Qeverisë dhe të institucioneve përkatëse, nuk kanë marrë për bazë nivelin e kërkuar të zbatimit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës. Pandemia e COVID-19 dhe vendimet gjegjëse të nxjerra nga Qeveria dhe nga institucionet e tjera, kanë ndikuar në realizimin e të drejtave të fëmijës në Republikën e Kosovës. Edhe pse nga ky raport është e vështirë të nxirret konkluzioni i saktë se shkalla e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, veçanërisht e atyre me aftësi të kufizuar, shkeljet nga veprimi apo mosveprimi i Qeverisë dhe i institucioneve të tjera janë evidentuar përgjatë hetimit në shumë fusha dhe aspekte.

Nuk ka pasur një strategji gjithëpërfshirëse mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuar, në shumë raste mbështetja dhe ndihma ka qenë e përkohshme, e organizuar keq dhe nuk ka mbuluar të gjithë fëmijët në të njëjtën kohë.

Ndërprerja dhe pezullimi i disa shërbimeve shëndetësore ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të fëmijëve duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuar, si dhe në raste të caktuara ka mundur ta rrezikonte edhe vetë jetën dhe zhvillimin e fëmijëve.

Ndërprerja dhe pezullimi për kohë të caktuar i shërbimeve shëndetësore përcjellëse (terapi fizio-rehabilituese, terapi këshilluese psiko-sociale, barnat esenciale, programet e mbështetjes ditore) i kanë privuar fëmijët me aftësi të kufizuar nga shërbimet bazike terapeutike rehabilituese. Në mungesë të këtyre shërbimeve, në disa raste është ndikuar në zbehjen, por edhe në rrënimin e tërë progresit që është arritur në aftësitë e caktuara të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Si rezultat i ndërprerjes dhe pezullimit të shërbimeve, për shumë fëmijë me aftësi të kufizuar barra e sigurimit të këtyre shërbimeve ka rënë mbi prindërit ose mbi kujdestarët e tyre. Kjo barrë përveç aspektit financiar, është vështirësuar në masë të madhe edhe në gjetjen e alternativave, në mënyrë që fëmijëve me aftësi të kufizuar të mos u ndërpriten shërbimet e planifikuara.

Deri më tani jemi të vetëdijshëm për ndikimin e drejtpërdrejtë të COVID-19 në aspektin shëndetësor të fëmijëve, mirëpo akoma nuk është arritur të dihet saktë niveli i ndikimit të tërthortë, e që sipas shumë ekspertëve të fushës, ky ndikim do të jetë me shumë pasoja dhe do të jetë i pranishëm për një kohë të gjatë në jetën e fëmijëve.

Pandemia pa asnjë dyshim ka ndikuar edhe në përkeqësimin e statusit ekonomik, duke e thelluar edhe më tepër hendekun e pabarazisë sociale ndërmjet familjeve. Gjendja ekonomike e familjeve raportohet të jetë rënduar edhe më tej me rrezikun e rritjes së shkallës së varfërisë.

Një aspekt mjaft shqetësues që ka pasur ndikim në jetën dhe në shëndetin e fëmijëve, e sidomos të atyre me aftësi të kufizuar, ka qenë edhe mungesa për periudha të caktuara edhe e barnave esenciale. E sikur të mos mjaftonte vetëm mungesa e këtyre barnave, për shumë prind ka qenë sfidë me rrezikshmëri të lartë edhe siguri i këtyre barnave nëpërmjet mënyrave joligjore.

Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë për pezullimin për një periudhë të caktuar të programit të vaksinimit, ka ndikuar në shtyrjen dhe në vonesat për imunizimin e fëmijëve të porsalindur. Ky proces më pastaj është shoqëruar dhe ka ndikuar edhe në çrregullimin e programit të vaksinimi të rregullt.

Shërbimet sociale edhe pse shumë të nevojshme në kohë pandemie, kanë qenë të kufizuara dhe janë shoqëruar me vështirësi të shumta. Situatën e ka përkeqësuar edhe shpallja me vonesë e granteve të rregullta me të cilat përkrahen ofruarit e shërbimeve sociale. Vonesa janë identifikuar edhe në aspektin e ndarjes së mjeteve tek ofruarit e shërbimeve, e të gjitha këto kanë ndikuar që një pjesë e përfituesve (një numër mjaft i madh janë fëmijë, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara) të këtyre shërbimeve të mbesnin pa shërbime.

Pandemia ka pasur ndikim mjaft të madh edhe në vonesat për zbatimin e agjendës legjislative të Qeverisë dhe të Kuvendit. Disa prej ligjeve që prekin interesin e drejtpërdrejtë të fëmijëve (Ligji për Shërbime Sociale dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal), nuk u arrit të procedoheshin në Kuvend për aprovim, ndonëse ishin draftuar.

Edhe pse nga të dhënat gjatë pandemisë vërehet një ulje e rasteve të privimit nga liria (ndalimit, paraburgimit dhe dënimit me burg), prapëseprapë rreziku për infektim ka qenë i lartë për të miturit që kanë qenë duke vuajtur masën edukuese korrektuese apo dënimin me burg. Kjo pandemi duhet të shërbejë si shembull që politikëbërësit dhe ligjvënësit t'i rishikojnë politikën dhe legjislacionin në mënyrë që të miturve në rrethana të tilla t'u mundësohet lirimi i parakohshëm apo kalimi në ndonjërin prej masave apo dënimeve alternative.

Pandemia ka ndikuar edhe tek fëmijët pa përkujdes prindëror, mirëpo edhe tek fëmijët që kanë pasur përkujdesje prindërore, kjo për shkak të pasojave shëndetësore që kanë mundur përkohësisht apo përherë t'i privonin fëmijët nga përkujdesja prindërore. Fëmijët pa përkujdes prindëror, sikurse fëmijët e tjerë, gjatë kohës së pandemisë në periudha të caktuara kanë qenë të detyruar të qëndronin të izoluar, kanë pasur mungesë të ndërveprimit me bashkëmoshatarë, u janë pezulluar apo ndërprerë kohë pas kohë edhe shërbimet e planifikuara, ka pasur vonesa në zgjidhjen e statusit të tyre ligjor apo kalimit në ndonjë formë tjetër të mbrojtjes.

XIV. E drejta për arsim dhe për aktivitete kulturore gjatë pandemisë

E drejta për arsim është njëra ndër të drejtat të cilat i ka garantuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës për çdo fëmijë pa dallim, si dhe paraqet njërin prej të drejtave dhe të lirive themelore, e cila po ashtu garantohet dhe mbrohet nga konventat dhe nga instrumentet kryesore ndërkombëtare. E drejta kushtetuese për t'u arsimuar shihet si e drejtë dhe detyrë në të njëjtën kohë, ku në njërin anë të gjithë fëmijët gëzojnë mundësinë për t'u arsimuar, e në anën tjetër parashikohen disa detyrime për ta jetësuar këtë të drejtë, detyrime të cilat bien mbi shtetin, mbi prindërit, por dhe mbi vetë fëmijët.

Pandemia COVID-19 ka shkaktuar efekt negativ dhe ka vështirësuar në masë të madhe procesin arsimor dhe gjithashtu ka vështirësuar aktivitetet kulturore në Republikën e Kosovës.

Për shkak të kushteve dhe të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19, MASHTI ka ndërmarrë masa për fillimin e vitit shkollor 2020/21, duke hartuar dokumente të cilat do t'ua lehtësojnë punën institucioneve arsimore, për këtë qëllim janë publikuar udhëzues të ndryshëm, por më i rëndësishëm është Master Plani për Zhvillimin e Mësimit në Kushte Pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës, i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 26 gusht

2020.²⁷⁶ Qëllimi i këtij dokumenti është që të pasqyrohet Projekti për fillimin e mësimit për vitin shkollor 2020 – 2021, me fokus në e-mësimin dhe mësimin në objektet shkollore, përfshirë një Plan të Veprimit dhe Koston e projektuar të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të e-mësimit. Komponentët kryesorë të e-mësimit në Kosovë janë:

1. *“Mësimi në distancë (RTK e YouTube) do të zbatohet (a) për klasat 1-9, (b) për edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) dhe (c) për arsimin për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (ANV)*
2. *Mësimi online (me Zoom, Google Meet / Classroom, dhe Microsoft Office) do të organizohet (a) tërësisht në shkollat e mesme të larta, dhe (b) pjesërisht për klasat 1-9, për EFH dhe ANV (krahas mësimit në distancë).*
3. *Mësimi praktik – praktika profesionale.*
4. *Zhvillimi i mësimit në objekte shkollore.”*

Sipas këtij dokumenti, parashihet që mësimi të zhvillohet sipas Skenarit A: mësimi zhvillohet në shkolla; Skenari B: mësimi i kombinuar (mësim në shkolla dhe mësim në distancë) dhe Skenari C: mësimi online dhe në distancë.

Sipas këtij dokumenti është paraparë: *“Pas llogaritjeve është konstatuar se për një sasi të caktuar do të shtohet vëllimi i punës së mësimdhënësve. . . . Kësaj duhet t’i shtohen pushimet e shtuara që e zgjasin qëndrimin në shkollë dhe përpjekjet e shtuara sepse punohet me dy grupe. Megjithëkëtë, nuk pritet që të shtohet vëllimi i punës më shumë se rreth 10-deri 20 % të normës së përgjithshme të mësimit. Kësaj pastaj duhet t’i shtohet edhe sasia e punës që shtohet për zëvendësimin e mësimdhënësve në gjendje të rëndë shëndetësore dhe të mësimdhënësve të moshuar me sëmundje kronike që po ashtu duhet shmangur kontaktin me numër më të madh të personave në të njëjtën kohë.”²⁷⁷*

Po ashtu, sipas këtij dokumenti parashihet: *“Kompensimi²⁷⁸ i angazhimit mbi normë të mësimdhënësve në vlerë të 1000 + 300 normave për tërë Kosovën, pastaj rreth 100 norma punëtorë teknik, 50 norma pedagogë dhe i 100 norma psikologë.”²⁷⁹*

Gjithashtu, Kushtetuta në nenin 47 [E Drejta për Arsimin] përcakton: *“1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike. 2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”* Njëkohësisht, në nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] përcaktohet: *“1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. 4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me*

²⁷⁶Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, vendimet e mbledhjes, (linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/08/Vendim-nga-mbledhja-e-27-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf>)

²⁷⁷ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Platforma e-mësimi, (linku <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>)

²⁷⁸ Sipas njohurive të përfaqësuesit të IAP-së, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” e ka kompensuar stafin akademik (shih Vendimin Nr. Prot.: 2/952, data 27.11.2020), po ashtu edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes një pakoje mbështetëse për realizimin e mësimit në distancë, i ka kompensuar mësimdhënësit e angazhuar për mësimin në distancë në RTK 4 (shih Vendimin Nr.09/21, të datës 02.04.2020).

²⁷⁹ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Platforma e-mësimi, (linku <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>)

fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”

Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4, përcakton kompetencat e zgjeruara të komunave: *“4.1 Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për atë që ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimitdhënësve dhe administratorëve.”*

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në nenin 1, përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.”*

Neni 3, Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar:

“1. Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim.

2. Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.

3. Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.

4. Gjatë planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore.”

Vendimet e Qeverisë lidhur me sektorin e arsimit në Kosovë gjatë pandemisë

Më 11 mars 2020, sipas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë, me qëllim të parandalimit të pandemisë COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës nxori Vendimin Nr.01/07, ku sipas nenit 1, paragrafi 1.1, përcaktohej: *“Ndërprerja e procesit edukativo-arsimor në institucioneve arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet deri më 27 mars 2020, me rekomandim që të lirohet njëri prind nga puna (kjo masë nuk vlen për punëtorët shëndetësor dhe për punëtorët në sektorin e sigurisë).”*²⁸⁰ Ndërsa sipas paragrafit 1.5 përcaktohej: *“Aktivitetet publike dhe*

²⁸⁰ Kjo masë është ndryshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr.01/16, datë 26.3.2020, sipas të cilit kjo masë është e vlefshme deri në një vendim tjetër.

*jopublike mund të zhvillohen të mbyllura/pa praninë e publikut si: ngjarje/tubime sportive, tubime, koncerte, konferenca, tryeza të rrumbullakëta deri në një vendim tjetër.*²⁸¹

Më 13 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, pas konfirmimit të rasteve të para pozitive me COVID-19, ka nxjerrë Vendimin nr.01/09, sipas të cilit, në paragrafin 7, përcaktohej: *“Pezullohen të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive.”*²⁸²

Më 15 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin nr.01/11, sipas të cilit shpallej emergjenca shëndetësore.²⁸³

Pas kësaj periudhe, në muajin mars 2020, në bazë të nenit 5, pikat 1.3 dhe 1.4, të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në zbatim të Vendimit 01/07, i datës 11.3.2020, MASHTI vendosi të fillonte zbatimin e mësimit online në të gjitha institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Në përputhje me këtë vendim, nga data 30 mars 2020, MASHTI vendosi përfshirjen edhe të shkollave të arsimit të mesëm të lartë profesional dhe të qendrave të kompetencës. Zbatimi i mësimit online kishte për qëllim sigurimin e shërbimeve arsimore dhe realizimin e kurrikulës në përputhje me kushtet e krijuara në rrethana të pandemisë COVID-19.

Më 30 mars 2020, MASHTI publikoi informata lidhur me përdorimin e platformës Zoom, si platformë e cila ofronte shërbime për takime në distancë dhe mund të përdorej për zhvillimin e procesit mësimor. Po ashtu MASHTI ka nxjerrë Udhëzimin për Drejtoritë Komunale të Arsimit për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta profesionale (ShML) dhe për qendrat e kompetencës, si dhe ka përcaktuar Detyrat dhe Përgjegjësitë për Realizimin e Mësimit në Distancë.

Më 4 prill 2020, është publikuar orari javor i transmetimit në RTK 4 për klasat 1-9, me këtë është filluar mësimi në distancë, i cili përmes emisioneve ka zgjatur për klasat e nivelit 1-5 nga gjysmë ore mësimi, ndërsa për klasat 6-9 është mbajtur në kohëzgjatje prej një ore.

Më 14 prill 2020, MASHTI ka nxjerrë Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit (DKA) dhe për qendrat burimore për realizimin e mësimit në distancë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Më 24 prill 2020, MASHTI ka nxjerrë edhe Udhëzuesin për Vlerësimin e Nxënësve në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID-19, si dhe Vendimin Ref:25/01B, i datës 24.4.2020, për procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Duke konsideruar situatën me pandeminë, në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), në muajin maj 2020 MASHTI ka nxjerrë Informata, Udhëzime dhe Rregulla për Kandidatët (maturantët), për provimin e Maturës Shtetërore, i paraparë për datën 4 korrik 2020.

²⁸¹ Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, vendimet e mbledhjes (linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>)

²⁸² Po aty.

²⁸³ Po aty.

Po ashtu, në muajin maj 2020 është nxjerrë edhe Udhëzuesi për organizimin dhe administrimin e testit të arritshmërisë 2020, i paraparë për datën 23 qershor 2020. Vlen të përmendet se nga ky test janë liruar nxënësit me nevoja të veçanta, të cilët janë arsimuar me Planin Individual të Arsimit; dhe ata me fusha të aktiviteteve. Ndërsa E-mësimi i transmetuar përmes emisioneve në Radiotelevizionin e Kosovës ka vazhduar deri në përfundimin e kalendarit shkollor.

Në muajin qershor 2020, IKShPK publikoi Manualin për Mbrojtje nga Përhapja e Virusit COVID-19, me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve nga përhapja e infektimit me virus. Manuali shërben si udhëzues i përkohshëm për aplikimin e masave mbrojtëse për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në institucionet publike dhe private.

Udhëzuesi përmban informata të përgjithshme lidhur me përhapjen e COVID-19, mënyrën e parandalimit të infeksionit, klasifikimin e ekspozimit të punëtorëve ndaj COVID-19 si dhe masat mbrojtëse për veprimtaritë e lejuara në fazën e dytë të hapjes graduale të ekonomisë.

Ky manual përmban udhëzime për fushat e ndryshme të cilat paraprakisht janë analizuar nga profesionistët shëndetësorë.

Më 11 shtator 2020, MASHTI ka nxjerrë Vendimin nr.01/B-101 për fillimin e mësimin në vitin e ri shkollor 2020/2021 në kushte pandemie, sipas të cilit faza e parë fillonte më 14 shtator 2020, mësimin e fillonin të gjithë fëmijët e klasës parafillore dhe nxënësit e klasave 1, 2, 3, 6, 10 në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës. Klasat 4 dhe 5 vijonin mësimin në shkollë (sipas Skenarit A) ose si mësim i kombinuar (skenari B - mësim në distancë dhe mësim online), varësisht nga kapaciteti i shkollës, në përputhje me vlerësimin e taskë-forcës së DKA-së dhe të institucioneve arsimore.

Ndërsa faza e dytë fillonte më 21 shtator 2020, mësimin e fillonin nxënësit e klasave 7, 8, 9 të arsimit të mesëm të ulët dhe të klasave 11 dhe 12 të arsimit të mesëm të lartë. Nxënësit vijonin mësimin dy ditë në javë në objekte shkollore dhe tri ditë në formë të mësimin online dhe në distancë ose një organizim tjetër sipas vlerësimin të menaxherit të shkollës.

Më 20 prill 2021, me qëllim të organizimit të mësimin plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë COVID-19, MASHTI ka nxjerrë Vendimin nr.01B/22, sipas të cilit përcaktohej se mësimi plotësues do të implementohej në nivelin I, II dhe III të arsimit parauniversitar.

Më 5 prill 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr.01/05, sipas të cilit parashihet që në institucionet publike dhe private në punë të paraqitet vetëm stafi i cili kryen shërbime esenciale (paragrafi 6), për institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar obligohen të organizojnë mësimin sipas udhëzimeve të MASHTI-t, ndërsa institucionet parashkollore dhe fillore vazhdojnë aktivitetin normalisht, duke i respektuar masat dhe rekomandimet kundër COVID-19 (paragrafi 16).

Po ashtu, sipas këtij vendimi, sa i përket arsimit të lartë, lejohet mbajtja e provimeve me prezencë fizike, por duke u respektuar masat dhe distanca fizike dhe duke u bërë ndarja në grupe nga 10 persona (paragrafi 17).

Sa u përket institucioneve vartëse të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sportit si dhe komunave, teatrot, bibliotekat, filarmonitë, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë,

qendrat e kulturës, lejohen të punojnë nga ora 5.00 deri në orën 21:00 duke shfrytëzuar 20% të hapësirës/sipërfaqes (paragrafi 34). Po ashtu u lejuan aktivitetet sportive për qëllime profesionale pa prezencë të publikut (paragrafi 35).

Më 18 prill 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin nr.01/07, sipas të cilit parashihet që në institucionet publike dhe private në punë të paraqitet vetëm stafi esencial (paragrafi 4), ndërsa për punonjësit të cilët nuk janë staf esencial, obligohen punëdhënësit të krijojnë kushte për kryerjen e detyrave të punës nga shtëpia (paragrafi 6), po ashtu, punëtorët shtatzëna duhet të lirohen nga obligimi për t'u paraqitur në punë, duke ua krijuar mundësinë që të punojnë nga shtëpia (paragrafi 7). Institucionet e arsimit të të gjitha niveleve të arsimit vazhdojnë mësimin sipas udhëzuesit përkatës për sektorin e arsimit. Sipas paragrafi 35, institucionet vartëse të MKRS-së lejohen të punojnë duke shfrytëzuar 30% të hapësirave.

Më 28 maj 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr.04/14, sipas të cilit sa u përket institucioneve të arsimit, nuk ka ndonjë ndryshim të masave, i vetmi ndryshim është tek institucionet vartëse të MKRS-së të cilat lejohen të punojnë duke shfrytëzuar 50% të hapësirave.

Më 22 qershor 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin nr.17/16, sipas të cilit, meqenëse situata epidemiologjike me COVID-19 paraqitet e qëndrueshme në Kosovë, nuk ka ndonjë ndryshim sa u përket institucioneve arsimore dhe institucioneve vartëse të MKRS-së, i vetmi ndryshim është tek aktivitetet garuese në hapësira të jashtme sportive të cilave u lejohet prania e shikuesve deri në 15% të kapaciteteve të objektit.

Vendimet e cekura më lart kanë pasur ndikim të madh edhe në realizimin e së drejtës për arsim. Nga mbyllja e përgjithshme dhe vendimi për mbylljen e shkollës janë afektuar në total 345.540 nxënës që kanë qenë duke e ndjekur vitin akademik 2019/2020.

Pas mbylljes së detyrueshme të të gjithë sistemit arsimor në Republikën e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me ndihmën e partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, arriti të zhvillonte dhe të ofronte mësimin nëpërmjet sistemit të mësimin në distancë, nëpërmjet këtyre formave:

1. Platformën E-Mësimi – platforma kryesore online e transmetuar nga kanali publik RTK.
2. Platformën e edukimit në fëmijërinë e hershme - edukimi në distancë – kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 – 6 vjeç.
3. Platforma e mësimin në distancë për fëmijët me nevoja të veçanta – Arsimi gjithëpërfshirës.
4. Platforma e mësimin E-shkollari – Platformë e mësimin për fëmijë për klasat 1-9.

Tri platformat e para janë ofruar për fëmijët në katër gjuhë: shqip, serbisht, turqisht dhe boshnjakisht. Përkundër rezultateve të treguara, mësimi në distancë i ofruar përmes platformave online dhe aktiviteteve përcjellëse të organizuara nëpërmjet aplikacioneve online (Zoom, Teams, Skype etj) u shoqërua edhe me sfida dhe vështirësi, e të cilat nuk ishin të pakta dhe pa ndikim. Këto sfida cenuan kohë pas kohë të drejtën e fëmijës për arsim, kjo për faktin se jo të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë kishin mundësi të vijonin mësimin në distancë,

sepse disa nga ta kishin mungesë interneti, mungesë të pajisjeve elektronike (telefon, tablet apo PC desktop), e disa nga ta edhe mungesë të hapësirës fizike në hapësirat ku banonin (sidomos tek rastet e familjeve që kishin dy apo më tepër nxënës). Gjendja më e rëndë sigurisht ka qenë tek fëmijët me aftësi të kufizuar, për shkak të nevojave të veçanta dhe kufizimeve për të përdorur apo për t'u qasur në platformë, si dhe fëmijët nga komunitetet: rom, ashkali dhe egjiptian.

Nga vlerësimi i shpejtë i ndikimit ekonomik të realizuar nga UNDP-ja, UN Women dhe nga UNFPA-ja tregon që 96% e pjesëmarrësve në anketë kanë pohuar se fëmijët e tyre kanë pasur mundësi të pjesëmarrjes në mësimin në distancë, ndërsa 4% kanë pohuar se fëmijët e tyre nuk kanë qenë në gjendje ta ndiqnin mësimin në distancë. Megjithëse një numër i vogël (4%) i të anketuarve pohuan se fëmijët e tyre humbën mësimin në distancë, mund të ketë pasur një ose disa arsye për këtë. Në këtë drejtim, kur u pyetën se cilat ishin arsyet e humbjes së mësimin në distancë, 30% pohuan se më shumë se një fëmijë duhej të përdorte të njëjtën pajisje, 21% u mungonte lidhja në internet, 17% nuk kishin pajisje, 13% nuk kishin sinjal televiziv, 3% nuk dinin se si t'i qaseshin mësimin në distancë, dhe 3% pohuan se një anëtar tjetër i familjes kishte nevojë për pajisje për të punuar nga shtëpia dhe kështu nuk ishin në gjendje t'i huazonin pajisjet për fëmijët. Ata 23% të cilët cituan arsye të tjera, thanë se cilësia e mësimin nuk ishte e mirë, mësuesi nuk e mbajti orën mësimore, fëmija shkon në shkollë speciale për fëmijë me nevoja të veçanta, dhe, në një rast, ata thjesht thanë se nuk ndoqën mësimin në distancë megjithëse kanë pajisjet e nevojshme teknike. Sidoqoftë, duhet të theksohet se mostra e përgjithshme e këtyre përgjigjeve është shumë e vogël, kështu që faktorët që parandalojnë qasjen në mësimin në distancë duhet të analizohen më tej me kujdes.

Këto sfida dhe pabarazi në mësimin në distancë theksohen edhe në raportin e UNICEF-it: *“Qasja në mësimin në distancë përgjatë pandemisë COVID-19 është larg për të qenë e barabartë. Privimi nga mundësitë e të mësuarit gjatë kohës së COVID-19 kërkon përdorimin e mjeteve alternative siç janë platformat dixhitale të të mësuarit, mjetet teknologjike, librat dhe angazhimi i drejtpërdrejtë me fëmijët e tyre në mënyrë që të mbështesin të mësuarit në shtëpi. Megjithatë, qasja në teknologji dhe materialet e nevojshme për të vazhduar mësimin ndërsa shkollat janë të mbyllura është jashtëzakonisht e pabarabartë. Familjet më të pasura janë përgjithësisht më të afta për të ruajtur të mësuarit e fëmijëve të tyre, pasi ka më shumë të ngjarë të pajisen më lehtë me teknologji, lidhje interneti, libra, si dhe njohuri dhe kohë për të ndihmuar mësimin e fëmijëve të tyre. Fatkeqësisht, ky nuk është rast për çdo fëmijë.”*

Në përputhje me qëllimin e cekur më lart dhe në vazhden e vizitave të Avokatit të Popullit dhe të zyrtarëve nga Institucioni i Avokatit të Popullit tek institucionet dhe organizata e caktuara, ata kanë realizuar vizita shtesë.

Vizitat dhe intervistat e realizuara nga IAP-ja

Më 16 mars 2021, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituar Qendrën Burimore (QB) për mësim dhe këshillim “Përparimi” në Prishtinë. Qëllimi i vizitës ishte të informoheshin më për së afërmi me punën e kësaj qendre, veçmas gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Përfaqësuesja e QB-së “Përparimi” i ka informuar përfaqësuesit e IAP-së, ndër të tjera, se ofrojnë: Mësim dhe këshillim për arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me dëmtime të rënda dhe të shumëfishta, nga njësia e shkollës speciale për fëmijë me dëmtime të rënda dhe të shumëfishta brenda

institucionit, e cila përshin tri nivele arsimore; njësia e shërbimeve të mbështetjes, e cila ofron mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në institucionet parauniversitare. Tutje ajo i ka informuar edhe për sfidat me të cilat ballafaqohet qendra e që ndërliiden kryesisht me buxhetin e limituar, mungesën e stafit rehabilitues si logoped, fizioterapeut dhe ergoterapist.

Më 1 qershor 2021, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituar Qendrën Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda” në Pejë. Qëllimi i vizitës ishte njohja më për së afërmi me punën e kësaj qendre, veçmas gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Përfaqësuesi i kësaj qendre i ka informuar përfaqësuesit e IAP-së se ndër të tjera, ofrojnë: Arsim special për nxënësit e verbër; rehabilitim dhe akomodim në konvikt të QBMK-së; integrim dhe mbështetje në shkollat e rregullta; mbështetje dhe këshillim në familje dhe në institucione parashkollore; trajnime për mësimdhënës, prindër dhe personelin që punon me fëmijë të verbër. Ndërsa ndër sfidat me të cilat ballafaqohet kjo qendër janë përmendur: identifikimi i plotë i fëmijëve të kategorizuar nga Komisioni mediko-social i grup-moshëse 0-18 vjeç, trajtimi i fëmijëve të verbër dhe me dëmtime të shumëfishta (përfshirja e tyre në sistem arsimor, ngritja e kapaciteteve profesionale e stafit në QBMK, përmirësimi i infrastrukturës së akomodimit të tyre në konviktin e Qendrës Burimore), sinteza vokale e cila siguron qasje në arsimim për të gjithë personat e verbër përmes teknologjisë informative, organizimi i shërbimeve në terren për mbështetje në integrim për nxënës të arsimit parauniversitar (materiale në brail, orientim dhe mobilitet, trajnime për stafin në shkolla të rregullta, pajisje tiflodidaktike, ngritje e vetëdijes për prindër etj.) Moskoordinimi ndërsektorial mes ministrive përkatëse për sigurimin e mjeteve tiflo-teknike dhe tiflo-pedagogjike gjithashtu u përmend si sfida.

Më 1 qershor 2021, Avokati i Popullit me përfaqësuesit e zyrës regjionale të IAP-së kanë vizituar Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Prizren. Qëllimi i vizitës ishte që të njihen më për së afërmi me punën e kësaj qendre, veçmas gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Përfaqësuesi i kësaj qendre i ka dërguar informata shtesë përfaqësuesit të IAP-së lidhur me punën që ka bërë dhe është duke bërë, veçmas në kohën e pandemisë, si dhe i ka informuar për shërbimet që i ofron kjo qendër: Identifikim, mbështetje, këshillim, mësimdhënie. Ndërsa si sfida me të cilat ballafaqohet kjo qendër ka përmendur: Mungesa e trajnimeve në formën fizike; mungesa e teknologjisë, përgatitja për përdorimin; mungesa e asistentëve, e infrastrukturës (sallë e sportit etj.).

Më 1 qershor 2021, Avokati i Popullit ka vizituar Qendrën Burimore “Lef Nosi” në Prizren. Qëllimi i vizitës ishte njohja më për së afërmi me punën e kësaj qendre, veçmas gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Përfaqësuesja e kësaj qendre i ka dërguar informata shtesë përfaqësuesit të IAP-së për punën që ka bërë dhe është duke bërë, veçmas në kohën e pandemisë, si dhe i ka informuar që kjo qendër ofron këto shërbime: Mësim dhe këshillim për fëmijët me dëmtime të rënda intelektuale dhe të shumëfishta. Ndër to ka përmendur se për qendrën në fjalë: *“Sfidë kryesore është numri i madh i nxënësve me dëmtime të rënda intelektuale e të shumëfishta në krahasim me stafin arsimor si dhe mungesa e profesionistëve (Psikologut, Logopedit, Fizioterapeutit, Pedagogut.) si dhe numri i asistentëve mbështetës për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.”*

Më 1 qershor 2021, përfaqësuesi i IAP-së ka vizituar Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë. Qëllimi i vizitës ishte njohja më për së afërmi me punën e kësaj qendre, veçmas

gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Kjo qendër, pos të tjerash, e informoi përfaqësuesin e IAP-së për punën që ka bërë dhe është duke bërë, veçmas në kohën e pandemisë, si dhe e informoi për shërbimet që i ofron kjo qendër: Edukimi dhe arsimimi i fëmijëve me dëmtime intelektuale. Tutje ajo theksoi edhe sfidat me të cilat ballafaqohet kjo qendër: “*Numri i vogël i mësimdhënësve udhëtues; Mungesë e automjetit për të dal në teren; Qendra ka vetëm Psikolog për momentin; Duhet edhe shumë kuadro rrahilituese për një zhvillim të mirëfilltë të Qendrës.*”

Përdorimi i teknologjisë ua ka lehtësuar shumë nxënësve dhe studentëve realizimin e së drejtës për arsim. Mirëpo kjo qasje ishte më pak efektive për nxënësit që nuk kishin në dispozicion infrastrukturën e duhur digjitale ose shkathtësitë e duhura për të përdorur pajisjet teknologjike.

Kur një nxënës/student nuk ka kompjuter ose internet, të cilat nevojiten për t’ju qasur mësimin online apo në distancë, ose nëse atyre u mungojnë njohuritë e teknologjisë informative për të marrë pjesë, kjo shkurton të drejtën e tyre për arsimim në masë të atillë sa që e drejta privohet nga çdo efektivitet.

Prandaj kur arsimi ofrohet kryesisht përmes platformave digjitale, mund të ketë ndikim diskriminues mbi të drejtën për qasje në arsim për personat nga grupet me gjendje të rëndë ekonomike, ata të cilët jetojnë në zona rurale, nxënësit të cilët jetojnë në një ambient shtëpiak më pak të përshtatshëm për mësim në shtëpi, familjet me më shumë se një nxënës apo student, nxënësit të cilët janë në vuajtje të dënimeve në qendrat korrektuese të Kosovës. Këto probleme janë më të theksuara në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku nxënësit kanë më pak qasje në pajisjet teknologjike dhe në lidhjet me internet.²⁸⁴

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t’i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është domosdoshmëri e kohës dhe duhet të respektohet nga të gjithë.

Të drejtën e arsimit, Kushtetuta e garanton si të drejtë të përgjithshme të njeriut që e gëzon çdo person (neni 47, paragrafi 1). Po ashtu Kushtetuta i garanton çdo personi mundësi të barabarta të shkollimit në bazë të nevojave dhe të aftësive individuale, që do të thotë se në realizimin e së drejtës së arsimit nuk lejohet të ketë kurrfarë diskriminimi (neni 47, paragrafi 2). Këtë

²⁸⁴ Banka Botërore, “*Impakti Ekonomik dhe Social i Covid-19*”, 2020. Ky raport gjen se mesatarisht në Ballkanin Perëndimor, rreth 60% e familjeve kanë internet me shpejtësi të mjaftueshme (definiuar si 10 mbps dhe më lart) për të ndjekur mësimin online. 10 mbps është më e ulët sesa standardi i pranueshëm në BE (30 mbps), duke përdorur kutin matës të BE-së, shumica e familjeve në rajon nuk janë të pajisura me internet me shpejtësi të madhe. Rreth 22% e nxënësve të Ballkanit Perëndimor raportojnë se kanë pak ose aspak qasje në internet në shtëpi, në krahasim me 1% në BE27. Mesatarisht, një në dhjetë familje me nxënës në shtëpi në Ballkanin Perëndimor nuk kanë kompjuter; në Shqipëri kjo shkon deri në 28%; në Kosovë, sipas informatës së pranuar nga Qeveria, por edhe sipas Master Planit të MASHTI-t, 4% e nxënësve në Kosovë nuk kanë mundësi ta ndjekin mësimin online ose mësimin në distancë, (linku: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>)

dispozitë kushtetuese e përmbajnë më tutje ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, të cilat parashohin që në zbatimin e të drejtave dhe të obligimeve të veta, qeveria, ministritë dhe komunat duhet t'i respektojnë të drejtat e fëmijëve, duke u mundësuar arsimin dhe mësimin në pajtim me dispozitat ligjore dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në kuptim të dispozitës së nenit 2 të Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se e drejta për arsimim u ofron individëve të drejtën për të pasur qasje efektive në institucionet arsimore që ekzistojnë, si dhe përcakton se shtetet nuk mund të mohojnë të drejtën për arsimim në institucionet arsimore dhe se nga kjo e drejtë përfitojnë fëmijët dhe të rriturit të cilët shteti ka obligim që t'i mbrojnë nga keqtrajtimi.

Po ashtu sipas nenit 14 të Konventës përcaktohet se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia etnike, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Nëse nxënësit nuk i ofrohet mbështetje, çështja e tillë mund të japë shkas për shkelje të nenit 14, lidhur me nenit 2 të Protokollit 1, mosdiskriminimi është parim themelor kur përcaktohet se si shteti do t'i kryejë obligimet e veta lidhur me qasjen gjithëpërfshirëse në arsim, shteti e ka detyrim organizimin e nevojshëm dhe të duhur për mënyrën si ofrohet arsimi, të përmirësojë pabarazitë faktike të cilat janë të pajustificueshme e rrjedhimisht përbëjnë diskriminim.

Masat e ndërmarra në kuadër të luftës kundër pandemisë, si dhe garantimi i përfshirjes dhe qasja e barabartë në mundësitë për mësim në distancë, mund të ngrenë pyetje në lidhje me pasojat e tyre potenciale diskriminuese.²⁸⁵

Gjatë pandemisë ka pasur kufizime ndaj së drejtës për arsimim, mirëpo këto kufizime nuk do të duhej ta cenonin të drejtën për arsimim në thelbin e saj apo ta zhveshnin atë nga efektiviteti. Kufizimet duhet të jenë të parashikuara me ligj dhe të ndjekin një qëllim të drejtë, edhe pse nuk ekziston ndonjë numërim shterues i “qëllimeve të drejta” në fushën e nenit 2 të Protokollit nr. 1 (*Leyla Şahin k. Turqisë*, § 154).

Avokati i Popullit vëren se duke u bazuar në dispozitat ligjore në Kosovë, por edhe në instrumentet ndërkombëtare, e drejta për arsim nuk është e drejtë absolute dhe se mund të kufizohet, mirëpo, të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

Të gjitha institucionet e pushtetit publik e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës të së drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

Avokati i Popullit, vlerëson se mbrojtja e shëndetit të nxënësve, studentëve dhe stafit punonjës të institucioneve arsimore, si dhe qytetarëve në përgjithësi nga përhapja e sëmundjeve ngjitëse,

²⁸⁵ Komisioni Evropian, “*Sondazh në shkollë: TIK-u në arsim*”, (linku: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/survey-schools-ict-education>).

është qëllim legjitim në synimin e të cilit e drejta për arsim mund të kufizohet për mbrojtjen e shëndetit.

Arsimi parauniversitar

Në komunikimet e Avokatit të Popullit me udhëheqësit e DKA-ve theksohet se vështirësitë kryesore që paraqiten janë mungesa e pajisjeve teknologjike informative, por edhe përgatitja e pamjaftueshme e mësimit dhe e nxënësve për përdorimin e teknologjisë.

Për më tepër, DKA-ja ka theksuar se Qeveria me vendimet e veta e ka kryer punën e saj dhe ka menaxhuar me pandeminë në formën më të mirë të mundshme në krahasim me kushtet me të cilat përballen. Por të njëjtët nuk janë pajtuar me vendimin me të cilën Qeveria ka liruar gratë shtatzëna nga procesi mësimor dhe të njëjtat janë zëvendësuar me studentë të universitetit publik, gjë që ka shkaktuar edhe rënien e mësimit në të gjitha shkollat e vendit. Po ashtu DKA-ja ka theksuar se në shumicën e komunave, nxënësve u kanë munguar pajisjet teknologjike dhe për këtë arsye edhe kanë humbur mësimin. Komuna e Graçanicës në dy raste ka furnizuar nxënësit me pajisje teknologjike, po ashtu ka pranuar edhe një donacion nga UNMIK-u. Në komunën e Gjakovës po ashtu ka pasur mungesë të pajisjeve teknologjike, kjo mungesë sidomos është vërejtur tek fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë, te nxënësit me kushte të vështira sociale si dhe te fëmijët me nevoja të veçanta. Në komunën e Mitrovicës së Jugut ka pasur furnizime nga MASHTI dhe nga donatorët, edhe përkundër kësaj ka pasur mungesa dhe disa nxënës kanë humbur mësimin në periudhat kur mësimi është organizuar sipas Skenarit C. Në komunën e Lipjanit ka pasur mungesa, DKA-ja, në bashkëpunim me biznese të ndryshme, UNMIK-un dhe UNICEF-in, kanë siguruar pajisje të ndryshme teknologjike, të cilat u janë shpërndarë nxënësve.

Nga komuna e Prizrenit është pranuar përgjigje: *“Në fillim të vitit shkollor një pjesë e nxënësve nuk kanë pasur pajisje teknologjike, dhe me identifikimin e nxënësve që nuk kanë pasur pajisje është bërë e mundur që me ndihmën e MASHTI-it, DKA-së dhe organizatave të ndryshme të bëhet i mundur furnizimi i nxënësve përmes donacioneve të dhuruara. Në mënyrë të veçantë janë furnizuar me pajisje teknologjike nxënësit e komunitetit vulnerabël, si dhe nxënësit me nevoja të veçanta, nxënësit e familjeve që janë raste sociale e kështu me radhë.”*

Po ashtu DKA-ja ka theksuar se sa i përket mësimit ka pasur mungesa të nxënësve dhe të mësimit për shkak të pandemisë, mirëpo orët e humbura janë zëvendësuar. Mungesat kanë qenë periodike dhe se nga puna ka munguar stafi në afate të shkurtra. Ndërsa sipas komunës së Prizrenit: *“Në të gjitha institucionet shkollore të komunës së Prizrenit për një periudhë të shkurtër, nuk kanë pasur qasje në mësimin online 175 nxënës për shkak të mungesës së pajisjeve teknologjike, mungesës së përdorimit të mjeteve teknologjike dhe qasjes në internet në zona të caktuara.”* Në të njëjtën kohë komunat kanë theksuar se orari i mësimit është shkurtuar dhe se kjo normalisht ka ndikuar në procesin mësimor. Ndërsa mësimit kanë punuar me orar të zgjatur nuk janë kompensuar.

Lidhur me zëvendësimet e mësimit nga studentë vullnetarë të Universitetit të Prishtinës, DKA-ja është përgjigjur: *“Studentët nuk janë të kualifikuar sipas UA – normativit të MASHTI-t për të mbajtur procesin mësimor dhe besoj se ky vendim i qeverisë ka qenë i ngutshëm, sepse mësimit të cilat janë liruar nga procesi mësimor nuk kanë qenë të*

infektuara (sipas shënimeve që i disponojmë nga shkolla) si dhe është fakt notor ajo që një student për atë kohë sa ka mundur që t'i përmbush nevojat për mësim. Në disa raste zëvendësimet janë bërë nga studentët e fakultetit të edukimit në bashkëpunim me mësimdhënësit përkatës.”

Rrjedhimisht, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për lirim të punonjëseve shtatzëna kishte rëndësi të veçantë për mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës, ndërsa zëvendësimi i mësimdhënëseve shtatzëna me studentë të Fakultetit të Edukimit ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore.²⁸⁶

Po ashtu, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, institucionet edukativo-arsimore obligohen të kërkojnë kuadro sipas këtij udhëzimi administrativ (neni 2), si dhe parashihen kriteret e kandidatëve të cilët mund të pranohen si mësimdhënës të kualifikuar (neni 10, paragrafi 1).

Duke u bazuar në këto dispozita, Avokati i Popullit vëren se angazhimi i studentëve për pozitat në të cilat ka pasur mundësi të angazhoheshin kandidatët e kualifikuar, të cilët i plotësonin kriteret sipas udhëzimit administrativ, ishte në kundërshtim me dispozitat e udhëzimit administrativ, pasi vetëm kandidatët të cilët i plotësonin kriteret e parapara konsideroheshin të kualifikuar për lëndët përkatëse, ndërsa eventualisht ndonjë pozitë për të cilën nuk mund të sigurohej kandidat i kualifikuar sipas udhëzimit administrativ, ka pasur mundësi të angazhoheshin studentë për një periudhë të caktuar kohore, por gjithnjë duke i shterur kërkesat për punësimin e personave të kualifikuar.

Po ashtu DKA-ja ka theksuar se mësimi plotësues është mbajtur në të gjitha nivelet e arsimit dhe se ka ndihmuar në arritjen e rezultateve për nxënës të cilët kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e COVID-19, duke shtuar se ngecjet e nxënësve kanë qenë evidente për shkak të rrethanave të krijuara nga COVID-19, puna praktike për zhvillimin e mësimin për nxënës të shkollave profesionale ka qenë e vështirë të realizohej.

Në lidhje me ndikimin e pandemisë sipas niveleve të arsimit, është pranuar përgjigje se pandemia ka ndikuar në të gjitha nivelet, por më së shumti të nxënës të niveleve 1-5 dhe 10-12.

Të pyetur nëse gjatë vlerësimit të nxënësve a kanë hasur në vështirësi, përgjigjja ka qenë se kanë pasur vështirësi në vlerësimin e nxënësve, arsyeja kryesore është thënë se disa nxënës kanë zhvilluar mësimin online, disa me prezencë në shkollë, mirëpo nuk ka ndonjë ankesë të pranuar lidhur me vlerësimin e nxënësve.

Trajtimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

Arsimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kushte normale është proces kompleks dhe kërkon resurse njerëzore të specializuara dhe materiale adekuate që t'u përgjigjen nevojave individuale

²⁸⁶ Neni 35, paragrafi 3, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar përcakton: “Autoritetet që bëjnë emërimet, siç përcaktohet në këtë ligj, krijojnë procedura të drejta, të hapura dhe transparente për angazhim bazuar në kualifikimet dhe nevojat e postit.” Po ashtu, sipas paragrafit 5 të këtij neni, parashihet: “... kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësoj ky emërim. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet për kualifikim të përcaktuar në këtë ligj, mund të bëhet një emërim i përkohshëm. ...”

të fëmijëve. Këtij kompleksiteti i shtohet edhe vështirësia e mësimit në distancë pasi kërkon ndër të tjera shkathtësi digjitale nga ana e mësimitdhënësve, e prindërve dhe e nxënësve.

Sipas DKA-së, trajtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë periudhës së pandemisë ka qenë përgjegjësi e mësimitdhënësve, e atyre mbështetës dhe e asistentëve të fëmijëve me nevoja të veçanta, ku përveç që u kanë siguruar tabletët, mësimitdhënësit në fjalë kanë qenë mjaft të përkushtuar në arritjen sa më të mirë të një mësimi cilësor. Po ashtu nxënësit me nevoja të veçanta janë trajtuar njëjtë sikurse edhe nxënësit e tjerë, MASHTI ka shpërndarë pajisje teknologjike për ta. Gjatë kohës së pandemisë, MASHTI ka nxjerrë udhëzime se si të organizohet mësimi online për fëmijët me nevoja të veçanta, duke dërguar materiale të mësimitdhënësit dhe të nxënësit me nevoja të veçanta. Po ashtu nxënësve me nevoja të veçanta u janë shpërndarë tablete falas. Këto kanë ndikuar që nxënësit me nevoja të veçanta ta kenë më të lehtë zhvillimin e mësimit online në kohë pandemie.

Lidhur me trajtimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, IAP-ja ka marrë përgjigje nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas të cilës: *“Sa i përket Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19 MASHTI ndanë këto të dhëna:*

Në fushën e arsimit janë përgatitë udhëzues të veçantë për menaxhimin e pandemisë për fëmijët me nevoja të veçanta. Po ashtu edhe në kuadër të udhëzuesve për të gjitha institucionet edukativo arsimore janë dhënë edhe instruksione të veçanta për nxënësit me nevoja të veçanta sipas niveleve.

MASHTI gjatë periudhës së pandemisë ka lancuar Platformen “arsimi gjithëpërfshirës”- me mbështetjen e organizatës “Save the children”. Platforma është bërë me qëllim të ofrimit të mundësive për zhvillim socio-emocional dhe njohës të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Platforma ofron aktivitete mësimore për fëmijë dhe materiale ndihmëse për prindër/kujdestarë ligjor, mësimitdhënës dhe asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta. Përveç aktiviteteve mësimore, platforma ofron informata dhe materiale ndihmëse lidhur me qasjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, metodat bazike, vlerësimin dhe informata tjera të rëndësishme për zhvillimin social, emocional dhe psikofizik të fëmijës. Linku i platformës <http://arsimigjithepershires.rks-gov.net/>

Angazhimi i 35 asistenteve për periudhën kohore dhjetor–mars 2021 në komunat Prishtine, Fushe Kosove, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj . Asistentet janë angazhuar në komunat ku nuk ka të punësuar asistente dhe nevojat janë të mëdha.

Pajisja e nxënësve me mjete teknologjike- gjatë vitin 2020-2021 janë shpërndarë 958 tablete për fëmijët me nevoja të veçanta që kanë probleme ekonomike. Prej tyre 632 janë dhënë nga UNICEF dhe 326 i Save the children. Pajisje janë dhuruar edhe për qendrën burimore për nxënësit me dëmtime në të pamur (Makina për shkrimin brail – Tetra Point

Llaptop lenovo I5 cope, Monitorë zmadhues 4cope , Llupë zmadhuese për tavolinë, dore, syza për caktimin e dioptrisë së syve dhe shkopa të bardhë për të verbër.”

Sipas statistikave të pranuar nga MASHTI, lidhur me numrin e përgjithshëm të nxënësve të cilët nuk e kanë ndjekur mësimin nga distanca, del se gjatë vitit shkollor 2019/2020, në Kosovë

nuk e kanë ndjekur mësimin 9070 nxënës, prej këtij numri 7573 ishin nxënës me mësim në gjuhën shqipe, ndërsa të tjerët ishin nxënës të komuniteteve të tjera. Nga ky numër, 325 nxënës ishin nxënës me nevoja të veçanta dhe 60 nxënës të cilët vijnë në mësimin në qendrat burimore.

Nga këto përgjigje vërehet se gjatë pandemisë ka pasur një angazhim të shtuar për përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta nga institucionet publike, sidomos angazhimi i asistentëve, por edhe furnizimi me mjete teknologjike ishte i një rëndësie të veçantë, mirëpo edhe përkundër këtij angazhimi, duke u bazuar edhe në statistikat e MASHTI-t, ekziston nevoja për përkrahje të vazhdueshme për këto kategori të nxënësve.

Trajtimi i personave në vuajtje të dënimit

Sipas informatave të pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK), në ShKK në arsimin parauniversitar vijnë në mësimin gjithsej 56 nxënës, në shkollën e mesme të ulët (klasat VI-IX) janë 6 nxënës, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë (klasat X-XII) janë 47 nxënës, po ashtu në arsimin e lartë janë 3 studentë të cilët vijnë në studimet në universitete.

Në paralelen e ndarë të ShFMU “Ismajl Luma”, procesi mësimor është zhvilluar sipas kalendarit shkollor, nuk ka pasur vështirësi të theksuara, mësimi është mbajtur online, nxënësit janë pajisur me mjete teknologjike dhe nuk ka pasur asnjë nxënës i cili ka përsëritur vitin për shkak të mungesës së pajisjeve teknologjike. Ndërsa në ShMT “Rudina”, paralele e ndarë e ShMT “Mithat Frashëri”, mësimi online nuk është mbajtur për shkak të mungesës së kabinetit të informatikës dhe të mosfurnizimit të nxënësve me pajisje teknologjike.

Duke u bazuar në këtë përgjigje, institucionet publike kanë dështuar t’i furnizonin nxënësit me pajisje teknologjike, dhe si rezultat i këtij dështimi, nxënësve u është mohuar qasja në arsim dhe u është mohuar e drejta për trajtim të barabartë sikurse nxënësit e tjerë.

Arsimi i lartë

Sa i përket ndikimit të pandemisë në arsimin e lartë, është pranuar një raport nga Universiteti Publik “Kadri Zeka” (UKZ) në Gjilan, i cili është përgatitur sipas kërkesës së MASHTI-t dhe përshkruan organizimin e mësimin online nga shfaqja e pandemisë deri në muajin prill 2021.

Në këtë raport thuhet: *“Si pasojë e gjendjes së krijuar me pandeminë COVID-19, Universiteti “Kadri Zeka”, në bazë të vendimit nr.01/371 të datës 20.03.2020, procesin mësimor në UKZ, në të gjitha njësitë akademike, e organizon në formë online, në përputhje me Udhëzuesin për përdorimin platformave online. Për të mundësuar zhvillimin e mësimin virtual, në UKZ përdoren platformat SMU, meet.google.com; Google Classroom dhe platforma Moodle e UKZ-së e-learning.”*

Periodha e parë nga data 20.03.2020 deri më datën 31.05.2020, është mbajtur mësimi online, periodha e dytë nga data 02.11.2020 deri më datën 06.02.2021, Senati i UKZ-së, në mbledhjen XIII të mbajtur më 12.10.2020, mori vendim që mësimi të mbahej në klasë dhe pjesërisht online, bazuar në Udhëzuesin për organizimin e procesit mësimor, i miratuar nga Senati i UKZ-së duke respektuar Masat e IKShPK-së për mbrojtjen nga COVID-19.

Pak ditë më vonë, bazuar në vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, i datës 31.10.2020, për masat antiCOVID-19, Senati i UKZ-së mori vendim (nr.01/11703 më 02.11.2020) që mësimi në UKZ të organizohej vetëm në formë online, ndërsa ushtrimet praktike, laboratorike,

konsultimet, provimet dhe kollokfiumet të mbaheshin në prani fizike duke respektuar rekomandimet e MSh-së.

Periodha e tretë nga data 17.03.2021 deri më datën 17.04.2021, përfshin semestrin veror të vitit të ri akademik 2020/2021, në të cilin gjendja e pandemisë COVID-19 vinte duke u keqësuar. Për këtë arsye, menaxhmenti i UKZ-së, në përputhje me Vendimin nr.01/63 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 11.02.2021, si dhe në zbatim të “Manualit për mbrojtje nga përhapja e COVID-19”, në mbledhjen e Kolegjiumit të Dekanëve, më 15.03.2021, mori vendim: *“Ligjëratat në të gjitha programet studimore ku nuk ka kushte për mësim në klasë të organizohen online. Ushtrimet praktike, laboratorike, konsultimet, provimet dhe kollokfiumet të mbahen në prani fizike duke respektuar Manualin për mbrojtje nga COVID-19.”*

Duke u bazuar në këto informata, si pasojë e pandemisë, në arsimin e lartë është mbajtur mësimi online, gjithnjë duke i zbatuar vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Manualin për mbrojtje nga përhapja e COVID-19.

Kultura, rinia dhe sporti

Me shfaqjen e pandemisë, hapësirat e teatrove, bibliotekat, orkestrat, galeritë, baleti, ansamblet, kinematë, qendrat rinore, qendrat e kulturës, muzetë, nuk mund t'i shfrytëzonin hapësirat, qofshin ato të hapura apo të mbyllura. Aktivitetet kulturore e artistike të ndikuara nga pandemia, kaluan në formatin digjital. Mosmbajtja e aktiviteteve kulturore ka sjellë shumë pasoja për artistët të cilët ende sot vazhdojnë të presin për një rifillim të jetës së tyre artistike në mënyrën qysh e kanë praktikuar gjithmonë.

Me mbylljen e institucioneve kulturore u pezulluan shumica e aktiviteteve që zhvilloheshin në kuadër të tyre. Që nga data 13 mars 2020, kur sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës,²⁸⁷ pezulloheshin të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive, nga mbyllja e tërësishme e deri në qershor, shikuesit mbetën pa shfaqje.

Transmetimi i shfaqjeve, që nga 12 qershori, bëri që publiku të përballlet me një “teatër digjital”. Më 5 prill 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr.01/05, sipas të cilit institucionet vartëse të MKRS-së lejoheshin të punonin duke shfrytëzuar 20% të hapësirës/sipërfaqes (paragrafi 34). Ndërsa nga data 18 prill 2021, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet vartëse të MKRS-së lejoheshin të punonin duke shfrytëzuar 30% të hapësirave, ndërsa sipas vendimit të datës 28 maj 2021, aktivitetet kulturore lejohen të punojnë duke shfrytëzuar 50% të hapësirave. Duke u bazuar në këto vendime, masat kufizuese, varësisht nga situata epidemiologjike, vazhdimisht janë lehtësuar.

Përfaqësuesi i IAP-së vizitoi Drejtorinë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, në komunën e Gjilanit, ku u informua se edhe përkundër rrethanave të rënduara nga pandemia, të gjitha aktivitetet e parapara nga drejtorja janë realizuar në formën elektronike.

IAP-ja po ashtu pranoi edhe Raportin e Punës për vitin 2020, nga Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në komunën e Ferizajt. Në raport përshkruhen të gjitha aktivitetet e realizuara, sukseset, sfidat dhe vështirësitë gjatë vitit 2020. Pas shfaqjes së pandemisë, disa aktivitete kulturore të planifikuara u anuluan, disa u shtynë për kohë të pacaktuar dhe disa aktivitete

²⁸⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr.01/09.

filluan të mbaheshin në formatin online. Natyrisht se për shkak të pandemisë asgjë nuk ishte si më parë.

XV. Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit i rekomandon:

Qeverisë së Republikës së Kosovës:

1. Të rritet buxheti për nevojat e ShSKUK-së dhe të MSh-së, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.
2. Të hartojë aktet nënligjore në pajtim me nenin 20 të Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës.
3. Qeveria ta realizojë një studim në nivel kombëtar për të kuptuar saktë dëmin dhe pasojat e shkaktuara nga pandemia në shëndetin mendor të fëmijëve.
4. Qeveria duhet të hartojë dhe të zbatojë një plan gjithëpërfshirës të përkrahjes së fëmijëve në përgjithësi, e të atyre me aftësi të kufizuara në veçanti, për shërbimet shëndetësore të garantuara me ligj, duke u fokusuar edhe në programet e rehabilitimit, të terapive psiko-sociale, të imunizimit, të ushqyeshmërisë cilësore, të ndihmës ndaj prindërve.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera përgjegjëse të hartojnë politika mbështetëse për të gjithë punëtorët që kanë humbur vendet e punës, duke përfshirë edhe sigurimin e mbështetjes financiare për të gjithë të papunët.
6. Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë dhe institucionet e tjera të sigurojnë qasje dhe përkthim adekuat të informacionit në lidhje me COVID-19 në kohën e duhur, në gjuhët zyrtare.

Ministrisë së Shëndetësisë:

7. Të ndërmarrë masa për trajtimin adekuat të personave të sëmurë kronikë psikiatrikë dhe me aftësi të kufizuara psiko-sociale, në pajtim me ligjin dhe me standardet e të drejtave të njeriut.
8. Të ndërmarrë masa dhe të intensifikojë monitorimin e qasjes së barabartë në përkujdesje për personat e sëmurë kronikë psikiatrikë dhe me aftësi të kufizuara psiko-sociale gjatë pandemisë.
9. Të sigurojë qasje në të gjitha informatat që i publikon në lidhje me situatën e pandemisë COVID-19 për personat me aftësi të kufizuara, në gjuhën e kuptueshme të tyre.

Ministrisë së Drejtësisë:

10. Vendimet për kufizime të të drejtave të të burgosurve të kenë mbështetje dhe bazë ligjore në dispozitat e LESP-së dhe në Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

11. Komunikimi i të burgosurve përmes SKYPE dhe mjeteve të tjera online duhet të rregullohet me akte konkrete juridike.
12. Kontakti dhe komunikimi me avokatin mbrojtës të garantohet edhe në kohë pandemie dhe të sigurohet që ky kontakt të vazhdohet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.
13. Të hartohet Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës në Familje që do të shërbente si udhërrëfyes për uljen dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.
14. Të planifikohen dhe të ndahen mjete të veçanta financiare për mbështetjen e fushatave për parandalimin e dhunës në familje dhe trajtimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje në periudhë pandemie.

Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve:

15. Ministria e Financave të ndërmarrë masa dhe sa me shpejt të bëhen pagesat e mbetura lidhur me subvencionet e punëtorëve dhe të qirasë për bizneset që ende nuk janë ndihmuar, ose që ende nuk kanë marrë përgjigje në kërkesat dhe në aplikacionet e tyre.

Këshillit Prokurorial të Kosovës:

16. Të rishikojë Planin e Veprimit për Menaxhimin e Krizës (i datës 29 maj 2020), duke dhënë udhëzime të qarta për prioritetin e rasteve që prokurorët duhet t'i trajtojnë gjatë kohës së pandemisë COVID-19

Inspektoratit të Punës:

17. Inspektorati i Punës, në zbatim të Ligjit të Punës, për sigurinë në punë, të shtojë kontrollin lidhur me respektimin e të drejtave të të punësuarve në sektorin privat, në veçanti për të punësuarit që kanë qenë të liruar për paraqitje në punë, sipas vendimeve të qeverisë për mbrojtje nga pandemia COVID-19.

Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit:

18. Ministria e Arsimit të hartojë strategji për kompensimin e mësimin të humbur, kthimit në proces mësimor të fëmijëve që për arsye të masave antiCOVID nuk kanë marrë pjesë në procesin e shkollimit ose kanë braktisur shkollimin si dhe ndërmarrjen e masave parandaluese kundër COVID-19.
19. Të angazhohet që sa më parë të bëhet digjitalizimi i shkollave.
20. Të rritet numri i asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, gjithnjë duke u bazuar në kërkesat e komunave.

Agjencisë për Informim dhe Privatësi:

21. Agjencia për Informim dhe Privatësi të publikojë udhëzues për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19.

Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës:

22. Ministria në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së, të dizajnojë plan veprimi për funksionimin e mekanizmave mbikëqyrës/inspektorateve në rrethana pandemie.